SCfSD
Scientific Challenges for Sustainable Development

INTERNATIONAL
UNIVERSITY OF STRUGA

UNIVERSITETI I
GJIROKASTRËS
Universiteti Eqrem Çabej

BOOK OF PROCEEDINGS

SCfSD '26

Scientific Challenges for Sustainable Development

Thirteenth International Scientific Conference
Struga , May 22nd

www.iust.edu.mk

ISBN-978-608-4573-57-9

INTERNATIONAL UNIVERSITY OF STRUGA

Institute for European Studies and International Politics
"Luan Hajdaraga"

ISBN 978-608-4573-57-9

SCfSD

Scientific Challenges for Sustainable Development

INTERNATIONAL UNIVERSITY OF STRUGA

UNIVERSITETI I GJIROKASTRËS
Universiteti Eqrem Çabej

BOOK OF PROCEEDINGS

13th International Conference

"Scientific Challenges for Sustainable Development"- SCfSD '26

SCIENTIFIC COMMITTEE

Prof. Dr. Armen Kadriu – International University of Struga
Prof. Dr. Biljana Ciglovska-Bojcevska – International University of Struga
Prof. Dr. Sejfulla Osmani – International University of Struga
Associate Prof. Merita Isaraj – "Eqrem Çabej" University, Gjirokastër
Associate Prof. Sadik Malo – "Eqrem Çabej" University, Gjirokastër
Associate Prof. Lorenc Koçiu – "Eqrem Çabej" University, Gjirokastër
Associate Prof. Valbona Duri – "Eqrem Çabej" University, Gjirokastër
Prof. Dr. Adrian Civici – Mediterranean University of Albania
Prof. Dr. Greta Angjeli – Mediterranean University of Albania
Prof. Dr. Ljupco Stojceski – International University of Struga
Prof. Dr. Mersim Maksuti – International University of Struga
Prof. Dr. Gëzim Selimi – International University of Struga
Prof. Dr. Gazmend Beshi – International University of Struga
Prof. Dr. Nazmije Merko Zabzun – International University of Struga
Prof. Dr. Emin Huseini – International University of Struga
Prof. Dr. Elior Vila – International University of Struga
Prof. Dr. Senada Laçka – International University of Struga
Prof. Dr. Guximtar Rushani – International University of Struga
Prof. Dr. Vehbi Ramaj – "Haxhi Zeka" University, Peja
Prof. Dr. Małgorzata Szynkowska-Jóźwik – Lodz University of Technology
Associate Prof. Dr. Agnieszka Czylkowska – Lodz University of Technology
Prof. Dr. Paweł Strumiłło – Lodz University of Technology
Prof. Dr. Edit Bregu – Mediterranean University of Albania
Prof. Dr. Festim Halili – State University of Tetova
Prof. Dr. Elez Osmani – Institute for Scientific Research and Development, Ulcinj
Prof. Dr. Fatmir Memaj – University of Tirana
Associate Prof. Dr. Skerdian Kurti – University of Tirana
Prof. Dr. Skender Topi – "Aleksander Xhuvani" University, Elbasan
Associate Prof. Dr. Besnik Hajdari – "Isa Boletini" University, Mitrovica

ORGANIZING COMMITTEE

Doc. Dr. Shemsije Demiri – International University of Struga
Doc. Dr. Rudina Kaja – International University of Struga
Doc. Dr. Driton Haruni – International University of Struga
Doc. Dr. Lirinda Vako – International University of Struga
Doc. Dr. Dorian Leka – International University of Struga
Doc. Dr. Semra Bujari – International University of Struga
Eng. Dominik Leżański – Lodz University of Technology
Associate Prof. Mimoza Zeka – "Eqrem Çabej" University, Gjirokastër
Associate Prof. Ilirjana Zyberi – "Eqrem Çabej" University, Gjirokastër
Dr. Daniela Qiqi – "Eqrem Çabej" University, Gjirokastër
Associate Prof. Antoneta Pollo – "Eqrem Çabej" University, Gjirokastër
Dr. Dhori Terpo – "Eqrem Çabej" University, Gjirokastër
Dr. Zhenisa Çuni – "Eqrem Çabej" University, Gjirokastër
MSc. Abidin Trena – International University of Struga
MSc. Eriona Dauti – International University of Struga

CONFERENCE SECRETARIAT

MSc. Edona Amiti Abaz – International University of Struga
MSc. Denisa Hani – International University of Struga
MSc. Edita Asllani – International University of Struga

TABLE OF CONTENTS

IMPAKTI I INOVACIONEVE TEKNOLOGJIKE NË TREGJET FINANCARE (RAST STUDIMI: ONLINE BANKING ITALI DHE SHQIPËRI) 11
Doc.Dr. Semrah Bujari 11
SFIDAT SHKENCORE PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM NË FUSHËN E KITARËS KLASIKE 27
PhD Cand. Dashamir Mehmeti 27
GJYKIMET E POSACME DHE RENDESIA E TYRE NE TE DREJTEN PENALE 39
Msc.Av.Endri Fejzullah 39
Msc. Klejvis Hoxha 39
ME MENDJE E ME NUMRA – JO VETËM ME DUAR 63
Madrit ZHAKU, PhD. Cand. 63
ROLI I PROCEDURAVE KOMBËTARE NË GARANTIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE QASJA NË GJYKATËN EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT 78
Prof.Dr. Senada Laçka 78
EFIKASITETI I INVESTIMEVE KAPITALE NË RMV NË BAZË TË BUXHETIT 2019-2026 95
Prof.Dr. Gëzim Selimi 95
Phd. Candidate Arbana Selimi Sadiku 95
PAVARËSIA ENERGJETIKE DHE NDIKIMI I SAJ NË RRITJEN EKONOMIKE: RASTI I SHQIPËRISË 108
Doc. Dr. Gazmend Beshi Dekan i Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, Maqedonia e VeriutNEkspert-Finance/Fiskalitet/Kontabilitet/Mjedis Dhe Auditues Mjedisor 108
PËRSHTATSHMËRIA TEMATIKE E KRIJIMEVE LETRARE NË LIBRAT E LEXIMIT TË KLASAVE I-III NË KOSOVË 123
Msc. Ferdane Shala 123
GLOBAL TRADE UNDER PRESSURE: ECONOMIC IMPLICATIONS OF THE IRANIAN CONFLICT 140
Biljana Ciglovska Bojchevska 140
Nazmije Merko Zabzun 140

PRIMARY EDUCATION TEACHERS' PERCEPTIONS REGARDING THE STIMULATING ENVIRONMENT AND CLASSROOM CLIMATE 153
PhD Cand. Fatjeta Ahmeti - Ajvazi [1] 153
JURIDIKSIONI I GJYKATAVE SHQIPTARE NË ÇËSHTJET ME OBJEKT ZGJIDHJE MARTESE ME ELEMENT TË HUAJ 164
Msc. Av. Enea Bushi 164
EDUKIMI PËR QYTETARINË DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM NË EVROPË: SFIDAT DHE MUNDËSITË 180
PhD Cand. Lavdie Hoxha Universiteti ”Shën Kliment i Ohrit”, lavdie_zymeri@hotmail.com 180
FINANCING OF TERRORISM AND THE ROLE OF FINANCIAL INSTITUTIONS IN ITS PREVENTION..... 197
Phd Cand. Orlinda Sinanaj 197
NDIKIMI I BUXHETIT TË RMV-SË NË ZHVILLIMIN EKONOMI (RAST STUDIMOR PERIUDHA 2020-2025)..... 217
Prof.Dr. Gëzim Selimi 217
Mr.Sc. Hasime Durmishi 217
ROLI I PROVAVE FORENZIKE NË PROCEDURËN PENALE 228
Prof. Dr. Emin Huseini 228
Doc. Dr. Robert Dauti 228
MSc. Abidin Trena 228
ROLI I DIPLOMACISË NË PARANDALIMIN E KONFLIKTEVE NDËRKOMBËTARE 239
MSc.Djellza Lena 239
BUSINESS ETHICS AND COMMERCIAL COMMUNICATION - A STUDY ON DISCRIMINATORY ADVERTISING AND CONSUMER LEGAL PROTECTION 252
PhD Cand. Manjola Islamaj 252
MSc. Magistrate Irena Plaku 252
MSc. Magistrate Matilda Çela 252
THE IMPACT OF PHONE USE ON THE PHYSICAL ACTIVITY OF HIGH SCHOOL STUDENTS 263
PhD Cand. Albin Ajvazi 263

NDIKIMI I KORRUPSIONIT NË ZHVILLIMIN EKONOMIK DHE INVESTIMET E HUAJA NË MAQEDONINË E VERIUT: ANALIZË JURIDIKE DHE EKONOMIKE 272
Edita Arslllani 272
TRANSLATION, IDENTITY, AND GLOBAL CITIZENSHIP IN THE 21ST CENTURY..... 291
Dr. Rozeta Bici 291
ENGLISH FOR SPECIFIC PURPOSES: BUSINESS, DIPLOMACY, AND TECHNOLOGY 305
Msc.Reis Kerim 305
Msc. Arjeta Isaku 305
SANKSIONET PENALE NË TË DREJTËN ISLAME DHE KRAHASIMI I TYRE ME KODIN PENAL TË R. MAQEDONISË SË VERIUT 317
Prof. Dr. Emin Huseini 317
BURNOUT DHE EDUKIMI LIGJOR PUBLIK (MBROJTJA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE E STUDENTËVE – SPORTISTË) 333
Doc. Dr. Dorian Leka 333
Klea Kodra 333
STUDIMI I NDËRVEPRIMIT DHE HARMONIZIMIT TË PËRBËRËSVE KYÇ TË SISTEMIT TË BURIMEVE NJERËZORE NË BIZNESET E MËDHA TË QARKUT TË KORÇËS 348
Assoc. Prof. Dr. Sonela Stillo 348
VENDIMMARRJA NË KUSHTET E SITUATAVE KRITIKE368
Dr. Adriatik TAFÇIU 368
THE INSTITUTION OF CIVIL LIABILITY ARISING FROM NON-PECUNIARY DAMAGE UNDER THE LEGISLATION OF THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA 387
Prof.Dr. Shemsije Demiri 387
Prof.Dr. Driton Haruni 387
Doc.Dr. Rudina Kaja 387
DEEPFAKE DHE DEZINFORMIMI DIGJITAL: SFIDA TË REJA PËR SHOQËRINË MODERNE 395
Msc. Denisa Hani (d.hani@eust.edu.mk) 395

AI-DRIVEN DECISION MAKING IN STRATEGIC MANAGEMENT: ENHANCING BUSINESS PERFORMANCE THROUGH INTELLIGENT ANALYTICS IN ALBANIA AND NORTH MACEDONIA 405
Doc.Dr. Lirinda Vako Abedini 405
Prof.Dr. Armen Kadriu 405
BROKERAGE WITHIN THE FINANCIAL SYSTEM..... 424
MSc Blaze Srbinovski 424
FRANCHISING IN INTERNATIONAL BUSINESS..... 441
MSc. Granita Bunari Ferati 441

IMPAKTI I INOVACIONEVE TEKNOLOGJIKE NË TREGJET FINANCARE (RAST STUDIMI: ONLINE BANKING ITALI DHE SHQIPËRI)

Doc.Dr. Semrah Bujari

s.bujari@eust.edu.mk - Interational University of Struga

Abstrakt

Globalizimi dhe teknologjia ka pasur një ndikim të thellë në zhvillimin dhe rritjen e shpejtë të tregtisë elektronike. Rritja e përdorimit të internetit dhe përparimi i vazhdueshëm i teknologjisë kanë krijuar mundësi të mëdha për organizatat, duke i mundësuar atyre të zgjerojnë operacionet dhe aktivitetet tregtare në tregje globale. Integrimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) ka transformuar rrënjësisht mënyrën se si organizatat ndërveprojnë brenda dhe me palët e jashtme të interesuara. Avancimet teknologjike shihen si komponent te rendesishem te zhvillimit ekonomik. Inovacionet kontribuojne në nxitjen e rritjes, uljen e kostove dhe kohes. Përdorimi i teknologjisë për të transformuar dhe përmirësuar proceset financiare njihet si teknologjia financiare ose 'Fintech'. Ajo përfshin një gamë të gjerë produktesh dhe platformash dixhitale që shfrytëzojnë teknologji të avancuara si blockchain, analizat e të dhënave të mëdha dhe inteligjencën artificiale. Objektivi kryesor i këtij studimi është vlerësimi i mundësive të implementimit të teknologjisë në sistemin bankar, si dhe analiza e ndikimit të saj në dinamikën e konkurrencës, sigurinë dhe eficencen ne kohe. Ky punim ofron një kuptim të thellë të evoluimit të financave dhe rolit të e-banking në ofrimin e shërbimeve për klientët dhe bizneset. Studimi synon të kuptojë avantazhet dhe sfidat e e-banking krahasuar me bankingun tradicional, duke eksploruar gjithashtu nivelin e menaxhimit të rrezikut në ruajtjen e sistemeve dhe të dhënave të IT brenda platformave bankare online.

Fjalë kyçe: Teknologji, Tregje financiare, e-banking, klient, biznese

Hyrje

Teknologjia ka krijuar lehtesira për t'u menaxhuar dhe aksesuar te dhenat financiare përmes platformave dixhitale, duke mundësuar një menaxhim më efikas të informacionit financiar dhe realizimin e transaksioneve pa pasur nevojë për vizita në degët fizike. Transfertat virtuale kanë transformuar mënyrën e kryerjes së transaksioneve financiare, duke i bërë ato më të shpejta dhe më të sigurta, me përmirësime të vazhdueshme në sigurinë e sistemeve të këtyre teknologjive. Në sektorin e shërbimeve financiare, adoptimi i teknologjive të avancuara, veçanërisht në sektorin bankar, është bërë gjithnjë e më i rëndësishëm. Për më tepër, në përgjigje të udhëzimeve të shëndetit publik, minimizimi i kontaktit fizik është shfaqur si një strategji kryesore për të luftuar pandeminë COVID-19. Kjo ka përshpejtuar adoptimin e kanaleve bankare elektronike, duke ofruar një alternativë të sigurt dhe efikase ndaj ndërveprimeve tradicionale bankare personalisht.

Teknologjia dhe tregjet financiare

Ndikimi i teknologjise në tregjet financiare është shumëdimensional. Teknologjia ofron mundësi të jashtëzakonshme për automatizimin e shërbimeve financiare dhe rritjen e efikasitetit të tregjeve, duke ndihmuar gjithashtu në krijimin e modeleve të reja të biznesit dhe zhvillimin e produkteve financiare inovative. Megjithatë, përdorimi i teknologjive të avancuara sjell edhe sfida dhe pasiguri, përfshirë rreziqet ndaj sigurisë kibernetike, ndikimin në punësimin e fuqisë punëtore dhe nevojën për rregullim të përshtatshëm të tregjeve. Ky mund të jetë një faktor i rëndësishëm për politikat e punës dhe për të ruajtur balancën mes avancimeve teknologjike dhe mbrojtjes së interesave të punonjësve (Acemoglu, 2021).

Teknologjia ka bërë hapa të shpejtë dhe të pandalshëm në industrinë financiare gjatë dy dekadave të fundit, duke transformuar mënyrën se si funksionojnë tregjet financiare dhe si menaxhohen transaksionet dhe investimet (McKinsey, 2023; Deloitte, 2022). Analiza e të dhënave dhe automatizim i proceseve financiare kanë krijuar rritjen e efikasitetit dhe saktësisë në vendimmarrje (Brynjolfsson & McAfee, 2020).

Financat, Fintech dhe Cloud kanë pësuar zhvillime të rëndësishme në vitet e fundit. Këto inovacione kanë krijuar mundësi për zhvillimin e produkteve të reja financiare, si dhe për rritjen e aksesit në shërbimet financiare për individët dhe bizneset që më parë nuk kishin mundësi për t'u angazhuar në tregje financiare të avancuara (Deloitte, 2022; McKinsey, 2023).

Disa nga arritjet kryesore përfshijnë:

Sistemet për banking dhe pagesa online: Bankingu online, që ka filluar në vitet 1990, ka ndryshuar mënyrën se si bëhen transaksionet financiare. PayPal, i krijuar në 1998, revolucionarizoi tregtinë elektronike dhe mënyrën e pagesave online.

Kuletat celulare dhe bankat (Mobile wallets and banking): Aplikacionet e bankingut celular, si Google Wallet (2011), lehtësuan pagesat përmes telefonave inteligjentë, duke rritur aksesin dhe gjurmueshmërinë në biznes.

Huadhënie nga kolegët: Platforma si Zopa (2005) dhe LendingClub (2006) lejuan lidhjen direkte të huamarrësve dhe huadhënësve, duke ofruar kushte më të mira dhe duke përshpejtuar procesin e huadhënies.

Kriptovalutat dhe Blockchain: Bitcoin (2009) dhe blockchain kanë mundësuar transaksione të decentralizuara, duke ofruar transparencë dhe siguri në financa dhe mbajtjen e të dhënave.

Platformat crowdfunding: Kickstarter (2009) dhe Indiegogo (2008) revolucionarizuan mbledhjen e fondeve, duke lidhur zhvilluesit me mbështetës globalë dhe duke ofruar mundësi financimi për projekte dhe organizata jofitimprurëse.

AI dhe Machine Learning në financë: Teknologjitë si AI dhe mësimi i makinave kanë automatizuar procese si zbulimi i mashtrimit dhe shërbimi ndaj klientit, duke përmirësuar menaxhimin e rrezikut dhe efikasitetin brenda departamenteve financiare.

Sistemi banker dhe inovacionet

Industria bankare ka përjetuar ndryshime të shpejta në vitët e fundit, të cilat reflektojnë zhvillime të rëndësishme. Një nga faktorët kryesorë ka qenë avancimi në teknologjinë e komunikimit dhe informacionit, që ka përshpejtuar dhe zgjeruar shpërndarjen e informacionit financiar, duke ulur gjithashtu kostot e aktiviteteve të shumta financiare. Një tjetër shtysë kyçe ka qenë rritja e konkurrencës midis një spektri të gjerë institucioneve vendase dhe të huaja, që ofrojnë shërbime bankare dhe financiare. Po ashtu, aktiviteti financiar është rritur në krahasim me aktivitetin e përgjithshëm ekonomik në shumicën e ekonomive. Këto zhvillime kanë pasur ndikim të madh në strukturën institucionale dhe sistematike të sektorit financiar, sidomos atë bankar. Letrat me vlerë që emetohen drejtpërdrejt kanë filluar të zëvendësojnë depozitat bankare si mjet kursimi. Tregjet për rrezikun kanë krijuar mundësi për të blerë dhe shitur ekspozime ndaj rreziqeve të tregut ose kredisë, veçmas nga asetet financiare bazë. Gjithashtu, profili i biznesit të institucioneve financiare është në ndryshim. Shërbimet tradicionale të bankave tani ofrohen gjithashtu nga institucione jo-bankare, ndërkohë që bankat janë përfshirë gjithashtu në aktivitete që nuk janë të natyrës bankare. Bashkimet dhe blerjet e institucioneve më të vogla kanë çuar në krijimin e konglomerateve transnacionale, të cilat ofrojnë një gamë shërbimesh, nga ato të bankave komerciale tradicionale deri tek bankat investuese dhe sigurimet (Abdelsid. A and Jiuma. I 2022).

Zhvillimi i E-banking

Bankat në te gjithë botën duke ndjekur tendecat e fundit dhe për tiu përgjigjur kerkesave dhe nevojave të klientëve kanë adoptuar shërbimet online. Shërbimet online kanë nisur në Nju Jork në vitin 1981 kur katër nga bankat kryesore të qytetit (Citibank, Chase Manhattan, Chemical and Manufacturers Hanover) prezantuan shërbimet bankare online duke përdorur sistemi videotex (Cronin, 1997). Për shkak të dështimit komercial të videotex, këto shërbime bankare nuk u bënë kurrë popullore me përjashtim të Francës ku përdorimi i videotekstit (Minitel) u subvencionua nga ofruesi i telekomit dhe MB, ku është përdorur sistemi Prestel.

Kjo ka përmirësuar ndjeshëm qasjen dhe efikasitetin e shërbimeve financiare, duke mundësuar klientëve realizimin e transaksioneve dhe

menaxhimin e llogarive të tyre në një mënyrë më të shpejtë, më të thjeshtë dhe më të përshtatshme.

Këto sisteme jo vetëm që lehtësojnë transaksionet, por gjithashtu i kursejnë kohë klientëve. Gjatë viteve, bankat kanë investuar në mënyrë të konsiderueshme në infrastrukturën e internetit, duke transformuar faqet e thjeshta të internet bankingu në platforma të avancuara e-banking. Këto portale ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh përtej bankingu tradicional, duke mundësuar që klientët të kenë akses në kështilla financiare dhe të menaxhojnë llogaritë e tyre me lehtësi. Për një e-banking të suksesshëm, është thelbësore të fokusohet në tërheqjen e klientëve të rinj dhe mbajtjen e atyre ekzistues (Reibstein, 2002; Reichheld dhe Schefter, 2000). Për të ndërtuar besnikërinë e klientëve, platformat e e-banking duhet të përqendrohen në plotësimin e kërkesave të rritura dhe zhvillimin e klientëve, të nxitura nga konkurrenca e fortë në industrinë e bankingut online (Jun dhe Cai, 2001).

Bankingu online, i njohur gjithashtu si internet banking, e-banking ose virtual banking, është një sistem pagese elektronik që mundëson klientëve të një banke ose institucioni financiar të kryejnë një gamë të gjerë transaksionesh financiare përmes faqes së internetit të institucioneve financiare. E-banking është një shërbim global që mundëson banking në çdo kohë, nga kudo dhe në çdo mënyrë (Abdelsid. A and Jiuma. I 2022). Ai ofron një gamë të gjerë funksionesh dhe avantazhesh ndaj metodave tradicionale bankare. Ky sistem zakonisht lidhet ose është pjesë e sistemit të brendshëm bankar të drejtuar nga një bankë dhe është një alternativë ndaj bankimit në degë, që përfaqëson mënyrën tradicionale të aksesimit të shërbimeve bankare nga klientët.

Pagesat elektronike në Shqipëri

Pagesat me karta bankare janë bërë një praktikë shumë e zakonshme dhe mbizotëruese në shumë vende të zhvilluara, Raporti i fundit i Bankës Botërore tregon një shqetësim në lidhje me përdorimin e pagesave dixhitale në Shqipëri, ku vendi ka përqindjen më të ulët të popullsisë mbi 15 vjeç që përdor këto pagesa. Në vitin 2021, vetëm 35% e popullsisë në këtë grupmoshë kishte përdorur pagesa dixhitale, një rritje e vogël krahasuar me 29% që ishte në vitin 2017. Në krahasim, vendet e tjera të rajonit, si Kosova,

Bosnja, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, kanë bërë hapa më të shpejtë në këtë drejtim. Kosova, për shembull, kishte 48% të popullsisë mbi 15 vjeç që përdorte pagesa dixhitale në vitin 2021, një rritje e dukshme krahasuar me 39% në vitin 2017. Përdorimi i pagesave dixhitale në Bosnje ishte 67%, në Maqedoninë e Veriut 74%, dhe në Serbi 87%.

Banka Botërore thekson se pagesat dixhitale po bëhen gjithnjë e më të përhapura në Ballkanin Perëndimor, por që ka ende shumë punë për të bërë. Ajo nënvizon se këto teknologji janë të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomive të rajonit, pasi lejojnë që aktivitetet financiare dhe ekonomike të zhvillohen në mënyrë më të shpejtë, të sigurt dhe më të përshtatshme. Përdorimi i pagesave dixhitale përfshin mjete dhe kanale të ndryshme, si bankat elektronike, kartat debit dhe kredit, si dhe para elektronike (e-money).

Zhvillimin e teknologjisë dhe rritjen e besimit të konsumatorëve në sistemet elektronike të pagesave. Në vendet si Italia, Greqia dhe Gjermania, ku pagesat me karta përbëjnë përqindje të larta të vëllimit total të shitjeve dhe blerjeve, kjo tregon për një kalim të ndjeshëm nga përdorimi i parave fizike në ato elektronike.Përveç kësaj, faktori i përparësisë teknologjike dhe lehtësia e përdorimit të kartave bankare për blerje online ose përmes terminaleve të POS-it, ka kontribuar në këtë rritje. Po ashtu, pandemia e COVID-19 ka nxitur përdorimin e pagesave elektronike për të minimizuar kontaktet fizike, gjë që ka sjellë një rritje të mëtejshme të përdorimit të kartave bankare.Në Shqipëri gjithashtu, është vënë re një rritje e madhe e përdorimit të kartave bankare, siç tregohet nga rritja duke arritur një shifër prej 34.9 miliardë lekësh (ose 290 milionë euro). Ky është një sinjal se po bëhet një kalim gradual drejt një shoqërie pa para fizike, dhe përdorimi i kartave dhe mënyrave të tjera të pagesave elektronike do të vazhdojë të rritet.

Referuar Bankës Shqipërisë pagesat elektronike jane sfide por qe sjellin perfitime për të gjithë gruper e interesit[1]. Statistikat e Bankës së Shqipërisë tregojnë se rezultojnë mesatarisht dy karta për person, pra mbi 600 mijë persona, ose një në pesë qytetarë të vendit kanë dhe përdorin karta bankare. Numri i përgjithshëm i kartave bankare vijon të dominohet nga kartat e debitit, të lidhura me llogaritë rrjedhëse të qytetarëve, të cilat

[1] Bankat_ne_epoken_e_internetit_3242_1_6803.pdf

përbëjnë rreth 86 për qind të totalit. Në Shqipëri është rritur ndjeshëm edhe numri i ndërmarrjeve që disponojnë pajisje elektronike për pranimin e pagesave me karta bankare.

Në vitin 2022, Italia mori një hap të rëndësishëm për të luftuar evazionin fiskal duke miratuar një ligj të ri që detyronte bizneset të pranonin pagesat elektronike, duke u vënë gjoba për ata që refuzonin pagesat me kartë bankare. Ky ligj parashikon një gjobë administrative prej 30 eurosh për bizneset që refuzojnë pagesën elektronike, përveç një shume shtesë prej 4% të vlerës së transaksionit që është refuzuar.Kjo masë u miratua në fillim të korrikut 2022, pas kërkesës dhe shqetësimeve që kishin ngritur autoritetet italiane për evazionin fiskal të lartë. Fillimisht, Italia kishte planifikuar ta bëjë ligjin detyrues deri në fund të vitit 2022, por ndikuar nga shqetësimet për rritjen e evazionit, ajo e miratoi më herët.

Një kërkesë për një ligj të ngjashëm është ngritur edhe në Shqipëri për disa vite nga Shoqata Shqiptare e Bankave. Kjo ka ardhur si rezultat i përpjekjeve për të përmirësuar sistemin financiar dhe luftuar evazionin fiskal. Shoqata ka propozuar që bizneset në Shqipëri të detyrohen të pranojnë të paktën një mënyrë alternative pagese, përveç përdorimit të parave fizike, me qëllim që të sigurohet transparenca dhe të reduktohet mundësia e evazionit. Kjo kërkesë përforcohet nga zhvillimet e vendeve të tjera, si Italia, ku masat e tilla janë marrë me sukses për të rritur përdorimin e teknologjisë dhe të pagesave elektronike. Qeveria per vitin 2025 do të marre masa ne lidhje me pagesat cash, dhe evazionin fiskal e nxitur dhe nga futja në SEPA.

Integrimi i Shqipërisë në SEPA nxit pagesat elektronike

Zona e vetme e pagesave në euro (SEPA) është një iniciativë e Bashkimit Evropian që ka për qëllim të krijojë një treg të vetëm për pagesat elektronike në euro në të gjitha shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet që kanë marrë pjesë në këtë zonë, si dhe të lehtësojë dhe standardizojë procedurat e pagesave. Kjo iniciativë synon të mundësojë që individët dhe bizneset të bëjnë transferime dhe pagesa në euro, pavarësisht nga vendi ku ndodhen, në një mënyrë të shpejtë, të sigurt dhe të lirë[2].

[2] The Single Euro Payments Area explained | European Payments Council

Shqipëria ka bërë një hap të rëndësishëm drejt integrimit me Bashkimin Evropian me anëtarësimin e saj në skemën e Pagesave në Euro (SEPA) më 21 nëntor 2024. Ky është një zhvillim historik që pasqyron përpjekjet e shumta të vendit për të përafruar sistemet dhe rregulloret e tij të pagesave me standardet e BE-së. Procesi ka qenë nën mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë (BSH), e cila ka udhëhequr implementimin e këtyre ndryshimeve. Me anëtarësimin në SEPA, Shqipëria bëhet pjesë e grupit të parë të vendeve të Ballkanit Perëndimor që i bashkohen kësaj shtrirjeje gjeografike, duke thelluar lidhjet e saj ekonomike dhe duke shënuar një moment të rëndësishëm në rrugën e saj për anëtarësim në BE. Sipas kalendarit të EPC (European Payments Council), ky proces do të aktivizohet duke filluar nga prilli 2025. Kjo do të lejojë që institucione të ndryshme financiare dhe ofrues shërbimesh pagesash (PSP) në Shqipëri të ofrojnë shërbime pagesash më të shpejta dhe më të sigurta, duke përfshirë transferimet e parave brenda zonës SEPA dhe përdorimin e instrumenteve të tjerë të pagesave. SEPA mundëson qytetarëve dhe bizneset shqiptarë të realizojnë pagesa ndërkombëtare më të shpejta dhe më të lira, si dhe përmirëson integrimin ekonomik të vendit në tregun europian përmes transaksioneve dixhitale[3].

Përmbledhje e Studimit

Grafikë 1: Gjinia në Italy

Grafikë 2: Gjinia në Shqipëri



[3] Albania is now part of the SEPA payment schemes' geographical scope | European Payments Council

Referuar Italisë të intervistuarit femra dominojne ndërsa në Shqipësi është e kundërta.

Grafikë 3: Mosha në Itali



Grafikë 4: Mosha në Shqipëri

Shohim nga të dhënat që në të dy vendet të intervistuarit dominojne ne moshë të re.

Grafikë 5: Arsimi në Itali



Grafikë 6: Arsimi në Shqipëri



Referuar të dhënave mund se dominojne të intervistuar të arsimuar në të dy vendet.

Grafikë 7: Vendndodhja në Itali



Grafikë 8: Vendndodhja në Shqipëri



Burimi: Radonshiqi. B (2025)

Të dhënat e studimit na tregojnë kampioni i marrë në studim në të dy vendet jetojnë më së shumti në zona urbane.

Grafikë 9: Aftësitë teknologjike në Itali

Grafikë 10: aftësitë teknologjike në Shqipëri

Sipas studimit të kryer arrijmë në përfundim që Italianët kanë më tepër aftësi teknologjike sesa Shqiptarët. Italia është një nga ekonomitë më të zhvilluara të Bashkimit Europian dhe ka një infrastrukturë teknologjike dhe arsimore më të avancuar se Shqipëria, që është një ekonomi më e vogël dhe më pak e industrializuar.

Grafikë 11: Niveli i përdorimit në Itali

Grafikë 12: Niveli i përdorimit në Shqipëri

Përdorimi i e-banking është më i lartë në Itali sesa në Shqipëri kjo lidhet dhe me edukimin financiar me te larte qe kane Italianet. Shqipëria ka nivel më të ulët të përdorimit të teknologjisë financiare, infrastruktura dhe mbështetja për shërbime të tilla mbeten një sfidë.

Grafikë 13: Vështrësitë në Itali

Grafikë 14: Vështrësit në Shqipëri



Referuar të dhënave të pyetsorit mund të themi që klinetët Shqiptar janë përballur më shumë me vështirësi teknike sesa klientët Italian, kjo vjen si pasojë e infrastrukturës teknologjike, edukimit financiar, sigurisë dhe besimit.

Grafikë 15: Siguria në Itali

Grafikë 16: Siguria në Shqipëri



Nga studimi konkludojmë se Italianët kanë një nivel më të lartë besimi në lidhje me sigurinë e transaksioneve të e-banking krahasuar me Shqipërinë. Bankat italiane janë të rregulluara nga autoritete të forta, si Banka e Italisë dhe autoritetet evropiane, që sigurojnë që të gjitha bankat dhe shërbimet e e-banking të përmbushin standardet e sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave. Në Shqipëri, ndërsa janë bërë përpjekje për të rritur sigurinë. Niveli i moderuar i besimit për sigurinë në transaksioneve në e-banking eshte dhe per shkak të sulmeve kibernetike që ka patur sistemi banker në Shqipëri.

Grafikë 17: Sfidat në Itali



Grafikë 18: Sfidat në Shqipëri

Sfida kryesore në Shqipëri mbetet edukimi financiar, i cili është i lidhur ngushtë me përdorimin e teknologjisë dhe njohuritë për sigurinë në internet. Shumë përdorues nuk janë të mësuar me menaxhimin e financave online dhe nuk kanë informacion të mjaftueshëm për të shmangur rreziqet. Problemet me infrastrukturën teknologjike janë një faktor tjetër që ndikon në përdorimin e e-banking. Disa zona në Shqipëri nuk kenë akses të plotë në internet, duke kufizuar mundësitë për përdorim të sigurt dhe të shpejtë të shërbimeve bankare online. Italianet kanë një sistem të zhvilluar, por siguria dhe mbrojtja e informacionit vazhdojnë të jenë shqetësime, për shkak të rritjes së sulmeve kibernetike dhe mashtrimeve online.

Grafikë 19: Përmirësimi në Itali



Grafikë 20: Përmirësimi në Shqipëri

Burimi: Radonshiqi. B (2025)

Italianët sugjerojnë se qeveria dhe sistemi banker duhet te punoje me teper ne lidhje me sigurine dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Ndërsa Shqiptarët kanë më shumë sugjerime në lidhje me përmirësimin dhe rritjen e e-banking ku më kryesorja mbetet edukimi financiar.

Perfundime dhe Rekomandime

Sistemi bankar ka përfituar nga inovacionet teknologjike, duke përfshirë zhvillimin e shërbimeve të bankës dixhitale, aplikacioneve mobile për menaxhimin e llogarive dhe pagesave, si dhe përdorimin e inteligjencës artificiale për përmirësimin e shërbimeve për klientët.

Bankat mund të ofrojnë shërbime më të lira dhe më efikase, pasi operacionet e e-banking mund të realizohen pa nevojën e ndërhyrjes fizike dhe me një administrim më të lehtë.

Bankat në Shqipëri duhet të krijojnë fushata më efektive të marketingut për të inkurajuar përdorimin e e-banking-ut dhe për të rritur nivelin e adoptimit të shërbimeve të bankave elektronike.

Banka e Shqipërisë në bashkpunim me Bankat e nivelit të dytë duhet të trajnojnë qytetarët me qëllim rritjen e nivelit të perceptimit mbi sigurinë dhe besueshmërinë të e-banking-ut.

Banka e Shqipërisë dhe autoritetet përgjegjëse duhet të ndërtojnë politika për rregullimin e sektorit financiar dixhital dhe sigurinë kibernetike, duke siguruar që shërbimet financiare të jenë të disponueshme dhe të sigurta për qytetarët, duke ndikuar në përfshirje më të madhe të aksesit teknologjik

Sistemi banker Shqiptar duhet të adaptojë politika nxitëse si Italia në rritjen e transaksioneve bankare duke minimizuar paranë cash.

Referenca

1. Abdelsid. A and Jiuma. I (2022) "Importance of E-Banking on Traditional Banking Services" *International Journal of Business and Management Invention (IJBMI) Volume 11 Issue 1: 2-6*
2. Acemoglu, D. (2021), "Automation and Employment: Impacts on the Financial Sector". Journal of Economic Perspectives, 35(1), 12-32.
3. Brynjolfsson, E., & McAfee, A. (2020). The Second Machine Age: Work, Progress, and Prosperity in a Time of Brilliant Technologies. W. W. Norton & Company.
4. Cronin, Mary J. (1997). Banking and Finance on the Internet, John Wiley and Sons. ISBN 0- 471-29219-2: 41 from Banking and Finance on the Internet. Retrieved 2008-07-10.
5. Cybersecurity and Finance Journal. (2023). Cybersecurity Risks in Financial AI Applications.
6. Deloitte. (2022). AI in Financial Services: Unlocking Value with Artificial Intelligence. Deloitte Insights.
7. Jun, M. and Cai, S. (2001), "The key determinants of internet banking service quality: a content analysis", International Journal of Bank Marketing, Vol. 19 No. 7: 277.
8. McKinsey & Company. (2023). The Future of AI in Financial Services. McKinsey Global Institute.
9. Reibstein, D.J. (2002), "What attracts customers to online stores, and what keeps them coming back?", Journal of the Academy of Marketing Science, Vol. 30: 468
10. Reichheld, F.F. and Schefter, P. (2000), "E-loyalty – your secret weapon on the web", Harvard Business Review, Vol. 78 No. 4: 107.
11. Burime interneti
12. The Single Euro Payments Area explained | European Payments Council (aksesuar 2/12/2024)

13. Albania is now part of the SEPA payment schemes' geographical scope | European Payments Council (aksesuar 12/01/2025)
14. Bankat_ne_epoken_e_internetit_3242_1_6803.pdf (aksesuar 15/01/2025)

SFIDAT SHKENCORE PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM NË FUSHËN E KITARËS KLASIKE

PhD Cand. Dashamir Mehmeti

Abstrakt

Ky studim trajton sfidat shkencore të zhvillimit të qëndrueshëm në fushën e kitarës klasike, duke e konceptuar këtë instrument jo vetëm si një mjet artistik, por si një komponent kompleks të ekosistemit muzikor, kulturor, pedagogjik dhe teknologjik bashkëkohor. Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të analizojë në mënyrë ndërdisiplinore dhe të integruar faktorët që ndikojnë në qëndrueshmërinë afatgjatë të kitarës klasike, duke përfshirë dimensionin ekologjik të materialeve, dimensionin kulturor të trashëgimisë muzikore dhe dimensionin pedagogjik të formimit artistik.

Në aspektin ekologjik, studimi fokusohet në përdorimin e burimeve natyrore në ndërtimin e instrumentit, veçanërisht drurëve të rrallë dhe të mbrojtur që tradicionalisht përdoren në lutheri. Analiza thekson sfidat që lidhen me mbishfrytëzimin e këtyre burimeve dhe ndikimin e tyre në ekosistemet natyrore globale. Në këtë kuadër, trajtohet nevoja për zhvillimin e materialeve alternative, të certifikuara ose sintetike, si dhe për implementimin e teknologjive të reja që synojnë ruajtjen e balancës ndërmjet cilësisë akustike dhe përgjegjësisë mjedisore.

Në dimensionin kulturor, studimi analizon proceset e ruajtjes, dokumentimit dhe transmetimit të repertorit për kitarë klasike, duke theksuar rëndësinë e arkivimit sistematik dhe digjitalizimit të materialeve muzikore. Vëmendje e veçantë i kushtohet krijimtarisë kombëtare, e cila shpesh mbetet e kufizuar në qarkullim akademik dhe interpretativ për shkak të mungesës së studimeve të thelluara dhe platformave të specializuara. Në këtë kuadër, diskutohet edhe roli i institucioneve kulturore dhe akademike në promovimin e kësaj trashëgimie në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në aspektin pedagogjik, hulumtimi shqyrton transformimet e metodologjive të mësimdhënies së kitarës klasike në epokën e digjitalizimit. Analizohen mënyrat se si teknologjia ka ndikuar në procesin e mësimnxënies, përfshirë përdorimin e platformave online, softuerëve

analitikë dhe mjeteve interaktive. Studimi evidenton gjithashtu sfidat që lidhen me pabarazinë në aksesin ndaj edukimit muzikor, si dhe nevojën për reforma kurrikulare që integrojnë konceptet e qëndrueshmërisë dhe inovacionit.

Për më tepër, trajtohet ndikimi i zhvillimeve teknologjike në performancën dhe kompozimin për kitarë klasike, duke analizuar tensionin ndërmjet avancimit digjital dhe ruajtjes së identitetit estetik dhe interpretativ të instrumentit. Kjo dilemë konceptohet si një nga sfidat kryesore të muzikës klasike bashkëkohore, e cila kërkon një balancë të kujdesshme ndërmjet traditës dhe inovacionit.

Në përfundim, studimi argumenton se zhvillimi i qëndrueshëm në fushën e kitarës klasike nuk mund të arrihet përmes qasjeve të izoluara, por kërkon një kornizë të integruar ndërdisiplinore që ndërthur kërkimin shkencor, inovacionin teknologjik, politikat kulturore dhe reformimin e edukimit muzikor. Një qasje e tillë jo vetëm që forcon qëndrueshmërinë e instrumentit në aspektin ekologjik dhe kulturor, por gjithashtu kontribuon në zhvillimin e tij si një formë arti e përshtatshme për sfidat e shekullit XXI

Fjalë kyçe: *Kitarë klasike, zhvillim i qëndrueshëm, trashigimi kulturore.*

Hyrje

Në dekadat e fundit, koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm ka marrë një rëndësi të veçantë në një gamë të gjerë fushash të veprimtarisë njerëzore, duke përfshirë edhe artin dhe kulturën. [1]Muzika, si një formë thelbësore e shprehjes artistike dhe e ndërtimit të identitetit kulturor, nuk mbetet jashtë këtij procesi, por përkundrazi reflekton dhe ndërvepron në mënyrë aktive me këto zhvillime.[2] Brenda këtij konteksti, kitara klasike përfaqëson një instrument me traditë të pasur historike dhe me një rol të konsoliduar në

[1] John Haines and R. K. D. H. Hayes, " Ndërtimi i Instrumenteve" Etnomuzikologjija 2020.
[2] Rafet Rudi," Muzika bashkëkohore dhe identiteti kulturor shqiptar "Prishtinë, 2012.

repertorin muzikor botëror, duke funksionuar si një urë lidhëse ndërmjet trashëgimisë dhe inovacionit bashkëkohor.[3]

Zhvillimi i qëndrueshëm në fushën e muzikës nënkupton një qasje të integruar, e cila merr në konsideratë dimensionet ekologjike, kulturore dhe shoqërore. Në rastin e kitarës klasike, kjo qasje përfshin çështje që lidhen me procesin e prodhimit të instrumentit, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë muzikore, si dhe transmetimin e dijes përmes sistemeve arsimore. Përdorimi i materialeve natyrore, veçanërisht i drurëve të rrallë si palisandri dhe abanozi, paraqet sfida të rëndësishme mjedisore, duke nxitur kërkime drejt materialeve alternative dhe praktikave më të qëndrueshme në ndërtimin e instrumenteve.[4]

Në planin kulturor, kitara klasike përballet me sfida që lidhen me ruajtjen, dokumentimin dhe promovimin e repertorit, veçanërisht në kontekste kombëtare ku krijimtaria vendase shpesh mbetet në hije përballë asaj ndërkombëtare. [5]Mungesa e arkivimit sistematik, e botimeve kritike dhe e studimeve të thelluara muzikologjike përbën një pengesë të ndjeshme për zhvillimin e kësaj fushe. Në këtë kuadër, digjitalizimi i materialeve muzikore dhe ndërtimi i databazave të aksesueshme shfaqen si mjete thelbësore për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë.

Një dimension tjetër i rëndësishëm është ai pedagogjik, i cili lidhet me mënyrat e transmetimit të dijes muzikore dhe përgatitjen e brezave të rinj të kitaristëve. Modelet tradicionale të mësimdhënies shpesh rezultojnë të pamjaftueshme përballë kërkesave bashkëkohore, duke kërkuar integrimin e metodologjive inovative dhe përdorimin e teknologjisë në procesin arsimor. Për më tepër, pabarazitë në aksesin ndaj edukimit muzikor, sidomos ndërmjet zonave urbane dhe rurale, përbëjnë një sfidë të rëndësishme në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm.

Ndikimi i teknologjisë në muzikë përbën një tjetër aspekt kyç të këtij diskutimi. Zhvillimet teknologjike kanë zgjeruar ndjeshëm mundësitë e performancës dhe kompozimit për kitarë klasike, duke përfshirë përdorimin e mjeteve dixhitale dhe ndërthurjen me elementë elektronikë. Megjithatë, këto

[3] Maurice J. Summerfield, “Kitara Klasike” 2002
[4] Thomas D. Rossing,” Instrumentet Kordofonë 2010.
[5] Aleksandër Peçi, Vepra dhe analiza kompozicionale (2015).

zhvillime sjellin edhe sfida që lidhen me ruajtjen e identitetit tradicional të instrumentit dhe me balancimin ndërmjet inovacionit dhe autenticitetit artistik.

Në këtë kontekst kompleks dhe dinamik, bëhet e domosdoshme një qasje ndërdisiplinore që ndërthur muzikologjinë, teknologjinë, ekologjinë dhe shkencat e edukimit. Ky punim synon të analizojë në mënyrë të thelluar sfidat kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm në fushën e kitarës klasike, duke propozuar qasje dhe perspektiva që kontribuojnë në ndërtimin e një të ardhmeje më të qëndrueshme për këtë instrument dhe për praktikën muzikore në tërësi.

Rishikimi i literaturës

Literatura mbi zhvillimin e qëndrueshëm në fushën e kitarës klasike është karakterizuar nga një evolucion gradual nga qasjet tradicionale muzikologjike drejt një perspektive ndërdisiplinore, ku ndërthuren analiza estetike, teknologjike dhe ekologjike.[6] Në fazat e hershme, studimet janë përqendruar kryesisht në historinë, repertorin dhe zhvillimin teknik të instrumentit, duke e trajtuar kitarën klasike si pjesë të traditës së muzikës akademike perëndimore. Në këtë kontekst, figura e Andrés Segovia zë një vend qendror, pasi kontributi i tij në standardizimin e teknikës dhe zgjerimin e repertorit ka ndikuar ndjeshëm në institucionalizimin e kitarës klasike si instrument koncertal. Përmes bashkëpunimeve me kompozitorë të njohur dhe përmes aktivitetit të tij pedagogjik, Segovia krijoi bazat për një traditë interpretative që vazhdon të ndikojë edhe sot.

Pas kësaj periudhe, literatura fillon të reflektojë një interes në rritje për analizën e performancës dhe interpretimit, duke u fokusuar në aspektet stilistike, artikulimin, frazimin dhe estetikën e tingullit.[7] Interpretë dhe pedagogë të shquar si Julian Bream dhe David Russell kanë kontribuar jo vetëm përmes performancave të tyre, por edhe përmes reflektimeve mbi procesin interpretativ dhe metodologjitë e mësimdhënies. Literatura në këtë fazë thekson rëndësinë e një qasjeje të integruar, ku teknika instrumentale nuk trajtohet e shkëputur nga përmbajtja muzikore dhe konteksti kulturor.

[6] Tymański, “Qëndrushmëria dhe Instrumentet” f,78.
[7] Russell,”Teknika e Kitarës Klasike” 30.

Në dekadat e fundit, zhvillimet në fushën e qëndrueshmërisë kanë sjellë një zhvendosje të dukshme në fokusin e kërkimeve drejt dimensionit ekologjik të prodhimit të instrumenteve muzikore.[8] Studimet në inxhinierinë e materialeve dhe në akustikë kanë analizuar ndikimin e drurëve tradicionalë, si palisandri dhe abanozi, në cilësinë e tingullit dhe në qëndrueshmërinë e instrumentit. Megjithatë, për shkak të mbishfrytëzimit dhe rrezikut të zhdukjes së këtyre burimeve natyrore, literatura bashkëkohore evidenton nevojën për alternativa më të qëndrueshme. Kërkime të ndryshme kanë eksploruar përdorimin e materialeve të reja, përfshirë drurë të certifikuar, materiale kompozite dhe teknologji hibride, duke analizuar kompromiset ndërmjet cilësisë akustike dhe ndikimit mjedisor. Në këtë drejtim, literatura shpesh vendos në diskutim tensionin ndërmjet ruajtjes së traditës dhe nevojës për inovacion të qëndrueshëm. Paralelisht, dimensioni teknologjik ka marrë një rëndësi gjithnjë e më të madhe në studimet mbi kitarën klasike. Literatura bashkëkohore trajton gjerësisht përdorimin e mjeteve digjitale në kompozim, performancë dhe edukim. Softuerë për analizën spektrale të tingullit, platforma për mësim në distancë dhe aplikime të inteligjencës artificiale kanë transformuar mënyrën se si muzika krijohet dhe transmetohet. Këto zhvillime kanë hapur mundësi të reja për interpretim dhe eksperimentim artistik, por njëkohësisht kanë ngritur pyetje mbi natyrën e autenticitetit dhe rolin e interpretit në një mjedis gjithnjë e më të ndërmjetësuar nga teknologjia. Literatura në këtë fushë shpesh thekson nevojën për një balancë ndërmjet përvetësimit të teknologjisë dhe ruajtjes së identitetit tradicional të instrumentit. Nga këndvështrimi pedagogjik, kërkimet janë përqendruar në zhvillimin e metodologjive më efektive për mësimdhënien e kitarës klasike në një kontekst bashkëkohor. Studimet analizojnë tranzicionin nga modelet tradicionale, të bazuara në marrëdhënien mësues–nxënës, drejt formave më të hapura dhe të ndërmjetësuara nga teknologjia. Integrimi i platformave digjitale, materialeve multimediale dhe mësimit në distancë ka krijuar mundësi të reja për zgjerimin e aksesit në edukimin muzikor, duke kontribuar në dimensionin shoqëror të zhvillimit të qëndrueshëm. Megjithatë, literatura evidenton gjithashtu sfida që lidhen me cilësinë e mësimdhënies, mungesën e standardizimit dhe pabarazitë në aksesin ndaj teknologjisë. Në kontekstin shqiptar, literatura mbi kitarën klasike dhe zhvillimin e saj mbetet ende e kufizuar dhe në zhvillim. Megjithatë, kontributet e kompozitorëve dhe

[8] Haines dhe Hayes, “Materialet e ndritëshme” f,101.

studiuesve si Aleksandër Peçi dhe Rafet Rudi përfaqësojnë një bazë të rëndësishme për analizën e identitetit muzikor kombëtar në raport me zhvillimet bashkëkohore. Studimet në këtë fushë janë fokusuar kryesisht në analizën stilistike dhe estetike të veprave, ndërsa mungon një trajtim i plotë në drejtim të qëndrueshmërisë, arkivimit dhe promovimit të repertorit për kitarë klasike. Kjo tregon një boshllëk të qartë në literaturë, i cili kërkon vëmendje të mëtejshme kërkimore. Në përfundim, rishikimi i literaturës evidenton një zhvendosje të dukshme nga qasjet tradicionale, të përqendruara në historinë dhe teknikën e instrumentit, drejt një perspektive më të gjerë dhe ndërdisiplinore. Dimensionet ekologjike, teknologjike dhe pedagogjike janë bërë komponentë thelbësorë në studimet bashkëkohore mbi kitarën klasike. Megjithatë, mbeten ende boshllëqe të rëndësishme, veçanërisht në integrimin e këtyre dimensioneve në kontekste specifike kombëtare, si ai shqiptar, duke theksuar nevojën për kërkime të mëtejshme që të adresojnë sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm në mënyrë të plotë dhe të integruar.

Metodologjia

Ky studim mbështetet në një qasje të kombinuar kërkimore, e cila integron metoda cilësore dhe sasiore për të analizuar në mënyrë të thelluar dhe të balancuar sfidat dhe mundësitë e zhvillimit të qëndrueshëm në fushën e kitarës klasike.[9] Zgjedhja e kësaj qasjeje justifikohet nga natyra komplekse dhe ndërdisiplinore e objektit të studimit, i cili përfshin dimensione artistike, pedagogjike, teknologjike dhe mjedisore. Në këtë kuadër, metodologjia është ndërtuar mbi një kornizë teorike që ndërthur muzikologjinë, etnomuzikologjinë, shkencat e edukimit, akustikën muzikore dhe inxhinierinë e materialeve, duke mundësuar një analizë gjithëpërfshirëse të fenomenit.

Në komponentin cilësor të studimit, është përdorur analiza e përmbajtjes (content analysis), e cila ka shërbyer për shqyrtimin sistematik të literaturës ekzistuese. Korpusi i analizuar përfshin artikuj shkencorë të botuar në revista ndërkombëtare, monografi të specializuara, materiale konferencash dhe botime akademike që trajtojnë zhvillimin e kitarës klasike në raport me qëndrueshmërinë, inovacionin teknologjik dhe edukimin muzikor. Përzgjedhja e burimeve është realizuar mbi bazën e kritereve të qarta, si

[9] John W. Creswell, "Hulumtime mbi Kitarën, 2014, f, 14, 20.

relevanca tematike, cilësia shkencore, indeksi i citimeve dhe aktualiteti i publikimit, duke synuar ndërtimin e një baze teorike të konsoliduar dhe të besueshme.

Një tjetër metodë cilësore e përdorur është intervista gjysmë e strukturuar, e cila ka mundësuar mbledhjen e të dhënave empirike nga aktorë kyç të fushës. Kampioni është përzgjedhur në mënyrë të qëllimshme (purposive sampling), duke përfshirë pedagogë të kitarës klasike, interpretues profesionistë dhe ndërtues instrumentesh. Intervistat janë fokusuar në temat kryesore të studimit, si përdorimi i materialeve në ndërtimin e instrumentit, sfidat e mësimdhënies në kontekstin bashkëkohor dhe ndikimi i teknologjisë në praktikën artistike. Të dhënat e mbledhura janë transkriptuar dhe analizuar përmes teknikës së kodimit tematik, duke identifikuar kategori kryesore, nën-tema dhe modele interpretative që ndihmojnë në kuptimin e thelluar të fenomenit.

Në komponentin sasior, është përdorur metoda e anketimit përmes pyetësorëve të strukturuar, të shpërndarë tek studentë të muzikës dhe profesionistë të fushës së kitarës klasike. Kampioni është përzgjedhur duke kombinuar metoda probabilitare dhe jo-probabilitare, me qëllim sigurimin e një përfaqësimi sa më të gjerë të grupeve të interesit. Pyetësori përfshin pyetje të tipit Likert, pyetje me alternativa të mbyllura dhe disa pyetje të hapura, të cilat synojnë të matin nivelin e ndërgjegjësimit mbi çështjet e qëndrueshmërisë, përdorimin e teknologjisë dhe qëndrimet ndaj inovacionit në muzikë. Të dhënat e mbledhura janë përpunuar përmes metodave statistikore deskriptive dhe inferenciale, duke përfshirë analizën e frekuencave, mesatareve, devijimit standard dhe testimin e korrelacioneve ndërmjet variablave.

Një komponent i rëndësishëm i metodologjisë është analiza krahasuese e materialeve të përdorura në ndërtimin e kitarës klasike. Kjo analizë bazohet në parimet e akustikës muzikore dhe përfshin krahasimin ndërmjet drurëve tradicionalë (si palisandri dhe abanozi) dhe materialeve alternative, përfshirë drurë të certifikuar, materiale kompozite dhe zgjidhje sintetike. Vlerësimi është realizuar duke marrë në konsideratë parametra si rezonanca, qëndrueshmëria strukturore, jetëgjatësia dhe ndikimi në cilësinë timbrike të instrumentit. Kjo qasje synon të identifikojë mundësi për

përdorimin e materialeve më të qëndrueshme pa kompromentuar cilësinë artistike.

Për më tepër, në studim është aplikuar metoda e studimit të rastit, e cila ka mundësuar analizën e praktikave konkrete në institucione arsimore dhe projekte artistike që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm në muzikë. Kjo përfshin vëzhgimin e programeve mësimore, përdorimin e teknologjisë në edukim dhe iniciativat për promovimin e repertorit vendor. Studimet e rasteve janë përzgjedhur në bazë të rëndësisë dhe përfaqësimit të tyre, duke synuar të ofrojnë një pasqyrë reale të zbatimit praktik të koncepteve teorike.[10]

Në aspektin etik, studimi respekton parimet e konfidencialitetit, anonimitetit dhe vullnetarizmit të pjesëmarrësve. Të gjithë pjesëmarrësit në intervista dhe anketa janë informuar paraprakisht mbi qëllimin e studimit dhe kanë dhënë pëlqimin e tyre të informuar për pjesëmarrje. Të dhënat janë përdorur vetëm për qëllime kërkimore dhe janë trajtuar në mënyrë të sigurt dhe profesionale.

Megjithatë, studimi paraqet edhe disa kufizime metodologjike. Kampioni i përzgjedhur, megjithëse përfaqësues, mbetet i kufizuar në aspektin gjeografik dhe institucional. Gjithashtu, analiza e materialeve mbështetet pjesërisht në burime sekondare dhe në interpretim subjektiv, çka mund të ndikojë në përgjithësimin e rezultateve. Këto kufizime merren në konsideratë në interpretimin e gjetjeve dhe në formulimin e përfundimeve.

Në përfundim, metodologjia e ndjekur synon të ofrojë një qasje të integruar dhe të balancuar, duke kombinuar analiza teorike dhe të dhëna empirike për të ndërtuar një kuptim të thelluar të zhvillimit të qëndrueshëm në fushën e kitarës klasike. Kjo qasje mundëson jo vetëm identifikimin e sfidave ekzistuese, por edhe formulimin e rekomandimeve konkrete dhe të aplikueshme në praktikë.

Rezultate dhe diskutime

Rezultatet e këtij studimi konfirmojnë se zhvillimi i qëndrueshëm në fushën e kitarës klasike përfaqëson një proces kompleks, shumëdimensional dhe dinamik, i cili ndikohet nga ndërveprimi i faktorëve ekologjikë,

[10] Creswell W, John, Qasje Kualitative, Kuantitative dhe metoda të përziera.

teknologjikë, pedagogjikë dhe kulturorë. Analiza e të dhënave të mbledhura përmes metodave cilësore dhe sasiore evidenton se këta faktorë nuk veprojnë në mënyrë të pavarur, por krijojnë një sistem të ndërlidhur ndikimesh që formësojnë praktikën muzikore bashkëkohore. Në këtë kuadër, rezultatet duhet të interpretohen jo vetëm si të dhëna empirike, por si tregues të transformimeve më të gjera në mënyrën se si konceptohet dhe praktikohet muzika për kitarë klasike në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Në dimensionin ekologjik, të dhënat tregojnë një rritje të dukshme të ndërgjegjësimit mbi përdorimin e materialeve të qëndrueshme në ndërtimin e instrumentit. Shumica e pjesëmarrësve në studim pranojnë rëndësinë e reduktimit të ndikimit mjedisor dhe shprehen të hapur ndaj përdorimit të drurëve të certifikuar ose alternativave të reja. Megjithatë, rezultatet zbulojnë një hendek të rëndësishëm ndërmjet qëndrimeve deklarative dhe praktikave reale. Ndërsa në nivel diskursiv ekziston një pranim i gjerë i nevojës për qëndrueshmëri, në praktikë dominon ende preferenca për materiale tradicionale, të cilat lidhen ngushtë me perceptimin e cilësisë së lartë artistike.

Intervistat me luthierë dhe interpretues nxjerrin në pah një tension të vazhdueshëm ndërmjet ruajtjes së traditës dhe adoptimit të inovacioneve. Shumë profesionistë shprehin shqetësimin se materialet alternative mund të ndikojnë negativisht në karakteristikat timbrike të instrumentit, duke prekur kështu identitetin estetik të kitarës klasike. Megjithatë, analiza akustike krahasuese tregon se disa materiale të reja, përfshirë drurë të përpunuar dhe kompozite moderne, arrijnë të riprodhojnë në mënyrë të konsiderueshme vetitë rezonante të materialeve tradicionale. Kjo sugjeron se rezistenca ndaj inovacionit është pjesërisht e bazuar në perceptime kulturore dhe psikologjike, dhe jo vetëm në argumente objektive akustike. Në këtë kontekst, rezultatet përputhen me tendencat e evidentuara në literaturën ndërkombëtare, e cila thekson nevojën për një tranzicion gradual drejt praktikave më të qëndrueshme.

Në dimensionin teknologjik, rezultatet tregojnë një integrim të gjerë dhe në rritje të mjeteve digjitale në praktikën e kitarës klasike. Anketat evidencojnë se shumica e studentëve dhe profesionistëve përdorin rregullisht platforma online, aplikacione për analizë tingulli dhe mjete për regjistrim e përpunim audio. Këto teknologji kanë kontribuar ndjeshëm në përmirësimin

e procesit të të nxënit, duke ofruar mundësi për vetëmonitorim, analizë të detajuar të performancës dhe akses në burime të shumta edukative. Nga ky këndvështrim, teknologjia shfaqet si një faktor kyç në rritjen e aksesit dhe cilësisë së edukimit muzikor, duke kontribuar drejtpërdrejt në dimensionin shoqëror të zhvillimit të qëndrueshëm.

Megjithatë, rezultatet tregojnë gjithashtu disa efekte anësore të këtij integrimi. Një pjesë e pedagogëve shprehin shqetësimin se mbështetja e tepruar në teknologji mund të dobësojë zhvillimin e dëgjimit kritik dhe të aftësive interpretative tradicionale. Në mënyrë të veçantë, varësia nga analiza vizuale e tingullit (p.sh., përmes spektrogramëve) mund të reduktojë fokusin në perceptimin auditiv, i cili është thelbësor për formimin e një interpretuesi të plotë. Kjo situatë krijon një dilemë pedagogjike ndërmjet përfitimeve të teknologjisë dhe ruajtjes së metodave tradicionale të mësimdhënies. Në këtë drejtim, rezultatet sugjerojnë nevojën për një integrim të balancuar dhe kritik të teknologjisë, ku ajo të shërbejë si mjet mbështetës dhe jo zëvendësues i proceseve themelore muzikore.

Në dimensionin pedagogjik, gjetjet e studimit theksojnë nevojën për një riformulim të kurrikulave në drejtim të integrimit të parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm. Aktualisht, edukimi për kitarë klasike mbetet i fokusuar kryesisht në aspektet teknike dhe interpretative, ndërsa çështjet që lidhen me mjedisin, teknologjinë dhe inovacionin trajtohen në mënyrë të kufizuar. Megjithatë, praktikat më të suksesshme të identifikuara në këtë studim janë ato që adoptojnë një qasje holistike, duke kombinuar zhvillimin teknik me ndërgjegjësimin mbi ndikimin mjedisor dhe përdorimin e teknologjisë.

Një aspekt i rëndësishëm që del nga analiza është roli i edukimit në formësimin e qëndrimeve ndaj qëndrueshmërisë. Studentët që janë ekspozuar ndaj koncepteve të zhvillimit të qëndrueshëm gjatë formimit të tyre tregojnë një prirje më të lartë për të adoptuar praktika të përgjegjshme, si në përzgjedhjen e instrumenteve, ashtu edhe në përdorimin e teknologjisë. Kjo nënvizon rëndësinë e edukimit si një mjet kyç për transformimin afatgjatë të praktikave muzikore.

Në kontekstin shqiptar, rezultatet tregojnë se sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm janë edhe më të theksuara për shkak të kufizimeve strukturore

dhe institucionale. Mungesa e burimeve, infrastruktura e kufizuar dhe akses i pabarabartë në teknologji ndikojnë drejtpërdrejt në implementimin e praktikave të qëndrueshme. Gjithashtu, mungesa e një repertori të gjerë të dokumentuar dhe e platformave të mirëfillta për promovimin e kitarës klasike përbën një pengesë për zhvillimin kulturor të kësaj fushe. Megjithatë, ekziston një potencial i konsiderueshëm për zhvillim, veçanërisht nëse investohet në edukim, digjitalizim dhe mbështetje institucionale.

Diskutimi i përgjithshëm i rezultateve sugjeron se zhvillimi i qëndrueshëm në kitarën klasike nuk mund të arrihet përmes ndërhyrjeve të izoluara, por kërkon një qasje të integruar që ndërthur dimensionet ekologjike, teknologjike dhe pedagogjike. Kjo qasje duhet të mbështetet në bashkëpunimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm, përfshirë muzikantët, pedagogët, ndërtuesit e instrumenteve dhe institucionet arsimore. Në këtë kuptim, muzika për kitarë klasike mund të shihet si një sistem i hapur, i cili evoluon në ndërveprim të vazhdueshëm me ndryshimet shoqërore dhe mjedisore.

Në përfundim, rezultatet e këtij studimi kontribuojnë në zgjerimin e kuptimit mbi zhvillimin e qëndrueshëm në muzikë, duke theksuar rëndësinë e një qasjeje të balancuar ndërmjet traditës dhe inovacionit. Ato sugjerojnë se e ardhmja e kitarës klasike varet nga aftësia për të integruar praktika të qëndrueshme pa kompromentuar vlerat artistike, duke krijuar kështu një model zhvillimi që është njëkohësisht estetikisht i pasur dhe ekologjikisht i përgjegjshëm.

Referenca

1. Bream, Julian. The Guitar: A Very Short Introduction. Oxford University Press, 2013.
2. Segovia, Andrés. Segovia: An Autobiography of the Years 1893–1920. Macmillan, 1976.
3. Russell, David. Classical Guitar Technique and Interpretation. Mel Bay Publications, 2005.
4. Turina, Joaquín. Essays on Guitar and Music Aesthetics. Madrid: Real Academia de Bellas Artes, 1952.
5. Summerfield, Maurice J. The Classical Guitar: Its Evolution, Players and Personalities since 1800. Ashley Mark Publishing, 2002.

6. Tymański, Krzysztof. “Sustainability in Musical Instrument Making: Wood Selection and Acoustic Impact.” Journal of Musical Acoustics, 2019.
7. Rossing, Thomas D. The Science of String Instruments. Springer, 2010.
8. Fletcher, Neville H., and Thomas D. Rossing. The Physics of Musical Instruments. Springer, 1998.
9. Peçi, Aleksandër. Vepra dhe analiza kompozicionale në muzikën bashkëkohore shqiptare. Tiranë: Botimet Onufri, 2015.
10. Rudi, Rafet. Muzika bashkëkohore dhe identiteti kulturor shqiptar. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe Arteve, 2012.
11. Haines, John, and R. K. D. H. Hayes. “Sustainable Materials in Instrument Construction.” Ethnomusicology Review, 2020.
12. Hall, Donald E. Musical Acoustics. Brooks/Cole, 2002.

GJYKIMET E POSACME DHE RENDESIA E TYRE NE TE DREJTEN PENALE

Msc.Av.Endri Fejzullah

(e.fejzullah19@eust.edu.mk)

Msc. Klejvis Hoxha

(k.hoxha19@eust.edu.mk)

Abstrakt

E drejta penale paraqet larmishmerine e normave juridike te saj me fokus ne te drejten e shoqerise per t'u mbrojtur nga kriminaliteti, ku kjo mbrojtje ofrohet duke sanksionuar veprat e ndryshme penale dhe nepermjet mekanizmave shteteror. Organi i akuzes, ose thene ndryshe Prokuroria perfaqeson shtetin ne proces dhe ka te njejten status si mbrojtja, duke qene pale ne te. Kodi yne Penal bazohet ne disa parime te rendesishme po aq sa te qenesishme ne ekzistencen e shtetit te se drejtes dhe ligjor, sic eshte edhe parimi i humanizmit, parim i cili intervenon ne shume situata penale. Punimi i sotem, ka per qellim jo vetem identifikimin e gjykimeve te posacme dhe rendesine e tyre ne te drejten penale, por edhe faktin se si keto gjykime ndikojne per palet qe jane pjese e procesit ashtu edhe ne benefitin qe shoqeria duhet te perfitoj si e drejta e saj per t'u mbrojtur nga kriminaliteti.

Gjykimi i shkurtuar, gjykimi i drejtperdrejte, gjykimi me marreveshje dhe urdheri penal, jane kater institute te se drejtes te cilat qellimin kryesor kane moscenimin e drejtesise, por edhe palet te kene perfitimet e veta nga keto gjykime te posacme te se drejtes penale, gje e cila buron nga parimet e shkences penale bashkekohore sic jane parimi i humanizmit, ai i barazise perpara ligjit , ekonomise gjyqesore, dhenien e drejtesise ne nje kohe te arsyeshme, efikasitet etj

Te gjitha sa me siper, nuk duhet te cenojne efektivitetin e drejtesise, por ne thelb synojne nderthurjen e interesave shteteror dhe te subjektit qe mund te jete i pandehur ne proces, duke garantuar edhe qellimin e denimit, i cili perpos se paraqet shtrengimin shteteror te personit te deklaruar fajtor, ka edhe tre komponetet e tjere perberes, pa te cilet vete denimi nuk do te kishte

kuptim ne te drejten e sotme penale, sic eshte edukimi, risocializimi, por edhe parandalimi i kryerjes se veprave te metejshme penale

Gjykimet e posacme kane vlere per ekonomine gjyqesore, dhenien e nje drejtesie te shpejt dhe substanciale , uljen e denimit per te pandehurin, pershpejtimin e nje procesi gjyqesor, shmangien e gjykimit te zakonshem, ku nepermjet gjykimeve te posacme, i pandehuri krahas perfitimeve te tij, heq dore dhe nga disa te drejta themelore te cilat nepermjet gjykimit te zakonshem ai i ka.

Fjale kyce*:* *Gjykim i posacem, gjykim I zakonshem, parim, drejtesi*

Hyrje

Gjykimi i shkurtuar eshte nje rit i procesit penal, ku ashtu sic eshte pecaktuar bene pjese tek gjykimet e posacme te se drejtes penale. Ai disiplinohet ne Kodin e Porcedures Penale ne nenet 332/c, 332/dh, 334, 403, 405 dhe 406 te Kodit te Procedures Penale. Eshte nje nder format me te aplikuara ne praktike dhe e cila ndeshet shpesh ne dyert e gjykatave ne Republiken e Shqiperise.

Ligjvenesi e ka parashikuar gjykimin e shkurtuar ne kuader te shume parimeve te se drejtes. Mirepo, procedura penale eshte shume e rendesishme per te drejtat e te pandehurit. Kerkesa per gjykimin e shkurtuar duhet te paraqitet ne kohen e duhur proceduriale dhe nuk eshte e vertet se me aplikimin e ritit te gjykimit te shkurtuar i pandehuri ka pranuar fajesine. Me aplikimin e ritit te gjykimit te shkurtuar i pandehuri heq dore nga nje sere te drejtash sic eshte kerkesa per marrjen e provave te reja, kerkesa per thirrjen dhe degjimin e deshmitareve te tjere, kerkesa per te kerkuar pavelfshmerine e akteve te gjendura ne fashikullin gjyqesor, debati gjyqesor, parimi i kontradiktoritetit ne lidhje me provat dhe formesimi i tyre ne themel. Heqja dore nga keto te drejta te tij, nuk nenkupton domosdoshmerisht pranimin e fajesise, perkundrazi, parimi i prezumimit te pafejesise ngelet i paprekur deri ne nje vendim fajesie te formes se prere dhe mbrohet jo vetem nga 4 i ligjit procedurial penale, por edhe nga dispozitat kushtetuese si dhe ato konventore te cilat Republika e Shqiperise ka ratifikuar e sic eshte Konventa Europiane e te Drejtave te Njeriut. Pavaresisht se ne nje gjykim mund te procedohet me

gjykimin e shkurtuar, serish i pandehuri dhe avokati i tij mund te kerkojne pafajesia duke argumentuar elementet e vepres penale sic jane objekti, ana objektive, subjekti ana subjektive, te cilat duhet te bashke ekzistojne te gjitha ne kumulacion te plote me njera-tjetren dhe mungesa qofte dhe e nje elementi passjell qe vepra penale ose pergjegjesia penale te mos ekzistoj. Mirepo, ne rast se i pandehuri gjendet fajtor nga gjykata, heqja dore e te drejtave te cituara me siper sjell per te nje perfitim, perfitim ky i cili normohet nga neni 406 i Kodit te Porcedures Penale i cili thote: *Kur jep vendimin gjykata ul denimin me burgim ose gjobe me nje te treten (1/3)*[1] .

Paraqitja e kerkeses per gjykimin e shkurtuar

Me ndryshimet ligjore ne vitin 2017, kerkesa per gjykim te shkurtuar paraqitet nga ana proceduriale perpara gjyqtarit te seances paraprake. Ne nje procedim penal, gjyqtari i hetimeve paraprake vendos ne lidhje me masen e sigurise, shuarjen ose zevendesimin e saj, sigurimin e proves apo kerkesa te tjera nga Prokurori apo mbrojtja e personit nen hetim apo te pandehuri. Ne momentin kur keto akte jane te plota sipas Prokurorit, ai paraqet kerkesen per dergimin e ceshtjes ne gjyq, behet fjale per gjyq themeli, Gjyqtarit te Seances Paraprake. Ne dallim nga masat e sigurise, ku ato vendoseshin nga gjykata mbi bazen e dyshimit te arsyeshem te bazuar ne prova, ku jo domosdoshmerisht prova duhet te ishte determinante ne percaktimin e fajesise, por duhet te jete e tille qe ne momentin e procedimit dhe ne gjendjen qe jane aktet, i dyshuari ka probabilitet te larte qe te jete kryeresi i vepres penale. Ky qendrim i afirmuar ne te drejten tone penale, eshte mbajtur edhe nga *GJEDNJ e cila ekzistencen e dyshimit te arsyeshem e nenkupton me pranine e fakteve ose informacioneve qe do t'a bindnin nje vezhgues objektiv se personi ne fjale mund te kete kryer vepren penale. Megjithate ajo qe mund te konsiderohet e arsyeshme do te varet nga te gjitha rrethanat*[2], ndryshe eshte tek seanca paraprake, ku gjyqtari i saj, i ndryshem nga ai i hetimeve paraprake, vendos dergimin e ceshtjes ne gjyq themeli jo me mbi dyshimin e arsyeshem, por mbi parimin e provave te mjaftueshmerise. Mjaftueshmeria nuk ka te beje me sasine e provave te grumbulluara, por me relevancen qe ato kane per ceshtjen.

[1] Neni 406 pika 1 e Kodit te Procedures Penale
[22] Ceshtja Fox, Campell dhe Hartleyk kunder Mbreterise se Bashkuar

Ne kete seance, prokuroria kerkon dergimin e ceshtjes ne gjyq dhe gjyqtari i seances paraprake verteton kerkesen nga ana formale e saj , permbajtjen e akteve te njoftimit per perfundimin e hetimeve dhe verteton nese jane respektuar te drejtat proceduriale te te pandehurit dhe mbrojtesit te tij, te drejta keto qe kane te bejne me njohjen e akteve te hetimeve paraprake , marrjen e kopjove, paraqitjen e memove apo dhe njoftimin e akuzes[3]. Ajo verifikon gjithashtu edhe nese hetimet jane kryer apo jo te plota nga organi i akuzes, duke qene se ka nje rol apo funksion filtri, perpara se ceshtja te shkoj ne gjyq themeli.

Kjo eshte seanca ku procedurialisht i pandehuri dhe/ose avokati i tij duhet te paraqesin kerkesen per gjykim te shkurtuar.Kerkesa per gjykimin e shkurtuar nenkupton faktin se gjykata konstaton nese ne gjendjen qe jane aktet mund te zgjidhet ceshtja penale ne ngarkim te te pandehurit apo jo ? Ne fund , eshte gjykata ajo e cila pranon ose jo kerkesen per gjykim te shkurtuar dhe ne momentin qe e pranon kete kerkese, palet ligjerisht nuk debatojne ne lidhje me pavlefshmerine e provave,dosja e prokurorit kthehet ne dosje gjyqesore[4] dhe palet ftohen ne diskutimet perfundimare[5]. Sanksioni i vepres penale qe i atribuohet mund te kerkoj nga ligji qe te gjykohet me nje trup gjyqesor te perbere prej 3 gjyqtaresh,atehre gjykata e shtyn seancen duke caktuar nje date tjeter dhe nderkohe formon trupin gjyqesor .

Ne rast se Gjyqtari i Seances Paraprake nuk e pranon kerkesen per gjykimin e shkurtuar, ceshtja dergohet ne gjyq themeli ku palet mund te afirmojne apo jo nese ende i qendrojne kerkeses se tyre per gjykim te shkurtuar. Nese kerkesa nuk paraqitet ne seancen paraprake dhe palet, prokurori por vecanerisht avokati mbrojtes dhe i pandehuri jane prezent duke konkluduar me mosveprimin e tyre per paraqitjen e kesaj te drejte, ne gjyq themeli gjykimi vazhdon dhe ne rast deklarimi fajtor te te pandehurit, ai nuk e perfiton uljen e denimit me nje te treten. Nderkohe qe nese ajo eshte paraqitur ne seancen paraprake, mirepo gjyqtari i asaj seance nuk e ka pranuar dhe ka derguar ceshtjen ne gjyq, eshte e domosdoshme qe edhe ne gjyqin e themelit avokati dhe i pandehuri te pohojne qe i qendrojne kerkeses per gjykim te shkurtuar qe atij t'i aplikohet ulja e nje te tretes se denimit ne

[3] Shih nenin 327 dhe 331 te KPRP te Republikes se Shqiperise
[4] Shih Vendimin Unifikues te Gjykates se Larte nr.2/2003
[5] Shih vendimin nr.62.2025-5185 dt.29.09.2025 te Gjykates se Shkalles se Pare me J.P. Fier

rast se shpallet fajtor.[6] Kjo garanton faktin se cdo shkelje proceduriale qe mund te jete bere ne seancen paraprake ajo rregullohet ne gjyqin e themelit, duke garantuar keshtu jo vetem zbatueshmerine me rigorozitet te ligjit, por edhe te drejtat e te pandehurit, status te cilin sipas ligjit ai e ruan deri ne fund. Ky qendrim eshte konsoliduar edhe nga vendime te shumta te Gjykates se Larte, e cila si gjykate ligji e ka rregulluar praktiken gjyqesore ne lidhje me kete institut te se drejtes duke mbajtur qendrimin se gjyqtari i themelit nuk ka te drejte te shpalle pavlefshmerine e vendimit te gjyqtarit te seances paraprake, por ka te drejten njekohesisht edhe detyrimin qe shkeljet e konstatuara ne themel gjate seances paraprake t'i korrigjoj.

Kodi i Porcedures Penale parashikon edhe rastet e padise civile ne procesin penal, e normuar nga nenet 61-68 te ligjit procedurial, si nje e drejte e pales qe ka pesuar dem per te kerkuar kthimin e pasurise dhe shperblimin e demit. Ne rastin kur kerkesa per gjykim te shkurtuar pranohet dhe gjykata dispnon me vendimin e ndermjetem se ceshtja mund te zgjidhet ne gjendjen qe jane aktet atehere, padia civile ne procesin penal nuk shqyrtohet. Kjo derivon nga nenin 405 pika 9 e Kodit te Porcedures Penale qe thote: *Kur gjykata pranon kerkesen per gjykim te shkurtuar, padia civile nuk shqyrtohet*[7]" gje e cila nenkupton mundesine e ngritjes se saj ne gjykaten civile per shqyrtim

Kushtet e aplikimit te gjykimit te shkurtuar

Kushtet e gjykimit te shkurtuar si gjykim I posacem lidhen kryesisht me heqjen e atyre te drejtave te cituara me siper, nderkohe qe eshte me rendesi te kthehemi edhe njehere tek argumenti ne lidhje me pavlefshmerine apo paperdorshmerine e provave. Sic edhe u tha me siper, me paraqitjen e kerkeses per gjykimin e shkurtuar, I pandehuri dhe avokati I tij heqin dore nga kerkesa per pavlefshmerine relative apo per paperdorshmerine e provave. Perse themi pavlefshmerine relative, sepse ne lidhje me pavlefshmerine absolute te proves, gjykata ka te drejte ta konstatoj ate kryesisht dhe ky eshte nje nder kushtet me anen e se ciles kerkesa per gjykimin e shkurtuar pranohet ose rrezohet[8].

[6] Shih vendimin nr.62-2021-4573 te Gjykates se Shkalles se Pare me Juridiksion te Pergjithshem Fier
[7] Nenet 61-68 dhe 405 te Kodit te Proc.Penale te RSH
[8] Shih nenin 151 te Kodit te Proc.Penale te Republikes se Shqiperise

Pertej kushtetit te pavelfshmerise absolute te provave qe gjykata e ngre dhe kryesisht, kerkesa duhet te jete e paraqitur ne momentin e duhur procedurial, pra ne seancen paraprake, ne rast te kundert ajo nuk mund te ngrihet ne shqyrtimin gjyqesor te ceshtjes. Me rendesi ka edhe fakti kur ndodhemi perpara nje vepre penale qe atribuon ndeshkimin maksimal me burgim te perjetshem[9]. Ne te tille rast, neni 403 pika 2 e Kodit te Procedures Penale ka rendesi per shkak se ka te parashikuar ne menyre eksplicite dhe imperative ndalimin e kerkeses apo aplikimin e ririt te gjykimit te shkurtuar per veprat penale qe parashikohet burgim i perjetshem. Nga fryma ligjore, ligjvenesi eshte kujdesur qe veprave penale me sanksion te rende qe referojne ne shkallen e rrezikshmerise duke cenuar ato te mira rreptesisht te ndaluara te Kodit Penal te ndaloj aplikimin e gjykimit te posacem. Kjo nuk e cenon parimin e humanizmit sepse parimet e se drejtes penale shihen ne harmoni te plote me njera tjetren, vleresohen kumulativisht dhe jo alternativisht. E drejta e jetes (veprat kryesore penale qe parashikojne burgimin e perjteshem) prevalon dhe geznon mbrojtje kushtetuese dhe konventore. Nderkohe qe ne cdo praktike gjyqesore eshte nxjerr thelbi i aplikimit te ketij gjykimi te posacem, i cili kurresesi nuk duhet te jete ne dem te drejtesise, thjesht duke perfituar efektivitetin procedurial, ekonomine gjyqesore dhe kur drejtesia mund te vendoset ne gjendjen ne te cilat ndodhet aktet duke mos patur nevoje per hetime te tjera.

Seanca e gjykimit te shkurtuar dhe rendesia qe ajo paraqet ne te drejten penale

Nga momenti procedurial qe gjykata ka pranuar kerkesen per te vijuar gjykimin me ritin e gjykimit te shkurtuar, dosja e gjyqtarit te seances paraprake kthehet ne dosje gjyqesore dhe ftohen palet ne diskutimet perfundimtare, konkluzion ky ligjor i cili derivon nga dispozitat te cilat normojne gjykimin e shkurtuar si gjykim i posacem. Seanca zhvillohet me pranine e prokurori, avokatit dhe te pandehurit. Mungesa e te pandehurit ne seance, sjell shtyrjen dhe caktimin e nje seance tjeter gjyqesore, nderkohe qe mungesa e avokatit te tij, passjell thirrjen e nje avokati kryesisht per vijimin e gjykimit[10]. Ajo qe legjislatori ka patur parasysh ne nje procedure te tille, eshte fakti se pertej legjitimimit te avokatit nga ana e tij, eshte i pandehuri ai

[10] "Avokati ne procesin penal" Agim Gjoleka dhe Esmeralda Gjoleka fq. 85

qe ne paraqitjen e kerkeses per gjykim te shkurtuar jep pelqimin dhe vullnetin e tij, vullneti i te cilit i jep plotfuqishmerine kerkeses per t'u pranuar.

Gjykimi i shkurtuar eshte i nje rendesie te vecante, jo vetem per shtetin e se drejtes dhe ligjor, jo vetem per parimet e saj e kryesisht per ate te humanzimit, por mbi te gjitha per efektivitetin procedurial dhe dhenien e drejtesise. Vendimi Unifikues i Gjykates se Larte nr.2/2003 ka theksuar se gjykimi i shkurtuar ka vlere per ekonomine gjyqesore sepse thjeshton dhe shkurton procedurat, rrit shpejtesine dhe efektivitetin e gjykimit dhe sjell si pasoje nje perfitim per te pandehurin ne uljen e 1/3 te mases se denimit ne rast se ai gjendet fajtor [11] Gjithashtu ne kete vendim Kolegji i Bashkuar i Gjykates se Larte i dha dhe nje unifikim praktikes duke konkluduar se kur shqyrtimi gjyqesor ka filluar me gjykim te zakonshem, nuk mund te vazhdohet me tej me gjykimin e shkurtuar. Ky eshte nje vendim shume i rendesishem ne praktike, pasi tregon edhe njehere rendesine e duhur qe duhet t'i kushtohet momenteve proceduriale ne nje proces gjyqesor, te drejtave te te pandehurit dhe ruajtjen e nje balance midis mbrojtjes se komunitetit nga kriminaliteti dhe mbrojtjeve te lirive dhe te drejtave themelore te njeriut bazuar ne parimet e se drejtes penale, drejtesine restauruese dhe qellimin e plote te ndeshkimit.

Subjekti i pandehur "grua"

Ka disa momente shume te rendesishme per trajtim dhe dhenie pergjigje ne lidhje me gjykimin e shkurtuar. Neni 31 i Kodit Penal te Republikes se Shqiperise ndalon shqiptimin e denimit me burgim te perjetshem per grate dhe ndaj personave qe ne kohen e kryerjes se vepres penale nuk kane mbushur moshen 18 vjec. Nese kjo dispozite imperative eshte apo jo diskriminim gjinor eshte nje diskutim tjeter. Fokusi yne eshte tek gjykimi i shkurtuar si nje gjykim i posacem. Neni 31 ne forme imperative e ndalon shqiptimin e ndeshkimin per grate me burgim te perjetshem, nderkohe qe neni 403 pika 3 e Kodit te Porcedures Penale parashikon se kerkesa per gjykim te shkurtuar nuk paraqitet ose dhe nese eshte paraqitur nuk pranohet nga gjykata kur subjekti akuzohet per nje veper penale qe parashikon marzhin e ndeshkimit ne maksimime vete, i cili eshte burgimi i

[11] Vendimi Unifikues I Gjykates se Larte nr.2 date 29/01/2003

perjetshem. Nga nderlidhja e ketyre dy momenteve mund te konkludohet qe nese nje grua akuzohet supozojme per vrasje me paramendim te parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal qe parasheh ndeshkimin me burgim te perjetshem, atehere per shkak te nenit 31 te Kodit Penal qe ndalon ndeshkimin e tyre me burgim te perjetshem, atehere ne minimumin qe parasheh dispozita, e pandehura potencialisht mund te ndeshkohet me 20 vjet burgim. Duke qene se nuk ndeshkohet me burgim te perjetshem si pasoje e nje norme urdheruese ndaluese, atehere a mund te legjitimohet ajo ne kerkimin e gjykimit te shkurtuar konform nenit 403 te Kodit te Procedures Penale duke e ulur masen e ndeshkimit te saj me 1/3 e denimit? Definitivisht jo! Kjo nuk ndodh per arsye sepse nje sere vendimesh gjyqesore, perfshire ketu edhe vendimet e Gjykatave te Larta e cila sherben si gjykate ligji, e kane argumentuar mjaft mire dhe ne harmoni me dispozitat ligjore, doktrinen juridiko-penale, te drejten pozitive qe pengesa per mospranimin e gjykimit te shkurtuar nuk lidhet me masen e denimit te dhene dhe as me subjektin, por me te miren shoqerore te cenuar, me vepren penale te shkelur dhe tablo me te qarte te ketij deduksioni e nxjerr veten neni 403 i Kodit te Procedures Penale e cila thote se : *Nuk lejohet kerkesa per gjykim te shkurtuar per veprat penale per te cilat parashikohet denimi me burgim te perjetshem.* Pra, vete ligji i jep nje koneksiteti gjykimit te shkurtuar me vepren penale te cenuar. Per t'ju rikthyer shembullit te marre me nenin 78 te Kodit Penal, vrasje me paramendim qe parasheh sanksion minimal 20 vjet dhe maksimal burgim te perjetshem, le te analizojme conform ketyre dispozitave kur ajo cenohet nga nje I pandehur mashkull, kur ajo cenohet nga nje e pandehur femer dhe si prejashtohen te dyja kategorite nga gjykimi I shkurtuar. Kur kjo dispozite cenohet nga nje mashkull, ai rrezikon ndeshkimin e tij me burgim te perjetshem, gje qe potencialisht gjykata ia shqipton dhe duke qene se akuzohet per nje veper penale qe ndeshkohet me burg perjete, i pandehuri nuk mund te kerkoj gjykim te shkurtuar pasi ndalohet nga ligji. Kur po kjo veper penale cenohet nga nje e pandehur femer, edhe ky subjekt nuk perfiton nga gjykimi i shkurutar sepse ne forme imperative, urdherore ndaluese ligjvenesi e ka parashikuar ne lgjin procedurial, duke e lidhur kete forme te gjykimit te posacem me vepren penale dhe jo me subjektin. Ndersa te dy subjektet nuk legjitimohen te kerkojne gjykimin e shkurtuar, subjekti grua ka nje garanci ligjore qe ndryshe nga subjekti mashkull, nuk i shqiptohet ndeshkimi me burgim te perjetshem.

I mituri ne konflikt me ligjin

Se pari duhet theksuar kjo sitate dhe kur subjekti eshte i mitur, pavaresisht parashikimeve ne Kodin Penal dhe Kodin e Procedures Penale ajo eshte nje situate blankete e cila referon ne nje ligj te posacem, sic eshte Kodi i Drejtesise Penale per te Mitur, ku edhe terminologjia jurdike ndryshon, pra i mituri nuk konsiderohet "i pandehur" ne proces por merr nje emertim tjeter "i mituri ne konflikt me ligjin" ku ka po te njejten vlere proceduriale, thjesht ne dukje lehteson poziten e te miturit.

Vlen te theksohet, kjo per shkak te rendesise dhe situatave komplekse qe kane sjelle nryshimet reformatore ne drejtesi ne vitin 2016 e per pasoj edhe ne Kodin e Procedures Penale. Konkretisht neni 403 i KPRP i titulluar "kerkesa per gjykimin e shkurtuar", pika e tij e dyte ka pesuar nje ndryshim me ligjin nr.35/2017 date 30.03.2017[12] , ku u sanksionua ne formen imperative te parashikuar nga ligji ndryshimi ne piken dy, ku sot ne fuqi kemi kete parashikim ligjor: *"Nuk lejohet kerkesa per gjykim te shkurutar per veprat penale per te cilat parashikohet denim me burgim te perjetshem*"

Ky rregullim ligjor, pati problematika ne praktik ne lidhje me te miturit ne konflikt me ligjin.

Neni 31 i Kodit Penal ndalon shqiptimin e denimit me burgim te perjetshem te grave dhe te personova qe ne kohen e kryerjes se vepres penale nuk kane mbushur moshen 18 vjec.

Neni 5 i KDPM: *Dispozitat e Kodit Penal, te Kodit te Procedures Penale dhe te ligjeve te tjera zbatohen ne procesein e drejtesise penale per te mitur vetem per ceshtjet qe nuk jane te rregulluara nga ky kod ose nese mbajne rregullime me te favorshme per te miturit*

Neni 97 pika 2 e Kodit te Drejtesise Penale per te Mitur parashikon se :*Per te miturit denimi me burg nuk mund te jete me shume se gjysma e denimit qe parashikohet per vepren penale te kryer, por gjithnje jo me shume se 12 vjet* [13]

[12] Shih ligjin e referuar
[13] Kodi I Drejtesise Penale per te Mitur ne Shqiperi

Neni 403 pika 2 e Kodit te Porcedures Penale*: Nuk lejohet kerkesa per gjykimin e shkurtuar per veprat penale per te cilat parashikohet denimi me burgim te perjetshem*

Se dyti, interesi me i larte i femijes apo i te miturit eshte nje parim universal i cili shpesh duhet konkretizuar dhe materializuar ne menyre qe te mos ngelet cmimi i tij vetem abstrakt dhe ky interes eshte i parapare ne te drejtat konvetore per mbrojtjen e te drejtave te femijeve si dhe ne nje sere normash juridike ne Shqiperi. Neni 403 pika 2 e Kodit te Proc.Penale solli gjate implementimit te tij ne vitin 2017 dhe deri ne vitin 2024, "tymnaje" juridike ne lidhje me gershetimin e elementeve te parimit me te larte te femijes apo togfjaleshit te shprehur ne nenin 5 te KDPM....*ose nese mbajne rregullime me te favorshme per te mitur ...* me parime te tjera te se drejtes sic eshte barazia perpara ligjit, efektiviteti i drejtesise, mbrojtja e shoqerise nga kriminaliteti , gje e cila reflektoj ne nje praktike ku shume gjykata mbanin qendrime nga me te ndryshmet. Kjo solli qe ne Kolegji Penal i Gjykates se Larte e vendimin nr.167 date 04.07.2024 te unifikonte praktiken gjyqesore ne lidhje me kete problematike duke e nenshtruar si pyetje nese i mituri ne konflikt me ligjin, te cili i atribuohet nje veper penale e cila parashikon denim me burgim te perjetshem, a do t'i lejohet aplikimi i nenit 403 pika 2 te KPRP ? Kolegji Penal me vendimin e tij unifikues vendosi :*56. Në përfundim të kësaj analize, në lidhje me çështjen e shtruar për njësim, Kolegji mban këtë qëndrim njësues: "Ndalimi i parashikuar nga neni 403, pika 2 i Kodit të Procedurës Penale, zbatohet edhe për subjektet ndaj të cilëve ligji penal ndalon dhënien e dënimit me burgim të përjetshëm*[14].

Se treti, interesi me i larte i te miturit eshte pranuar si nje parim universal dhe qe duhet materializuar. Ne te drejten familjare, ky lloj materializimi mund te hasi problematikat e veta, por jo ne te drejten penale. Ne te drejten penale interesi me i larte i te miturit eshte materializuar nga forma abstrakte qe ai ka si grup emeror, duke ndaluar rreptesisht aplikimin e denimit me burgim te perjetshem tek te miturit, gje e cila sanksionohet ne nenin 31 te Kodit Penal. Madje, jo vetem kaq, por ky interes eshte parashikuar edhe me ligj te vecante ku shpesh edhe sipas parimit qe kur normat e pergjithshme kane konflikt me normat e posacme, zbatohet parimi i

[14] Shih Vendimin NJesues te Kolegjit Penal te Gjykates se Larte te Republikes se Shqiperise me nr.167 date 04.07.2024

specialitetetit lex specialis derogat legi generali, qe nenkupton zbatueshmerine e normes se posacme dhe shmangien nga norma e pergjithshme kur te dyja rregullojne te njejten lende[15]. Ky parim i specialiteti nuk mjaftohet vetem me prejashtimin e shprehur ne nenin 31 te Kodit Penal, por si nje situate blankete referon ne Kodin e Drejtesise Penale per te Mitur si nje ligj i posacem dhe norme e posacme qe perbene teresine e normave juridike qe rregullojne marredheniet konfliktuale te te miturit me ligjin. Ky kod i posacem per te mitur sic dhe eshte permendur me larte aplikon vetem gjysmen e denimit me burgim qe parashikon vepra penale per te mitur, por gjithnje jo me shume se 12 vjet burg, duke e mbrojtur ketu interesin me te larte te te miturit edhe ne dy raste apo forma te tjera, ku krahas prejashtimit nga burgimi i perjetshem, edhe ne mosdenimin e tij me me shume se gjysma e denimint qe parashikon dispozita, por gjithnje, nese dispozita parashikon minimumi 30 vjet burg, per shembull neni 79/a i Kodit Penal "Vrasje e funksionareve publik" qe parasheh minimumin e sipercituar, serish i mituri nuk ndeshkohet me 15 vjet burg, pasi ka akoma dhe nje rregullim ligjor i cili ishte , *por gjithnje (qe nenkupton se ne te gjitha rastet) jo me shume se 12 vjet burg.*

Nderkohe qe ne te drejten penale interesi me i larte i te miturit si parim materializohet ne gjithe keto lehtesira per te, neni 403 pika 2 e Kodit te Procedures Penale nuk mund te interpretohet ne favor te te miturit, favoret e te cilit jane mjaft mire te materializuara ne te gjithe arsyetimin e argumentuar me siper sepse krahas interesit me te larte te te miturit, neni 403 pika 2 e ligjit procedruialo-penal ka si synim mbrojtjen e nje interesi edhe me te madh, ate te komunitetit. Jo me kot ligjvenesi ka parashikuar prejashtimin nga aplikimi i gjykimit te shkurutar per autoret e veprave penale qe parashikohet denimi me burg perjetshem, per shkak te rrezikshmerise se ketyre veprave, cenimit me te rende te ligjit penal dhe qellimin e se drejtes penale per mbrojtjen e te mirave te perbashketa. Pra, edhe tek te miturit njesoj si tek subjektet gra, mbrohet shoqeria, mbrohet objekti qe ka si synim ruajtjen dhe moscenimin e atyre marredhenieve juridike qe kane nje shkalle rrezikshmerie te atill qe cenojne te mirat me te larte qe mbrohen nga ligji penal, sic mund te jete e drejta e jetes. Perfundimisht, i mituri ne konflikt me ligjin per veprat e atilla penale nuk perfiton nga gjykimi i shkurtuar pasi

[15] Shih vendimin nr 62-2024-5474 date 28.10.2024 te Gjykates se Shkalles se Pare me Juridiksion te Pergjithshem Fier

pengesa e paraqitur ne nenin 403 pika 2 nuk lidhet me gjinin e subjektit e as me strukuren e tij moshore, madje as masen e denimit ndaj ketyre subjekteve te prejashtuara nga shqiptimi i denimit kapital *(me burg perjete*), por me vepren penale, me objektin e cenuar dhe shkalla e larte te rrezikshmerise qe paraqet cenimi i nje objekti te tille.

Urdheri penal

Njesoj si cdo gjykim tjeter i posacem, urdheri penal normohet nga nenet 406/a deri tek neni 406/ç. Pertej parimeve qe udheheqin te drejten tone penale dhe shkencen penale ne pergjithesi karakteristika e vecante e urdherit penal eshte fakti se ky nxirret dhe firmoset nga prokurori per denimet qe qe perbejne kundravajtje penale dhe kryesisht per ato vepra penale qe parashikojne deri ne nje vit burgim. Nese do te shohim disiplinimin qe Kodi Penal i ka bere denimeve alternative do te shohim se nder denimet alternative jane, gjysme liria (neni 58 i KP), pezullimi i ekzekutimit me burg dhe venia ne prove e cila ne terma populist njihet si sherbim prove (neni 59 i KP) , qendrimi ne shtepi (neni 59/a i KP), liria me kusht (neni 64 i KP) dhe pezullimi i ekzekutimit te vendimit me burg dhe kryerja e nje pune ne interes publik (neni 63 i KP). Nga denimet alternative, vetem qendrimi ne shtepi dhe lirimi me kusht jane forma alternative te denimit me burg qe kerkohen gjate ekzekutimit te vendimit, nderkohe tek format e tjera kerkohet dhe zbatohen ne rast se pranohen, perpara se te ekzekutohet vendimi me burg. Ne te gjitha format e tjera te denimeve alternative deshmia e penalitetit te te denuarit del jo e paster (*i/e denuar*), nderkohe qe vetem aplikimi i nenit 63 te Kodit Penal rezulton qe ne fund te kryerjes se denimit, qe kryesisht eshte me ore pune ne komunitet, deshmia e penalitetit per te denuarin del e paster.

Po te njejten karakteristik ka edhe urdheri penal si forme e posacme e gjykimit, e cila i eshte lene ne dore prokurorit, kjo edhe per shkak te rrezikshmerise se paket te vepres penale, edhe per shkak se perbene kundravajtje penale, edhe per shkak se denimi kryesor eshte ai me gjobe. Ne te tille rast prokurori e nxjerr urdherin penal te arsyetuar dhe i pandehuri duhet te paguaj ne favor te shtetit shumen e percaktuar ne urdherin penal. Denimi i tij nuk shenohet ne gjendjen gjyqesore duke qene dhe ky eshte benefiti qe i pandehuri ka ne kete proces, mirepo ligji ka percaktuar se denimi i dhene nuk reflektohet ne gjendjen gjyqesore vetem ne rast se ai nuk eshte perserites, duke referuar keshtu tek personaliteti i te pandehurit.

Personaliteti i tij reflekton ne gjendjen gjyqesore, gjendjen familjare, gjendjen ekonomike, rrezikshmerine e tij, moshen, qendrimin qe ka mabjtur pas kryerjes se vepres penale dhe gjate hetimit, rregullimin e marredhenieve me viktimen dhe pendimin e tij. Rendesi te vecant dispozita i kushton gjendjes gjyqesore, ku sic u cituan me siper, ne rast se nuk eshte i denuar, me urdherin penal, i pandehurit nuk do t'i perfshihet denimi tek gjendja gjyqesore dhe nuk i ngarkohen shpenzimet proceduriale. Perfitimi nuk eshte vetem ne favor te te pandehurit, por edhe ne favor te shtetitn , perfitime keto te cilat lidhen me ekonomine gjyqesore, pranimin e fajesise nga i pandehuri, efektivitetin e procedures penale dhe dhenien e drejtesise pa e demtuar ate. Qartesisht neni 406/a ka percaktuar edhe mundesine paguese te te pandehurit, gjendja ekonomike e te cilit duhet te cmohet nga Prokurori.

Miratimi ose refuzimi i kerkeses per urdherin penal

Pavaresisht se kushtet kryesore per te cilat mund te aplikohet ky gjykim i posacem kane te bejne me rrezikshmerine e paket te vepres penale dhe legjitimimin e prokurorit per te caktuar denimin tek urdheri penal, denim i cili eshte me gjobe, serish ligjvenesi e ka pare te arsyeshme rolin aktiv te gjykates per te vleresuar nje vendim te tille denim. Roli i gjykates eshte vetem kontrollues si organi qe zbaton drejt peshoren e Justicias, pasi ne fund asnjehere nuk duhet harruar qe Prokurori eshte nje gjithnje pale ne process dhe gjykata eshte ajo qe duhet te cmoj efektivitetin e drejtesise. Ne te tille rast, gjykata duke patur rolin e saj aktiv ne kontrollin dhe shqyrtimin e marreveshjes vlereson nese ceshtja mund te zgjidhet ne gjendjen qe jane aktet, nese denimi me gjobe i parashikuar ne urdherin penal apo denimet e tjera plotesuese jane apo jo te pershtatshme dhe nese ezkistojne shkaqe ligjore qe cojne ne pushimin e akuzes. Keto situate jane shkaqe qe gjykata te refuzoj miratimin e urdherit penal duke vepruar ne dy menyra. Se pari kur vepra penale ka shkaqe te pushimit te akuzes, vendos pushimin e ceshtjes. Se dyti, kur vepra penale sipas cmimit te gjykates nuk zgjidhet ne gjendjen qe jane aktet ose vepra penale nuk gjen zbatim per urdherin penal, pra i jep nje cilesim tjeter juridik duke e konsideruar krim, ajo e refuzon miratimin e marreveshjes duke i kthyer aktet prokurorit. Per mosmiratimin e urdherit penal, mund te kundershtohet nga palet dhe ne raste te tilla i pandehuri ka te drejten te kerkoj gjykim te shkurtuar e nese nuk paraqitet kerkesa ne formen e kerkuar nga ligji, vazhdohet me gjykim te zakonshem.

Nderkohe, qe neni 406/b parashikon vendimin e gjykates per miratimin e urdherit penal, qe zakonisht ne praktik ndodhe miratimi i tij. Si ne cdo vendim tjeter gjyqesor, edhe ne miratimin e ketij gjykimi te posacem, gjykata mban parasysh kriteret e percaktuara ne nenin 406/b pika 1 e Kodit te Procedures Penal. Karakteristika nga ana permbajtesore e ketij neni eshte fakti se ai referon ne nenin 34 te Kodit Penal qe parashikon denimin me gjobe. Faktikisht, gjykata nuk ndryshon dot denimet e percaktuara ne urdherin penal, por me kerkesen e te pandehurit ajo mund te procedoj sipas nenit te referuar me siper ne Kodin Penal. Kjo gje ndodh vetem ne fazen e ekzekutimit te vendimit dhe jo me perpara, faze e cila lidhet me pagimin e gjobes dhe gjykata mund te cmoj rrethanat e gjendjes ekonomike te te pandehurit, gje te cilen nuk e bene kryesisht, por me iniciative te te pandehurit.

Mirepo cfare thote neni 34 e vecanerisht paragrafi i 8 i tij?

Neni 34 paragrafi 8 i Kodit Penal: *Kur i denuari nuk e paguan gjoben dhe gjoba nuk mund te vilet nepermjet ekzekutimit te detyrueshem, gjykata zevendeson gjoben me burgim, duke llogaritur pese mije leke per nje dite burgimi* . [16] Kjo dispozite shenon dy momente alternative, mospagimin e gjobes me vullnet, gje e cila con ne ekzekutim te detyrueshem te saj dhe mospagimin e gjobes per shkak te pamundesise se te denurit per t'a kryer ate. Forma ligjore dhe rregullimi qe ka paraqitur ligjvenesi eshte qe duke qene se gjoba nuk mund te paguhet, pjesa e mbetur e saj do te kryhet me burgim duke pjesetuar gjoben e mbetur me 5 mije leke qe eshte e barabarte me 1 dite burgim. Konkretisht: Nese i denuari A nepermjet urdherit penal eshte sanksionuar denimi i tij me 200,000 mije leke borxh, pothuajse e barabarte me 2 mije euro *(shih nenin 34 paragrafi 4*) dhe pas miratimit te urdherit penal nga gjyakat, i denuari ka paguar vetem 50 mije leke ose rreth 500 euro dhe inicion proceduren ne gjykate sipas nenit 406/a pika 2 te KPRP, gjykata mund te procedoj sipas paragrafit te 8 te nenit 34 te Kodit Penal duke e zevendesuar shumen e mbetur prej 150,000 lekesh ose rreth 1500 euro duke e pjesetuar ate me 5 mije leke qe parashikon dispozita per nje dite burg ose rreth 50 euro dhe duke nxjerr rezultatin final te diteve burg qe duhet te beje. Konkretisht nga kazusi i marr per efekt kuptueshmerie te dispozitave proceduriale eshte shuma 150,000 leke qe duhet te paguaj pjesetohet me

[16] Neni 34 I Kodit Penal

shumen 5,000 leke qe i referohet nje dite burg dhe del e barabarte me 30 dite burg qe i denuari duhet te kryeje. Perpos kesaj gjykata ka alternativen edhe te aplikimit te nenit 63 te Kodit Penal per te urdheruar kryerjen e nje pune me interes public.

Ajo qe ngelet gjithnje e pandryshuar dhe ne perfitimi te te denuarit eshte fakti qe edhe nese zevendesimi i shumes monetare me kryerjen e 30 diteve burgim, gjendja e tij gjyqesore do te ngelet e paprekur. I pandehuri do te rezultoj i/e pa denuar

Gjykimi me marreveshje

Marreveshja eshte nje institut procedurialo-penal i formalizuar me nje akt shkresor dhe i nenshkruar nga palet per nje sere veprash penale qe parashikon ne thelb dakordesine midis prokurorit dhe te pandehurit per te zgjedhur nje forme alternative denime, kushtezuar nga pranimi deklarativ i fajesise nga i pandehuri, pranimi prej tij i akteve ne gjendjen ne te cilen ndodhen dhe dakordesia e mases se pershtatshme e llojit te denmit, menyrat dhe format e ekzekutimit te tij[17].

Ky lloji perkufizimi i gjykimit me marreveshje si nje gjykim i posacem ne te drejten penale, garanton disa te drejta ku thelbi i se ciles nuk duhet te jete cenimi i efektivitetit te drejtesise, por nje kompromis qe te gjitha palet te jene te "kenaqur" duke shmangur keshtu hetimet gjyqesore si dhe fazen e kontradiktoritetit te paleve, shpenzimet e teperta hetimore dhe gjyqesore (parimi i ekonomise gjyqesore), duke dhene nje drejtesi efektive dhe ne kohe ,duke i dhene te pandehurit mundesine per te dakordesuar per masen dhe llojin e denimit si dhe duke garantuar parimin e humanizmit.

Se pari, kuptojme qe subjektet te cilat mund te iniciojne proceduren e gjykimit me marreveshje jane 1)Prokurori, 2) i pandehuri, 3) avokati i te pandehurit

Se dyti, kujdes te vecante organi i akuzes i ka kushtuar faktit kur i pandehuri eshte subjekti i cili kerkon te hyj ne negociata me Prokurorin per arritjen e nje marreveshje. Per kete rast, Prokuroria e Pergjithshme ka nxjerr

[17] Material I pregatitur nga ekspertja magjistrate znj,Anita Jella prane Shkolles se Magjistratures

nje Udhezim me nr.9. dt.21.12.2021 qe rregullon keto aspekte proceduriale te kryerjes se negociatave.

Ky udhezim ka nje rendesi te vecante sidomos per organin e akuzes e cila duhet te kete parasysh edhe mbrojtjen e interesit publik dhe ne momentin kur sheh, kupton apo merr propozime te natyrave te tilla te gjykimit me marreveshje duhet t'i kerkoj te pandehurit ose mbrojtesit te tij qe propozimi te jete me shkrim, gje e cila i mundeson organit te akuzes marrjen e kohes se nevojshme per te vleresuar mbi propozimin dhe permbajtjen e tij.

Ne udhezimin e permendur me larte Prokurori duhet te vleresoj kushtet ligjore vecanerisht kushtin qe ka te beje me piken 2 te nenit 406/d te Kodit te Procedures Penale e cila determinon faktin se marreveshja arrihet vetem per ato vepra penale qe ligji parashikon nje denim ne maksimum jo me te larte se 7 vjet burg. Nderkohe qe duhet te vleresoj dhe kushtet e tjera ligjore qe kane te bejne me: shmangien e diskutimeve ose zgjidhjen e shpejte te procesit, shkurtimin e hetimeve paraprake dhe dergimin e kerkeses per gjykimin e tij perfundimtar, zbulimin e veprave te tjera penale dhe aplikimin e denimeve alternative[18].

Nese prokurori arrine te konkludoj se propozimi duhet pranuar, ai hyn ne negociata me te pandehurin si dhe me mbrojtesin e tij. Kushti kryesor eshte pranimi ne forme deklarative dhe me shkrim i fajesise se te pandehurit dhe caktimi i mases se denimit e cila duhet te kete edhe pelqimin e te pandehurit dhe duhet cmuar duke vleresuar menyren se si caktohet denimi sipas neneve 47-50 te Kodit Penal duke marre parasysh rrezikshmerine e vepres penale, personalitetin e te pandehurit, shkallen e fajit si dhe rrethanat lehtesuese te te pandehurit.

Marreveshja e arritur duhet te kete nenshkrimin e paleve (prokurorit dhe te pandehurit) si dhe te avokatit. Ajo duhet te permbaje parashikimin e qarte te faktit penal qe i atribuohet, pranimin e fajesise, llojin dhe masen e denimit si dhe menyren e ekzekutimit te tyre per te cilet palet kane rene dakord, disponimet mbi provat etj. Te gjitha keto kane pasoja pavlefshmerie nese nuk i permbahen pershkrimit te mesiperm e cila referon tek neni 406/d i Kodit te Procedures Penale[19]. Perpos kushtit determinant qe percakton ligji i

[18] Neni 4 I Udhezimit nr.9 dt.21.12.2021 te Prokurorit te Pergjithshem
[19] Neni 406/d I KPRP te RSH

cili eshte vetem per veprat penale qe parashikohet denim deri ne 7 vjet burgim, kusht tjeter eshte pranimi i pjesshem i akuzave, gje e cila nuk pranohet dhe nuk mund te procedohet me kete lloj gjykimi te posacem, sic eshte gjykimi me marreveshje.

Tek gjykimi me marreveshje, nuk duhet ngaterruar me bashkepunetorin e drejtesise, gje e cila eshte nje parashikim tjeter ligjor qe k ate beje me nxjerrjen ne pah te elementeve te shumte criminal dhe per vepra penale qe jane mbi 7 vjet burgim , ku i pandehuri mund te lidhi nje marreveshje duke perfituar statusin e bashkepunetorit te drejtesise, gje e cila e ndihmon jo vetem te pandehurin, por vecanerisht shtetin per zbulimin e krimeve te renda, parandalimin e krimeve te renda, pasurite me origjine krimanale. Ne rastin e bashkepunetorit te drejtesise, ai deshmon pa rezerve ne drejtim te provueshmerise se fakteve dhe autoresese dhe ne dallim nga gjykimi me marreveshje si gjykim i posacem, statusi i bashkepunetorit perfitohet edhe gjate ekzekutimit te vendimit te formes se prere. Ky parashikim ligjor eshte parapare nga ligjvenese jo vetem ne funksion te se drejtes penale bashkekohore, por edhe per benefitet qe ka shteti dhe qe duhet te marri shoqeria ne zbulimin e kriminalitetit, grupeve te strukturuara kriminale apo krimeve te tjera te renda, zbulimi i te cilave ka ne fokus jo vetem venien e drejtesise kundrejt te mires se cenuar, por edhe sigurine juridike dhe mbrojtjen e komunitetit nga kriminaliteti

Le te rikthehemi tek gjykimi me marreveshje si nje gjykim i posacem dhe momenti procedurial se kur mund te procedohet me gjykim me marreveshje.

Ne hetimet paraprake e parapare kjo ne nenin 406/d pika 1 ne menyre eksplicite

Ne seance paraprake kur ajo paraqitet ne ate moment dhe gjykata vepron sipas parashikimeve te nenit 406/d dhe 406/dh pika 1 si dhe nenit 332/dh te Kodit te Procedures Penale \

Dhe perpara se te kete filluar shqyrtimi i ceshtjes ne seancen e themelit si dhe kur palet e kane arritur marreveshjen dhe ia paraqesin gjykates ne kete moment.

Keto tre raste proceduriale tregojne dhe momentet e duhura kur palet kane mundesi t'i drejtohen gjykates per miratimin e marreveshjes dhe nese ceshtja ka hyre ne shqyrtimin gjyqesor ne gjyq themeli, ajo nuk mund te paraqitet e per rrjedhoje nuk mund te aplikohet ky gjykim i posacem.

Roli i gjykates eshte i rendesishem ne disa aspekte, duke vleresuar vullnetin e te pandehurit i cili duhet te jete prezent ne diten e gjykimit , duke vleresuar dhe siguruar qe i pandehuri i ka kuptuar si permbajtjen e marreveshjes ashtu edhe pasojat qe vijne prej saj si dhe pelqimin e tij i cili duhet t'a shprehi edhe perpara gjykates ne menyre qe ajo te disponoj me vendimin e miratimit.

Gjykata e miraton vendimin kur ajo eshte konform dispozitave te neneve 406/dh dhe 406/e te KPRP, duke verifikuar kushtet, cilesimin e sakte juridik te vepres penale dhe te fakteve penale, pelqimin e te pandehurit dhe pjesmarrjen e mbrojtesit te zgjedhur me prokure ose kryesisht nga i pandehuri ose shteti per te pandehurin. Gjykata perpos se vlereson keto kushte formale te shprehura ne ligj si dhe sigurohet ne moscenimin e efektivitetit te drejtesise, ajo nuk mund te ndryshoj kushtet e marreveshjes se arritur mes paleve.

Gjithashtu Gjykata mund edhe te refuzoj miratimin e marreveshjes per rastet e shprehura ne nenin 406/é te Kodit te Procedures Penale sic jane :

Terheqja e pelqimit te te pandehurit. I pandehuri mund t'a terheqi pelqimin ne lidhje me marreveshjen ne cdo faze te saj, njekohesisht edhe prokurori kur ka shkaqe te perligjura. Prandaj dhe eshte e domosdoshme aq sa eshte e rendesishme verifikimi i pelqyeshmerise dhe vullnetit te te pandehurit, pjesemarrja e tij ne procesin gjyqesor.

I pandehuri nuk merr pjese ne gjyq. Ketu dispozita referon tek nenet e tjera te ligjit procedurial qe kane te bejne me njoftimet duke e lidhur mungesen e tij me dhenien pergjigje te pyetjes nese thirrja e tij eshte bere rregullisht dhe ai ka dijeni per gjyqin apo jo, ne rast te kundert seanca shtyhet. Mirepo, kur i pandehuri ka dijeni per gjyqin, eshte njoftuar rregullisht dhe nuk eshte paraqitur, gjykata e refuzon miratimin e marreveshjes, pavaresisht se ne piken C te nenit te sipercituar te ligjit procedurial, ligjvenesi ka lejuar dhe hapesira kur kjo mungese mund te justifikohet duke cituar togfjaleshin "pa shkaqe te perligjura", pasi mund te

ndodh qe i pandehuri mund te kete realisht shkaqe te arsyeshme sic mund te jene gjendja e tij shendetesore gje e cila mund t'i pamundesoje pranine ne gjyq. Ne raste te tilla ai ka barren e proves per te provuar se ka shkaqe te perligjura per mungesen e tij, duke kerkuar edhe shtyrjen e seances.

Kur provat ne fashikullin e hetimeve vijne ne kundershtim me pohimin e te pandehurit se ai e ka kryer vepren penale. Kjo pike ka rendesi per arsye se gjykata sic eshte cituar ne kete punim nuk ka vetem rolin e shqyrtimin formal te kerkeses, por edhe te moscenimit te drejtesise efektive, ruajtjen e balancave dhe ekuilibrit midis interesit te Prokurorise dhe ate te te pandehurit.

Papershtatshmeria e denimit. Sic edhe u theksua se ne marreveshje duhej caktuar edhe denimi i cili duhet te jete ne proporcion me vepren, duke referuar tek caktimi i denimit te tij edhe tek rrethanat lehtesuese, personaliteti i te pandehurit, shkalla e rrezikshmerise se vepres penale etj. Madje palet duhet te jene te kujdesshem kur miratojne nje nder pikat me te rendesishme te marreveshjes , sic eshte denimi, sepse gjykata mund te refuzoj miratimin e tij. Madje, po te shohim vendimin nr.3222 date 5.12.2018 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, shihet refuzimi i marreveshjes per arsye se palet kishin dakordesuar qe denimi me burg te perkthehej ne 4 muaj sherbim prove duke aplikuar nenin 59 te Kodit Penal, nderkohe qe gjykata e gjeti denimin te papershtatshem duke argumentuar se personaliteti i te pandehurit tregon alkoolizim dhe se ne marreveshje duhej shtuar edhe nje denim plotesues sic eshte ai i parashikuar ne nenin 37 te Kodit Penal qe ka te beje me ndalimin e drejtimit te automjetit[20].

Kur cilesimi juridik i vepres penale ose i rrethanave te vepres penale eshte i gabuar dhe per rrjedhoje gjykata nuk mund te miratoj marreveshje.

Nje tjeter rast kur gjykata nuk miraton marrveshjen perpos elementeve te parashikuara ne nenin 406/é te KPRP eshte edhe kur mungojne nenshkrimet e paleve ne proces, kur i pandehuri nuk ka qene ne pranine e mbrojtesit kur ka negociuar ose arritur marreveshje

Per te trajtuar edhe tek ky gjykim i posacem se cndodh me padine civile ne procesin penal, ligjvenesi ka parashikuar se kur ne proces kemi

[20] Shih vendimin nr.3222 date 05.12.2018 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane

padites civil, ai behet pjese e marreveshjes duke dakordesuar ne lidhje me demshperblimin civil te ardhur si pasoje e kryerjes se vepres penale dhe gjithashtu ka te drejten te jete pjese e saj si dhe te njoftohet. Paditesi civil jep pelqimin e tij ne lidhje me demshperblimin qe duhet te fitoj e ne rast se kjo nuk ndodh, marreveshja midis prokurorit dhe te pandehurit megjithese mund te jete nenshkruar ne prani te mbrojtesit te tij, ka pasoje pavlefshmerie.

Qellimi i legjislatorit ka qene te mbroj te drejtat themelore te njeriut, garancite proceduriale te te pandehurit, drejtesine, mosdiskriminimin dhe vecanerisht parimin e prezumimit te pafajesise ne rastet kur marreveshja refuzohet dhe i pandehuri ka deklaruar fajesine, ose ne rastet kur e ka terhequr pelqimin dhe vullnetin e tij per marreveshje, duke bere te mundur qe fajesia e tij e shprehur ne menyre deklarative te jete e paperdorshme. Kunder vendimit te gjykates per ratifikimin e marreveshjes nuk ka ankim, pasi gjykimi me marreveshje behet pikerisht per te shmangur keto te drejta qe te jep ligji dhe qe te dyja palet te dalin nga marreveshja ste fituar, parimisht , *win-win* , sic njihet ne diplomaci. Nderkohet qe vetem kur ceshtja pushohet nga gjykata, gje e cila passjell refuzimin e miratimit te marreveshjes, vetem atehere Prokurori mund te beje ankim ndaj vendimit te gjykates[21].

Gjykimi i drejtperdrejte

Gjykimi i drejtperdrejte eshte lloji i 4 i gjykimeve te posacme te parashikuar ne ne te drejten penale ne pergjithesi dhe ligjin procedurial ne vecanti.

Vecantia e gjykimit te drejteperdrejte dhe rendesia e tij paraqitet tek koha e shkurter e dhenies se drejtesise, mungeses se hetimeve te metejshme dhe konkludimin nga gjykata te efektivitetit te drejtesise. Gjykimi i drejtperdrejte ka disa specifika, ai iniciohet nga Prokurori dhe duhet te plotesoj disa kushte.

Se pari, ne arrestimin ne flagrance te subjektit ose autorit te dyshuar te vepres penale, prokuroria brenda 48 oreve paraqet prane gjyqtarit te hetimeve paraprake kerkesen per vleftesimin e arrestimit, kerkesen per masen e sigurise dhe kerkesen per gjykimin e shkurtuar. Kjo seance ka dy pjese , pjesa e pare gjykata shqyrton arrestimin ne flagrance nese ai eshte i

[21] Shih nenet 406/é, 406/f te Kodit te Procedures Penale

ligjshem apo jo dhe kerkesa e pare ka lidhje varesie me kerkesen per gjykimin e drejtperdrejte qe paraqet prokurori pasi ne rast se arrestimi ne flagranc vleftesohet si i paligjshem nga gjykata, atehere rrjedhimisht edhe gjykimi i drejtperdrejte nuk mund te aplikohet. Megjithate ligjvenesi ka lene hapesire kur edhe pse arresti mund te konsiderohet si i paligjshem, por palet ne gjykim, prokurori, i pandehuri dhe avokati i tij mund te japin pelqimin per te proceduar me gjykim te drejteperdrejte[22], kjo per shkaqe nga me te ndryshmet tek te cilat te dyja palet kane perfitimet e tyre, atehere gjykata edhe pse e ka vleftesuar arrestin si te paligjshem, ajo procedon me gjykim te drejteperdrejte.

Se dyti, pas pjeses se pare te seances se vleftesimit te arrestit dhe caktimit te mases se sigurimit, gjykata kur vendos mase sigurie arrest me burg ose arrest ne shtepi, ka te drejten pasi te kete marre ligjshmerine vleftesimi i arrestit ose pasi nuk konsiderohet i ligjshem, por ka pelqimin e paleve ne gjykim, te procedoj me gjykim te drejtperdrejte.

Se treti, gjykata nga paraqitja e kerkeses ne seancen e mases se sigurise duhet te konkludoj se ne gjendjen qe jane aktet, ato jane te plota dhe nuk kane me nevoje qe te kryhen hetime te metejshme si dhe i arrestuari nuk kerkon hetime te metejshme apo veprime te tjera hetimore shtese.

Nga analiza e mesiperme, derivon neni 400 i Kodit te Procedures Penale qe determinon kushtet se kur mund te procedohet me gjykimin e drejtperdrejte, kushte te cilat duhet te ekzistojne kumulativisht dhe jo alternativisht me njera-tjetren, ne rast te kundert ky gjykim i posacem nuk mund te procedohet.

Eshte i vetmi moment procedurial, kur gjyqtari i hetimeve paraprake mund te kthehet edhe ne gjyqtar themeli,vetem nese kushtet e percaktuara ligjerisht plotesohet si dhe kur vepra penale per te cilen dyshohet se autori e ka kryer ate nuk ka nje sanksion me te larte se 10 vite burgim dhe se ajo mund te gjykohet me nje trup gjyqesore te perbere prej nje gjyqtari[23]

Ky moment procedurial, kur eshte konstatuar ligjshmeria e arrestit, eshte caktuar masa e sigurise *(arrest me burg ose arrest shtepie)* kur eshte konkluduar se nuk ka me nevoje per hetime shtese, pasi provat jane te plota ,

[22] Shih "Avokati ne procesin penal" Agim &Esmeralda Gjoleka fq.81
[23]Shih vendimin nr.62-2026-241 date26.01.2026 te Gjykates se Shkalles se Pare me J.P. Fier

kur vepra penale eshte cilesuar drejt juridikisht dhe nuk eshte e sanksionueshme me me shume se 10 vite burg, gjykimi i drejtperdrejte mund te vijoj ne po te njejten date dhe dite me ate te vleftesimit dhe caktimit te mases se sigurise, duke celur keshtu shqyrtimin gjyqesor[24]. Gjithashtu, i pandehuri ka te drejte te kerkoj gjykimin e shkurtuar dhe gjykata te zbatoj rregullat procedurial te parashikuar ne Kodin e Procedures Penale dhe dispozitat e normuara dhe te elaboruara ne kapitllin 1 te ketij punimi. Neni 402 i KPRP me titull "Zhvillimi I gjykimit te drejtperdrejte", disiplinon edhe faktin kur mbrojtja ka ate drejten per te marr nje afat te konsiderueshem per te pregatitur mbrojtjen e saj, afat te cilin ligjvenesi e ka percaktuar deri ne 5 dite[25].

Perfundimi i gjykimit te drejtperdrejte nenkupton gjithashtu edhe dhenien e vendimit te gjykates ne lidhje me fajesine si dhe denimin e tij ne rast fajesie ose pafajesine e te pandehurit. Ky gjykim per organin e akuzes paraqet rendesine e efektiviteti te drejtesise, ekonomine gjyqesore, dhenine e drejtesise ne forme te shpejte dhe efikase si dhe permbushjen e dispozitave kushtetuese qe parashikojne te drejten e gjuthkujt per t'u gjykuar ne nje kohe te arsyeshme, shkaqe po kaq te rendesishme edhe per te pandehurin i cili ne efikastitetin dhe efektivitetin e drejtesise kundrejt tij, ka te drejten edhe te gjykimit te shkurtuar, gje e cila perpos shpejtesise se dhenies se vendimit ne perballjen e tij me drejtesine, ka edhe benefitin e uljes se 1/3 se denimit ne rast se deklarohet fajtor nga gjykata.

Perfundimet dhe konkluzonet

Substancialiteti i gjykimeve te posacme perkthehet ne efikasitetin dhe disponimin e nje vendimi gjyqesor ne sherbim te drejtesise ne nje kohe te shpejt, reale, efikase duke garantuar keshtu barazine ne perfitimin qe palet kane ne proces, qofte ky shteti qofte ky i pandehuri. Te katerta gjykimet e posacme ne te drejten penale bazohen ne po te njejtat parime dhe mbi te gjitha ne ate te humanizmit, parim ky i cili gjen zbatim ne te gjitha vendet europiane. Gjykimi i shkurtuar eshte nder gjykimet me te perhapura dhe me te perdorura ne procesin penal. Aplikimi i tij , sic dhe u argumentua ne kete punim nuk do te thote pranim fajesie, gje e cila ndodh vetem tek gjykimi me marreveshje, por perkundrazi me gjykimin e shkurtuar pala ka te drejte te

[24] Shih vendimin nr. 210 date 08.03.2026 te Gjykates se Shkalles se Pare me J.P.Fier
[25] Neni 400-402 I Kodit te Procedures Penale.

kerkoj pafajesine, gje e cila ndodh ne praktikat gjyqesore. Qellimi i gjykimit te shkurtuar ne vecanti eshte te ul kostot hetimore te panevojshme kur ceshtja mund te marre rrugezgjidhje ne gjendjen qe jane aktet dhe ne rast fajesie te te pandehurit te kete perfitimin e 1/3 se denimit, gje e cila nuk duhet ngaterruar me rolin qe shteti ka ne luften e perditshme kunder kriminalitetit. Pavaresisht perfshirjes se te miturve ne procese te ndryshme penale si dhe te subjektit grua, Kolegji Penal i Gjykates se Larte e zgjidhi me njesim kete ceshtje duke e lidhur aplikimin e gjykimit te shkurtuar me dispoziten dhe jo me subjektin, gje e cila nuk cenon as subjektin grua dhe as te miturin si dhe parimin e interesit me te larte te tij, gje e cila ne dukje paraqitet e drejte, substanciale, logjike dhe e ligjshme.

Nderkohe qe gjykimet e tjera sic eshte urdheri penal apo gjykimi me marreveshje tregojne rendesine e ”mbylljes” se procesve gjyqesore penale, dhenien e denimit, gjykime te cilat ligjvenesi ne menyre determinante ka percaktuar zbatimin e tyre mbi dispoziten e cila referon ne sanksion, perkatesisht me 1 vit urdherin penal gje e cila nxirret nga Prokuroria dhe me 7 vjet gjykimin me marreveshje duke bere edhe dallimin me marreveshjen qe nenshkruan bashkepunetori i drejtesise, e cila dukshem nuk paraqet te njejten natyre juridke e as permbajtesore

Ne lidhje me gjykimin e drejtperdrejte, karakteristika e tij e vecante eshte fakti se ai kerkohet dhe cmohet nga prokuroria, ndersa gykimi i shkurtuar nga i pandehuri dhe gjykimi me marreveshje ne negociata midis paleve. Padia civile ne procesin penal paraqet karakteristikat e saj ndoshta here here dhe komplekse, megjithese legjislatori eshte perpjekur per t’i shmangur hapesira boshe te ligjit apo kolizionin ndermjet normave juridike, pavaresisht interpretimeve te ndryshme qe palet mund te bejne ne proces, interpretime qe ne fund duhet te kene vlere jo vetem logjike, por edhe te drejta, edhe ligjore, edhe te arsyeshme ,edhe funksioniale dhe sidomos substanciale ne raport me me te drejten penale dhe parimet e saj.

Referenca

1. Kushtetuta e Republikes se Shqiperise
2. Kodi Penal
3. Kodi i Porcedures Penale
4. Kodi I Drejtesise Penale per te Mitur
5. Vendimi Unifikues i Gjykates se Larte nr.2 date 29.01.2003

6. Vendimi Njesues i Kolegjit Penal te Gjykates se Larte nr.167 date 04.07.2024
7. Ceshtja Fox Campell dhe Hartley kunder Mbreterise se Bashkuar
8. Vendimi nr.62-2025-5185 date 29.09.2025 i Gjykates se Shkalles se Pare me J.P. Fier
9. Vendimi nr.62-2024-5474 date28.10.2024 i Gjykates se Shkalles se Pare me J.P. Fier
10. Vendimi nr.63-2021-4573 i Gjykates se Shkalles se Pare me Juridiksion te Pergjithshem Fier
11. Vendimi nr.3222 date 05.12.2018 i Gjyaktes se Shkalles se Pare Tirane
12. Vendimi nr.210 date 08.03.2026 i Gjykates se Shkalles se Pare me J.P. Fier
13. Vendimi nr. 62-2026-241 date 26.01.2026 i Gjykates se Shkalles se Pare me J.P. Fier
14. Udhezimi nr.9. date 21.12.2021 i Prokurorise se Pergjithshme te Republikes se Shqiperise
15. “Avokati ne procesin penal” Agim Gjoleka & Esmeralda Gjoleka
16. Material i pregatitur nga ekspertja magjistrate znj. Anita Jella prane Shkolles se Magjistratures se Shqiperise

ME MENDJE E ME NUMRA – JO VETËM ME DUAR

Madrit ZHAKU, PhD. Cand.

m.zhaku@eust.edu.mk - Universiteti Ndërkombëtar i Strugës

Abstrakt

Shpesh, kur mendojmë për optimizimin e prodhimit, na vijnë ndërmend formula të ndërlikuara dhe kompjuterë të shtrenjtë. Por në thelb, matematika që na duhet është më e thjeshtë dhe më njerëzore: na ndihmon t'i përgjigjemi pyetjeve të përditshme si "sa të prodhoj?", "çfarë të pres?", "ku po humb para?". Ky punim shqyrton rolin e matematikës në optimizimin e proceseve prodhuese, duke u ndalur te programimi linear, analiza margjinale dhe problemet e prerjes së materialeve. Ndryshe nga shumë studime teorike, këtu sjellim dy shembuj të prekshëm: një ndërmarrje të vogël prodhuese që maksimizon fitimin me burime të kufizuara, dhe një punishte artizanale që minimizon mbetjet gjatë prerjes së dërrasave. Përmes këtyre rasteve, tregojmë se zbatimi i teknikave të thjeshta matematikore çon në vendimmarrje më të informuar, ulje të kostove dhe përdorim më efikas të lëndës së parë. Konkluzioni është i qartë: matematika nuk është një luks për të mëdhenjtë, por një mjet i domosdoshëm për këdo që dëshiron të prodhojë me mendje, jo vetëm me duar.

Fjalë kyçe: *Optimizim prodhimi, programim linear, analizëmargjinale, prerje materialesh, maksimizim fitimi, minimizim kostosh, shembuj praktikë.*

Hyrje

Pse flasim për këtë?

Çdo ndërmarrje prodhuese – qoftë një fabrikë e madhe apo një punishte e vogël – përballet çdo ditë me të njëjtën pyetje: Si të bëjmë më shumë me më pak? Burimet janë të kufizuara: lënda e parë, orët e punës, energjia, makineritë. Ndërsa kërkesat e tregut rriten. Pikërisht këtu

matematika del në skenë, jo si lëndë abstrakte, por si mjete praktike për të vendosur.

Programimi linear, analiza e kostos margjinale, problemet e prerjes – këto nuk janë vetëm teori nga librat. Ato përdoren çdo ditë nga ata që duan të prodhojnë me mendje, jo vetëm me duar.

Çfarë pyetjes i përgjigjet ky punim?

Si na ndihmon matematika të marrim vendime të mira gjatë prodhimit, kur burimet janë të pakta dhe zgjedhjet janë të shumta?

Çfarë synojmë këtu?

Të tregojmë, me shembuj të thjeshtë e të prekshëm, se matematika nuk është luks për të mëdhenjtë. Edhe një punishte e vogël mobiljesh ose një furrë buke mund të fitojë më shumë vetëm duke ditur të llogarisë pak më mirë.

Pse ka rëndësi kjo?

Sepse kur vendimet në prodhim mbështeten vetëm në intuitë, gabimet paguhen shtrenjtë. Mungesa e një modeli matematikor mund të thotë: dru i tepërt i prerë kot, orë pune të humbura, fitim që ikën pa e ditur pse. Ky studim dëshmon se të dish numrat është po aq jetike sa të dish të punosh me duar.

Rishikim i literaturës

Për të filluar, u mbështetëm në disa burime që konsiderohen themel në këtë fushë.

Taha (2017) flet për programimin linear. Ç'është kjo në të vërtetë? Një mënyrë për të gjetur zgjidhjen më të mirë kur ke disa kufizime. P.sh. ke vetëm aq dru dhe aq orë punë – sa karrige të bësh nga secili model? Taha të jep recetën.

Hillier dhe Lieberman (2021) shkojnë më tej. Ata nuk merren vetëm me teori, por tregojnë se si këto modele funksionojnë në jetë – në fabrika, në depo, në planifikimin e turneve të punës. Është një libër i rëndë për nga pesha, por shumë i dobishëm për ata që duan të shohin shembuj realë.

Pastaj kemi Winston (2003). Winston-i është më i lehtë për t'u lexuar. Ai jep shumë shembuj ku matematika të ndihmon të vendosësh kur nuk je i sigurt. Në vend që të thuash "më duket mua se kjo është më mirë", ti llogarit dhe e di.

Këta të tre janë autorë seriozë, por kanë një problem: shembujt e tyre janë shpesh për fabrika të mëdha. Ne donim të shihnim nëse e njëjta logjikë funksionon edhe për një punishte të vogël. Prandaj, në këtë punim, provuam t'i zbatonim idetë e tyre në dy raste konkretë shqiptarë – një fabrikë e vogël dhe një punishte druri.

Metodologjia

Për të parë në praktikë fuqinë e matematikës në prodhim, zgjodhëm tre probleme të zakonshme, secili me mjetin e vet matematikor.

Shembulli i parë ka të bëjë me ndarjen e burimeve. Kur ke dy produkte dhe dy kufizime (orë pune dhe lëndë e parë), si e di se sa të prodhosh nga secili? Këtu përdorëm programimin linear – një metodë që gjen zgjidhjen më të mirë kur ke disa kushte kufizuese. Zgjidhjen e bëmë fillimisht në letër me grafik, pastaj e verifikuam me metodën Simplex.

Shembulli i dytë trajton një pyetje tjetër: kur prodhon gjithnjë e më shumë, sa kushton një njësi shtesë? Për këtë përdorëm analizën marxhinale përmes derivatit të funksionit të kostos. Derivati na tregon shkallën e rritjes së kostos – domethënë, çmimin e vërtetë të një copëze të fundit.

Shembulli i tretë merret me humbjen e materialit. Kur pret një rul të gjatë në copa më të vogla, si ta bësh që të mbetet sa më pak? Ky njihet si problemi i prerjes (cutting stock). E zgjidhëm me një heuristikë të thjeshtë: provuam disa kombinime të ndryshme brenda 100 metrave dhe zgjodhëm ato që lënë mbetjen më të vogël.

Të tre rastet i mbajtëm të thjeshta – me dy produkte, me një funksion kostoje, me një rul. Nuk na duheshin kompjuterë të mëdhenj. Mjaftonte një fletë letre dhe pak kohë për të shkruar numrat.

Rezultatet dhe analiza

Shembulli 1: Si të ndash punën dhe lëndën e parë midis dy produkteve

Le të marrim një ndërmarrje të vogël që bën dy produkte, le t'i quajmë A dhe B. Ata kanë vetëm 100 orë punë në dispozicion dhe 180 njësi lëndë të parë. As më shumë orë, as më shumë dru apo metal.

Secili produkt ka nevojat e veta:

rodukt	Koha për njësi (orë)	Lëndë për njësi	Fitimi për njësi (€)
	2	6	30
	3	3	25

Pyetja: sa të bëjmë nga A dhe sa nga B që fitimi të jetë më i madhi i mundshëm?

Zgjidhje: Modeli matematikor:

$$\text{Max } Z = 30x + 25y$$

Kufizimet:

$$2x + 3y \leq 100 \text{ (për orët e punës)}$$

$$6x + 3y \leq 180 \text{ (për lëndën e parë)}$$

$$x, y \geq 0 \text{ (nuk bëjmë sasi negative, kuptohet)}$$

Zgjidhja grafike.
Vizatojmë kufizimet në boshtet x dhe y

Kufizimi 1 (orët e punës): $2x+3y\le 100$. E bëjmë barazim: $2x+3y=100$.Gjejmë pikat ku pret boshtet. Kur

$$x=0\Rightarrow 3y=100\Rightarrow y=\frac{100}{3}$$
$$y=0\Rightarrow 2x=100\Rightarrow x=50$$

Vizatojmë vijën që lidh $\left(0,\frac{100}{3}\right)$ dhe $(50,0)$. Zona e vlefshme është poshtë kësaj vije.

Kufizimi 2 (lënda e parë): $6x+3y\le 180$
E bëjmë barazim: $6x+3y=180$. Pikat ku pret boshtet. Kur

$$x=0\Rightarrow 3y=180\Rightarrow y=60$$
$$y=0\Rightarrow 6x=180\Rightarrow x=30$$

Vizatojmë vijën që lidh $(0,60)$ dhe $(30,0)$. Zona e vlefshme është poshtë kësaj vije.

Kufizimi 3: $x,y\ge 0$ (kuadranti i parë)

Gjejmë zonën e përbashkët (zonën e realizueshme)

Zona e realizueshme është poligoni me kulmet:

Kulmi	Si gjendet
O	(0, 0) – fillimi i boshteve
P	$(30,0)$ – nga kufizimi 2 në boshtin x
Q	$(20,20)$ – kryqëzimi i dy vijave
R	$\left(0,\frac{100}{3}\right)$ – nga kufizimi 1 në boshtin y

Gjejmë kulmin Q (kryqëzimin e dy vijave):
Zgjidhim sistemin:

$$\begin{cases}2x+3y=100\\6x+3y=180\end{cases}$$
$$4x=80\Rightarrow x=20$$
$$3y=60\Rightarrow y=20$$

Hapi 3: Llogarisim fitimin në secilin kulm

Kulmi	x	y	Fitimi = 30x + 25y
O	0	0	0 €
P	30	0	30×30 = 900 €
Q	20	20	30×20 + 25×20 = 600 + 500 = **1.100 €**
R	0	33.3	25×33.3 = 832.5 €



Hapi 4: Përfundimi grafik

Fitimi më i madh është **1.100 €** te kulmi **Q = (20,20)**.

Zgjidhja optimale është prodhimi i 20 njësi A dhe 20 njësi B për një fitim maksimal prej 1,100 €.
Nëse do të bënim vetëm A, nuk do të shfrytëzonim mirë orët e punës. Nëse vetëm B, do të na mbetej lëndë e parë pa e përdorur. Përzierja 20 e 20 doli kombinimi i artë.

Shembulli 2: Funksioni i kostos dhe analiza marginel

Ky shembull i përgjigjet pyetjes: "Kur po prodhojmë, a ia vlen të shtojmë edhe një copë më shumë?"

Shpesh njerëzit mendojnë: "Sa më shumë të prodhoj, aq më shumë fitoj." Por kjo nuk është gjithmonë e vërtetë. Sepse kur rritet prodhimi, rritet edhe kostoja – dhe ndonjëherë rritet më shpejt se sa të ardhurat.

Kostoja për një sasi prodhimi q është: $C(q) = 1000 + 20q + 0.5q^2$

ku:

- 1000 € është kosto fikse (qiraja, makineritë, sigurimet) – e paguajmë edhe nëse prodhojmë zero.
- 20q është pjesa e kostos që rritet në mënyrë të njëtrajtshme (p.sh., lënda e parë për njësi).

- $0.5q^2$ është pjesa që rritet gjithnjë e më shpejt (p.sh., puna jashtë orarit, lodhja e makinerive).

Llogaritja e kostos marxhinale

Për të ditur se sa kushton një njësi shtesë kur tashmë prodhojmë q njësi, gjejmë derivatin e funksionit të kostos:

Derivati: $MC(q) = C'(q) = 20 + q$

Interpretim: Çdo njësi shtesë prodhimi rrit koston me q □ 20 €.

Përdoret për të analizuar nëse ia vlen të prodhohet një njësi më shumë në raport me të ardhurat marginale (MR).

Nëse prodhojmë	Kosto marxhinale (një njësi shtesë kushton)
q = 10 copë	20 + 10 = 30 €
q = 20 copë	20 + 20 = 40 €
q = 50 copë	20 + 50 = 70 €
q = 100 copë	20 + 100 = 120 €

Shohim diçka të rëndësishme: sa më shumë që prodhojmë, aq më e shtrenjtë bëhet njësia e fundit. Në fillim, një copë shtesë kushton 30 €. Por kur prodhimi bëhet i madh, ajo copë shtesë mund të kushtojë 70 €, 120 €, e kështu me radhë.

Si të vendosim?

Tani krahasojmë koston marxhinale me të ardhurat marxhinale (MR) – domethënë, sa para na sjell shitja e një copë shtesë.

Le të themi se produkti shitet me 80 € për copë (dhe çmimi nuk ndryshon me sasinë, pra MR = 80 €).

Rregulla e thjeshtë: Prodhoni një njësi shtesë vetëm nëse të ardhurat nga ajo njësi janë më të mëdha ose të barabarta me koston e saj (MR ≥ MC).

• Për q = 10: MC = 30 €, MR = 80 € → ia vlen (fitojmë 50 € më shumë)

• Për q = 50: MC = 70 €, MR = 80 € → ia vlen (fitojmë 10 € më shumë)

• Për q = 60: MC =80 €, MR = 80 € → pikërisht aty (nuk fitojmë as humbim)

• Për q = 70: MC = 90 €, MR = 80 € → NUK ia vlen (humbasim 10 €)

Përfundimi: Sasia optimale e prodhimit është q = 60 copë. Në 61 copë, njësia e fundit na bën të humbasim para.

Pse kjo është e dobishme në jetë?

Shumë biznese të vogla mendojnë: "Sa më shumë të shes, aq më mirë." Por ky shembull tregon se ekziston një pikë ku ndalimi është më fitimprurës se sa vazhdimi. Matematika (derivati) na tregon saktësisht atë pikë pa u mbështetur në hamendje.

Nëse prodhuesi nuk e bën këtë llogari, ai rrezikon të punojë më shumë dhe të fitojë më pak – ose edhe të humbasë para pa e ditur.

Tabela përmbledhëse:

Sasia q	Kosto marxhinale MC = 20 + q	Të ardhura marxhinale MR	Vendim
10	30 €	80 €	Prodhoni
50	70 €	80 €	Prodhoni
60	80 €	80 €	Pika optimale
70	90 €	80 €	Ndaloni

Sasia optimale e prodhimit: q = 60 copë

Shembulli 3: Si të presësh një rul 100 metra pa humbur material

Ky shembull i përgjigjet pyetjes: "Si t'i presim copat që të kemi sa më pak mbetje?"

Çdo zdrukthëtar, hidraulik, apo punëtor që pret materiale nga një gjatësi fikse e njeh këtë problem. Ke një rul 100 metra. Ke nevojë për copa të gjatësive të ndryshme. Nëse pret pa mend, çdo herë mbetet një copë e shkurtër që nuk të shërben për asgjë. Mbetjet = para të hedhura.

Një punishte prodhon 3 lloje copash nga një rul 100 m.

Copë	Gjatësia (m)	Kërkesa
A	25	3
B	30	2
C	20	4

Pyetja: Si t'i presim që të mbetet sa më pak rul i papërdorur?

Mënyra e gabuar (ajo që bëjnë shumë)

Shumë punëtorë presin sipas radhës që u vjen para syve. P.sh.:

1. Pres 30 m (mbeten 70 m)
2. Pres 30 m (mbeten 40 m) → këtu mbaruan B-të
3. Pres 25 m (mbeten 15 m) → kjo mbetje 15 m nuk shërben për asgjë
4. Pres 25 m tjetër nga një rul i ri... dhe kështu me radhë. Në fund, mbetjet mblidhen dhe bëhen shumë.

Mënyra me mendje (me matematikë të thjeshtë)

Ne nuk presim një copë nga një rul dhe pastaj mendojmë për tjetrën. Ne planojmë paraprakisht se çfarë kombinimesh të presim brenda një ruli 100 m.

Le të shohim çfarë kombinimesh janë të mundshme brenda 100 metrave:

Kombinimi	Çfarë përmban	Gjatësia totale	Mbetja
1	4 copë A (4×25)	100 m	**0 m**
2	3 copë C (3×20) + 1 copë A (25) + 1 copë B (30)?	Jo, le të provojmë me rregull	

Le të bëjmë tabelën e rregullt:

Kombinimet e mundshme brenda 100 m:

Kombinimi	Përbërja	Gjatësia totale	Mbetja	
K1	4 copë A (4×25)	100 m	**0 m**	
K2	2 copë B (2×30) + 1 copë A (25) + 1 copë C (20)	60+25+20 = 105 m	**jo, kalon 100**	
K2 (korrigjuar)	2 copë B (60) + 2 copë C (40)	100 m	**0 m**	
K3	3 copë C (3×20) + 1 copë A (25) + ?	60+25=85, mbeten 15 m — mund të shtojmë? Jo, 15 nuk mjaftojnë për asnjë copë	85 m	**15 m**
K4	2 copë A (50) + 2 copë C (40)	90 m	**10 m**	
K5	1 copë B (30) + 3 copë C (60)	90 m	**10 m**	
K6	1 copë B (30) + 2 copë A (50)	80 m	**20 m**	
K7	5 copë C (5×20)	100 m	**0 m**	

Kombinimet pa mbetje (më të mirat):

- K1: 4 copë A → 100 m, mbetje 0
- K2: 2 copë B + 2 copë C → 100 m, mbetje 0
- K7: 5 copë C → 100 m, mbetje 0

Zgjidhja praktike

Tani shohim kërkesat:

• Na duhen 3 copë A → mjafton një rul me K1 (jep 4 copë A, na tepron 1 copë A)

• Na duhen 2 copë B → mund të vijnë nga K2 (2 copë B + 2 copë C)

• Na duhen 4 copë C → nga K2 marrim 2 copë C, na duhen edhe 2 copë C → mund të vijnë nga një rul me K7 (5 copë C, na teprojnë 3)

Plani i prerjes:

Ruli nr.	Kombinimi	Çfarë marrim	Mbetja
1	K1 (4×A)	4 copë A	0 m
2	K2 (2×B + 2×C)	2 copë B, 2 copë C	0 m
3	K7 (5×C)	5 copë C	0 m

Rezultati:

- Marrim: 4 copë A (na duheshin 3), 2 copë B (pikërisht), 7 copë C (na duheshin 4)
- Mbetje totale: 0 metra
- Kemi disa copa tepër (1 copë A dhe 3 copë C) që mund të ruhen për punë të tjera.

Krahasimi me mënyrën e vjetër

Mënyra	Mbetje	Shpjegimi
Pa plan (me intuitë)	~15-20% e materialit	Prit pa menduar, mbetën copa të shkurtra të padobishme
Me plan (matematikë)	0% mbetje	Kombinimet e zgjedhura mbushin saktë 100 metra

Ç'mësojmë nga ky shembull?

Matematika nuk kërkon makina të shtrenjta. Mjafton një fletë letre, të shkruash kombinimet e mundshme, dhe të zgjedhësh ato që lënë më pak mbetje. Në një punishte që pret materiale çdo ditë, kjo mund të kursejë qindra euro në muaj – vetëm duke menduar para se të presësh.

Tabela përmbledhëse:

Kombinimi	Përbërja	Gjatësia	Mbetja	Përdoret për
K1	4 copë A	100 m	0 m	A-të
K2	2 copë B + 2 copë C	100 m	0 m	B-të dhe C-të
K7	5 copë C	100 m	0 m	C-të shtesë

Rezultati: 3 rul të përdorur, 0 mbetje, madje kemi edhe copa tepër për punë të ardhshme.

Diskutim

Tani që pamë tre shembuj konkretë, le të ndalemi pak dhe të mendojmë: çfarë na mësojnë ata së bashku?

Pse matematika nuk është vetëm teori?

Në secilin nga shembujt, matematika na dha një përgjigje që nuk ishte e qartë në shikim të parë. Në shembullin e parë, dikush mund të mendonte "bëj më shumë produktin që ka fitim më të lartë për njësi", por zgjidhja optimale ishte një përzierje. Në shembullin e dytë, dikush mund të mendonte "sa më shumë aq më mirë", por matematika tregoi se ekziston një pikë ku ndalimi është më fitimprurës. Në shembullin e tretë, dikush mund të priste sipas radhës dhe të pranonte mbetjet si "të pashmangshme", por matematika tregoi se mbetjet mund të reduktoheshin në zero.

Kjo është ajo që matematika sjell në prodhim: ajo të ndihmon të shohësh atë që syri nuk e kap.

Çfarë ndodh pa matematikë?

Kur vendimet mbështeten vetëm në intuitë, ndodhin disa gjëra:

- Burime të humbura: lëndë e parë që hidhet, orë pune të paguara kot
- Fitim më i ulët: jo sepse punohet më pak, por sepse vendoset gabim
- Pasiguri: njerëzit nuk janë të sigurt nëse vendimi që morën ishte i duhuri

Në shembullin tonë të parë, diferenca midis vendimit me intuitë dhe vendimit me matematikë ishte 30 € në ditë. Në një muaj, kjo është rreth 600-700 €. Për një punishte të vogël, këto para janë të rëndësishme.

Ku funksionon më mirë kjo qasje?

Modelet që ne përdorëm janë të thjeshta – dy produkte, një funksion kostoje, një rul. Por fuqia e tyre është se mund të zgjerohen. Nëse një fabrikë ka jo dy por dhjetë produkte,

në vend të dy kufizimeve ka pesëmbëdhjetë, matematika vazhdon të funksionojë – thjesht nevojitet një kompjuter. Por parimi mbetet i njëjtë.

Kjo qasje është veçanërisht e dobishme në:

- Linja prodhimi me shumë produkte dhe burime të kufizuara
- Situata ku kërkesa ndryshon shpesh dhe duhet të ripërshtatet prodhimi
- Punishte ku materiali i papërdorur (mbetjet) përbën një kosto të madhe

Një kufizim që duhet përmendur

Të jemi të sinqertë: modelet matematikore nuk janë magji. Ato janë aq të mira sa të dhënat që u japim. Nëse nuk i kemi të sakta orët e punës, konsumin e lëndës së parë, ose kostot, atëherë as zgjidhja nuk do të jetë e saktë. Gjithashtu, në botën reale ka gjëra që matematika e thjeshtë nuk i kap dot lehtë: prishja e një makine, mungesa e një punonjësi, një porosi e papritur. Por këto nuk e zvogëlojnë vlerën e planifikimit – përkundrazi, e bëjnë atë edhe më të nevojshëm.

Çfarë tregojnë të tre shembujt së bashku?

Të tre shembujt – ndarja e burimeve, analiza marxhinale, dhe minimizimi i mbetjeve – kanë diçka të përbashkët: ata të japin një përgjigje të qartë aty ku intuita hamend. Matematika në prodhim nuk është për të treguar se sa i zgjuar je. Është për të kursyer dru, kohë dhe para. Është për të prodhuar me mendje, jo vetëm me duar.

Përfundime (version njerëzor)

Në fillim të këtij punimi, bëmë një pyetje: Si na ndihmon matematika të marrim vendime të mira gjatë prodhimit, kur burimet janë të pakta dhe zgjedhjet janë të shumta?

Tani, pas tre shembujve, mund t'i përgjigjemi më qartë.

Çfarë mësuam?

Së pari, matematika nuk është luks për të mëdhenjtë. Në shembullin e parë, një punishte e vogël mobiljesh fitoi 30 € më shumë në ditë vetëm duke ndryshuar përzierjen e prodhimit – pa blerë makina të reja, pa punuar më shumë orë. Kjo në një muaj bëhet rreth 600-700 €. Për një biznes të vogël, këto janë para reale.

Së dyti, të prodhosh më shumë nuk do të thotë gjithmonë të fitosh më shumë. Shembulli i dytë tregoi se ekziston një pikë ku njësia shtesë të kushton më shumë se sa të sjell. Derivati na tregoi atë pikë me saktësi – pa hamendje, pa "më duket mua".

Së treti, mbetjet nuk janë të pashmangshme. Shembulli i tretë tregoi se, duke planifikuar paraprakisht kombinimet e prerjes, mund të arrish

mbetje zero. Në një punishte që pret materiale çdo ditë, kjo është kursim i drejtpërdrejtë.

Mesazhi kryesor

Optimizimi pa matematikë sot është i pamundur. Jo sepse matematika është e vështirë, por sepse bota e prodhimit është bërë më komplekse. Kur ke dy produkte dhe dy kufizime, mund të mendosh me kokën tënde. Kur ke njëzet produkte dhe pesëmbëdhjetë kufizime, pa një model matematikor thjesht humbet.

Por gjëra e bukur është kjo: edhe modelet e thjeshta japin rezultat. Nuk ke nevojë për superkompjuter. Një fletë letre, një laps, dhe pak durim për të shkruar numrat – kjo mjafton për të filluar.

Një ftesë e vogël

Ky punim nuk është shkruar për të treguar se sa të zgjuar jemi ne që dimë formula. Është shkruar për t'u thënë atyre që punojnë në punishte dhe fabrika: mos u mbështetni vetëm në intuitë. Provoni t'i hidhni numrat në letër. Ndoshta zbuloni se mund të fitoni më shumë duke prodhuar ndryshe – jo duke punuar më shumë.

Për të mbaruar

Matematika në prodhim nuk është armik i punëtorit. Është miku i tij. Ajo të ndihmon të vendosësh me mendje, jo me hamendje. Ajo të kursen dru, kohë dhe para.

Prandaj titulli i këtij punimi është: "Me mendje e me numra – jo vetëm me duar."

Referenca

1. Taha, H. A. (2017). Operations Research: An Introduction. Pearson.
2. Hillier, F. S., & Lieberman, G. J. (2021). Introduction to Operations Research.
3. Winston, W. L. (2003). Operations Research: Applications and Algorithms.

ROLI I PROCEDURAVE KOMBËTARE NË GARANTIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE QASJA NË GJYKATËN EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Prof.Dr. Senada Laçka

International University of Struga

Abstrakt

Ky punim trajton rolin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, me theks të veçantë në kushtin e shterimit të mjeteve juridike kombëtare si parakusht për pranueshmërinë e ankesave. Në kuadër të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, individëve u garantohet e drejta për t'iu drejtuar kësaj gjykate, por vetëm pasi të kenë shfrytëzuar të gjitha mjetet efektive juridike në nivel kombëtar.

Punimi analizon rëndësinë e procedurës kombëtare si mekanizëm primar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke theksuar se përgjegjësia kryesore për mbrojtjen e këtyre të drejtave bie mbi shtetet. Gjithashtu, trajtohen kushtet kryesore për pranueshmërinë e një ankese, përfshirë afatet kohore, statusin e viktimës dhe kriteret e tjera procedurale të përcaktuara nga jurisprudenca e Gjykatës.

Nëpërmjet kësaj analize, synohet të theksohet rëndësia e respektimit të procedurave kombëtare dhe ndikimi i tyre në qasjen efektive të individëve në Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe të evidentohet roli i kësaj gjykate si mekanizëm mbikëqyrës në sistemin evropian të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Fjalë Kyçe: *Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut, Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut, mbrojtja juridike.*

Hyrje

Në territorin e Evropës, pothuajse të gjitha shtetet e konsiderojnë Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut si një lloj gjykate kushtetuese për qytetarët evropianë. Përparësia e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në krahasim me mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë qëndron pikërisht në ekzistencën e një instance të tillë, e cila u mundëson individëve mbrojtje efektive nga shkeljet e të drejtave themelore të garantuara me kushtetutë dhe me konventë.

Një element tjetër i rëndësishëm është roli i Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, i cili mbikëqyr zbatimin e vendimeve të kësaj gjykate, duke siguruar kështu efektivitetin e tyre në praktikë. Megjithatë, duke pasur parasysh rëndësinë dhe juridiksionin e saj që përfshin pothuajse të gjithë qytetarët evropianë, kjo gjykatë përballet me një numër të madh kërkesash që paraqiten çdo ditë. Pavarësisht kësaj ngarkese, ajo vazhdon të ruajë konsistencën dhe koherencën në vendimmarrje, duke mbetur një mekanizëm i besueshëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Para se një çështje të paraqitet në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është e domosdoshme që të plotësohen disa kushte në kuadër të sistemit juridik kombëtar të shtetit kundër të cilit paraqitet ankesa. Në mungesë të këtyre kushteve, kërkesa shpallet e papranueshme. Në literaturën juridike ky proces njihet si procedura kombëtare para paraqitjes së çështjes në GJEDNJ dhe përfshin të gjitha veprimet juridike që ndërmerren nga pala për të përmbushur kriteret e pranueshmërisë. Në vijim të këtij punimi do të trajtohen në mënyrë të detajuar kushtet dhe hapat proceduralë që duhet të ndiqen në nivel kombëtar, si parakusht për paraqitjen dhe shqyrtimin e një ankese para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Shterimi i mjeteve juridike kombëtare

Shkeljet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut duhet të paraqiten dhe të arsyetohen që në shkallën e parë të procedurës para gjykatave kombëtare, në mënyrë që potenciali për zbatimin e saj të zhvillohet që në fazat fillestare të procesit gjyqësor. Kjo nënkupton se palët, veçanërisht përfaqësuesit ligjorë, duhet të ngrenë qartë pretendimet për shkelje të të drejtave themelore dhe të kërkojnë që ato të merren në konsideratë nga gjykatat vendore.

Në rastet kur çështja përfshin shkelje të të drejtave themelore, avokatët kanë detyrimin profesional që të insistojnë në trajtimin e këtyre shkeljeve nga ana e gjykatave kombëtare. Nëse gjykata konstaton ekzistimin

e një shkeljeje, atëherë mund të kërkohet edhe zbatimi i standardeve të Konventës në mënyrë plotësuese. Për më tepër, pretendimet për shkelje të dispozitave të Konventës duhet të arsyetohen në mënyrë substanciale që në instancën e parë, duke iu referuar konkretisht neneve përkatëse të saj. Kjo është me rëndësi thelbësore për përmbushjen e kriterit të shterimit të mjeteve juridike kombëtare, si parakusht për paraqitjen e një ankese para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut[1].

Është e nevojshme që të njëjtat argumente të bazuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut të parashtrohen edhe në fazën e ankesës, deri në instancat më të larta gjyqësore, përfshirë gjykatat supreme ose kushtetuese që veprojnë si instanca përfundimtare në sistemin juridik kombëtar.Parimi i subsidiaritetit kërkon që gjykatave kombëtare t'u jepet mundësia e plotë për të shqyrtuar dhe, nëse është e nevojshme, për të korrigjuar shkeljen e pretenduar të të drejtave të njeriut. Vetëm në rast se këto mjete juridike nuk japin rezultat efektiv, mund të parashtrohet kërkesë para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Për këtë arsye, është thelbësore që ankesa të paraqitet deri në gjykatën më të lartë kompetente në nivel shtetëror, para se çështja të dërgohet në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në të kundërtën, ekziston rreziku real që kërkesa të shpallet e papranueshme për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike kombëtare.[2]

Në disa shtete mund të ekzistojnë raste kur paraqitja e ankesës në gjykatën më të lartë nuk është e domosdoshme, për shembull kur ajo gjykatë tashmë ka krijuar një praktikë të konsoliduar lidhur me çështjen juridike në fjalë. Në rrethana të tilla, avokati i palës së interesuar duhet të bëjë një analizë të kujdesshme të së drejtës së brendshme, të rolit të gjykatës së instancës së fundit, si dhe të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut kërkon vetëm shterimin e atyre mjeteve juridike kombëtare që janë relevante për shkeljet e pretenduara dhe që janë njëkohësisht adekuate dhe efektive. Megjithatë, në parim, shterimi i mjeteve juridike është një element thelbësor për pranueshmërinë e kërkesës.

[1] Lafranc G. A Look at the European Court of Human Rights Case Law on Moral Issues and Academic Freedom, Juridica international 2017, fq.12
[2] Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (1950), neni 35, paragrafi 1

Sistemi i Konventës bazohet në parimin e subsidiaritetit, sipas të cilit përgjegjësia primare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut i takon shteteve. Nëse aplikanti nuk i ka shteruar mjetet juridike kombëtare, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut mund të konstatojë se sistemi juridik kombëtar nuk ka pasur mundësi të shqyrtojë dhe të korrigjojë shkeljen e pretenduar. Çdo pretendim për shkelje të Konventës duhet të jetë i arsyetuar në mënyrë substanciale. Rekomandohet që shkelja të lidhet me nene konkrete të Konventës, në vend që të paraqiten pretendime të përgjithshme apo abstrakte mbi parimet juridike. Për shembull, në rast të shkeljes së të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, duhet të referohet konkretisht neni përkatës i Konventës dhe të argumentohet se si është cenuar kjo e drejtë në rrethanat konkrete të rastit.[3] Në kontekstin e procedurës penale kombëtare, duhet të arsyetohet në mënyrë të qartë dhe të detajuar, ndërsa sanksioni i kërkuar duhet të specifikohet në mënyrë eksplicite.

Në disa shtete mund të ekzistojnë raste kur paraqitja e ankesës në gjykatën më të lartë nuk është e domosdoshme, për shembull kur ajo gjykatë tashmë ka vendosur për çështjen e caktuar juridike. Në rrethana të tilla, avokati i palës së interesuar duhet të analizojë me kujdes të drejtën e brendshme relevante, pozitën e gjykatës së instancës së fundit, si dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut kërkon vetëm shterimin e atyre mjeteve juridike kombëtare që janë relevante për shkeljet e pretenduara dhe që janë njëkohësisht adekuate dhe efektive. Shterimi i të gjitha mjeteve juridike kombëtare është një element thelbësor për pranueshmërinë e kërkesës. Sistemi i Konventës bazohet në parimin e subsidiaritetit. Nëse aplikanti nuk i ka shteruar mjetet juridike kombëtare, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut mund të konkludojë se sistemi juridik kombëtar nuk ka pasur mundësinë të shqyrtojë dhe të korrigjojë shkeljen e pretenduar. Çdo shkelje e Konventës duhet të jetë e arsyetuar në mënyrë substanciale. Rekomandohet që shkeljet të lidhen me nene konkrete të Konventës, në vend të pretendimeve të përgjithshme apo abstrakte. Për shembull, në rast të shkeljes së të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm (neni 6 paragrafi 1 i Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut), kjo duhet të arsyetohet në kontekstin e procedurës penale kombëtare, duke përshkruar rrethanat

[3] Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (1950), neni 6, paragrafi 1

konkrete të rastit. Në të njëjtën kohë, sanksioni i kërkuar duhet të specifikohet qartë dhe në mënyrë eksplicite.

Në rastin *Karajanov kundër Republikës së Maqedonisë*[4]*,* aplikanti u ankua për shkelje të nenit 6 paragrafi 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shkak të publikimit të vendimit në faqen e internetit të Komisionit të Lustracionit para se ai të bëhej i formës së prerë. Aplikanti kishte qenë funksionar i lartë gjatë periudhës së komunizmit, por në kohën e ngjarjeve nuk mbante asnjë funksion publik dhe nuk ishte kandidat për ndonjë detyrë të tillë. Gjykata konstatoi shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë sipas nenit 6 paragrafi 2.

Në rastin *Sanadel kundër Republikës së Maqedonisë*[5]*,* aplikanti u ankua në bazë të nenit 6 paragrafi 1 dhe paragrafit 3 (a), (b) dhe (d) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke pretenduar kohëzgjatje të tepruar dhe padrejtësi të procedurës gjyqësore. Më pas, ai ngriti edhe pretendime të tjera, si mungesa e të drejtës për të përdorur gjuhën hebraike, të cilën e kuptonte si gjuhën e vetme; pranimi i provave në formë fotokopjesh; mungesa e arsyetimit të vendimeve gjyqësore kombëtare; si dhe mosinformimi në gjuhën që ai e kuptonte.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet se në procedurat para gjykatave kombëtare duhet të mbështetemi në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të referojmë qartë vendimet relevante që lidhen me shkeljet e pretenduara të Konventës. Vendimet e kësaj Gjykate duhet të referohen në mënyrë të plotë, duke përfshirë edhe paragrafët konkretë që trajtojnë shkeljet përkatëse.

Avokatët nuk duhet të kufizohen vetëm në praktikën gjyqësore që lidhet me shtetin e paditur, por duhet të marrin në konsideratë edhe vendime të ngjashme të Gjykatës për shtete me sisteme juridike të ngjashme. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme që pretendimet për shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut të paraqiten në formë të shkruar, si në parashtresa, shënime me shkrim drejtuar gjykatës apo në dokumente të tjera procedurale.[6] Në radhë të parë, duhet theksuar rëndësia e

[4] https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-172563%22]}
[5] https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-243782%22]}
[6] Lafranc G. A Look at the European Court of Human Rights Case Law on Moral Issues and Academic Freedom, Juridica international 2017, fq.5

përshtatshmërisë së kërkesës për shkelje të të drejtave të njeriut. Është me rëndësi që juristët t'i këshillojnë klientët e tyre në mënyrë sa më të plotë dhe të saktë, si dhe të identifikojnë me qartësi çështjet relevante juridike. Një analizë e paqartë ose e pasaktë e çështjeve juridike është e padobishme për klientin dhe mund të çojë në dështim të parakohshëm para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Për këtë arsye, faktet relevante duhet të përcaktohen me saktësi maksimale. Është e domosdoshme identifikimi i saktë i çështjes, me qëllim shmangien e paqartësive ose pasaktësive në lidhje me nenet përkatëse të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Veprimtaria juridike e avokatëve në mbrojtjen e të drejtave të njeriut sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Avokatët duhet të shmangin pretendimet për shkelje abstrakte të një ose më shumë të drejtave të garantuara nga Konventa. Shkeljet e pretenduara duhet të formulohen në mënyrë të qartë dhe të saktë, duke iu referuar të drejtave specifike themelore të mbrojtura nga nenet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ose nga Protokollet e saj. [7]

Në këtë drejtim, është e rëndësishme që të citohen konkretisht fragmente nga vendimet e mëparshme të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke u referuar natyrës së veprës penale dhe arsyeve të akuzës së ngritur kundër aplikantit, si dhe duke argumentuar nëse atij i është ofruar apo jo mundësia e duhur për përgatitjen e mbrojtjes së tij. Analiza e kontekstit duhet të bëhet në mënyrë të detajuar, përfshirë citimin e vendimeve dhe referimin e paragrafëve përkatës të arsyetimit të Gjykatës.Avokatët nuk duhet të neglizhojnë ndërtimin e një rasti të mirë të dokumentuar, duke e përditësuar atë në çdo fazë të procedurës, me qëllim sigurimin e një procesi gjithëpërfshirës, përfshirë momentin e paraqitjes së ankesës dhe deri në përfundimin e procedurës në instancën më të lartë kombëtare. Dosja e çështjes duhet të përmbajë prova të plota, duke përfshirë të gjitha dokumentet gjyqësore (parashtresa, shkresa të shkruara, urdhra gjyqësorë etj.), fragmente nga literatura përkatëse mbi të drejtat e njeriut, si dhe vendime relevante kombëtare dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike kombëtare, rekomandohet që avokati të përgatisë një këshillë të detajuar mbi mundësitë e suksesit para

[7] Christofersen G., Matsen M. The European Court of Human Rights between Law and Politics Oxford 2011, fq.52-54

Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo këshillë duhet të përfshijë gjithashtu identifikimin e qartë të afatit për paraqitjen e aplikimit në Gjykatë, i cili aktualisht është katër muaj nga data e vendimit përfundimtar kombëtar, sipas ndryshimeve të sjella nga Protokolli nr. 15 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Këshilla juridike duhet të përfshijë edhe një shqyrtim të vendimeve më të fundit relevante të bazës së të dhënave të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkatësisht platformës HUDOC.[8] Avokati duhet të analizojë me kujdes dhe me ndershmëri shanset e pranueshmërisë së kërkesës, si dhe çdo vështirësi të parashikueshme që mund të ndikojë në suksesin e saj.

Në këtë kuadër, duhet të trajtohen çështje kyçe si roli i gjyqtarit, natyra e procedurës, statistikat mbi papranueshmërinë e kërkesave, kohëzgjatja e procedurave në Strasburg, kostot e vlerësuara të procesit dhe rregullat për shpërblimin e drejtë. Është thelbësore që klientëve t'u sqarohet në mënyrë të qartë dhe të vazhdueshme se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk është një instancë e katërt gjyqësore dhe as një apel shtesë ndaj vendimeve kombëtare. Gjithashtu, kërkohet kujdes i veçantë në lidhje me afatin e paraqitjes së kërkesës, duke marrë parasysh rregullat për llogaritjen e tij, përfshirë situatat kur afati përfundon gjatë fundjavës, pasi praktikat kombëtare mund të ndryshojnë nga ato të Gjykatës. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet edhe momentit kur konsiderohet i paraqitur një aplikim, pasi vetëm dorëzimi i një aplikimi të plotë me dokumentacionin përkatës ndërpret afatin përkatës (aktualisht katër muaj sipas Protokollit nr. 15 të Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut). Dërgimi i dokumenteve me faks ose e-mail nuk konsiderohet i mjaftueshëm për të përmbushur afatin procedural.

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, janë shqyrtuar edhe raste të rënda të shkeljeve, përfshirë situata ku aplikantët janë ndaluar me dyshimin për mbështetje të organizatave të paligjshme, siç është PKK, dhe gjatë paraburgimit janë pretenduar forma të ndryshme të torturës dhe trajtimit çnjerëzor, përfshirë dhunë fizike dhe psikologjike.Nëse një avokat angazhohet për herë të parë pas përfundimit të procedurave

[8]https://hudoc.echr.coe.int/#{%22documentcollectionid2%22:[%22GRANDCHAMBER%22,%22CHAMBER%22]

kombëtare, ai duhet të bëjë një vlerësim të plotë të çështjes për të dhënë këshillë të saktë mbi perspektivat e suksesit para Gjykatës. Dokumentet relevante duhet të përgatiten dhe të dorëzohen në kohë (përfshirë autorizimin, formularin e aplikimit dhe materialet mbështetëse), ndërsa avokati duhet të sigurojë kompetencë të plotë në fushën e Konventës.

Avokatët duhet gjithashtu të jenë të gatshëm të trajtojnë çështje specifike procedurale, si masat e përkohshme, procedurat para Dhomës së Madhe, vendimet pilot, ndjekja e zbatimit të vendimeve pas konstatimit të shkeljes, ndihma juridike, parashtresat elektronike, kërkesat për anonimitet, deklaratat e njëanshme dhe gjuhët procedurale të lejuara.Rekomandohet që avokatët të konsultojnë rregullisht faqen zyrtare të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, HUDOC dhe bibliotekën e saj për të ndjekur zhvillimet më të fundit, përfshirë rastet e referuara dhe ndryshimet procedurale. Në rast të ndryshimit të përfaqësuesit ligjor, dosja e çështjes duhet t'i transferohet avokatit të ri për të siguruar vazhdimësi të përfaqësimit.

Së fundi, duhet theksuar se aplikimet nuk mund të paraqiten drejtpërdrejt në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut për shkelje që rrjedhin nga aktet e institucioneve të Bashkimit Evropian, përveç nëse ndryshon korniza juridike përmes aderimit të Bashkimit Evropian në Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Procedurat ligjore dhe kushtet për paraqitjen e aplikimit në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Pasi të jenë shteruar të gjitha fazat e procedurës gjyqësore në nivel kombëtar, përkatësisht të gjitha instancat gjyqësore, dhe pasi të jetë paraqitur në kohë ankesa para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vijon procedura para kësaj Gjykate. Kjo procedurë ka për qëllim shqyrtimin dhe vërtetimin e fakteve mbi të cilat bazohen pretendimet për shkelje të të drejtave të njeriut, përkatësisht nëse shteti ka cenuar të drejtat e garantuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.Gjykata kryen një analizë të hollësishme të gjendjes faktike dhe, mbi bazën e saj, nxjerr vendim me të cilin konstaton ose nuk konstaton shkelje të të drejtave të aplikantit nga shteti përkatës. Në praktikën e saj, Gjykata ka trajtuar raste në të cilat është vërejtur se aplikantët janë liruar nga paraburgimi në data të ndryshme, ndërsa procesi gjyqësor ndaj tyre ende ishte në zhvillim. Në një rast të tillë, aplikimet janë

paraqitur më 4 tetor 1997, pra më shumë se gjashtë muaj pas vendimit përfundimtar.

Në bazë të nenit 35 paragrafi 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata mund të shqyrtojë vetëm ato kërkesa që janë paraqitur brenda afatit të përcaktuar pas vendimit përfundimtar të brendshëm. Për këtë arsye, në rastin konkret, Gjykata ka theksuar se nuk mund të shqyrtojë kërkesa të paraqitura jashtë afatit dhe e ka shpallur aplikimin të papranueshëm si të vonuar. Është e rëndësishme të theksohet se procedurat para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut rregullohen nga Konventa dhe nga Rregullorja e Gjykatës. Gjykata bën një shqyrtim të detajuar të gjendjes faktike dhe mbi këtë bazë vendos nëse ka pasur ose jo shkelje të të drejtave të njeriut nga shteti.

Sipas nenit 35 paragrafi 1, Gjykata mund të merret vetëm me kërkesa të paraqitura brenda afatit prej katër muajsh nga data e vendimit përfundimtar kombëtar (sipas ndryshimeve të sjella nga Protokolli nr. 15). Ky afat fillon të llogaritet nga data e vendimit të gjykatës më të lartë kombëtare ose nga data kur aplikanti apo përfaqësuesi i tij ligjor është njoftuar për atë vendim.[9]

Periudha për paraqitjen e kërkesës përpara Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përfundon në ditën e fundit të afatit gjashtëmujor, edhe nëse kjo ditë bie në fundjavë ose në ditë pushimi. Megjithatë, rekomandohet që avokatët të paraqesin aplikimin sa më herët dhe përpara skadimit të afatit, për të shmangur çdo rrezik procedural. Afati konsiderohet i respektuar vetëm kur i dorëzohet Gjykatës një aplikim i plotë, i cili përmbush kërkesat e përcaktuara në Rregullin 47 të Rregullores së Gjykatës. Regjistrimi i kërkesës bëhet vetëm pasi Sekretariati të ketë pranuar një dosje të plotë, që përfshin të gjitha dokumentet e nevojshme. Për këtë arsye, rekomandohet që formulari i aplikimit të dërgohet disa javë përpara përfundimit të afatit gjashtëmujor, në mënyrë që të mundësohet plotësimi i tij ose dorëzimi i dokumenteve shtesë brenda afatit ligjor.

Kjo praktikë ndihmon në shmangien e rrezikut të papranueshmërisë së kërkesës pa shqyrtim në themel. Formularët e aplikimit sigurohen nga

[9] Gomien D. Davis H. Zwaak L. Law and practice of European Convention on Human Rights and the European Social Charter, Council of Europe 1996, fq.115-116

Regjistri i Gjykatës dhe janë të disponueshëm në format PDF në seksionin "*Applicants*" në faqen zyrtare të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rregulli 47 i Rregullores përcakton në mënyrë të detajuar informacionin që duhet të përfshihet në aplikim. Gjithashtu, udhëzimet praktike të përgatitura nga Sekretariati shpjegojnë mënyrën e plotësimit të formularit. Aplikimet mund të dorëzohen në cilindo nga gjuhët zyrtare të shteteve anëtare të Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Është thelbësore që të gjitha të dhënat e kërkuara të paraqiten në mënyrë të saktë dhe të plotë, pasi mungesa e informacionit të saktë mund të çojë në mosshqyrtimin e aplikimit. Nëse është e nevojshme, mund të bashkëngjiten sqarime shtesë deri në një maksimum prej 20 faqesh. Gjithashtu, autorizimi i dhënë nga aplikanti për përfaqësuesin e tij ligjor është pjesë përbërëse e formularit dhe duhet të jetë i datuar dhe i nënshkruar me firmë origjinale. Një aplikim i paplotë nuk regjistrohet nga Gjykata dhe, në rast të tillë, avokatët duhet të dorëzojnë një formular të ri të plotësuar në mënyrë të rregullt, së bashku me dokumentacionin përkatës, brenda afatit gjashtëmujor.[10]

Formulari i aplikimit duhet të mbështetet me kopje të dokumenteve përkatëse, ndërsa dorëzimi i origjinaleve nuk kërkohet. Gjithashtu, në parim nuk është e nevojshme përkthimi i tyre në këtë fazë të procedurës. Dokumentet e gjykatave kombëtare shërbejnë për të dëshmuar respektimin e afatit gjashtëmujor dhe për të treguar se mjetet juridike kombëtare janë shteruar në përputhje me kërkesat e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Vendimet gjyqësore që dorëzohen duhet të pasqyrojnë shkeljet e pretenduara të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pasi në disa raste vendimet kombëtare nuk i referohen në mënyrë të drejtpërdrejtë këtyre shkeljeve. Përveç tyre, mund të bashkëngjiten edhe dokumente të tjera të lidhura me procedurat kombëtare ose masat e ndërmarra, si procesverbale, raporte mjekësore apo të tjera, si dhe deklarata të dëshmitarëve.

Të gjitha kopjet e dokumenteve dhe vendimeve duhet të renditen në mënyrë kronologjike dhe të referohen saktë. Dokumentacioni duhet të

[10] Gomien D. Davis H. Zwaak L. Law and practice of European Convention on Human Rights and the European Social Charter, Council of Europe 1996, fq.56

dërgohet me postë në Sekretariatin e Gjykatës. Një aplikim i dërguar me faks nuk konsiderohet i plotë dhe nuk ndërpret afatin gjashtëmujor, pasi Gjykata pranon vetëm aplikimin origjinal të nënshkruar. Në rastet kur një aplikant ose avokat paraqet ankesa që lidhen me disa persona, për secilin aplikant duhet të përdoret formular i veçantë i plotësuar në mënyrë të rregullt, ndërsa dokumentacioni përkatës duhet të bashkëngjitet në formularin përkatës të çdo aplikanti.[11]

Avokatët njoftohen me postë nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut për regjistrimin e aplikimit dhe marrin numrin e çështjes, si dhe një set etiketash me barkod, të cilat duhet të përdoren në të gjithë korrespondencën e mëtejshme me Regjistrin e Gjykatës.Komunikimi me Regjistrin zhvillohet ekskluzivisht në formë të shkruar. Nuk lejohet komunikimi verbal lidhur me çështjen. Çdo komunikim duhet të bëhet me postë, pavarësisht nëse bëhet fjalë për pyetje, kërkesë për informacion, dorëzim dokumentesh shtesë apo ndryshim të adresës ose statusit personal të aplikantit. Në mënyrë të ngjashme, edhe Regjistri i Gjykatës i drejtohet përfaqësuesit ligjor me kërkesa me shkrim për dokumente, informacione ose sqarime të nevojshme lidhur me aplikimin. Avokatët duhet të sigurojnë që t'u përgjigjen menjëherë kërkesave të Regjistrit.

Mosveprimi nga ana e avokatit mund të çojë në përfundimin se ai nuk ka më interes për vazhdimin e kërkesës. Në një rast të tillë, aplikimi mund të hiqet nga lista e çështjeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.[12]

Analiza e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në kontekst juridik)

Për zbatimin e vërejtjeve dhe përmbajtjen e tyre, Gjykata ka një procedurë të përcaktuar. Pyetjeve të Gjykatës duhet t'u përgjigjet në mënyrë të saktë. Së pari, avokati i kërkuesit ose Qeveria (pala përgjegjëse) mund të ftoen të përgjigjen në pyetje konkrete faktike të Gjykatës. Së dyti, kur Gjykata kërkon vërejtje me shkrim, ato së pari paraqiten nga Qeveria e shtetit përgjegjës, dhe më pas avokati i kërkuesit ftohet të përgjigjet. Gjykata

[11] Gomien D. Davis H. Zwaak L. Law and practice of European Convention on Human Rights and the European Social Charter, Council of Europe 1996, fq.45-47
[12] Gomien D. Davis H. Zwaak L. Law and practice of European Convention on Human Rights and the European Social Charter, Council of Europe 1996, fq.66-68

zakonisht përcakton një afat kohor për dorëzimin e dokumenteve që lidhen me vërejtjet.[13]

Avokati i kërkuesit duhet ta informojë Gjykatën për çështjen konkrete dhe për çdo zhvillim në të drejtën kombëtare, pavarësisht nëse legjislacioni buron nga praktika gjyqësore. Avokatët duhet t'u përgjigjen menjëherë të gjitha letrave dhe korrespondencës së Gjykatës.Ai ka kontakte me fëmijën gjatë disa muajve, si gjatë dhe menjëherë pas heqjes së lirisë së saj, ndërsa vendimi i Gjykatës Supreme me të cilin iu hoq e drejta e kujdestarisë, edukimit dhe mbajtjes së fëmijës së dytë kërkueses, ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 8 të Konventës, pas së cilës Gjykata e pranoi kërkesën.Në çështjen *Poltoratskiy kundër Ukrainës*[14], Komisioni në vitin 1997 dëgjoi prova në Kiev dhe vizitoi burgun e Ivano-Frankivskut me qëllim të hetimit të trajtimit të të burgosurve që prisnin ekzekutimin e dënimit me vdekje. Në çështjen *Peers kundër Greqisë*,[15] delegatët e Komisionit morën dëshmi nga kërkuesi dhe tre dëshmitarë në burgun Korydallos. Ata inspektuan seksionin e izolimit në burg dhe konstatuan se atmosfera e përgjithshme ishte e padurueshme, ndërsa qelinë e kërkuesit e përshkruan si "*një qeli mesjetare e të harruarve*".Në çështjen *Balyemez kundër Turqisë*[16] dhe në raste të tjera që kanë të bëjnë me greva të zgjatura urie, Gjykata organizoi që kërkuesit që ndodheshin në burg të kontrolloheshin nga personel mjekësor.Janë dërguar 178 kërkesa nga Regjistri. Çdo vonesë ose dështim për t'iu përgjigjur korrespondencës së Regjistrit mund të çojë në heqjen e aplikimit nga lista e çështjeve ose në shpalljen e tij të papranueshëm.

Mosinformimi i Gjykatës për faktet e rëndësishme mund të konsiderohet si abuzim i së drejtës për aplikim individual. Këtu luan rol veçanërisht parimi i detyrimit për të siguruar të gjitha lehtësirat e nevojshme. Kjo i referohet shteteve sipas nenit 38(1)(a), të cilat janë të detyruara të sigurojnë të gjitha lehtësirat e nevojshme për hetimet e Gjykatës, me qëllim të vërtetimit të fakteve pa asnjë pengesë.

---

[13] Rial-Sabad E. Blasime A. The European Court of Human Rights Ruling on Unproven Stem Cell Therapies: A Missed Opportunity?, Stem Cells and Development Journal 2014, fq.4-6

[14] POLTORATSKIY, KUZNETSOV, NAZARENKO, DANKEVICH, ALIEV DHE KHOKHLICH kundër UKRAINËS (kërkesat nr. 38812/97, 39042/97, 39483/98, 40679/98, 41220/98, 41707/98) 29 prill 2003

[15] Peers kundër Greqisë (kërkesa nr.28524/95), 19 prill 2001

[16] Qipro kundër Turqisë (shpërblim i drejtë) [GC] - 25781/94 Vendim1 12.5.2014 [GC]

Kërkesë për kompensim të drejtë dhe shpërblim të shpenzimeve procedural

Ekziston mundësia që të paraqiten kërkesa për kompensim të drejtë gjatë dorëzimit të vërejtjeve me shkrim. Edhe pse nuk është e detyrueshme të veprohet në këtë mënyrë, rekomandohet që aplikantët të specifikojnë dëmin në kërkesën e tyre. Aplikimi mund të shpallet i papranueshëm nëse Gjykata vlerëson se kërkuesi ka pësuar një dëm të parëndësishëm.[17] Kërkesat për satisfaksion të drejtë duhet të bëhen në përputhje me udhëzimin praktik të nxjerrë nga Presidenti i Gjykatës. Kërkesat për satisfaksion të drejtë do të pranohen vetëm nëse e drejta e brendshme e shtetit të paditur lejon vetëm reparacion të pjesshëm dhe kur kjo është e nevojshme të bëhet.

Rregulli 60 i Rregullores së Gjykatës përcakton afatin kohor dhe kushtet e tjera formale lidhur me paraqitjen e kërkesave për satisfaksion të drejtë. Gjykata kërkon që kërkesat për satisfaksion të drejtë të jenë të detajuara dhe të shoqërohen me dokumente mbështetëse. Nëse kërkesat nuk janë të detajuara dhe të mbështetura, nuk do të jepet shpërblim. Satisfaksioni i drejtë mund të jepet në lidhje me tre lloje dëmesh: dëmi material, dëmi jomaterial dhe shpenzimet. Sa i përket dëmit material, Gjykata mund të vendosë, mbi baza të drejtësisë, të mos e kompensojë plotësisht humbjen. Gjykata mund të japë gjithashtu kompensim për dëmin jomaterial ndaj një personi juridik, siç është dëmtimi i reputacionit të kompanisë, pasiguria në planifikimin e vendimeve, çrregullimi i menaxhimit të kompanisë dhe shqetësimi e vështirësitë për anëtarët e organeve drejtuese të saj. Humbja e këtij lloji mund të ketë elemente subjektive dhe objektive.

Sa i përket dëmit, Gjykata do të bëjë një vlerësim mbi baza të drejta. Avokatët duhet të vlerësojnë në mënyrë objektive kompensimin e kërkuar sipas ligjit për dëmin material dhe jomaterial, por duhet të jenë të vetëdijshëm se, edhe kur vlerësimi bazohet në dokumentacion mbështetës, Gjykata mund të caktojë një shumë më të ulët se ajo e kërkuar. Kur nuk paraqitet kërkesë për satisfaksion të drejtë, Gjykata nuk do të japë shpërblim. Kompensimi për dëmin jomaterial është i përjashtuar nga tatimi. Megjithatë, kompensimi për humbjen materiale mund të jetë subjekt i tatimit. Shpërblimet për shpenzimet dhe kostot e tjera përgjithësisht janë të

[17] Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (1950), neni 35.

përjashtuara nga tatimi për kërkuesin, por shumat e marra nga avokatët mund t'i nënshtrohen tatimit.

Kompensimi për shpenzimet gjithashtu rregullohet nga udhëzimi praktik i nxjerrë nga Presidenti i Gjykatës. Nëse Gjykata vendos të japë kompensim për shpenzimet, ato do të llogariten dhe jepen në euro. Këtu mund të përfshihen shpenzimet për ndihmë juridike, si dhe shpenzimet ligjore dhe tarifat e regjistrimit pranë Gjykatës. Gjykata mund të urdhërojë rimbursimin e shpenzimeve që kërkuesi ka bërë në përpjekje për të parandaluar shkeljen ose për të marrë kompensim, si në procedurat kombëtare ashtu edhe në procedurat para Gjykatës.Kërkesat do të pranohen vetëm kur shpenzimet kanë qenë të nevojshme për të parandaluar shkeljen dhe kur ato janë të arsyeshme dhe plotësisht të mbështetura me prova.Sa i përket tarifave të avokatëve, kërkuesi duhet të tregojë se tarifat janë paguar ose se ekziston një detyrim ligjor për t'u paguar. Gjykata ka diskrecion në dhënien e shpenzimeve të avokatëve, gjë që shpesh çon në një shpërblim më të ulët se ai i kërkuar nga kërkuesi, edhe kur kërkesat janë të konfirmuara dhe të mbështetura me fatura dhe raporte tarifash. Gjykata nuk është e detyruar nga rregullat kombëtare për llogaritjen e tarifave të avokatëve.[18]

Në çështjen *Kingsley kundër Mbretërisë së Bashkuar*[19] është konstatuar shkelje e nenit 6 të Konventës, ku është përcaktuar se "*kërkuesi ka të drejtë të marrë diçka më shumë sesa një fitore morale ose satisfaksion"* për shkak të frustrimit të pësuar, pasigurisë, shqetësimit ose dëmtimit të reputacionit.Parimi *restitutio in integrum* kërkon zhvillimin e një rigjykimi të plotë para gjykatave të brendshme, por nuk i detyron kërkuesit që ta realizojnë atë.Është e nevojshme që Gjykatës t'i sigurohen raporte të detajuara të pagesave ose fatura. Gjykata nuk do të urdhërojë kompensim për kërkuesin në lidhje me procedurat e brendshme në të cilat tarifat e tilla nuk kanë qenë të lidhura me shkeljen e Konventës, të konstatuar nga Gjykata.Në dritën e sa më sipër, avokatët nuk duhet të habiten që Gjykata shpesh i ul shumat e dhëna, edhe pse kërkesa është pranuar.Pagesa e kompensimit dhe shpenzimeve të dhëna nga Gjykata mund të kryhet drejtpërdrejt në llogarinë bankare të kërkuesit ose të avokatit të tij, në varësi të udhëzimeve të dërguara nga Sekretariati i Gjykatës.

[18] Merrillis J.1993 pg. 93
[19] Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar, (kërkesa nr.27229/95), 3 prill 2001

Sistemi i ndihmës juridike për aplikantët në procedurat para Gjykatës

Gjykata nuk ofron ndihmë juridike në fillim të procedurës. Në fazat e mëvonshme të procedurës, pasi Gjykata të ketë vendosur t'u dërgojë kërkesë palëve përkatëse me qëllim marrjen e vërejtjeve të tyre me shkrim, aplikantët mund të përfitojnë ndihmë juridike nëse nuk janë në gjendje të përballojnë pagesën e një avokati dhe nëse Gjykata vlerëson se një ndihmë e tillë është e nevojshme për zhvillimin e rregullt të çështjes. Rregullat 100 deri në 105 të Rregullores së Gjykatës përmbajnë detajet lidhur me ndihmën juridike. Kryetari i Dhomës mund të japë vetë ndihmë juridike pasi Qeveria e shtetit të thirrur të ketë paraqitur vërejtjet e saj me shkrim për kërkesën.

Kërkuesi duhet të paraqesë kërkesë, ndërsa autoritetet kombëtare duhet të konfirmojnë deklaratën që tregon të ardhurat, mjetet financiare dhe detyrimet financiare të aplikantit. Kryetari i Dhomës mund të kërkojë nga Qeveria përkatëse të japë mendim lidhur me kërkesën për ndihmë juridike. [20] Sekretari do t'i njoftojë palët nëse ndihma juridike jepet ose refuzohet. Sekretari do të përcaktojë tarifën e zbatueshme të pagesës dhe të gjitha pagesat përkatëse lidhur me udhëtimin, akomodimin dhe shpenzimet e tjera.

Në çështjen *Pizzano kundër Italisë*[21], kërkuesi ishte ankuar sipas nenit 6 të KEDNJ-së, duke pretenduar se gjykata kishte qenë e njëanshme në procedurën penale të zhvilluar kundër tij. Çështja më pas u shqyrtua edhe nga Dhoma e Madhe, ku kërkuesi u shpall i pafajshëm. Në procedurën para Dhomës së Madhe u dëgjua një dëshmitar kyç dhe akuza u anulua. Duhet theksuar se shuma e dhënë përmes ndihmës juridike është e ulët dhe përfaqëson vetëm një kontribut në shpenzimet ligjore.[22]

Shqyrtimi dhe zgjidhja e kërkesave të paraqitura para Gjykatës

Rregulli 62 i Rregullores së Gjykatës përcakton kushtet sipas të cilave mund të arrihet një marrëveshje ndërmjet kërkuesit dhe shtetit përkatës me qëllim përfundimin e mosmarrëveshjes së tyre. Gjykata i

[20] Horovenco B. Protection of partients' rights in the European Court of Human Rights, Zaporizhzhia National University 2015, fq.33-35

[21] CASE OF PISANO v. ITALY. 36732/97 | Judgment (Struck out of the List) | Court (Grand Chamber) | 24/10/2002. https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-60706%22]}

[22] Horovenco B. Protection of partients' rights in the European Court of Human Rights, Zaporizhzhia National University 2015, fq.36

inkurajon gjithmonë palët të arrijnë një zgjidhje miqësore. Negociatat për zgjidhje janë konfidenciale dhe mund të rezultojnë në pagesa financiare. Avokatët luajnë një rol kyç në këto negociata. Ata duhet të jenë në gjendje t'i këshillojnë klientët e tyre nëse duhet të pranohet një marrëveshje, veçanërisht në lidhje me shumën e çdo oferte të bërë nga Qeveria e thirrur.

Një nga mënyrat e zgjidhjes së mosmarrëveshjes ndërmjet kërkuesit dhe shtetit të paditur, në periudhën midis pranueshmërisë së kërkesës dhe dhënies së vendimit përfundimtar, është arritja e një marrëveshjeje miqësore. Pas shpalljes së pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata ua vë në dispozicion palëve procedurën e marrëveshjes miqësore.[23]

Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 68 të Rregullores së GJEDNJ-së, Regjistrari vendos kontakte me palët me qëllim sigurimin e arritjes së një marrëveshjeje të tillë. Në fazën e hershme, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mund të japë një mendim "*të përkohshëm"* lidhur me themelin e mosmarrëveshjes. Ndonjëherë, Gjykata vetë i shqyrton mundësitë për një zgjidhje miqësore në diskutim me njërën ose me të dyja palët veçmas. Fleksibiliteti dhe informaliteti i kësaj atmosfere kontribuojnë në krijimin e një mjedisi në të cilin palëve u lehtësohet arritja e një kompromisi përkatës. [24]

Konkluzione

Procedurat para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut karakterizohen nga një sistem i rregulluar në mënyrë të detajuar që synon garantimin e një procesi të drejtë, efektiv dhe transparent për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Rregullat procedurale përcaktojnë qartë mënyrën e paraqitjes së kërkesave, komunikimin ndërmjet palëve dhe Gjykatës, si dhe fazat e shqyrtimit të çështjeve. Një element i rëndësishëm i këtij sistemi është mundësia e arritjes së një zgjidhjeje miqësore ndërmjet kërkuesit dhe shtetit të paditur, e cila inkurajohet vazhdimisht nga Gjykata.

Ky mekanizëm kontribuon në zgjidhjen më të shpejtë të mosmarrëveshjeve dhe lehtëson ngarkesën gjyqësore, duke ruajtur në të njëjtën kohë efektivitetin e mbrojtjes së të drejtave të garantuara nga Konventa.Gjithashtu, sistemi i ndihmës juridike dhe i satisfaksionit të drejtë

[23] Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (1950), neni 38
[24] Вељановска, С. Човекови права, Авторизирани предавања, Кичево 2019, fq.217-218

luan rol të rëndësishëm në sigurimin e aksesit në drejtësi për individët që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare. Gjykata vlerëson kërkesat për kompensim mbi baza të drejta, duke marrë parasysh natyrën e dëmit material, jomaterial dhe shpenzimeve procedurale.

Procedurat para Gjykatës pasqyrojnë një balancë midis mbrojtjes së të drejtave individuale dhe funksionimit efikas të sistemit gjyqësor ndërkombëtar, duke siguruar një mekanizëm të besueshëm për zbatimin e standardeve të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Referenca

1. Lafranc G. A Look at the European Court of Human Rights Case Law on Moral Issues and Academic Freedom, Juridica international 2017, fq.12
2. Horovenco B. Protection of partients' rights in the European Court of Human Rights, Zaporizhzhia National University 2015,
3. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (1950), neni 38
4. Вељановска, С. Човекови права, Авторизирани предавања, Кичево 2019,
5. Gomien D. Davis H. Zwaak L. Law and practice of European Convention on Human Rights and the European Social Charter, Council of Europe 1996,
6. Rial-Sabad E. Blasime A. The European Court of Human Rights Ruling on Unproven Stem Cell Therapies: A Missed Opportunity?, Stem Cells and Development Journal 2014,
7. Lafranc G. A Look at the European Court of Human Rights Case Law on Moral Issues and Academic Freedom, Juridica international 2017,
8. Christofersen G., Matsen M. The European Court of Human Rights between Law and Politics Oxford 2011,
9. CASE OF PISANO v. ITALY. 36732/97 | Judgment (Struck out of the List) | Court (Grand Chamber) | 24/10/2002. https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-60706%22]}
10. POLTORATSKIY, KUZNETSOV, NAZARENKO, DANKEVICH, ALIEV DHE KHOKHLICH kundër UKRAINËS (kërkesat nr. 38812/97, 39042/97, 39483/98, 40679/98, 41220/98, 41707/98) 29 prill 2003, https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-4476%22]}
11. https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-172563%22]}
12. https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-243782%22]}
13. https://hudoc.echr.coe.int/#{%22documentcollectionid2%22:[%22GRANDCHAMBER%22,%22CHAMBER%22

EFIKASITETI I INVESTIMEVE KAPITALE NË RMV NË BAZË TË BUXHETIT 2019-2026

Prof.Dr. Gëzim Selimi

Phd. Candidate Arbana Selimi Sadiku

Abstrakt

Investimet janë kategori ekonomike e cila kursimin, përkatësisht mjetet e lira dhe tepricën e parave i shndërron në të mira të kapitalit material dhe jo material, d.m.th investimet paraqesin zmadhimin e fondeve të kapitaleve aktuale. Efektet nga investimet përcaktohen si marrëdhënie ndërmjet fitimit dhe mjeteve të investuara. Mirëpo, efektet janë shumë më të gjera, nga ky efekt i drejtpërdrejtë dhe konkretisht matës, përkatësisht ato janë të shumta dhe të ndryshme

Ky punim analizon efikasitetin e investimeve kapitale në Maqedoninë e Veriut për periudhën 2019–2026, duke u mbështetur në tregues makroekonomikë dhe fiskalë konkretë si BPV, rritja ekonomike, niveli i shpenzimeve kapitale dhe shkalla e realizimit të tyre. Qëllimi është të vlerësohet lidhja midis investimeve kapitale dhe performancës ekonomike, si dhe të identifikohen dobësitë strukturore në planifikimin dhe zbatimin buxhetor. Të dhënat tregojnë se megjithëse investimet kapitale kanë shënuar rritje në disa vite, niveli i realizimit mbetet i paqëndrueshëm, duke kufizuar ndikimin e tyre në rritjen reale të BPV-së. Analiza sugjeron se efikasiteti i ulët operacional dhe devijimet midis planifikimit dhe realizimit janë faktorë kyç që ndikojnë në efektin zhvillimor të këtyre investimeve. Punimi kontribuon duke ofruar një vlerësim të bazuar në të dhëna dhe duke hapur rrugë për analiza më të avancuara si DEA në studime të ardhshme.

Fjalët kyce: *Efikasiteti, investimet kapitale, kursimi.*

Hyrje

Investimet kapitale konsiderohen një nga instrumentet kryesore të politikës fiskale për nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe përmirësimin e infrastrukturës publike. Politika e investimeve përfshin masa dhe instrumente të qeverisë me të cilat, kryesisht, zgjidhen tre probleme themelore lidhur me investimet, lloje të investimeve, burime të mjeteve për investim dhe efikasitet. Në vendet në zhvillim, si Maqedonia e Veriut, roli i tyre është edhe më i rëndësishëm për shkak të nevojës për modernizim ekonomik dhe rritje të produktivitetit.

Gjatë periudhës 2019–2026, ekonomia e vendit ka kaluar nëpër faza të ndryshme, duke përfshirë rënien ekonomike në vitin 2020 (-4.7%), rikuperimin pas pandemisë dhe një trend gradual rritjeje deri në vitin 2026. Në të njëjtën kohë, investimet kapitale kanë pësuar luhatje të konsiderueshme, si në aspektin e planifikimit ashtu edhe të realizimit. Investime kapitale publike, në periudha më të gjata kohore, të akorduara nga Buxheti i RMV-së, shënojnë shkurtim të konsiderueshëm çdo vit, shoqëruar edhe me shkallë relativisht të ulëta të realizimit. Ky proces ka reperkusionet e veta të paktën mbi humbjet në rritjen ekonomike të RMV-së por edhe mbi rritjen eventuale të konkurrencës së ekonomisë së RMV-së për shkak të pamundësisë të përmirësohet infrastruktura. Por, për shembull, në vitin 2020 realizimi ishte rreth 68%, ndërsa në vitin 2024 dhe 2025 arriti nivele më të larta, duke reflektuar përmirësime në menaxhimin fiskal.

Megjithatë, një nga problemet kryesore mbetet mospërputhja midis shumave të planifikuara dhe atyre të realizuara, që ndikon drejtpërdrejt në efikasitetin ekonomik të këtyre investimeve. Në këtë kontekst, lind nevoja për një analizë të thelluar që jo vetëm mat nivelin e investimeve, por edhe efektivitetin e tyre në raport me rritjen ekonomike dhe stabilitetin fiskal.

Për pohimin apo mohimin e këtij efikasiteti do të përdorim këto hipoteza:

H1: Investimet kapitale ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike.

H2: Realizimi i investimeve rrit efikasitetin.

H3: Mospërputhja plan-realizim ndikon negativisht në performancën ekonomike dhe stabilitetin fiskal.

Ky punim synon të plotësojë këtë boshllëk duke analizuar në mënyrë empirike efikasitetin e investimeve kapitale në Maqedoninë e Veriut për periudhën 2019–2026.

Rëndësia dhe roli i efikasitetit të investimeve kapitale

Investimet kapitale përbëjnë një nga instrumentet më të rëndësishme të politikës ekonomike dhe fiskale, veçanërisht në vendet në zhvillim ku nevojat për infrastrukturë, modernizim dhe rritje të produktivitetit janë të larta. Investimet kapitale konsiderohen si një masë shumë e rëndësishme e shëndetit të ekonomisë, kur qeveritë po bëjnë investime kapitale publike, do të thotë se ata janë të sigurt në të ardhmen dhe synojnë të rrisin ekonominë e tyre duke përmirësuar kapacitetin prodhues ekzistues. Përdorimi i faktorëve të prodhimit (burimet njerëzore, burimet natyrore, kapitali dhe aftësia sipërmarrëse) kontribuojë në rritjen e ekonomisë së vendit.

Por, duhet pasur parasysh, se rëndësia e tyre nuk qëndron vetëm në madhësinë e fondeve të alokuara, por mbi të gjitha në efikasitetin me të cilin këto fonde përdoren. Në këtë kuptim, mund të konstatojmë se efikasiteti i investimeve kapitale lidhet drejtpërdrejt me aftësinë e ekonomisë për të gjeneruar rritje të qëndrueshme dhe për të përmirësuar mirëqenien sociale.

Në teori, investimet kapitale ndikojnë në rritjen ekonomike përmes disa kanaleve kryesore. Së pari, ato kontribuojnë drejtpërsëdrejti në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese të një ekonomie duke përmirësuar infrastrukturën fizike, si rrugët, aeroportet, portet detare, energjinë, ujin dhe teknologjinë në përgjithësi. Këto investime ulin kostot e prodhimit, rrisin konkurrencën dhe, si pasoj e këtyre ndikimeve, krijojnë kushte më të favorshme për sektorin privat. Së dyti, ato ndikojnë në rritjen e produktivitetit të faktorëve të prodhimit, duke rritur dukshëm efikasitetin e punës dhe kapitalit ekzistues. Së treti, investimet kapitale kanë një efekt multiplikues në ekonomi, duke nxitur dhe shtuar kërkesën agregate dhe duke hapur vende të reja pune e duke rritur punësimin në afat të shkurtër.

Megjithatë, përfitimet e përmendura, sa do që të jen ambicioze, nuk realizohen automatikisht. Ato varen, para se gjithash, nga cilësia e planifikimit, përzgjedhja e projekteve dhe kapaciteti institucional për zbatim. Pikërisht këtu hyn në lojë koncepti i efikasitetit. Një nivel i lartë i shpenzimeve kapitale, në mënyrë automatike, nuk garanton rezultate të larta

ekonomike nëse projektet nuk janë të mirë strukturuara, nëse vonohen ose nëse projektet nuk realizohen sipas planit. Në shumë raste, disa vendet përballen me situata ku fondet ekzistojnë, por nuk arrijnë të transformohen në rezultate konkrete për shkak të dobësive në menaxhimin publik.

Efikasiteti i investimeve kapitale mund të analizohet në disa dimensione. Një dimension është efikasiteti teknik, që lidhet me përdorimin optimal të burimeve për të arritur rezultate maksimale. Një dimension tjetër është efikasiteti alokativ, që lidhet me zgjedhjen e projekteve më të përshtatshme në raport me nevojat e ekonomisë. Po ashtu, efikasiteti kohor është i rëndësishëm, pasi vonesat në realizimin e investimeve kapitale, shpesh i reduktojnë ndjeshëm efektet ekonomike të këtyre investimeve. Në këtë kontekst, një projekt i realizuar me vonesë jo vetëm që rrit koston, por edhe humb një pjesë të ndikimit të tij në zhvillimin ekonomik.

Në praktikë, një nga problemet më të shpeshta është mospërputhja midis planifikimit dhe realizimit të investimeve kapitale. Buxhetet shpesh përfshijnë projeksione ambicioze, por realizimi mbetet më i ulët për shkak të pengesave të ndryshme, siç janë ato administrative, procedurave të gjata të prokurimit, mungesës së kapaciteteve teknike ose faktorëve politikë. Kjo mospërputhje, në mes planifikimit dhe realizimit, e ul efikasitetin e përgjithshëm dhe krijon pasiguri në politikën ekonomike. Për më tepër, ajo ndikon edhe në zvogëlimin e besueshmërisë në institucionet publike dhe në perceptimin e investitorëve të mundshëm.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është lidhja midis investimeve kapitale dhe stabilitetit fiskal i një vendi. Financimi i këtyre investimeve shpesh shoqërohet me rritje të deficitit buxhetor ose të borxhit publik. Nëse investimet nuk janë efikase, atëherë kostoja fiskale mbetet e lartë pa gjeneruar përfitime të mjaftueshme ekonomike. Në këtë rast, ekonomia përballet me një situatë të dyfishtë negative: nga njëra anë kemi rritje të borxhit dhe nga ana tjetër, mungesë të rritjes ekonomike. Për këtë arsye, efikasiteti i investimeve kapitale është një element kyç për ruajtjen e qëndrueshmërisë fiskale në afat të mesëm dhe të gjatë.

Në kontekstin e zhvillimit rajonal, investimet kapitale luajnë rol të rëndësishëm në reduktimin e pabarazive territoriale. Nëse ato shpërndahen në mënyrë të balancuar dhe bazuar në nevoja reale, mund të kontribuojnë në

zhvillimin e zonave më pak të zhvilluara dhe në integrimin ekonomik të tyre. Por nëse mungon efikasiteti, këto investime mund të përqendrohen në projekte me ndikim të kufizuar ose në zona që tashmë janë të zhvilluara, duke thelluar diferencat ekzistuese.

Në dekadat e fundit, rëndësia e matjes së efikasitetit është rritur ndjeshëm për të vlerësuar performancën e investimeve në mënyrë më objektive dhe krahasuese. Këto qasje lejojnë identifikimin e dobësive në përdorimin e burimeve dhe ofrojnë bazë për përmirësimin e politikave publike. Ato ndihmojnë gjithashtu në zhvendosjen e fokusit nga "sa shpenzohet" drejt "çfarë arrihet me këto shpenzime".

Pra, efikasiteti i investimeve kapitale është një faktor vendimtar për suksesin e politikave ekonomike. Ai përcakton nëse burimet publike shndërrohen në rritje reale ekonomike, në përmirësim të infrastrukturës dhe në rritje të mirëqenies së qytetarëve. Pa një nivel të lartë efikasiteti, edhe nivelet e larta të investimeve mund të kenë ndikim të kufizuar. Për këtë arsye, përmirësimi i menaxhimit të investimeve kapitale duhet të jetë një prioritet kryesor për çdo ekonomi që synon zhvillim të qëndrueshëm dhe konkurrueshmëri më të lartë.

Efikasiteti i investimeve kapitale në Republikën e Maqedonisë së Veriut që nga viti 2019 deri në vitin 2026

Siç e cekëm edhe më lartë se investimet kapitale përbëjnë një nga instrumentet më të rëndësishme të politikës ekonomike, veçanërisht në vendet në zhvillim, siç është edhe RMV-ja, ku nevojat për infrastrukturë, modernizim dhe rritje të produktivitetit janë të larta.

Për të matur efikasitetin e investimeve kapitale do të përdorim kombinimin e modeleve DEA (Data Envelopment Analysis - Analiza e mbështjelljes së të dhënave) dhe modeli ML (Malmquist).

Modeli analitik DEA ndërton një "kufi efikasiteti" duke i krahasuar njësitë mes tyre. Në literaturë, DEA përdoret për të matur sa mirë një shtet i kthen inputet (shpenzime publike, digjitalizimin, institucionet, etj.) në outpute (të ardhura, zhvillim ekonomik, standard e shërbime sociale, arsim, shkencë, etj.). Njësitë që janë më të mirat formojnë kufirin, ndërsa të tjerat maten sa larg janë prej tij. Malmquist (ML) pastaj mat ndryshimin nga një

periudhë në tjetrën, nuk shikon vetëm nivelin, por në analizë përfshin edhe progresin apo regresin.

- DEA (Data Envelopment Analysis) → mat efikasitetin relativ ndër vite, ndërsa

- Indeksi Malmquist (ML) → mat ndryshimin e produktivitetit nga një vit në tjetrin.

Në praktikë, për Maqedoninë, inputi kryesor është: Shpenzimet kapitale nga buxheti (në denarë ose % e GDP) , deficiti buxhetor ndërsa Outputet janë: rritja reale e BPV-së (%), BPV (në vlerë absolute) dhe BPV për banor. Problemi është që për Maqedoninë nuk ka një tabelë të vetme standarde si për vendet e BE-së, por do të përdorim të dhëna statistikore nga institucione të ndryshme nga RMV-ja dhe ato ndërkombëtare si duke kombinuar studimet rajonale dhe evropiane. Për një analizë nëpërmjet metodës DEA-ML duhen të dhëna që lidhen drejtpërdrejt me inputet, outputet dhe dimensionin kohor.

Tabela 1: Inputet dhe Outputet për DEA

Viti	Inv. kapitale (plan)	Realizimi	Deficiti	BPV (mil denarë)	Rritja %
2019	25,971	17,813	17,200	692,683	3.9
2020	23,771	16,115	17,385	669,280	-4.7
2021	23,975	23,408	34,937	729,445	4.5
2022	38,236	28,637	33,529	816,084	2.8
2023	48,751	43,500	42,759	902,905	2.6
2024	45,179	44,698	33,510	964,087	3.0
2025	47,156	47,351	41,350	1,004,177	3.5
2026	40,113	—	39,239	1,133,380	3.1

Tabela 2: Shkalla e realizimit të investimeve kapitale

Viti	Plan	Realizim	% realizimi
2019	25,971	17,813	68.6%
2020	23,771	16,115	67.8%
2021	23,975	23,408	97.6%
2022	38,236	28,637	74.9%
2023	48,751	43,500	89.2%
2024	45,179	44,698	98.9%

2025	47,156	47,351	100.4%
2026	40,113	—	—

Tabela 3: Vlerësimi paraprak i efikasitetit (interpretim logjik)

Viti	Vlerësim efikasiteti	Arsye
2019	Mesatar	Realizim i ulët
2020	I ulët	Rënie ekonomike + realizim i dobët
2021	I lartë	Realizim pothuajse i plotë + rritje
2022	Mesatar	Investime të larta, por realizim i pjesshëm
2023	Mesatar-lartë	Përmirësim në realizim
2024	I lartë	Stabilitet dhe realizim i lartë
2025	Shumë i lartë	Realizim maksimal + rritje
2026	I pasigurt	Mungesë e të dhënave për realizim

A. Formula bazë e efikasitetit në modelin DEA

Në thelb, modeli DEA mat efikasitetin si raport midis outputeve dhe inputeve:

$$\textbf{Efikasiteti} = \frac{\sum_{r=1}^{s} u_r y_r}{\sum_{i=1}^{m} v_i x_i}$$ ku:

y_r= outputet (p.sh. BPV, rritja ekonomike)

x_i= inputet (p.sh. investimet kapitale, deficiti)

u_r, v_i= peshat (përcaktohen nga modeli)

Siç cekëm në fillim se metoda DEA krijon një kufi efikasiteti ku njësitë më të mira formojnë këtë kufi ndërsa të tjerat krahasohen me to dhe vite si 2021, 2024, 2025 janë më afër kufirit ndërsa vitet e tjera janë më larg dhe kanë potencial për përmirësim.

Gjatë përdorimit të formulës së lartshënuar rezultatet e metodës DEA janë prezantuar në tabelë e më poshtme.

Viti	Efikasiteti DEA
2019	1.00
2020	1.00
2021	1.00
2022	1.30
2023	1.51
2024	1.28

2025	1.31

Vlera e paraqitura në tabelë kanë këtë interpretim: 1.00 = efikas në kufirin optimal; ndërsa nëse >1 dmth. potencial për rritje outputi me të njëjtat inpute (pra jo plotësisht efikas në praktikë).

Të dhënat e lartshënuara do ti paraqesim edhe nëpërmjet një grafiku.

Analiza e efikasitetit të investimeve kapitale sipas modelit DEA

Rezultatet e modelit DEA tregojnë se efikasiteti i investimeve kapitale në Maqedoninë e Veriut gjatë periudhës 2019–2025 nuk ka qenë linear, por ka kaluar në disa faza të dallueshme.

Në vitet 2019–2021, efikasiteti rezulton në nivelin 1, që nënkupton pozicionim në kufirin efikas. Megjithatë, kjo nuk duhet interpretuar si performancë optimale absolute, por më tepër si reflektim i një niveli relativisht të ulët të outputeve ekonomike dhe një strukture më të thjeshtë të inputeve.

Një ndryshim i rëndësishëm vërehet në vitin 2022, indeksi i efikasitetit rritet në 1.30, duke treguar se me të njëjtat nivele inputesh, ekonomia kishte potencial për të gjeneruar rreth 30% më shumë output. Ky trend intensifikohet në vitin 2023, ku koeficienti arrin 1.51, që nënkupton nivelin më të lartë të jo efikasitetit në të gjithë periudhën e analizuar. Ky rezultat lidhet drejtpërdrejt me: rritjen e ndjeshme të investimeve kapitale, përmirësimin e realizimit të tyre dhe stabilizimin e rritjes ekonomike.

Megjithatë, në vitet 2024 dhe 2025 vërehet një stabilizim relativ i efikasitetit (1.28 dhe 1.31), që sugjeron se sistemi ka arritur një nivel të caktuar maturimi, por pa arritur optimizim të plotë.

B. Formulimi i indeksit Malmquist (ML) bëhet nëpërmjet formulës:

$$\boldsymbol{M} = \left[\frac{D_t(x_{t+1},y_{t+1})}{D_t(x_t,y_t)} \cdot \frac{D_{t+1}(x_{t+1},y_{t+1})}{D_{t+1}(x_t,y_t)}\right]^{\frac{1}{2}}$$ prej ku interpretimi i rezultateve të fituara është: M > 1 → rritje e efikasitetit; M = 1 → pa ndryshim dhe M < 1 → rënie e efikasitetit. Nga përllogaritjet e bëra dalin këto ML indekse:

Tabela 4: Indeksi Malmquist (interpretim i pritur)

Periudha	ML Indeks	Interpretim
2019–2020	<1	Rënie (kriza COVID)
2020–2021	>1	Rikuperim i fortë
2021–2022	<1	Stagnim
2022–2023	>1	Përmirësim
2023–2024	>1	Stabilitet
2024–2025	>1	Maksimizim efikasiteti
2025–2026	≈1 ose <1	Rrezik rënie

Nga llogaritjet e të dhënave mund të bëjmë një interpretim të përgjithshëm, se:

a. Problemi kryesor nuk është niveli i investimeve, por realizimi i tyre;

b. Vitet më efikase janë 2021, 2024 dhe 2025;

c. Viti më problematik është viti 2020 (për shkak të pandemisë Covid 19) dhe

d. se ka lidhje të dukshme midis, realizimit të lartë dhe rritjes ekonomike më stabile.

Përfundim

Si përfundim në bazë të rezultateve të prezantuara në lidhje me efikasitetin e investimeve kapitale në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga viti 2019 deri në vitin 2026 të llogaritura sipas modelit DEA-ML konfirmojnë disa çështje strukturore:

1. Problemi nuk është vetëm niveli i investimeve - Rritja e investimeve kapitale nuk përkthehet automatikisht në efikasitet më të lartë. Vitet me investime më të mëdha (2022–2023) kanë edhe devijime më të mëdha nga kufiri efikas.

2. Realizimi është faktor kyç - Vitet me realizim më të lartë (2024–2025) tregojnë stabilizim të efikasitetit. Kjo mbështet fort hipotezën që: cilësia e realizimit është më e rëndësishme se madhësia e buxhetit. Edhe pse shumat për investime kapitale janë relativisht të larta në letër, realizimi mbetet problematik. Për shembull, në fillim të vitit 2026 u realizuan vetëm rreth 20% e planit në dy muajt e parë, çka tregon ritëm të ngadaltë dhe përqendrim të shpenzimeve në fund të vitit. Ky fenomen zakonisht prodhon investime me cilësi më të dobët dhe vendime të nxituara.

3. Potencial i pashfrytëzuar - Vlerat mbi 1 në vitet e fundit tregojnë se: ekziston hapësirë për rritje të outputeve pa rritur inputet dhe se sistemi nuk është plotësisht i optimizuar. Pra kemi shpërndarje jo optimale dhe ndikim i kufizuar zhvillimor edhe kur realizohen investimet ato shpesh nuk shpërndahen sipas nevojave reale rajonale dhe nuk lidhen me strategji të qarta zhvillimore. Kjo e ul ndikimin në rritje ekonomike dhe në uljen e pabarazive.

4. Ulje reale e peshës së investimeve kapitale – për shembull në vitin 2026, investimet kapitale jo vetëm që nuk rriten proporcionalisht me buxhetin, por madje bien nga rreth 768 milionë € në rreth 640–660 milionë € . Kjo tregon një zhvendosje të prioriteteve nga zhvillimi afatgjatë drejt shpenzimeve rrjedhëse (paga, transfere sociale).

5. Dominimi i shpenzimeve jo-produktive - Një pjesë gjithnjë e më e madhe e buxhetit të RMV-së shkon për: paga në sektorin publik, pensione dhe transfere sociale. Kjo e kufizon hapësirën reale për investime zhvillimore dhe e ul efektin shumëzues të investimeve kapitale në ekonomi.

6. Përqendrim i investimeve në pak projekte të mëdha - një pjesë e konsiderueshme e investimeve kapitale lidhet me projekte të mëdha infrastrukturore (p.sh. korridoret rrugore). Kjo sjell dy probleme: rrezik të lartë vonesash dhe tejkalimi kostosh e njëherit edhe mungesë diversifikimi në sektorë si arsimi, shëndetësia apo inovacioni. Pra, efekti në zhvillim është më i kufizuar sesa pritet.

7. Probleme në menaxhim dhe kapacitete institucionale - mos-efikasiteti në investimet kapitale lidhet edhe me: procedura të gjata të prokurimit, mungesë projektesh të gatshme dhe kapacitete të dobëta në nivel lokal për zbatim. Kjo bën që fondet të qëndrojnë të pashfrytëzuara ose të shtyhen nga një vit në tjetrin.

Në bazë të këtyre rezultateve hipoteza H1 - "Investimet kapitale ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike" nuk konfirmohet për arsye se: efekti ekziston, por është i dobët dhe investimet nuk përkthehen automatikisht në rritje.

Ndërsa Hipoteza H2 - "Realizimi i investimeve rrit efikasitetin" konfirmohet nga DEA -ML, pasi: vitet me realizim të lartë, efikasiteti është më i mire dhe lidhja është e qartë në analizë,

Hipoteza H3 - "Mospërputhja plan-realizim ndikon negativisht" po ashtu konfirmohet pasi periudhat me realizim të dobët, efikasiteti bie kur ka devijime.

Pra, problemi kryesor nuk është sa shpenzon shteti si investime kapitale por problemi është si dhe sa mirë i realizon ato investime. Nëse ekonomia nuk reagon ndjeshëm ndaj rritjes së investimeve apo rritjes së deficitit, kjo tregon një efikasitet i ulët strukturor dhe mungesë lidhjeje të fortë midis politikës fiskale dhe rritjes reale.

Ndërsa sa i takon viteve 2025 dhe 2026 efikasiteti i ulët i investimeve kapitale në Maqedoni reflektohet drejtpërdrejt në performancën e rritjes ekonomike. Pavarësisht nivelit relativisht të lartë të shpenzimeve kapitale në buxhet, rritja reale e GDP-së në vitet 2025 dhe 2026 mbetet në intervalin 3–3.5%, që konsiderohet nivel mesatar dhe i pamjaftueshëm për një konvergjencë më të shpejtë ekonomike. Diferenca ndërmjet rritjes nominale të GDP-së (rreth 6–8%) dhe rritjes reale (rreth 3%) tregon se një pjesë e madhe e rritjes është rezultat i inflacionit dhe jo i zgjerimit real të aktivitetit ekonomik. Kjo nënkupton se investimet kapitale nuk po arrijnë të krijojnë vlerë të shtuar të qëndrueshme në ekonomi dhe ritmi relativisht i ulët i rritjes ekonomike në vitet 2025–2026 përbën një tregues indirekt të efikasitetit të kufizuar të investimeve kapitale, duke reflektuar dobësi në planifikim, realizim dhe orientim zhvillimor të shpenzimeve publike.

Për ti eliminuar apo minimizuar këto mangësi Qeveria e RMV-së në shtator të vitit 2025 ka themeluar Komitetin për investime publike, me të cilin vendosen themelet për menaxhimin më efikas, transparent dhe strategjik të investimeve publike që do të sigurojë koordinim institucional dhe qasje të integruar në vendimmarrje. Ky Komitet, ndër të tjerat, do të ketë rol të rëndësishëm në shqyrtimin dhe vlerësimin e ideve projektuese, sa i përket dhënies së prioritetit dhe vendimmarrjes së tyre, me ç'rast do ta destinojnë ciklin e investimeve shtetërore drejt projekteve që sjellin vlerë më të madhe për qytetarët dhe ekonominë si dhe do ta monitorojë progresin e investimeve, do ta vlerësojë fizibilitetin e tyre dhe do të sigurojë rekomandime për shfrytëzimin më të mirë të mjeteve publike. Në këtë mënyrë do të garantohet përputhja e plotë e investimeve publike me qëllimet dhe prioritetet e Qeverisë, si dhe harmonizimi i realizimit të tyre me strategjitë nacionale të zhvillimit.

Po ashtu, në funksion të rritjes së efikasitetit të investimeve kapitale publike me Rregulloren e re të menaxhimit të investimeve publike parashikohet që të gjithë shfrytëzuesit buxhetorë dhe subjektet publike, siç janë ndërmarrjet publike dhe shoqëritë aksionare shtetërore, përfshirë komunat, janë të detyruara t'i parashtrojnë nismat e tyre për zbatimin e projekteve të infrastrukturës publike me një shumë të vlerësuar prej 5 milionë eurosh e më shumë në Ministrinë e Financave, e cila do t'i shqyrtojë dhe verifikojë studimet parainvestuese në mënyrë të pavarur.

Literatura e shfrytëzuar

1. Abdylmenaf Bexheti, Financat publike, Tetovë, 2007.
2. Alqi Naqellari, Politikat ekonomike dhe ambienti politik shqiptar, Tiranë, 2010.
3. Alqi Naqellari, Politikat ekonomike Keynsianizmi-I, Tranë 2020.
4. Anastas Angjeli &Adrian Civici, Përballë Krizës, Tiranë, 2021.
5. Anastas Angjeli, Kriza ekonomike në kohën e koronavirusit, Tiranë, 2020.
6. Aristotel Pano & Anastas Angjeli, Ndërhyrja e shtetit në ekonomi, Tiranë, 2015.
7. Asim Stranjak, Monetarne financije, Mostar, 1979.
8. Dimitar Eftimoski, Ekonomija na razvojot, Shkup, 2003.
9. Edlira Luci&Dorina Kripa, Investime, Tiranë, 2007.

10. Greta Angjeli, Auditimi dhe qeverisja e mirë, Tiranë, 2014.
11. Gëzim Selimi, Planifikimi ekonomik, Strugë 2026.
12. Halit Xhafa&Beshir Ciceri, Drejtimi financiar 1, Tiranë 2003.
13. Halit Xhafa&Beshir Ciceri, Drejtimi financiar 2 Tiranë 2003.
14. I. Shuli&R. Perri, Analiza e pasqyrave financiare, Tiranë 2016.
15. Isa Mustafa, Menaxhmenti financiar, Prishtinë, 2007.
16. Margarita Janeska&Marjan Angeleski, Finansiska i aktuarska matematika, Prilep, 2009.
17. Metodija Nestorovski, Ekonomija na investiciite, Shkup, 2000.
18. Mishkin, Ekonomiksi, Prishtinë 2022.
19. Nazmi Iballi, Analiza financiare me auditim, Prishtinë 2019.
20. Sabahudin Komoni, Financat, Prishtinë 2009.
21. Sabri Kadriu, Financa publike, Prishtinë 2012
22. Selman Selmanaj, Sistemet ekonomike bashkëkohore, Prishtinë, 1996.
23. Sh.Jakupi & H. Shehu, Revizioni financiar, prishtinë 2011.
24. Spiro Brumbulli, Investimet, Tiranë 2002.
25. Ministria e financave – www.finance.gov.mk
26. Ministria e ekonomisë – www.economy.gov.mk
27. Banaka Popullore – www.nbrm.mk
28. Enti Shteteror për statistikë -www.stat.gov.mk
29. Statistikat rajonale dhe të përgjithshme – www.stat.mk
30. Drejtoria e te Hyrave Publike DHP – www.ujp.gov.mk
31. Faktor.mk; denar.mk; opserver.mk; scribd.com; capitalam.mk; epbih.ba; portalb.mk; prishtinaonline.com; Respublika.edu.mk; alfaz.mk;

PAVARËSIA ENERGJETIKE DHE NDIKIMI I SAJ NË RRITJEN EKONOMIKE: RASTI I SHQIPËRISË

Doc. Dr. Gazmend Beshi
Dekan i Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, Maqedonia e VeriutNEkspert-Finance/Fiskalitet/Kontabilitet/Mjedis Dhe Auditues Mjedisor

Abstrakt

Ky punim analizon rolin e pavarësisë energjetike në rritjen ekonomike të Shqipërisë, duke e trajtuar energjinë si faktor strukturor të modelit ekonomik dhe si kanal të rëndësishëm të stabilitetit makroekonomik. Në kushtet e tranzicionit energjetik, rritjes së kërkesës për energji dhe paqëndrueshmërisë së tregjeve ndërkombëtare, një ekonomi e vogël dhe e hapur si Shqipëria përballet me sfida të veçanta. Struktura kombëtare e prodhimit të energjisë elektrike mbështetet kryesisht te hidroenergjia, e cila është burim i rinovueshëm, por njëkohësisht e varur nga reshjet dhe ciklet klimatike. Punimi përdor një qasje analitike dhe empirike, duke ndërtuar një bazë të dhënash vjetore për periudhën 2017-2024 nga burime zyrtare Eurostat/FRED dhe World Bank/FRED. Për modelin ekonometrik përdoret rritja reale e PBB-së si variabël e varur, ndërsa presioni i çmimeve të energjisë dhe inflacioni i përgjithshëm përdoren si variabla shpjeguese. Rezultatet tregojnë se, për shkak të kampionit të kufizuar, regresioni nuk jep prova statistikisht të forta për shkakësi të drejtpërdrejtë, por evidenton rëndësinë e stabilitetit energjetik në interpretimin e performancës ekonomike. Analiza strukturore mbështet argumentin se diversifikimi energjetik, magazinimi i energjisë dhe modernizimi i rrjetit janë kushte thelbësore për rritje ekonomike më të qëndrueshme.

Fjalë kyçe: *pavarësia energjetike; rritja ekonomike; Shqipëria; hidroenergji; diversifikim energjetik; analizë ekonometrike.*

Hyrje

Energjia përbën një nga inputet më të rëndësishme të ekonomisë moderne, pasi ajo përdoret në prodhim, transport, shërbime, bujqësi, ndërtim, industri dhe konsum familjar. Çdo luhatje në disponueshmërinë ose në çmimin e energjisë reflektohet në kosto, në çmime, në investime dhe në aftësinë e një ekonomie për të ruajtur ritme të qëndrueshme rritjeje. Për këtë arsye, pavarësia energjetike nuk mund të trajtohet vetëm si objektiv teknik i sektorit energjetik, por si pjesë e modelit ekonomik kombëtar.

Në rastin e Shqipërisë, çështja merr rëndësi të veçantë për shkak të strukturës së prodhimit vendas të energjisë elektrike. Hidroenergjia ka qenë historikisht baza kryesore e sistemit energjetik shqiptar. Kjo i ka dhënë vendit avantazh në aspektin e përdorimit të burimeve të rinovueshme dhe të prodhimit me emetime të ulëta, por e ka bërë sistemin të ndjeshëm ndaj thatësirave, reshjeve të pamjaftueshme dhe cikleve të paparashikueshme hidrologjike.

Në vite me prurje të larta ujore, vendi mund të prodhojë sasi të konsiderueshme energjie dhe të ulë nevojën për importe. Në vite të thata, e njëjta strukturë kthehet në faktor rreziku, sepse prodhimi vendas bie dhe ekonomia detyrohet të mbështetet te energjia e importuar. Kjo krijon ndikime në bilancin tregtar, në kostot e ndërmarrjeve publike dhe private, në stabilitetin fiskal dhe në çmimet e konsumatorit.

Qëllimi i këtij punimi është të vlerësojë pavarësinë energjetike si element të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë dhe të analizojë, me të dhëna reale, lidhjen midis presionit të çmimeve të energjisë, inflacionit dhe rritjes reale të PBB-së. Punimi synon të ofrojë një analizë të kuptueshme për konferencë shkencore, pa pretenduar se një model me kampion të shkurtër mund të zëvendësojë analiza më të gjera makroekonometrike.

Nga pikëpamja e politikave publike, tema është aktuale sepse Shqipëria synon të forcojë integrimin ekonomik me Bashkimin Evropian, të rrisë qëndrueshmërinë e zhvillimit dhe të përfitojë nga tranzicioni i gjelbër. Në këtë proces, sektori energjetik nuk duhet parë si sektor i izoluar, por si infrastrukturë bazë për turizmin, industrinë, shërbimet, bujqësinë, ndërtimin dhe teknologjinë.

Rishikimi i literaturës

Literatura mbi ekonominë e energjisë ka evidentuar vazhdimisht marrëdhënien midis konsumit të energjisë dhe rritjes ekonomike. Në një ekonomi moderne, energjia nuk është thjesht mall konsumi, por faktor prodhimi që mbështet kapitalin fizik, punën, teknologjinë dhe organizimin ekonomik. Studimet ndërkombëtare argumentojnë se mungesa e energjisë së qëndrueshme pengon produktivitetin dhe rrit kostot e transaksioneve ekonomike.

Stern (2011) thekson se energjia ka rol të veçantë në rritjen ekonomike, sepse ajo nuk mund të zëvendësohet lehtësisht nga kapitali ose puna në afat të shkurtër. Nëse energjia mungon ose bëhet e shtrenjtë, ndërmarrjet nuk mund të ruajnë të njëjtin nivel prodhimi pa ndryshime në teknologji, në organizim ose në strukturën e kostove. Kjo e bën energjinë një variabël strategjike në analizën e zhvillimit ekonomik.

Apergis dhe Payne (2010) kanë trajtuar lidhjen midis konsumit të energjisë dhe rritjes ekonomike në vende të zhvilluara, duke treguar se marrëdhënia mund të jetë e dyanshme: energjia mbështet rritjen, ndërsa rritja ekonomike rrit kërkesën për energji. Ozturk (2010) evidenton se rezultatet ndryshojnë sipas strukturës ekonomike, nivelit të zhvillimit, miksit energjetik dhe politikave publike.

Në kontekstin e vendeve të vogla, literatura thekson rëndësinë e diversifikimit. Një sistem energjetik që mbështetet në një burim të vetëm, edhe kur ai burim është i rinovueshëm, mbetet i ekspozuar ndaj riskut të përqendrimit. Për Shqipërinë, ky përqendrim lidhet kryesisht me hidroenergjinë dhe me varësinë e saj nga ciklet klimatike.

Një pjesë e literaturës bashkëkohore e lidh sigurinë energjetike me konkurrueshmërinë. Vendet që arrijnë furnizim të qëndrueshëm dhe kosto të parashikueshme krijojnë kushte më të mira për investime private. Në të kundërt, ekonomitë ku energjia bëhet burim pasigurie përballen me shtyrje të investimeve, rritje të kostos së kapitalit dhe ulje të besimit të biznesit.

Nga ana tjetër, tranzicioni energjetik nuk është vetëm çështje mjedisore. Ai prek strukturën industriale, tregun e punës, financat publike dhe aftësinë e ekonomisë për t'u përshtatur me standardet e reja

ndërkombëtare. Për këtë arsye, politika energjetike duhet të lidhet me politikën ekonomike dhe jo të kufizohet në vendimmarrje teknike të prodhimit dhe shpërndarjes.

Kuadri teorik dhe hipoteza e studimit

Në këtë punim, energjia trajtohet si faktor prodhimi dhe si mekanizëm transmetimi makroekonomik. Në funksionin e zgjeruar të prodhimit, prodhimi agregat mund të konceptohet si rezultat i kapitalit, punës, teknologjisë dhe energjisë. Kur energjia është e qëndrueshme dhe me kosto të parashikueshme, ajo mbështet produktivitetin,kur ajo bëhet e pasigurt, rrit riskun dhe kufizon zgjerimin ekonomik.

Pavarësia energjetike nuk nënkupton izolim nga tregjet rajonale, por aftësi për të menaxhuar rrezikun e furnizimit dhe të çmimeve. Një vend mund të jetë i integruar në tregjet europiane dhe, njëkohësisht, të ketë nivel të lartë sigurie energjetike, nëse disponon burime të ndryshme, kapacitete magazinimi, rrjet të modernizuar dhe institucione të afta për të menaxhuar riskun.

Hipoteza kryesore e punimit është se paqëndrueshmëria energjetike ndikon në performancën ekonomike përmes disa kanaleve: rritjes së kostove të prodhimit, ndikimit mbi inflacionin, përkeqësimit të bilancit tregtar në periudha importi dhe uljes së parashikueshmërisë për investitorët. Kjo hipotezë testohet në mënyrë indikative përmes një modeli regresioni me të dhëna reale për Shqipërinë.

Nga pikëpamja teorike, lidhja nuk pritet të jetë gjithmonë lineare. Në një vit të caktuar, rritja e çmimeve të energjisë mund të përkojë me rritje të PBB-së për shkak të faktorëve të tjerë, si rikuperimi pas krizës, turizmi, konsumi ose investimet publike. Prandaj, interpretimi ekonomik duhet të shkojë përtej shenjës së koeficientit dhe të analizojë edhe kontekstin e përgjithshëm makroekonomik.

Modeli konceptual i këtij punimi është: struktura energjetike ndikon në sigurinë e furnizimit,siguria e furnizimit ndikon në kosto, inflacion dhe investime,këta faktorë ndikojnë më pas në rritjen ekonomike. Kjo qasje lejon që energjia të trajtohet si ndërmjetës midis burimeve natyrore dhe performancës ekonomike.

Burimet e të dhënave dhe metodologjia

Analiza empirike bazohet në të dhëna zyrtare të disponueshme publikisht. Për rritjen ekonomike përdoret seria e PBB-së reale të Shqipërisë nga Eurostat, e publikuar në FRED si seri tremujore e rregulluar sezonalisht. Vlerat tremujore agregohen në mesatare vjetore dhe më pas llogaritet rritja vjetore reale e PBB-së.

Për presionin e çmimeve të energjisë përdoret indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit për energjinë në Shqipëri, i publikuar nga Eurostat në FRED. Seria mujore agregohet në mesatare vjetore dhe shndërrohet në normë vjetore ndryshimi. Ky tregues nuk mat drejtpërdrejt pavarësinë energjetike, por shërben si zëvendësues i presionit të kostos energjetike mbi ekonominë.

Për inflacionin e përgjithshëm përdoret seria e World Bank/FRED për inflacionin e çmimeve të konsumit. Për dimensionin e importit energjetik, punimi përdor si evidencë përshkruese të dhënat CEIC/World Bank për importet neto të energjisë si përqindje e përdorimit të energjisë. Këto të dhëna tregojnë se importet neto ishin 32.276% në vitin 2022 dhe 22.702% në vitin 2023.

Modeli bazë i regresionit është: Rritja reale e PBB = $\beta 0 + \beta 1$(Rritja e indeksit të çmimeve të energjisë) + $\beta 2$(Inflacioni) + ε. Për shkak të periudhës së shkurtër 2017-2024, rezultatet interpretohen me kujdes dhe nuk përdoren për pretendime të forta shkakësore. Megjithatë, ato japin një bazë empirike për të diskutuar marrëdhënien midis presionit energjetik dhe performancës ekonomike.

Për të kontrolluar mundësinë që ndikimi i çmimeve të energjisë të shfaqet me vonesë, përllogaritet edhe një model i dytë ku rritja e indeksit të energjisë futet me një vit vonesë. Kjo qasje është e thjeshtë, por e dobishme, sepse lejon krahasimin midis efektit aktual dhe efektit të mundshëm të vonuar.

Përpunimi i të dhënave përfshin katër hapa: mbledhjen e vlerave nga burimet zyrtare, harmonizimin e frekuencave në bazë vjetore, llogaritjen e ndryshimeve përqindore dhe vlerësimin e regresionit OLS. Rezultatet

shoqërohen me interpretim ekonomik dhe me kufizime metodologjike, në mënyrë që analiza të mbetet e kontrolluar dhe e besueshme.

Analiza strukturore e sektorit energjetik shqiptar

Shqipëria ka një profil energjetik të veçantë në rajon. Varësia e lartë nga hidroenergjia krijon një sistem me emetime relativisht të ulëta në prodhimin e energjisë elektrike, por njëkohësisht me ndjeshmëri të lartë ndaj kushteve hidrologjike. Kjo do të thotë se avantazhi mjedisor nuk përkthehet automatikisht në stabilitet ekonomik.

Një sistem i mbështetur kryesisht te hidroenergjia ka nevojë për burime plotësuese, sidomos energji diellore, energji të erës, magazinim dhe menaxhim më të avancuar të rrjetit. Pa këta elementë, prodhimi i energjisë mbetet i lidhur ngushtë me motin dhe me prurjet ujore, ndërsa ekonomia përballet me rrezik të përsëritur në periudha thatësire.

Të dhënat për importet neto tregojnë se Shqipëria mbetet e ekspozuar ndaj tregjeve të jashtme të energjisë. Edhe kur importet bien nga një vit në tjetrin, vetë ndryshimi i madh midis viteve tregon se sistemi nuk ka elasticitet të mjaftueshëm për të garantuar stabilitet afatgjatë. Kjo është arsyeja pse pavarësia energjetike duhet të shihet si aftësi për të zbutur luhatjet, jo si vetë-mjaftueshmëri absolute.

Një faktor tjetër strukturor është gjendja e rrjetit. Edhe nëse kapacitetet e prodhimit rriten, sistemi nuk arrin të jetë eficient nëse transmetimi dhe shpërndarja nuk përshtaten me burime të reja dhe me konsumatorë aktivë. Rrjeti i së ardhmes duhet të lejojë prodhim të shpërndarë, matje të avancuar dhe menaxhim më të mirë të ngarkesës.

Në planin ekonomik, paqëndrueshmëria energjetike ndikon edhe tek pritshmëritë. Bizneset që planifikojnë investime në prodhim, hoteleri, bujqësi të përpunuar ose industri të lehtë kanë nevojë për furnizim të parashikueshëm. Çdo pasiguri e përsëritur rrit koston e planifikimit dhe nxit kërkesën për zgjidhje individuale më pak eficiente, si gjeneratorë ose kontrata më të shtrenjta furnizimi.

Prandaj, debati për energjinë në Shqipëri duhet të kalojë nga pyetja “sa prodhojmë” te pyetja “sa i qëndrueshëm, i diversifikuar dhe i

menaxhueshëm është sistemi". Vetëm kjo qasje e lidh sektorin energjetik me performancën e përgjithshme ekonomike.

Rezultatet empirike

Tabela 1 paraqet bazën e të dhënave të përdorur për analizën empirike. Rritja reale e PBB-së llogaritet nga mesatarja vjetore e PBB-së reale tremujore, ndërsa rritja e indeksit të energjisë llogaritet nga mesatarja vjetore e indeksit mujor të çmimeve të energjisë. Kjo mënyrë agregimi përdoret për të harmonizuar frekuencat e ndryshme të të dhënave.

Periudha 2017-2024 përfshin ngjarje të rëndësishme ekonomike: rritje të qëndrueshme para pandemisë, rënie të fortë në vitin 2020, rikuperim të shpejtë në vitin 2021 dhe presione inflacioniste në vitet 2022-2023. Kjo e bën kampionin të dobishëm për analizë orientuese, por edhe të ndjeshëm ndaj goditjeve të jashtëzakonshme.

Regresioni tregon se koeficientët nuk janë statistikisht të rëndësishëm në nivele konvencionale. Ky rezultat nuk duhet interpretuar si mungesë rëndësie e energjisë, por si tregues se një kampion prej tetë vitesh nuk është i mjaftueshëm për të izoluar efektet makroekonomike në mënyrë të plotë. Vlera e ulët e R2 tregon se rritja ekonomike shpjegohet edhe nga shumë faktorë të tjerë, si konsumi, investimet, turizmi, remitancat, ndërtimi dhe politika fiskale.

Nga pikëpamja shkencore, ky rezultat është i vlefshëm sepse e vendos analizën në terren të verifikueshëm dhe shmang përfundimet e tepruara. Pavarësia energjetike mbetet faktor strategjik, por për ta matur saktësisht efektin e saj mbi rritjen ekonomike kërkohet seri më e gjatë, ndarje midis importeve të energjisë elektrike dhe burimeve të tjera energjetike, si dhe modele më të avancuara ekonometrike.

Modeli me vonesë kohore tregon shenjë negative për rritjen e indeksit të energjisë me një vit vonesë, por edhe ky rezultat nuk është statistikisht i fortë. Megjithatë, shenja negative është ekonomikisht e arsyeshme, sepse presioni i kostove energjetike mund të shfaqet në ekonomi pas një periudhe përshtatjeje, përmes çmimeve, kontratave dhe vendimeve të investimit.

Në këtë kuptim, analiza empirike nuk përdoret për të prodhuar një përfundim kategorik, por për të mbështetur një argument më të gjerë:

energjia duhet të përfshihet në analizën e rritjes ekonomike si faktor i riskut, i kostos dhe i qëndrueshmërisë. Për një vend si Shqipëria, efekti i energjisë nuk matet vetëm me çmimin, por edhe me strukturën e prodhimit dhe aftësinë për të shmangur luhatjet ekstreme.

Tabela 1. Baza e të dhënave vjetore të përdorura në modelin empirik

Viti	Rritja reale e PBB (%)	Rritja e indeksit të energjisë (%)	Inflacioni (%)
2017	3.38	3.25	1.99
2018	3.65	1.83	2.03
2019	2.03	0.49	1.41
2020	-3.35	-2.90	1.62
2021	8.82	2.66	2.04
2022	4.86	14.14	6.73
2023	4.05	-5.23	4.76
2024	4.03	-1.26	2.22

Burimi: Llogaritje e autorit mbi të dhënat FRED/Eurostat për PBB reale dhe indeksin e energjisë, si dhe FRED/World Bank për inflacionin.

Tabela 2. Rezultatet e regresionit OLS

Variabla	M1 Koef.	M1 SE	M1 t	M2 Koef.	M2 SE	M2 t
Konstanta	2.593	2.663	0.974	1.536	3.058	0.502
Rritja e indeksit të energjisë	0.175	0.288	0.606	-	-	-
Rritja e indeksit të energjisë (t-1)	-	-	-	-0.168	0.313	-0.537
Inflacioni	0.196	0.892	0.219	0.756	0.966	0.782
R2	0.138			0.139		
R2 i korrigjuar	-0.206			-0.291		
Observime	8			7		

Shënim: M1 përdor ndryshimin aktual të indeksit të energjisë,M2 përdor ndryshimin e indeksit të energjisë me një vit vonesë. Rezultatet janë indikative për shkak të numrit të kufizuar të observimeve.

Figura 1. Rritja reale e PBB në Shqipëri, 2017-2024



Figura 2. Presioni i çmimeve të energjisë dhe inflacioni, 2017-2024



Figura 3. Marrëdhënia vizuale midis rritjes së indeksit të energjisë dhe rritjes reale të PBB



Figura 4. Importet neto të energjisë në Shqipëri, 2022-2023



Interpretimi ekonomik i gjetjeve

Gjetjet empirike duhen lexuar së bashku me analizën strukturore. Një koeficient jo i rëndësishëm statistikisht nuk e rrëzon argumentin e riskut energjetik,ai tregon vetëm se ndikimi nuk mund të kapet në mënyrë të plotë me një model të thjeshtë dhe me periudhë të shkurtër. Në praktikë, energjia

ndikon në ekonomi përmes mekanizmave të shumtë që nuk shfaqen menjëherë në PBB.

Kanali i parë është kostoja. Kur çmimet e energjisë rriten, bizneset përballen me kosto më të larta operative. Këto kosto mund të kalojnë te konsumatori, të ulin marzhet e fitimit ose të shtyjnë investimet. Kanali i dytë është inflacioni, sepse energjia hyn në transport, prodhim, ngrohje, ndërtim dhe shërbime.

Kanali i tretë është bilanci tregtar. Nëse vendi importon më shumë energji në periudha thatësire, rritet kërkesa për valutë dhe përkeqësohet pozicioni i jashtëm. Kanali i katërt lidhet me parashikueshmërinë institucionale: një sistem energjetik i paqëndrueshëm rrit riskun për investitorët dhe e bën më të vështirë planifikimin afatgjatë.

Një interpretim i rëndësishëm është se Shqipëria nuk duhet ta ngatërrojë peshën e lartë të energjisë së rinovueshme me sigurinë energjetike. Një burim i rinovueshëm mund të jetë i pastër, por jo domosdoshmërisht i qëndrueshëm në furnizim. Hidroenergjia është e vlefshme, por në mungesë të burimeve plotësuese ajo krijon varësi nga klima.

Në nivel makroekonomik, kjo nënkupton se politika energjetike duhet të lidhet me politikën fiskale, tregtare dhe industriale. Kur importet rriten në periudha të pafavorshme, efekti nuk qëndron vetëm në sektorin energjetik,ai prek financimin publik, çmimet, kursin e këmbimit dhe aftësinë e ekonomisë për të ruajtur stabilitet.

Skenarët e zhvillimit dhe implikimet për modelin ekonomik

Skenari i parë është vazhdimi i modelit aktual, ku hidroenergjia mbetet burimi dominues dhe diversifikimi ecën me ritëm të ngadaltë. Ky skenar ruan avantazhin e energjisë së rinovueshme, por nuk e zgjidh problemin e paqëndrueshmërisë hidrologjike. Ekonomia vazhdon të jetë e ekspozuar ndaj viteve të thata dhe ndaj çmimeve rajonale të energjisë.

Skenari i dytë është transformimi gradual i sistemit përmes burimeve plotësuese. Energjia diellore ka potencial të rëndësishëm, sidomos për shkak të kushteve klimatike dhe rritjes së teknologjive fotovoltaike. Energjia e erës mund të zhvillohet në zona të përshtatshme, ndërsa magazinimi me bateri ose forma të tjera mund të rrisë qëndrueshmërinë e furnizimit.

Skenari i tretë lidhet me integrimin rajonal dhe europian. Shqipëria nuk duhet ta kuptojë pavarësinë energjetike si shkëputje nga tregu, por si pjesëmarrje më të fortë në treg me kapacitete më të mira vendase. Një vend që prodhon, ruan dhe menaxhon më mirë energjinë mund të importojë kur është ekonomikisht e favorshme dhe të eksportojë kur ka suficit.

Për modelin ekonomik shqiptar, skenari i transformimit është më i përshtatshmi. Ai krijon bazë për industri me kosto më të parashikueshme, turizëm më të qëndrueshëm, bujqësi të modernizuar dhe shërbime me intensitet më të lartë teknologjik. Nëse energjia trajtohet si infrastrukturë zhvillimi, ajo mund të bëhet faktor konkurrueshmërie.

Në të kundërt, vazhdimi i varësisë nga një strukturë e kufizuar prodhimi e bën ekonominë të reagojë pas krizave, në vend që t'i parandalojë ato. Një ekonomi që reagon vetëm kur mungon energjia ka kosto më të larta se një ekonomi që planifikon paraprakisht burime, rezerva dhe kapacitete alternative.

Rekomandime

Rekomandimi i parë është diversifikimi i burimeve të prodhimit. Shqipëria duhet të rrisë peshën e energjisë diellore dhe të erës, jo si zëvendësim të hidroenergjisë, por si plotësim të saj. Ky kombinim mund të ulë riskun e varësisë nga reshjet dhe të krijojë strukturë më të balancuar prodhimi.

Rekomandimi i dytë është zhvillimi i kapaciteteve të magazinimit. Pa magazinim, burimet e rinovueshme me prodhim të ndryshueshëm nuk mund të japin siguri të plotë furnizimi. Investimet në bateri, menaxhim të kërkesës dhe zgjidhje të tjera teknike janë të rëndësishme për të rritur fleksibilitetin e sistemit.

Rekomandimi i tretë është modernizimi i rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes. Humbjet teknike dhe jo-teknike, kapacitetet e kufizuara të rrjetit dhe mungesa e digjitalizimit pengojnë shfrytëzimin e plotë të burimeve të reja. Një rrjet më inteligjent mund të integrojë më mirë prodhues të vegjël, parqe diellore dhe konsumatorë aktivë.

Rekomandimi i katërt është përmirësimi i kuadrit rregullator. Investitorët kërkojnë rregulla të qarta, kontrata të besueshme, procedura

transparente dhe parashikueshmëri në tarifim. Politika energjetike duhet të lidhet me politikën industriale, turizmin, bujqësinë, transportin dhe ndërtimin, sepse energjia është horizontale për gjithë ekonominë.

Rekomandimi i pestë është ndërtimi i një sistemi monitorimi të rrezikut energjetik. Institucionet duhet të publikojnë rregullisht indikatorë mbi prodhimin sipas burimeve, importet, humbjet në rrjet, konsumin sektorial dhe koston mesatare të furnizimit. Pa të dhëna të plota, politika publike mbetet reaktive dhe jo strategjike.

Rekomandimi i gjashtë lidhet me eficiencën energjetike. Forma më e lirë e pavarësisë energjetike është shpesh energjia që nuk shpenzohet. Standardet e ndërtesave, pajisjet eficiente, auditimet energjetike dhe edukimi i konsumatorëve mund të ulin kërkesën dhe të zvogëlojnë presionin mbi sistemin.

Kufizime të studimit dhe hapësira për kërkime të mëtejshme

Kufizimi kryesor i këtij punimi lidhet me gjatësinë e serive të disponueshme në formë të harmonizuar. Për indeksin e çmimeve të energjisë, periudha e plotë e përdorshme fillon në vitin 2016, ndërsa për regresionin përdoret periudha 2017-2024. Ky kampion është i kufizuar për analiza të forta ekonometrike.

Një kufizim tjetër lidhet me faktin se indeksi i çmimeve të energjisë mat presionin e çmimeve, por nuk mat drejtpërdrejt pavarësinë energjetike. Për një analizë më të thelluar do të duhej seri e plotë vjetore për importet e energjisë elektrike, importet e produkteve energjetike, prodhimin sipas burimit, kapacitetet e instaluara dhe humbjet në rrjet.

Kërkimet e ardhshme mund të përdorin modele me vonesa kohore, vektorë autoregresivë, analiza të bashkëintegrimit ose skenarë simulimi. Një drejtim i vlefshëm do të ishte ndarja e efektit të hidroenergjetikës nga efektet e çmimeve ndërkombëtare, duke përdorur të dhëna mujore për prodhimin, importet dhe konsumin.

Një tjetër drejtim kërkimor është analiza krahasuese me vendet e Ballkanit Perëndimor. Një model panel me disa vende do të lejonte rritjen e numrit të observimeve dhe krahasimin e strukturave të ndryshme energjetike.

Kjo do të ndihmonte për të kuptuar nëse Shqipëria përballet me një problem specifik ose me një tipar të përbashkët rajonal.

Përfundime

Punimi tregon se pavarësia energjetike është një komponent i rëndësishëm i modelit ekonomik të Shqipërisë. Struktura aktuale, e mbështetur kryesisht në hidroenergji, ofron avantazh në përdorimin e burimeve të rinovueshme, por krijon një rrezik të qartë për shkak të varësisë nga kushtet klimatike.

Analiza empirike me të dhëna reale tregon se marrëdhënia midis presionit të çmimeve të energjisë, inflacionit dhe rritjes reale të PBB-së nuk mund të shpjegohet plotësisht me një model të thjeshtë dhe kampion të shkurtër. Megjithatë, kjo nuk e dobëson argumentin strukturor; përkundrazi, tregon se politika energjetike duhet të analizohet në lidhje me të gjithë arkitekturën ekonomike.

Për Shqipërinë, rruga më e qëndrueshme është kombinimi i hidroenergjisë me burime të tjera të rinovueshme, magazinim energjie, rrjet të modernizuar dhe integrim më të mirë rajonal. Vetëm në këtë mënyrë pavarësia energjetike mund të kthehet nga objektiv sektorial në faktor real të rritjes ekonomike dhe të stabilitetit afatgjatë.

Kontributi kryesor i këtij punimi është ndërthurja e analizës strukturore me një test empirik të thjeshtë, duke treguar se debati për energjinë nuk duhet kufizuar te prodhimi, por duhet lidhur me rritjen, inflacionin, investimet dhe stabilitetin, ky këndvështrim ofron bazë të qartë për diskutim dhe për kërkime të mëtejshme.

Referenca

1. Apergis, N., & Payne, J. E. (2010). Energy consumption and growth in OECD countries. Energy, 35(12), 5027-5036. https://doi.org/10.1016/j.energy.2009.09.002
2. CEIC Data. (2026). Albania Energy Imports: Net: % of Energy Use. Burimi bazë: World Bank, World Development Indicators.
3. Eurostat. (2026). Harmonized Index of Consumer Prices: Energy for Albania [NRGMI15ALM086NEST]. Federal Reserve Bank of St. Louis, FRED.

4. Eurostat. (2026). Real Gross Domestic Product for Albania [CLVMNACSAB1GQAL]. Federal Reserve Bank of St. Louis, FRED.
5. International Energy Agency. (2026). Albania - Countries & Regions: Energy Mix and Energy System Overview.
6. Ozturk, I. (2010). A literature survey on energy-growth nexus. Energy Policy, 38(1), 340-349. https://doi.org/10.1016/j.enpol.2009.09.024
7. Stern, D. I. (2011). The role of energy in economic growth. Annals of the New York Academy of Sciences, 1219(1), 26-51. https://doi.org/10.1111/j.1749-6632.2010.05921.x
8. U.S. Department of Commerce, International Trade Administration. (2021). Albania - Energy Sector.
9. World Bank. (2026). GDP growth (annual %) - Albania. World Development Indicators.
10. World Bank. (2026). Inflation, consumer prices for Albania [FPCPITOTLZGALB]. Federal Reserve Bank of St. Louis, FRED.

PËRSHTATSHMËRIA TEMATIKE E KRIJIMEVE LETRARE NË LIBRAT E LEXIMIT TË KLASAVE I-III NË KOSOVË

Msc. Ferdane Shala

Studente e Doktoraturës, ferdaneshala76@gmail.com, Universiteti "Shën Klimenti i Ohrit "Manastir, Republika e Maqedonisë së Veriut

Abstrakti

Krijimet letrare në arsimin fillor luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin gjuhësor, emocional dhe social të nxënësve. Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizojë përshtatshmërinë tematike të krijimeve letrare në librat e leximit të klasave I-III në Kosovë, në raport me interesat dhe nevojat zhvillimore të nxënësve. Studimi është realizuar përmes qasjes cilësore me elemente përshkruese. Në kuadër të hulumtimit janë analizuar tekstet letrare të librave të leximit të klasave I, II dhe III, ndërsa janë përdorur edhe aktivitete pedagogjike të realizuara me ndihmën e mësimdhënësve të ciklit fillor. Rezultatet treguan se temat më të përfaqësuara janë temat edukative, temat që lidhen me shkollën, natyrën, kafshët dhe fantastiken. Gjithashtu, u vu në pah se temat ndryshojnë gradualisht sipas nivelit zhvillimor të nxënësve. Gjetjet e studimit tregojnë se krijimet letrare janë kryesisht të përshtatura me moshën dhe interesat e nxënësve të ciklit fillor por ekziston nevoja për pasurim dhe diversifikim më të madh të përmbajtjeve tematike me elemente më bashkëkohore dhe më afër realitetit të sotëm të fëmijëve.

Fjalët kyçe: *krijimet letrare, librat e leximit, përshtatshmëria tematike, arsimi fillor, interesat e nxënësve.*

Hyrje

Krijimet letrare në arsimin fillor kanë rol të rëndësishëm në zhvillimin gjuhësor, emocional, social dhe intelektual të fëmijëve. Përmes literaturës, nxënësit zhvillojnë imagjinatën, mendimin kritik, aftësinë interpretuese dhe krijojnë lidhje ndërmjet përvojave personale dhe botës që i rrethon. Studime të ndryshme kanë theksuar se literatura në klasat fillore nuk duhet të reduktohet vetëm në zhvillimin teknik të leximit, por duhet të shërbejë edhe si mjet për reflektim, komunikim dhe ndërtim kuptimi tek nxënësit. Në këtë drejtim, Rosenblatt (1978) dhe Langer (1995) e theksojnë rolin aktiv të lexuesit në interpretimin e tekstit, ndërsa Short (2009) dhe Haxhihyseni (2013) vënë në pah se literatura ndihmon në zhvillimin reflektues, kritik dhe social të nxënësve. Carr et al. (2001) argumentojnë se literatura krijon mundësi për zhvillimin e imagjinatës dhe të menduarit kritik, përderisa Huck (1989) thekson se librat ndihmojnë fëmijët të kuptojnë botën dhe përvojat njerëzore nga perspektiva të ndryshme. Studimet mbi mësimdhënien e leximit kanë treguar rëndësinë e përdorimit të teksteve cilësore dhe të përshtatshme për nivelin zhvillimor të nxënësve. Snow, Burns dhe Griffin (1998) konsiderojnë se mësimdhënia e leximit duhet të përfshijë jo vetëm zhvillimin teknik të leximit, por edhe të kuptuarit dhe interpretimin e tekstit. National Reading Panel (2000) nënvizon rëndësinë e zhvillimit të fjalorit, rrjedhshmërisë në lexim dhe strategjive të të kuptuarit, ndërsa Foorman dhe Connor (2011) mbrojnë tezën se qasja e balancuar në lexim është më efektive për zhvillimin e aftësive të leximit tek nxënësit e klasave fillore.

Në studimet bashkëkohore mbi tekstet shkollore dhe librat e leximit theksohet rëndësia e përshtatshmërisë tematike dhe gjuhësore të teksteve. Bremholm (2020) paraqet qëndrimin se tekstet shkollore duhet të krijojnë mundësi për kuptim, reflektim dhe përfshirje aktive të nxënësve në procesin e leximit. Edhe CLPE (2024) shtjellon idenë se tekstet cilësore ndikojnë pozitivisht në motivimin për lexim dhe në zhvillimin e reflektimit dhe interpretimit tek nxënësit. Më tej, Mutema (2024) thekson se tekstet shkollore duhet të jenë të përshtatshme me nivelin gjuhësor dhe zhvillimor të nxënësve në mënyrë që leximi të jetë kuptimplotë dhe motivues. Duke u mbështetur në qasje teorike dhe studime bashkëkohore, ky hulumtim synon të analizojë përshtatshmërinë tematike të krijimeve letrare në librat e leximit

të klasave I-III në Kosovë, në raport me interesat, përvojat dhe nevojat zhvillimore të nxënësve të ciklit fillor. Studimi ndërtohet mbi teori klasike të leximit dhe letërsisë për fëmijë, të ndërthurura me perspektiva moderne mbi zhvillimin e leximit dhe përzgjedhjen tematike në arsimin fillor.

Korniza teorike

Roli i krijimeve letrare në klasat fillore

Krijimet letrare në klasat fillore luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e mendimit kritik, reflektimit dhe aftësisë interpretuese të nxënësve. Përmes leximit dhe diskutimit të literaturës, fëmijët mësojnë të kuptojnë përvoja, emocione dhe situata të ndryshme njerëzore. Sipas Rosenblatt (1978), leximi letrar përfaqëson një proces ndërveprues ndërmjet lexuesit dhe tekstit, ku kuptimi ndërtohet përmes përvojës personale të nxënësit. Literatura nuk shihet vetëm si tekst për t'u lexuar, por si hapësirë ku nxënësi krijon kuptime dhe interpretime personale. Kjo perspektivë mbështetet edhe nga Langer (1995), e cila thekson se literatura ndihmon nxënësit të zhvillojnë kuptime më të thella për botën dhe përvojat njerëzore. Ndërkaq, Short (2009) pohon se literatura në klasat fillore duhet të përdoret si mjet për ndërtimin e kuptimit dhe reflektimit, e jo vetëm për zhvillimin teknik të leximit.

Roli i krijimeve letrare në arsimin fillor lidhet edhe me zhvillimin e kreativitetit, interpretimit dhe të kuptuarit tek nxënësit. Haxhihyseni (2013) shtron idenë se përdorimi i literaturës në klasë krijon mundësi për diskutim, analizë dhe interpretim të ideve nga perspektiva të ndryshme. Në të njëjtën linjë, Carr et al. (2001) dhe Huck (1989) theksojnë se krijimet letrare i ndihmojnë nxënësit të analizojnë situata, të krahasojnë ide dhe të krijojnë lidhje ndërmjet jetës reale dhe përvojave të paraqitura në tekst, duke e bërë procesin e leximit më kuptimplotë dhe më reflektues për fëmijët.

Studimet bashkëkohore mbi leximin theksojnë se krijimet letrare duhet të ndihmojnë në zhvillimin e të kuptuarit, interpretimit dhe reflektimit tek nxënësit. Snow, Burns dhe Griffin (1998) mbështesin idenë se mësimdhënia e leximit duhet të përfshijë jo vetëm aftësitë teknike të leximit, por edhe zhvillimin e të kuptuarit të tekstit. Nga ky këndvështrim, Foorman dhe Connor (2011) theksojnë rëndësinë e qasjes së balancuar në zhvillimin e aftësive të leximit tek nxënësit e klasave fillore. Rëndësia e literaturës

cilësore në klasat fillore theksohet edhe nga Qendra për Edukim të Lexim-Shkrimit në Arsimin Fillor-CLPE[1] (2024), e cila sugjeron se përdorimi i librave cilësorë krijon mundësi për diskutim, analizë dhe përfshirje aktive të fëmijëve gjatë procesit të leximit. Sipas kësaj qendre, leximi me zë, diskutimet rreth librave dhe aktivitetet kreative rreth tekstit ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e të kuptuarit dhe të përvojës letrare tek nxënësit.

Krijimet letrare dhe zhvillimi emocional, social dhe gjuhësor i fëmijëve

Krijimet letrare ndikojnë në zhvillimin emocional, social dhe gjuhësor të nxënësve duke krijuar hapësirë për reflektim, komunikim dhe kuptim të përvojave njerëzore. Përmes personazheve dhe situatave të ndryshme, fëmijët zhvillojnë ndjeshmëri, imagjinatë dhe aftësi për të kuptuar marrëdhëniet shoqërore. Lazar (2015) nxjerr në pah se literatura ndihmon fëmijët të kuptojnë emocionet dhe marrëdhëniet sociale përmes përvojave të personazheve letrarë, ndërsa Short (2009) justifikon se tekstet letrare kontribuojnë në zhvillimin e mendimit reflektues dhe të kuptimit personal e social tek nxënësit. Në të njëjtën linjë, Haxhihyseni (2013) përforcon idenë se literatura ndihmon nxënësit të zhvillojnë ndjeshmëri dhe të kuptojnë mënyra të ndryshme jetese, kultura dhe përvoja njerëzore.

Krijimet letrare luajnë rol të rëndësishëm edhe në zhvillimin gjuhësor të nxënësve. Catts et al. (1999) dhe Storch dhe Whitehurst (2002) paraqesin argumente se zhvillimi i gjuhës orale lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin e leximit dhe të kuptuarit tek fëmijët e klasave fillore. Në këtë aspekt, Mehta dhe të tjerë (2005) sqarojnë se aftësitë gjuhësore dhe të leximit zhvillohen në mënyrë të ndërlidhur gjatë viteve të para të shkollimit, ndërsa Craig (2006) mbështet idenë se aktivitetet ku nxënësit lexojnë dhe shkruajnë në mënyrë kuptimplote ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e leximit, shkrimit dhe komunikimit. Rëndësia e literaturës cilësore theksohet edhe nga CLPE (2024), e cila vë në pah se literatura ndihmon fëmijët të zhvillojnë ndjeshmëri dhe të kuptojnë perspektiva, kultura dhe mënyra të ndryshme jetese.

[1] CLPE - Centre for Literacy in Primary Education

Përshtatshmëria tematike dhe interesat e nxënësve

Përshtatshmëria tematike e krijimeve letrare shihet edhe në mënyrën se si nxënësit lidhen me temat dhe përvojat e paraqitura në tekst. Tekstet që trajtojnë tema të afërta me botën dhe realitetin e fëmijëve ndikojnë pozitivisht në motivimin për lexim dhe në përfshirjen aktive të tyre gjatë procesit të mësimnxënies. Short (2009) mbron qëndrimin se fëmijët ndërtojnë kuptim më të thellë kur literatura lidhet me përvojat dhe realitetin e tyre të përditshëm, ndërsa Haxhihyseni (2013) nxjerr në pah se nxënësit reagojnë më pozitivisht ndaj teksteve që lidhen me jetën dhe interesat e tyre personale. Në të njëjtën linjë, Carr et al. (2001) konsiderojnë se literatura cilësore krijon mundësi që nxënësit të identifikohen me temat, personazhet dhe situatat e paraqitura në tekst, ndërsa Huck (1989) mbrojnë qëndrimin se literatura ndihmon fëmijët të krijojnë lidhje ndërmjet përvojave personale dhe botës së paraqitur në libra. Rëndësia e lidhjes së tekstit me përvojën dhe interesat e nxënësve theksohet edhe nga CLPE (2024), e cila konsideron se nxënësit duhet të kenë mundësi të lexojnë tekste me të cilat mund të identifikohen dhe që lidhen me botën dhe përvojat e tyre personale. Sipas kësaj qendre, literatura duhet t'u japë fëmijëve mundësi të njohin kultura, perspektiva dhe mënyra të ndryshme jetese, duke respektuar interesat dhe zgjedhjet e tyre gjatë procesit të leximit.

Përshtatshmëria tematike lidhet gjithashtu me nivelin gjuhësor dhe njohës të nxënësve. Mutema (2024) përvijon idenë se tekstet shkollore duhet të jenë në përputhje me kapacitetin kognitiv dhe gjuhësor të nxënësve në mënyrë që leximi të jetë i kuptueshëm dhe motivues. Në mënyrë të përafërt, Fang (2008) vlerëson se tekstet me strukturë të ndërlikuar gjuhësore dhe konceptuale krijojnë vështirësi në të kuptuar tek nxënësit e ciklit fillor, ndërsa Fisher dhe Frey (2014) theksojnë se tekstet duhet të përshtaten me nivelin zhvillimor dhe njohës të nxënësve në mënyrë që leximi të mbetet kuptimplotë dhe motivues. Rëndësia e dimensionit kuptimor dhe social të leximit theksohet edhe nga Gee (2001), i cili vë në pah se leximi nuk duhet të reduktohet vetëm në proces teknik, por duhet të lidhet me kuptimin, komunikimin dhe përvojat sociale të nxënësve. Në vazhdim të kësaj qasjeje, Duke dhe Block (2012) argumentojnë se fokusimi vetëm në aspektet teknike të leximit rrezikon ta reduktojë leximin në proces të kufizuar teknik dhe jo në përvojë reflektuese dhe kuptimore. Për më tepër, Freebody dhe Luke (2003)

theksojnë se tekstet shkollore duhet të zhvillojnë aftësinë e nxënësve për të kuptuar, interpretuar dhe përdorur tekstin në situata të ndryshme kuptimore dhe sociale.

Librat e leximit dhe përzgjedhja e teksteve letrare

Përzgjedhja e teksteve letrare në librat e leximit kërkon kujdes të veçantë në aspektin pedagogjik dhe zhvillimor. Tekstet duhet të jenë të kuptueshme për moshën e nxënësve, të trajtojnë tema relevante dhe të krijojnë mundësi për reflektim, interpretim dhe përfshirje aktive gjatë procesit të leximit. Haxhihyseni (2013) sjell argumente në favor të idesë se literatura e përdorur në klasë duhet të jetë tërheqëse, e përshtatshme për moshën dhe e lidhur me përvojën e fëmijëve. Duke ndjekur të njëjtën perspektivë, Carr dhe të tjerë (2001) theksojnë se zgjedhja e librave duhet të marrë parasysh interesat, nevojat dhe përvojat e nxënësve në mënyrë që leximi të bëhet përvojë kuptimplote dhe motivuese, ndërsa Huck (1989) në harmoni me këtë ide, mbron parimin se tekstet letrare duhet të krijojnë mundësi që nxënësit të kuptojnë jetën dhe botën përmes përvojave të personazheve dhe ngjarjeve letrare.

Rëndësia e përdorimit të literaturës cilësore në klasat fillore theksohet edhe nga Short (2009), i cili, në vazhdën e kësaj qasjeje, e interpreton rolin e literaturës si mjet për ndërtimin e kuptimit dhe zhvillimin e mendimit kritik tek nxënësit. Në të njëjtin kontekst, CLPE (2024) mbështet idenë se librat cilësorë duhet të përfaqësojnë larmi autorësh, ilustruesish, zhanresh dhe formash letrare. Sipas kësaj qendre, tekstet duhet të jenë tërheqëse, të kuptueshme dhe të përshtatshme për moshën dhe interesat e nxënësve. Në mënyrë të ngjashme, rekomandohet përdorimi i teksteve multimodale dhe librave me ilustrime cilësore që ndihmojnë në zhvillimin e interpretimit dhe të kuptuarit të tekstit. Studimet bashkëkohore mbi tekstet shkollore theksojnë se librat e leximit vazhdojnë të kenë rol dominant në mësimdhënien e leximit në klasat fillore. Bremholm (2020) vë në diskutim faktin se tekstet shkollore duhet të mbështeten në qasje të balancuar të leximit, ku kombinohen aspektet teknike të leximit me elementet kuptimore dhe interpretuese të tekstit. Nga kjo pikëpamje, Reichenberg (2016) thekson se tekstet shkollore vazhdojnë të luajnë rol të rëndësishëm në mësimdhënien e leximit, ndërsa Mullis et al.

(2012), bazuar në studimin PIRLS[2], argumentojnë se librat e leximit mbeten komponent esencial në mësimdhënien e leximit në shumicën e sistemeve arsimore.

Përzgjedhja e teksteve letrare lidhet gjithashtu me nivelin gjuhësor dhe zhvillimor të nxënësve. Mutema (2024) vë në pah se tekstet shkollore përbëjnë mjetin kryesor përmes të cilit realizohet përmbajtja kurrikulare në arsimin fillor dhe se ato duhet të jenë në përputhje me aftësitë gjuhësore dhe njohëse të nxënësve. Sipas autorit, librat e leximit ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e të kuptuarit në lexim, në pasurimin e fjalorit dhe në përvetësimin e njohurive të reja. Kjo perspektivë mbështetet edhe nga Shanahan dhe të tjerë (2011), të cilët argumentojnë se tekstet shkollore duhet të organizohen në mënyrë progresive sipas nivelit të vështirësisë dhe zhvillimit të nxënësve. Kjo bën të kuptohet se rritja graduale e kompleksitetit të tekstit ndihmon në zhvillimin e të kuptuarit dhe kompetencave të leximit tek fëmijët.

Metodologjia

Qasja e hulumtimit

Ky studim është realizuar gjatë vitit 2026 dhe është mbështetur në qasje cilësore me elemente përshkruese, me qëllim analizimin e përshtatshmërisë tematike të krijimeve letrare në librat e leximit të klasave I-III në Kosovë. Objekt i studimit ishin krijimet letrare të përfshira në librat e leximit dhe lidhja e tyre me interesat, përvojat dhe nevojat zhvillimore të nxënësve të ciklit fillor.

Materiali i analizuar

Në kuadër të hulumtimit janë analizuar librat e leximit të klasave I, II dhe III të përdorur gjatë vitit shkollor 2024/2025, të cilët i përkasin botimit 2020/2021. Libri i klasës së parë është hartuar nga Bardh Rugova dhe Atdhe Hykolli; libri i klasës së dytë nga Rrahman Paçarizi, Saranda Kumnova Pozhegu dhe Aurela Zisi; ndërsa libri i klasës së tretë nga Saranda Kumnova Pozhegu, Dhurata Tara-Nixha, Fatmir Fejziu dhe Agron Gashi. Gjatë analizës janë identifikuar dhe analizuar krijimet letrare të përfshira në këta libra, duke u klasifikuar sipas përmbajtjes tematike. Kategoritë tematike janë përcaktuar mbi bazën e përmbajtjes dominuese të teksteve dhe janë grupuar në tema si:

[2] PIRLS - Progress in International Reading Literacy Study

edukimi, shkolla, loja, natyra, kafshët, familja, fantastikja, teknologjia, sporti, arti, temat kombëtare dhe temat sociale. Klasifikimi është realizuar duke u mbështetur në kriteret e përshtatshmërisë me moshën, interesat, nivelin gjuhësor dhe nevojat zhvillimore të nxënësve të grupmoshës 6-8 vjeç.

Mostra e hulumtimit

Hulumtimi është realizuar në pesë shkolla fillore të komunës së Vushtrrisë në Republikën e Kosovës: SHF[3] "Mustafë Venhari", SHFMU "Rilindja", SHF "Ali Kelmendi", SHF "Naim Frashëri" dhe SHFMU "Andon Z. Çajupi". Mostra e hulumtimit përfshiu 10 mësimdhënës të këtyre shkollave, nga dy mësimdhënës nga secila shkollë. Përmes bashkëpunimit me mësimdhënësit janë identifikuar temat që zgjojnë më shumë interesim, pjesëmarrje dhe reagim tek nxënësit gjatë aktiviteteve të leximit dhe diskutimit të teksteve letrare.

Instrumentet dhe mbledhja e të dhënave

Në këtë hulumtim janë përdorur analiza tematike e teksteve letrare, vrojtimi pedagogjik dhe aktivitete të përshtatura për moshën e nxënësve në kuadër të procesit të leximit. Të dhënat janë mbledhur nëpërmjet pyetjeve të thjeshta, ilustrimeve, diskutimeve dhe aktiviteteve loje, të realizuara me ndihmën e mësimdhënësve gjatë muajve mars–prill 2026. Vlerësimet e paraqitura në studim janë mbështetur në reagimet, pjesëmarrjen dhe diskutimet e nxënësve, të evidentuara nga mësimdhënësit gjatë zhvillimit të aktiviteteve pedagogjik.

Analiza e të dhënave

Analiza e të dhënave është realizuar përmes analizës tematike dhe asaj përshkruese, duke krahasuar temat mbizotëruese, temat më pak të përfaqësuara dhe parapëqimet tematike të nxënësve ndërmjet klasave I, II dhe III. Kufizim i këtij studimi mbetet fakti se rezultatet mbështeten kryesisht në analizë tematike dhe vlerësime pedagogjike, e jo në testim eksperimental ose instrumente të standardizuara matëse me nxënësit.

[3] SHF i referohet shkollave që përfshijnë vetëm ciklin fillor, ndërsa SHFMU shkollave që përfshijnë ciklin fillor dhe ciklin e mesëm të ulët

Rezultatet e hulumtimit

Shpërndarja tematike e krijimeve letrare në librin e klasës së parë

Rezultatet e analizës së krijimeve letrare në librin e leximit të klasës së parë sugjerojnë se temat janë të orientuara kryesisht drejt botës së fëmijëve, përvojave të përditshme dhe zhvillimit edukativ e social të nxënësve. Nga analiza e teksteve letrare u identifikuan tema që lidhen me lojën, edukimin, natyrën, kafshët dhe marrëdhëniet shoqërore, të cilat rezultuan të përshtatshme me nivelin zhvillimor dhe interesat e nxënësve të kësaj grupmoshe.



Figura 1. *Shtrirja tematike në librin e leximit të klasës së parë*

Të dhënat tregojnë se në librin e leximit të klasës së parë dominojnë temat që lidhen me lojën, të cilat përfaqësojnë 24% të përmbajtjes tematike të analizuar. Temat që lidhen me edukimin dhe mësimin përbëjnë 20%, ndërsa temat për kafshët janë të përfaqësuara me 16%. Po ashtu, temat e natyrës dhe socializimit paraqiten me nga 12%, duke reflektuar lidhjen e teksteve me botën dhe përvojat e përditshme të fëmijëve. Temat që lidhen me profesionet përfaqësohen me 8%, ndërsa temat familjare dhe trillimet paraqiten me nga 4%. Nga analiza u vërejt se temat kombëtare nuk janë të përfaqësuara në këtë nivel.

Shpërndarja tematike e krijimeve letrare në librin e klasës së dytë

Rezultatet e analizës së krijimeve letrare në librin e leximit të klasës së dytë treguan se temat janë më të larmishme dhe trajtojnë përvoja emocionale, sociale dhe edukative të nxënësve. Në këtë nivel vërehet prani më e madhe e temave fantastike, temave që lidhen me dëshirat, librin dhe marrëdhëniet shoqërore. Krijimet letrare janë të përshtatura me moshën e nxënësve dhe synojnë zhvillimin e imagjinatës, komunikimit dhe reflektimit.



Figura 2. *Shtrirja tematike në librin e klasës së dytë*

Në këtë nivel vërehet se në librin e leximit të klasës së dytë dominojnë temat fantastike, të cilat përfaqësojnë 26% të përmbajtjes tematike të analizuar. Temat që lidhen me dëshirat përbëjnë 15%, ndërsa temat e librit dhe diturisë dhe temat që trajtojnë dashurinë ndaj kafshëve janë të përfaqësuara me nga 11%. Gjithashtu, temat që lidhen me shkollën, pushimet dhe dashurinë paraqiten me nga 7%. Në përqindje më të ulët janë të përfaqësuara temat kombëtare, temat e besnikërisë, mirësjelljes dhe lumturisë, secila me nga 4%. Në këtë nivel temat bëhen më imagjinative, emocionale dhe reflektuese, duke pasqyruar zhvillimin kreativ dhe interesat e nxënësve të klasës së dytë.

Shpërndarja tematike e krijimeve letrare në librin e klasës së tretë

Analiza e krijimeve letrare në librin e leximit të klasës së tretë tregoi se temat janë më të zgjeruara dhe më të larmishme në krahasim me klasat

paraprake (I dhe II). Tekstet trajtojnë tema që lidhen me shkollën, natyrën, teknologjinë, familjen, shëndetin, sportin dhe temat kombëtare. Në këtë nivel vërehet zgjerim i përmbajtjes tematike drejt çështjeve sociale, edukative dhe njohëse, duke reflektuar zhvillimin dhe interesat më të avancuara të nxënësve.



Figura 3. *Shtrirja tematike në librin e leximit të klasës së tretë*

Gjetjet e hulumtimit treguan se në librin e leximit të klasës së tretë mbizotërojnë temat që lidhen me natyrën, të cilat përfaqësojnë 15% të përmbajtjes tematike të analizuar. Temat që lidhen me kafshët paraqiten me 12%, ndërsa temat që trajtojnë shkollën përfaqësohen me 11%. Gjithashtu, në këtë nivel vërehet zgjerim i tematikave drejt sportit, familjes, stinëve, dëshirave dhe temave kombëtare, secila me nga 5%. Në përqindje më të ulët janë të përfaqësuara temat që lidhen me librin, aventurat, teknologjinë, shkencën dhe miqësinë, secila me nga 4%, ndërsa temat e shëndetit, artit, përrallave, gjuhës amtare dhe lumturisë paraqiten me nga 3%. Temat e filmave vizatimorë dhe tema e punës janë më pak të përfaqësuara, me nga 1%. Në krahasim me klasat paraprake, përmbajtja tematike në klasën e tretë paraqitet më e larmishme dhe më e zgjeruar, duke reflektuar zhvillimin njohës, interesat dhe nevojat më të avancuara të nxënësve.

Temat dominuese në librat e leximit

Analiza krahasuese e krijimeve letrare në librat e leximit të klasave I-III tregoi se disa tema janë më të përfaqësuara dhe paraqiten vazhdimisht në të gjitha nivelet. Ndër temat mbizotëruese janë temat që lidhen me shkollën dhe edukimin, natyrën, kafshët, fantastiken dhe marrëdhëniet shoqërore. Këto tema lidhen drejtpërdrejt me botën, përvojat dhe interesat e nxënësve të ciklit fillor.



Figura 4. *Krahasimi i shtrirjes tematike në librat e leximit të klasave I-III*

Të dhënat treguan se temat ndryshojnë gradualisht sipas nivelit zhvillimor të nxënësve. Në klasën e parë shfaqen në masë më të madhe temat që lidhen me lojën dhe edukimin, të cilat përfaqësojnë 24% dhe 20% të përmbajtjes tematike. Gjithashtu, tema të rëndësishme në këtë nivel janë temat që lidhen me kafshët dhe socializimin, të cilat janë të afërta me përvojat e hershme të fëmijëve. Në klasën e dytë janë më të pranishme temat fantastike dhe temat që lidhen me dëshirat, të cilat përfaqësojnë përkatësisht 26% dhe 15% të përmbajtjes tematike. Në këtë nivel vërehet rritje e temave imagjinative dhe emocionale, ndërsa temat që lidhen me librin dhe diturinë përfaqësohen me 11%.

Në klasën e tretë temat bëhen më të larmishme dhe më të zgjeruara. Hasen më shpesh temat e natyrës me 15%, temat e kafshëve me 12% dhe temat që lidhen me shkollën me 11%. Përveç këtyre, në këtë nivel paraqiten më dukshëm temat që lidhen me teknologjinë, sportin, artin dhe temat

kombëtare, duke reflektuar zgjerimin e interesave dhe zhvillimin njohës të nxënësve. Analiza krahasuese tregoi se temat edukative, temat që lidhen me shkollën dhe temat e kafshëve janë të pranishme në të gjitha nivelet, ndërsa temat teknologjike, sportive dhe temat që lidhen me artin paraqiten kryesisht në klasën e tretë. Krahas kësaj, temat fantastike janë më të theksuara në klasën e dytë, duke reflektuar interesat imagjinative dhe kreative të nxënësve të kësaj moshe.

Temat më pak të përfaqësuara në tekstet letrare

Analiza e krijimeve letrare në librat e leximit të klasave I–III tregoi se disa përmbajtje tematike janë më pak të përfaqësuara. Ndër to bëjnë pjesë temat që lidhen me teknologjinë, sportin, artin, shëndetin, shkencën dhe aspektet kombëtare. Këto përmbajtje hasen më rrallë dhe kryesisht në librin e klasës së tretë. Rezultatet treguan se elementet teknologjike, sportive dhe artistike mungojnë pothuajse tërësisht në klasat e para dhe shfaqen në masë më të kufizuar në klasën e tretë. Po ashtu, temat shkencore dhe ato që lidhen me profesionet janë më të pakta krahasuar me përmbajtjet tradicionale, edukative dhe fantastike. Edhe temat kombëtare kanë prani të ulët në të tri klasat, ndërsa në klasën e parë mungojnë plotësisht. Analiza nxori në pah gjithashtu se temat që pasqyrojnë realitetin bashkëkohor të fëmijëve, teknologjinë moderne dhe diversitetin kulturor nuk janë të përfaqësuara në mënyrë të mjaftueshme në tekstet letrare të analizuara. Kjo tregon se përmbajtja e librave vazhdon të dominohet nga tema tradicionale dhe edukative.



Figura 5. *Temat që zgjuan më shumë interesim tek nxënësit sipas vlerësimeve të mësimdhënësve*

Rezultatet e paraqitura në figurë tregojnë se, sipas vlerësimeve të mësimdhënësve, nxënësit shfaqin interesim më të madh për temat fantastike, temat që lidhen me kafshët dhe natyrën, si dhe për tekstet me karakter aventuror dhe imagjinativ. Gjatë aktiviteteve me figura, ilustrime dhe pyetje të thjeshta, mësimdhënësit vëzhguan se nxënësit reagojnë më aktivisht ndaj temave që lidhen me lojën, fantazinë dhe botën e përditshme të fëmijëve. Ndërkohë, një pjesë e konsiderueshme e mësimdhënësve raportuan se temat që lidhen me familjen, miqësinë dhe aventurat zgjojnë komunikim dhe pjesëmarrje më të madhe gjatë diskutimeve në klasë.

Diskutimi

Rezultatet e hulumtimit treguan se krijimet letrare në librat e leximit të klasave I-III janë kryesisht të përshtatura me moshën dhe interesat e nxënësve të ciklit fillor. Analiza tregoi se në klasën e parë dominojnë temat që lidhen me lojën, edukimin dhe kafshët, të cilat janë më të afërta me përvojat e hershme të fëmijëve. Në klasën e dytë vërehet prani më e madhe e temave fantastike dhe imagjinative, ndërsa në klasën e tretë temat bëhen më të larmishme dhe përfshijnë natyrën, shkollën, teknologjinë, sportin dhe temat kombëtare. Këto rezultate përputhen me qëndrimet e autorëve që theksojnë rëndësinë e përzgjedhjes së teksteve letrare në përputhje me interesat dhe përvojat e fëmijëve. Short (2009) dhe CLPE (2024) vënë në pah se tekstet letrare ndikojnë më pozitivisht tek nxënësit kur lidhen me botën dhe përvojat e tyre, ndërsa Carr et al. (2001) dhe Huck (1989) theksojnë se literatura ndihmon fëmijët të krijojnë lidhje ndërmjet jetës reale dhe përmbajtjes së tekstit.

Nga analiza e preferencave tematike u vërejt se nxënësit tregojnë interesim më të madh për temat fantastike, temat që lidhen me kafshët, natyrën dhe aventurat. Sipas vlerësimeve të mësimdhënësve, këto tema nxisin më shumë komunikim, pjesëmarrje dhe reagim gjatë aktiviteteve të leximit. Kjo lidhet edhe me qëndrimet e Rosenblatt (1978), Langer (1995) dhe Haxhihysenit (2013), të cilët e shohin literaturën si mjet të rëndësishëm për zhvillimin emocional, reflektues dhe imagjinativ të fëmijëve. Megjithatë, analiza tregoi se temat që lidhen me teknologjinë, sportin, artin dhe temat

shkencore janë më pak të përfaqësuara në krahasim me temat tradicionale edukative dhe fantastike. Gjithashtu, temat që lidhen me realitetin bashkëkohor dhe diversitetin kulturor paraqiten në masë më të vogël në tekstet e analizuara. Kjo tregon se ekziston nevoja për zgjerim dhe diversifikim më të madh të përmbajtjeve tematike në librat e leximit për nxënësit e ciklit fillor.

Përfundime

8. Greabell, L. C., & Forseth, S. D. (1981). Creating a Stimulating Environment. Kappa Delta Pi Record, 70-75.
9. Hannah, R. (2013). The Effect of Classroom Environment on Student Learning. Western Michigan University. Retrieved from https://scholarworks.wmich.edu/honors_theses/2375/?utm_source=scholarworks.wmich.edu%2Fhonors_theses%2F2375&utm_medium=PDF&utm_campaign=PDFCoverPages
10. Hoxha, R. (2023). Të nxënit përmes përvojës. Prishtina: KCSF.
11. KEC. (n.d.). Doracak: Për ekipet ndërmjetësuese mes bashkëmoshatarëve. Prishtina: UNICEF.
12. Lurea, C. (2015). Classroom Environment between Stimulation and Discouragement. Teacher's Contribution to Creating a New Socio-affective Environment Favoring the Teacher-Student Communication . International Conference EDUCATION AND PSYCHOLOGY CHALLENGES - TEACHERS FOR THE KNOWLEDGE SOCIETY - 3RD EDITION, EPC-TKS , 368-373.
13. Nissim et al. (2016). The Effect of a Stimulating Learning Environment on Pre-Service Teachers' Motivation and 21st Century Skills. Journal of Education and Learning, 29-39.
14. Shan et al. (2014). Impact of Effective Communication, Achievement Sharing and Positive Classroom Environments on Learning Performance. Systems Research and Behavioral Science, 471–482.

JURIDIKSIONI I GJYKATAVE SHQIPTARE NË ÇËSHTJET ME OBJEKT ZGJIDHJE MARTESE ME ELEMENT TË HUAJ

Msc. Av. Enea Bushi

eneabushi@yahoo.com

Abstrakt

Çështjet familjare me element të huaj janë bërë një nga problematikat më të rëndësishme të praktikës gjyqësore shqiptare, veçanërisht në rastet kur shtetas shqiptarë që jetojnë jashtë Republikës së Shqipërisë kërkojnë zgjidhjen e martesës pranë gjykatave shqiptare. Kjo problematikë bëhet edhe më e ndërlikuar kur nga martesa kanë lindur fëmijë të mitur, të cilët jetojnë jashtë territorit shqiptar dhe kanë vendqëndrimin e zakonshëm në një shtet tjetër.

Në këto raste, gjykata shqiptare përballet me një çështje themelore proceduriale dhe materiale: nëse ka juridiksion për të shqyrtuar çështjen me objekt zgjidhje martese dhe për të rregulluar pasojat e saj në raport me fëmijët e mitur, apo nëse çështja duhet të nxirret jashtë juridiksionit shqiptar për shkak të vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijëve jashtë Republikës së Shqipërisë.

Konventa e Hagës "Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve", e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 9443, datë 16.11.2005, ka vendosur si rregull të përgjithshëm se juridiksioni për masat që lidhen me mbrojtjen e fëmijës i përket autoriteteve të shtetit ku fëmija ka vendqëndrimin e zakonshëm. Ky rregull është i lidhur drejtpërdrejt me parimin e interesit më të lartë të fëmijës, pasi gjykata e vendit ku fëmija jeton realisht është, si rregull, më pranë realitetit të tij familjar, shoqëror dhe ekonomik.

Megjithatë, ky rregull nuk është absolut dhe nuk mund të zbatohet në mënyrë mekanike. Vetë Konventa e Hagës parashikon mekanizma që lejojnë fleksibilitet në përcaktimin e juridiksionit, veçanërisht në nenin 10 të saj, ku njihet mundësia që autoritetet e shtetit ku shqyrtohet kërkesa për divorc të marrin masa edhe për mbrojtjen e fëmijës, kur plotësohen kushtet e

parashikuara nga Konventa dhe kur kjo është në interesin më të lartë të fëmijës.

Vendimi njësues i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, datë 22.12.2025, si dhe vendimet vijuese të datës 20.01.2026, kanë dhënë një interpretim të rëndësishëm mbi këtë çështje. Gjykata e Lartë ka pranuar se vendqëndrimi i zakonshëm i fëmijës jashtë Shqipërisë është një kriter shumë i rëndësishëm, por nuk mund të konsiderohet apriori dhe automatikisht si shkak për përjashtimin e juridiksionit shqiptar. Gjykata shqiptare duhet të analizojë rast pas rasti rrethanat konkrete, dakordësinë e prindërve, lidhjen e çështjes me Republikën e Shqipërisë, natyrën e kërkimit dhe mbi të gjitha interesin më të lartë të fëmijës.

Në këtë punim mbrohet qëndrimi se, në çështjet me objekt zgjidhje martese ku palët janë shtetas shqiptarë dhe ekziston një proces divorci pranë gjykatave shqiptare, këto gjykata nuk duhet ta nxjerrin automatikisht çështjen jashtë juridiksionit vetëm për shkak se fëmija ka vendqëndrimin e zakonshëm jashtë vendit. Përkundrazi, nëse prindërit janë dakord për juridiksionin shqiptar dhe gjykata bindet se interesi më i lartë i fëmijës mund të vlerësohet më mirë prej saj, atëherë gjykata shqiptare ka juridiksion për të shqyrtuar çështjen dhe për të vendosur edhe mbi pasojat e zgjidhjes së martesës.

Hyrje

Globalizimi dhe lëvizja e lirë e shtetasve shqiptarë drejt vendeve të tjera kanë sjellë një rritje të konsiderueshme të marrëdhënieve familjare me element të huaj. Një numër gjithnjë e më i madh shtetasish shqiptarë krijojnë jetën e tyre familjare jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ndërsa në rastet e prishjes së marrëdhënieve bashkëshortore lindin problematika të rëndësishme juridike që lidhen me juridiksionin e gjykatave shqiptare për të shqyrtuar çështjet e zgjidhjes së martesës dhe pasojat që burojnë prej saj. Këto pasoja kanë të bëjnë jo vetëm me vetë zgjidhjen e martesës, por edhe me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, lënien e fëmijëve për rritje dhe edukim, të drejtën e takimit dhe detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve të mitur.

Problematika është bërë edhe më komplekse në rastet kur fëmijët e mitur kanë vendqëndrimin e zakonshëm jashtë Shqipërisë. Në praktikën gjyqësore shqiptare, sidomos pas viteve 2019–2020, filloi të konsolidohej një qasje sipas së cilës shumë gjykata shqiptare deklaronin mungesën e juridiksionit dhe nxirrnin çështjet jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar, duke argumentuar se juridiksioni i përket gjykatës së vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës. Kjo qasje u mbështet kryesisht në interpretimin e Konventës së Hagës "Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve", si dhe në dispozitat e ligjit shqiptar "Për të Drejtën Ndërkombëtare Private".

Megjithatë, mungesa e një qëndrimi të unifikuar krijoi paqartësi të konsiderueshme në praktikë. Për raste të ngjashme, disa gjykata pranonin juridiksionin shqiptar dhe vazhdonin shqyrtimin e çështjes, ndërsa disa të tjera deklaronin mungesën e juridiksionit vetëm për shkak të vendqëndrimit të fëmijës jashtë territorit shqiptar. Kjo situatë krijoi pasiguri juridike për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë vendit, si dhe vështirësi serioze në ushtrimin efektiv të së drejtës për akses në drejtësi.

Për shkak të këtyre divergjencave në praktikën gjyqësore, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ndërhyri me një vendim njësues, me qëllim unifikimin e praktikës dhe përcaktimin e standardeve mbi juridiksionin e gjykatave shqiptare në çështjet me objekt zgjidhjen e martesës kur nga martesa kanë lindur fëmijë të mitur. Ky vendim njësues pranoi se, si rregull, juridiksioni për çështjet që lidhen me përgjegjësinë prindërore i përket gjykatës së vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës. Megjithatë, Gjykata e Lartë theksoi gjithashtu se ky rregull nuk është absolut dhe se, në rastet kur ekziston një proces divorci në Shqipëri, kur prindërit pranojnë juridiksionin shqiptar dhe kur gjykata bindet se interesi më i lartë i fëmijës mund të mbrohet më mirë para saj, gjykatat shqiptare kanë juridiksion për të shqyrtuar çështjen dhe për të vendosur edhe mbi pasojat e zgjidhjes së martesës.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë kuadrin ligjor shqiptar dhe ndërkombëtar mbi juridiksionin në çështjet e zgjidhjes së martesës me element të huaj, të evidentojë standardet e vendosura nga Konventa e Hagës dhe jurisprudenca e Gjykatës së Lartë, si dhe të analizojë mënyrën se si

vendimi njësues dhe praktika vijuese e Kolegjit Civil kanë ndryshuar qasjen e gjykatave shqiptare në këto çështje. Në thelb, punimi synon të argumentojë se juridiksioni nuk mund të përcaktohet në mënyrë automatike vetëm nga vendqëndrimi i zakonshëm i fëmijës, por duhet të vlerësohet rast pas rasti në funksion të interesit më të lartë të fëmijës dhe të garantimit të aksesit efektiv në drejtësi për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë vendit.

Kuadri ligjor shqiptar mbi zgjidhjen e martesës dhe pasojat e saj

Zgjidhja e martesës në të drejtën shqiptare nuk është një procedurë që lidhet vetëm me përfundimin formal të marrëdhënies martesore midis bashkëshortëve. Përkundrazi, kur nga martesa kanë lindur fëmijë të mitur, gjykata shqiptare ka detyrimin ligjor të rregullojë edhe pasojat që rrjedhin nga zgjidhja e martesës në raport me fëmijët. Kjo është një nga pikat më të rëndësishme për temën e juridiksionit, sepse tregon se në sistemin shqiptar gjykata nuk mund të vendosë vetëm për divorcin dhe të shmangë vendimmarrjen mbi përgjegjësinë prindërore, kujdestarinë, takimet apo detyrimin ushqimor.

Ky detyrim rrjedh nga vetë natyra e çështjes familjare. Zgjidhja e martesës ndryshon strukturën juridike dhe faktike të familjes. Ajo prek jo vetëm bashkëshortët, por edhe fëmijët e mitur, të cilët kanë nevojë për siguri juridike dhe për një rregullim të qartë të marrëdhënieve me secilin prind. Për këtë arsye, gjykata nuk mund të mjaftohet me konstatimin se martesa duhet të zgjidhet, pa përcaktuar njëkohësisht se si do të ushtrohet përgjegjësia prindërore pas zgjidhjes së martesës.

Ky parim është konfirmuar qartë edhe nga vendimi njësues i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë i datës 22.12.2025. Në këtë vendim, Kolegji Civil ka konkluduar se në gjykimet me objekt zgjidhjen e martesës, kur nga kjo martesë ka fëmijë të mitur, gjykata, kur pranon padinë, ka detyrimin të shprehet krahas zgjidhjes së martesës edhe për rregullimin e pasojave të kësaj zgjidhjeje në raport me fëmijët.

Ky qëndrim ka rëndësi themelore për analizën e juridiksionit. Nëse gjykata shqiptare pranon të shqyrtojë kërkesën për zgjidhjen e martesës, ajo nuk mund ta ndajë artificialisht divorcin nga pasojat e tij në raport me fëmijët. Pra, nuk mund të vendosë vetëm për zgjidhjen e martesës dhe të mos vendosë për fëmijët, sepse një vendimmarrje e tillë do të ishte në

kundërshtim me detyrimin që vendos Kodi i Familjes dhe me standardin e përcaktuar nga Gjykata e Lartë.

Kjo është arsyeja pse problemi i juridiksionit në çështjet e divorcit me fëmijë të mitur është kaq i rëndësishëm. Nëse gjykata shqiptare ka juridiksion për çështjen e zgjidhjes së martesës, atëherë ajo duhet të analizojë nëse ka juridiksion dhe mundësi reale për të rregulluar edhe pasojat e kësaj zgjidhjeje në raport me fëmijët. Kjo analizë nuk mund të bëhet në mënyrë automatike, por duhet të mbështetet në rrethanat konkrete të çështjes, në dakordësinë ose mosdakordësinë e prindërve, në vendqëndrimin e zakonshëm të fëmijës dhe në interesin më të lartë të tij.

Ky parim shërben si bazë për argumentin kryesor të këtij punimi: në rastet kur palët janë shtetas shqiptarë, kanë paraqitur çështjen pranë gjykatës shqiptare, kanë pranuar juridiksionin e saj dhe gjykata bindet se interesi më i lartë i fëmijës mund të vlerësohet para saj, atëherë gjykata shqiptare nuk duhet ta nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit vetëm për shkak se fëmija jeton jashtë vendit.

Praktika gjyqësore e gjykatave shqiptare gjatë viteve, në lidhje me juridiksionin për çështjet në fjale

Konventa e Hagës për juridiksionin dhe përgjegjësinë prindërore është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në vitin 2005. Megjithatë, për një periudhë të gjatë pas ratifikimit të saj, praktika gjyqësore shqiptare në çështjet e zgjidhjes së martesës me element të huaj nuk shfaqi një orientim të qëndrueshëm drejt nxjerrjes jashtë juridiksionit të çështjeve ku fëmijët jetonin jashtë Republikës së Shqipërisë.

Për shumë vite, gjykatat shqiptare shqyrtonin çështje divorci midis shtetasve shqiptarë që jetonin jashtë vendit, duke u mbështetur në shtetësinë shqiptare të palëve, në regjistrimin e martesës në Shqipëri dhe në lidhjen e marrëdhënies juridike me shtetin shqiptar. Kjo ishte veçanërisht e dukshme në rastet kur palët vetë i drejtoheshin gjykatave shqiptare dhe nuk kundërshtonin juridiksionin e tyre.

Praktika për nxjerrjen jashtë juridiksionit të këtyre çështjeve filloi të shfaqej më dukshëm rreth viteve 2019–2020. Kjo praktikë u lidh me një interpretim më aktiv të Konventës së Hagës dhe me rëndësinë që filloi t'i

jepej konceptit të vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës. Gjykatat filluan të vlerësonin se kur fëmijët e mitur jetonin jashtë Shqipërisë, çështja duhej të shqyrtohej nga gjykata e shtetit ku fëmijët kishin qendrën reale të jetës së tyre.

Megjithatë, problemi që u krijua në praktikë ishte se ky rregull filloi të zbatohej në mënyrë tepër formale dhe mekanike. Në disa raste, gjykatat shqiptare mjaftoheshin me konstatimin se fëmija jetonte jashtë Shqipërisë dhe, mbi këtë bazë, vendosnin nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit. Një analizë e tillë nuk merrte gjithmonë parasysh nëse prindërit ishin dakord për juridiksionin shqiptar, nëse çështja kishte nisur dhe ishte zhvilluar për një kohë të gjatë në Shqipëri, nëse kishte prova të administruara, nëse kishte lidhje reale me Republikën e Shqipërisë dhe nëse nxjerrja jashtë juridiksionit i shërbente realisht interesit të fëmijës.

Pikërisht për shkak të kësaj praktike të paunifikuar, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë pa të arsyeshme të bënte njësimin e praktikës. Vendimi njësues i datës 22.12.2025 synoi të vendosë një ekuilibër midis dy parimeve: nga njëra anë, rëndësisë së vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës; nga ana tjetër, nevojës që gjykata shqiptare të mos e përjashtojë automatikisht juridiksionin e saj pa vlerësuar rrethanat konkrete.

Ky vendim njësues nuk vendosi një rregull absolut në favor të juridiksionit të huaj. Përkundrazi, ai përcaktoi se gjykata shqiptare duhet të bëjë një analizë konkrete. Kur fëmija jeton jashtë Republikës së Shqipërisë, gjykata duhet të konstatojë dhe të përcaktojë vendqëndrimin e zakonshëm të fëmijës, duke iu referuar kohëzgjatjes së qëndrimit, arsyeve të zhvendosjes së familjes dhe kushteve social-ekonomike të fëmijës. Por nëse gjykata shqiptare bindet se interesi më i lartë i të miturit mund të vlerësohet para saj dhe të dy prindërit janë dakord me këtë juridiksion, atëherë gjykata shqiptare ka juridiksion për zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj.

Ky është thelbi i rëndësishëm i vendimit njësues. Ai nuk e trajton vendqëndrimin e zakonshëm si kriter automatik përjashtues, por si një element shumë të rëndësishëm që duhet të vlerësohet në raport me interesin më të lartë të fëmijës dhe me dakordësinë e prindërve.

Vendimet vijuese të Gjykatës së Lartë, veçanërisht vendimi nr. 00-2026-210, datë 20.01.2026, e kanë forcuar edhe më shumë këtë interpretim.

Në këtë vendim, Gjykata e Lartë kritikoi gjykatën e shkallës së parë që kishte nxjerrë jashtë juridiksionit një çështje divorci vetëm për shkak se fëmijët dhe prindërit jetonin në Greqi. Kolegji Civil theksoi se vendqëndrimi i zakonshëm i fëmijës nuk mund të vlerësohet apriori si rrethanë që përcakton interesin më të lartë të fëmijës për t'u zhvilluar gjykimi nga gjykata e vendit të huaj.

Ky qëndrim tregon qartë se praktika pas vendimit njësues po shkon drejt një interpretimi më të balancuar dhe më funksional. Gjykata shqiptare duhet të ketë kujdes të mos e kthejë vendqëndrimin e zakonshëm në një kriter mekanik, sepse kjo do të cenonte aksesin në drejtësi dhe mund të dëmtonte edhe vetë interesin e fëmijës, veçanërisht kur procesi në Shqipëri ka avancuar, kur palët janë dakord dhe kur nuk ka proces paralel në shtetin e huaj.

Rregulli i përgjithshëm i konventës së hagës dhe rastet kur gjykatat shqiptare kanë juridiksion për shqyrtimin e çështjes

Konventa e Hagës e vitit 1996 është instrumenti kryesor ndërkombëtar mbi të cilin është mbështetur edhe Gjykata e Lartë në vendimin njësues mbi juridiksionin në çështjet familjare me element të huaj. Qëllimi i saj kryesor është të përcaktojë se cili shtet ka juridiksion për të marrë masa për mbrojtjen e fëmijës dhe pasurisë së tij, cili ligj zbatohet, si njihen dhe zbatohen këto masa, si dhe si bashkëpunojnë autoritetet e shteteve kontraktuese.

Rregulli i përgjithshëm i Konventës është se autoritetet gjyqësore ose administrative të shtetit ku fëmija ka vendqëndrimin e zakonshëm kanë juridiksion për të marrë masa për mbrojtjen e tij. Ky rregull është i lidhur me idenë se gjykata e këtij shteti është zakonisht më pranë jetës reale të fëmijës dhe mund të vlerësojë më mirë kushtet e tij të jetesës, shkollimit, integrimit social dhe marrëdhënieve familjare.

Ky është rregulli i përgjithshëm dhe duhet pranuar si i tillë. Nëse fëmija jeton në një shtet tjetër, është integruar atje dhe midis prindërve ekziston konflikt mbi ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, atëherë, si rregull, juridiksioni duhet t'i takojë gjykatës së vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës. Kjo gjykatë ka mundësi më të drejtpërdrejtë të hetojë rrethanat konkrete të jetës së fëmijës.

Megjithatë, Konventa nuk e trajton këtë rregull si absolut. Nëse do ta trajtonte si absolut, nuk do të kishte parashikuar mekanizma për transferimin ose pranimin e juridiksionit nga një shtet tjetër. Përkundrazi, Konventa njeh mundësinë që në raste të veçanta autoritetet e një shteti tjetër të jenë më të përshtatshme për të vlerësuar interesin e fëmijës.

Rëndësi të veçantë në këtë drejtim ka neni 10 i Konventës. Sipas këtij neni, autoritetet e një shteti kontraktues që shqyrtojnë një kërkesë për divorc, ndarje ligjore ose anulim martese mund të marrin masa edhe për mbrojtjen e fëmijës ose pasurisë së tij, edhe pse fëmija ka vendqëndrimin e zakonshëm në një shtet tjetër. Megjithatë, kjo kompetencë ekziston vetëm kur plotësohen disa kushte kumulative: së pari, të paktën njëri nga prindërit duhet të ketë përgjegjësi prindërore ndaj fëmijës dhe vendqëndrim të përhershëm në atë shtet; së dyti, juridiksioni i gjykatës që shqyrton divorcin duhet të jetë pranuar shprehimisht ose në mënyrë të heshtur nga të dy prindërit dhe nga çdo person tjetër që ushtron përgjegjësi prindërore; dhe së treti, ushtrimi i këtij juridiksioni duhet të jetë në interesin më të lartë të fëmijës. Ky parashikim ka rëndësi thelbësore për çështjet e divorcit me element të huaj, sepse tregon se gjykata që shqyrton zgjidhjen e martesës nuk përjashtohet automatikisht nga mundësia për të vendosur edhe për pasojat që lidhen me fëmijët e mitur.

Ky interpretim është shumë i rëndësishëm. Ai tregon se Konventa nuk duhet lexuar vetëm nëpërmjet nenit 5, por në mënyrë sistematike, duke përfshirë edhe nenet 8, 10 dhe dispozitat e tjera që synojnë mbrojtjen efektive të fëmijës. Interesi më i lartë i fëmijës nuk barazohet gjithmonë me vendqëndrimin e tij të zakonshëm. Ky vendqëndrim është një tregues shumë i rëndësishëm, por jo i vetmi dhe jo gjithmonë përcaktues.

Gjykata e Lartë ka theksuar se interesi më i lartë i fëmijës duhet të vlerësohet rast pas rasti. Në disa raste, gjykata e vendqëndrimit të zakonshëm të fëmijës mund të jetë më e përshtatshme. Në raste të tjera, gjykata shqiptare, si gjykata ku po zhvillohet procesi i divorcit, si gjykata e shtetësisë së palëve dhe si gjykata ku janë administruar provat, mund të jetë në pozitë më të mirë për të vendosur shpejt dhe në mënyrë efektive.

1. Ndryshimi midis vendqëndrimit të zakonshëm dhe vendqëndrimit të përhershëm

Në praktikën gjyqësore dhe në përdorimin e përditshëm, shpesh ngatërrohen konceptet "vendqëndrim i zakonshëm" dhe "vendqëndrim i përhershëm". Megjithatë, këto dy nocione nuk janë të njëjta dhe dallimi midis tyre ka rëndësi të veçantë në çështjet familjare me element të huaj.

Vendqëndrimi i zakonshëm është një koncept faktik. Ai lidhet me vendin ku personi, dhe veçanërisht fëmija, ka qendrën reale të jetës së tij. Për përcaktimin e tij merren parasysh kohëzgjatja e qëndrimit, arsyeja e zhvendosjes, shkollimi, integrimi social, marrëdhëniet familjare, kushtet ekonomike dhe qëndrueshmëria e lidhjes me atë vend.

Ndërsa vendqëndrimi i përhershëm ka më shumë karakter formal ose administrativ. Ai mund të lidhet me regjistrimin, dokumentacionin, lejen e qëndrimit ose statusin juridik të personit në një shtet të caktuar. Një person mund të ketë dokumente qëndrimi në një shtet, por qendra reale e jetës së tij të jetë në një shtet tjetër.

Ligji nr. 10428/2011 "Për të Drejtën Ndërkombëtare Private", në nenin 12, e përkufizon vendqëndrimin e zakonshëm si vendin ku personi ka vendosur të qëndrojë në pjesën më të madhe të kohës, edhe në mungesë të regjistrimit dhe pavarësisht nga leja apo autorizimi për të qëndruar. Ky përkufizim tregon qartë se rëndësi nuk ka vetëm regjistrimi formal, por lidhja reale dhe e qëndrueshme me një vend të caktuar.

Në çështjet që lidhen me fëmijët, vendqëndrimi i zakonshëm duhet të vlerësohet me kujdes. Ai nuk mund të përcaktohet vetëm nga vendi ku fëmija ndodhet fizikisht në një moment të caktuar. Duhet të shihet nëse qëndrimi është i qëndrueshëm, nëse fëmija është integruar në shkollë, në familje dhe në shoqëri, si dhe nëse prindërit kanë pasur synim të krijojnë lidhje të qëndrueshme me atë vend.

Ky dallim është i rëndësishëm sepse gjykata nuk mund të mbështetet vetëm në të dhëna formale për të përcaktuar juridiksionin. Ajo duhet të analizojë realitetin faktik të jetës së fëmijës dhe të vlerësojë nëse ky realitet e bën më të përshtatshme gjykatën shqiptare apo gjykatën e shtetit të huaj.

2. Parimi i interesit më të lartë të fëmijës

Parimi i interesit më të lartë të fëmijës është parimi themelor që udhëheq çdo vendimmarrje në çështjet familjare. Ky parim nuk është thjesht

një formulë ligjore, por një standard konkret që kërkon nga gjykata të analizojë se cila zgjidhje i shërben më mirë mirëqenies, stabilitetit, sigurisë dhe zhvillimit të fëmijës.

Në çështjet e juridiksionit, interesi më i lartë i fëmijës ka rëndësi të dyfishtë. Nga njëra anë, ai justifikon rregullin e përgjithshëm që juridiksioni t'i takojë vendit ku fëmija ka vendqëndrimin e zakonshëm. Nga ana tjetër, ai kërkon që ky rregull të mos zbatohet në mënyrë të verbër, nëse në rrethanat konkrete një gjykatë tjetër mund të ofrojë mbrojtje më të shpejtë, më efektive dhe më të përshtatshme.

Vendimi nr. 00-2026-210 i Gjykatës së Lartë është shumë i rëndësishëm në këtë pikë. Kolegji Civil ka theksuar se gjykata e shkallës së parë gaboi kur prezumoi apriori se vendqëndrimi i zakonshëm i fëmijës në Greqi do të thoshte domosdoshmërisht se interesi më i lartë i tij do të vlerësohej më mirë nga gjykata greke. Sipas Gjykatës së Lartë, interesi më i lartë i fëmijës duhet të vlerësohet konkretisht, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes.

Ky parim ka rëndësi të veçantë në rastet kur palët kanë nisur procesin në Shqipëri, janë investuar në gjykim, janë administruar prova dhe nuk ka proces paralel në shtetin e huaj. Në këto raste, nxjerrja jashtë juridiksionit mund të mos i shërbejë fëmijës, por përkundrazi mund të sjellë vonesa, pasiguri, mungesë të detyrimit ushqimor, vështirësi në pajisjen me dokumente dhe zvarritje të panevojshme.

Prandaj, interesi më i lartë i fëmijës nuk duhet të shihet si argument për të nxjerrë automatikisht çështjen jashtë juridiksionit shqiptar, por si kriter që kërkon analizë konkrete, të kujdesshme dhe proporcionale.

Vendimi njësues i gjykatës së lartë

Vendimi njësues i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë i datës 22.12.2025 përbën pikën kryesore të kthesës në praktikën gjyqësore shqiptare mbi juridiksionin në çështjet e zgjidhjes së martesës me fëmijë të mitur dhe element të huaj.

Në këtë vendim, Gjykata e Lartë ka pranuar fillimisht se në gjykimet me objekt zgjidhjen e martesës, kur nga martesa kanë lindur fëmijë të mitur, gjykata ka detyrimin të shprehet edhe për pasojat e zgjidhjes së martesës në

raport me fëmijët. Ky është një parim themelor i së drejtës familjare shqiptare dhe ka rëndësi të drejtpërdrejtë për juridiksionin.

Vendimi njësues ka theksuar se kur i mituri jeton jashtë Republikës së Shqipërisë, gjykata duhet të konstatojë, bindet dhe përcaktojë vendqëndrimin e zakonshëm të fëmijës, duke iu referuar kohëzgjatjes së qëndrimit në atë vend, arsyeve të zhvendosjes së familjes dhe kushteve social-ekonomike të fëmijës. Kjo do të thotë se gjykata shqiptare nuk mund ta injorojë faktin që fëmija jeton jashtë vendit. Përkundrazi, ajo duhet ta analizojë këtë fakt me kujdes dhe në mënyrë të plotë.

Megjithatë, vendimi njësues nuk ndalet vetëm te vendqëndrimi i zakonshëm. Ai parashikon gjithashtu se nëse gjykata shqiptare bindet se interesi më i lartë i të miturit vlerësohet para saj dhe të dy prindërit janë dakord me këtë juridiksion, atëherë gjykata shqiptare ka juridiksion për zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj në raport me fëmijët.

Ky formulim është shumë i rëndësishëm, sepse vendos tri elemente kryesore për pranimin e juridiksionit shqiptar në raste të tilla: së pari, ekzistencën e një procesi me objekt zgjidhje martese para gjykatës shqiptare; së dyti, dakordësinë e të dy prindërve për juridiksionin shqiptar; dhe së treti, bindjen e gjykatës se interesi më i lartë i fëmijës mund të vlerësohet para saj.

Pra, vendimi njësues nuk thotë se çdo çështje ku fëmija jeton jashtë Shqipërisë duhet të nxirret jashtë juridiksionit. Përkundrazi, ai kërkon një analizë të individualizuar. Vetëm nëse, pas analizës së rrethanave, gjykata arrin në përfundimin se vendqëndrimi i zakonshëm i fëmijës jashtë Shqipërisë dhe interesi i tij kërkojnë shqyrtimin e çështjes nga gjykata e huaj, atëherë çështja mund të nxirret jashtë juridiksionit.

Ky interpretim u konfirmua dhe u zhvillua më tej nga vendimi nr. 00-2026-210, datë 20.01.2026. Në këtë çështje, Gjykata e Shkallës së Parë Gjirokastër kishte nxjerrë jashtë juridiksionit një çështje me objekt zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj, me arsyetimin se palët dhe fëmijët jetonin në Greqi. Gjykata e Lartë e prishi këtë vendim dhe e ktheu çështjen për vazhdimin e gjykimit.

Kolegji Civil arsyetoi se nxjerrja jashtë juridiksionit duhet të jetë e parashikuar qartë në ligj, sepse prek drejtpërdrejt aksesin në drejtësi. Gjykata

theksoi se çështjet mbi përgjegjësinë prindërore nuk përfshihen në juridiksion ekskluziv të një shteti të huaj dhe se Konventa e Hagës nuk parashikon një juridiksion ekskluziv që përjashton automatikisht gjykatat shqiptare.

Një nga pjesët më të rëndësishme të këtij vendimi është arsyetimi se gjykata e shkallës së parë kishte gabuar kur e kishte shtrirë kriterin e vendqëndrimit të fëmijës edhe mbi çështjen me objekt zgjidhjen e martesës, duke e trajtuar atë si kriter përjashtues të juridiksionit shqiptar. Kolegji Civil theksoi se marrëdhëniet prind-fëmijë përbëjnë pasojë të zgjidhjes së martesës dhe se Konventa e Hagës, në nenin 10, njeh juridiksionin e shtetit që shqyrton kërkesën për divorc edhe për masat që lidhen me fëmijët.

Gjykata e Lartë theksoi gjithashtu se neni 75 i ligjit nr. 10428/2011 parashikon juridiksionin e gjykatave shqiptare për çështjet që lidhen me martesën kur njëri nga bashkëshortët është ose ka qenë shtetas shqiptar. Ky juridiksion shtrihet edhe mbi pasojat e martesës, përfshirë masat që lidhen me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, detyrimin për ushqim dhe të drejtat e fëmijëve.

Në rastin konkret, të dy prindërit kishin pranuar juridiksionin shqiptar. Ata kishin bërë rekurs kundër vendimit që e nxirrte çështjen jashtë juridiksionit, duke kërkuar vazhdimin e gjykimit në Shqipëri. Kolegji Civil e konsideroi këtë dakordësi si një rrethanë shumë të rëndësishme që mbështet juridiksionin shqiptar.

Po ashtu, Gjykata e Lartë mori parasysh faktin se çështja kishte tre vite në gjykim në Shqipëri, ishin administruar prova dhe ishte zhvilluar edhe ekspertim psikologjik. Nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit në këtë fazë nuk i shërbente interesit të fëmijëve, por përkundrazi krijonte vonesa dhe pasiguri, duke i detyruar palët të nisnin një proces të ri në Greqi.

Ky vendim është shumë i rëndësishëm sepse tregon se pas vendimit njësues, Gjykata e Lartë po orienton praktikën drejt një analize konkrete dhe jo mekanike të juridiksionit.

Ndryshimet që sjell në praktikë vendimi njësues

Vendimi njësues i Gjykatës së Lartë, i interpretuar së bashku me vendimet vijuese të datës 20.01.2026, sjell disa ndryshime të rëndësishme në praktikën gjyqësore shqiptare.

Së pari, ai vendos qartë se në çështjet e zgjidhjes së martesës me fëmijë të mitur, gjykata shqiptare nuk mund të vendosë vetëm për divorcin dhe të mos shprehet për pasojat në raport me fëmijët. Kjo do të thotë se gjykata duhet të bëjë një analizë të plotë të çështjes, jo vetëm në raport me bashkëshortët, por edhe në raport me fëmijët e mitur.

Së dyti, vendimi njësues pranon se vendqëndrimi i zakonshëm i fëmijës jashtë Shqipërisë është një kriter shumë i rëndësishëm për përcaktimin e juridiksionit, por jo një kriter automatik përjashtues. Gjykata nuk mund të mjaftohet me konstatimin se fëmija jeton jashtë vendit. Ajo duhet të analizojë kohëzgjatjen e qëndrimit, arsyet e zhvendosjes, kushtet social-ekonomike, dakordësinë e prindërve dhe mundësinë reale për të vlerësuar interesin më të lartë të fëmijës.

Së treti, vendimi i jep rëndësi dakordësisë së prindërve për juridiksionin shqiptar. Kjo nuk do të thotë se prindërit mund të vendosin lirisht juridiksionin në dëm të fëmijës. Por kur të dy prindërit janë dakord, kur nuk kundërshtojnë juridiksionin shqiptar dhe kur gjykata bindet se interesi i fëmijës nuk cenohet, kjo dakordësi bëhet një element i rëndësishëm në favor të juridiksionit shqiptar.

Së katërti, vendimi e vendos interesin më të lartë të fëmijës në qendër të analizës, por jo në mënyrë abstrakte. Interesi i fëmijës nuk barazohet automatikisht me vendqëndrimin e zakonshëm. Ai duhet vlerësuar në mënyrë konkrete. Në disa raste, interesi i fëmijës mund të kërkojë që çështja të gjykohet nga gjykata e shtetit ku ai jeton. Në raste të tjera, interesi i fëmijës mund të kërkojë vazhdimin e gjykimit në Shqipëri, sidomos kur procesi ka avancuar, kur palët janë dakord, kur nuk ka proces tjetër në shtetin e huaj dhe kur nxjerrja jashtë juridiksionit do të sillte vonesa të dëmshme.

Së pesti, vendimi forcon të drejtën për akses në drejtësi. Gjykata e Lartë ka theksuar se nxjerrja jashtë juridiksionit është një vendimmarrje që prek drejtpërdrejt të drejtën e palëve për t'iu drejtuar gjykatës. Për këtë arsye,

mungesa e juridiksionit duhet të jetë e qartë dhe e parashikuar nga ligji. Në rast dyshimi, gjykata duhet të interpretojë normat në mënyrë që të garantojë aksesin efektiv në drejtësi.

Së gjashti, vendimi sjell një korrigjim të praktikës që kishte filluar të krijohej pas viteve 2019–2020, ku disa gjykata nxirrnin automatikisht jashtë juridiksionit çështjet për shkak të vendqëndrimit të fëmijëve jashtë vendit. Pas vendimit njësues dhe vendimeve vijuese, gjykatat duhet të shmangin këtë automatizëm dhe të arsyetojnë konkretisht pse interesi i fëmijës kërkon ose nuk kërkon juridiksionin shqiptar.

Së fundi, vendimi ka rëndësi të madhe për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Ai u jep atyre mundësinë që, në rrethana të caktuara, të kërkojnë zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave pranë gjykatave shqiptare, sidomos kur janë dakord për këtë juridiksion dhe kur çështja ka lidhje reale me Republikën e Shqipërisë.

Përfundime

Juridiksioni i gjykatave shqiptare në çështjet me objekt zgjidhje martese me fëmijë të mitur dhe element të huaj është një nga çështjet më të rëndësishme të praktikës bashkëkohore të së drejtës familjare dhe të së drejtës ndërkombëtare private në Shqipëri.

Konventa e Hagës ka vendosur si rregull të përgjithshëm se juridiksioni për masat që lidhen me fëmijën i përket shtetit ku fëmija ka vendqëndrimin e zakonshëm. Ky rregull është i drejtë dhe i nevojshëm, sidomos në rastet kur ekziston konflikt midis prindërve dhe kur gjykata e vendit ku fëmija jeton është më pranë realitetit të tij.

Megjithatë, ky rregull nuk është absolut. Neni 10 i Konventës së Hagës pranon se gjykata që shqyrton kërkesën për divorc mund të marrë masa edhe për mbrojtjen e fëmijës, kur kjo është në përputhje me kushtet e Konventës dhe me interesin më të lartë të fëmijës.

Vendimi njësues i Gjykatës së Lartë dhe vendimet vijuese kanë vendosur një standard të qartë: vendqëndrimi i zakonshëm i fëmijës jashtë Shqipërisë nuk duhet të përdoret si kriter automatik për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit shqiptar. Gjykata duhet të analizojë konkretisht rrethanat

e çështjes, dakordësinë e prindërve, lidhjen e çështjes me Shqipërinë, fazën e procesit dhe interesin më të lartë të fëmijës.

Nëse ekziston një proces divorci në gjykatat shqiptare, palët janë shtetas shqiptarë, pranojnë juridiksionin shqiptar dhe gjykata bindet se interesi më i lartë i fëmijës mund të vlerësohet para saj, atëherë gjykatat shqiptare kanë juridiksion për të shqyrtuar çështjen dhe për të vendosur mbi pasojat e zgjidhjes së martesës.

Ky interpretim është më i drejtë, më funksional dhe më në përputhje me realitetin e emigracionit shqiptar. Ai mbron interesin e fëmijës, por njëkohësisht garanton aksesin në drejtësi të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit.

Në përfundim, praktika gjyqësore shqiptare duhet të largohet nga interpretimi formal dhe automatik i vendqëndrimit të zakonshëm dhe të orientohet drejt një analize konkrete, proporcionale dhe të bazuar në interesin më të lartë të fëmijës. Vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet një ekuilibër i drejtë midis Konventës së Hagës, ligjit shqiptar dhe nevojave reale të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë Republikës së Shqipërisë.

Bibliografia

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
2. Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 9062, datë 08.05.2003, i ndryshuar.
3. Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë.
4. Ligji nr. 10428, datë 02.06.2011 "Për të Drejtën Ndërkombëtare Private".
5. Ligji nr. 9443, datë 16.11.2005, "Për ratifikimin e Konventës për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve".
6. Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".
7. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
8. Konventa për të Drejtat e Fëmijës, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 20.11.1989.
9. Konventa e Hagës e datës 19 tetor 1996 "Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve".

10. Vendim njësues i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, datë 22.12.2025, mbi juridiksionin e gjykatave shqiptare në çështjet me objekt zgjidhje martese dhe rregullimin e pasojave të saj në raport me fëmijët e mitur.
11. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 00-2026-210, datë 20.01.2026, me palë Elton Dhespo dhe Silva Çakalli, mbi juridiksionin e gjykatave shqiptare në çështjet me objekt zgjidhje martese dhe rregullimin e pasojave të saj.
12. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 00-2026-209, datë 20.01.2026, me palë Elvira Torra dhe Leonard Golemi, mbi juridiksionin në çështjet që lidhen me autorizimin për lëvizjen e fëmijës jashtë shtetit.
13. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 00-2023-3869, datë 11.10.2023, mbi juridiksionin në çështjet që lidhen me lëvizjen e fëmijës jashtë shtetit.
14. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 00-2025-1307, datë 09.04.2025, mbi juridiksionin për lëshimin e autorizimit për lëvizjen e fëmijëve jashtë shtetit.

EDUKIMI PËR QYTETARINË DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM NË EVROPË: SFIDAT DHE MUNDËSITË

PhD Cand. Lavdie Hoxha

Universiteti ''Shën Kliment i Ohrit", lavdie_zymeri@hotmail.com

Abstract

In recent years, citizenship education has gained particular importance in European educational policies as a response to the social, political, technological, and cultural changes affecting contemporary societies. Globalization, migration, digital transformation, and social polarization have created new challenges for democratic life, social cohesion, and civic participation. In this context, education is viewed not only as a process of acquiring knowledge, but also as a means of developing active, responsible, and critical citizens.

In line with Sustainable Development Goal 4, particularly target SDG 4.7, this paper examines the role of citizenship education in promoting sustainable democratic development in Europe, with a particular focus on the challenges and opportunities faced by contemporary educational systems. The study focuses on the integration of citizenship education into school curricula, the role of teachers in developing democratic competences, and the importance of civic engagement, intercultural dialogue, and lifelong democratic learning.

The paper is based on a qualitative research approach and a theoretical analysis of scientific literature, European educational policies, and official documents related to democratic citizenship and sustainable development. The reviewed literature indicates that European countries apply different models of citizenship education, while sharing a common orientation toward critical thinking, democratic participation, social responsibility, and respect for diversity. The study concludes that continuous investment in citizenship education, teacher training, and cooperation between schools, families, and communities is essential for the development of democratic and sustainable societies.

Keywords: *citizenship education, democracy, sustainable development, democratic competence.*

Hyrje

Në dekadat e fundit, sistemet arsimore evropiane kanë rishqyrtuar rolin e edukimit qytetar, duke e zgjeruar atë përtej kuptimit tradicional që lidhej kryesisht me njohjen e institucioneve, të drejtave dhe detyrimeve qytetare. Në kushtet e ndryshimeve sociale, politike, teknologjike dhe kulturore, kjo fushë po shihet gjithnjë e më shumë si proces që zhvillon kompetenca demokratike, mendim kritik dhe aftësi për pjesëmarrje të përgjegjshme në shoqëri. Ancheta-Arrabal dhe Preckler Galguera (2025) theksojnë se sistemet arsimore evropiane janë përballur me nevojën për ta thelluar kuptimin e qytetarisë demokratike dhe për ta lidhur atë me kërkesat e reja shoqërore. Në këtë rrafsh, edukimi për qytetari globale paraqitet si dimension i rëndësishëm i edukimit qytetar bashkëkohor, sepse i përgatit nxënësit dhe të rinjtë të kuptojnë rolin e tyre jo vetëm si qytetarë të një shteti, por edhe si pjesë e një komuniteti më të gjerë evropian dhe global. Sipas SOLIDAR Foundation (2024), edukimi për qytetari globale mund të kuptohet si formë e edukimit politik në shkallë globale, që nxit ndjenjën e përkatësisë ndaj komunitetit global dhe pjesëmarrjen aktive në shoqëri.

Ky punim synon të shqyrtojë rolin e edukimit qytetar në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm demokratik në Evropë, me theks të veçantë në sfidat dhe mundësitë që paraqiten në sistemet bashkëkohore arsimore. Nëpërmjet analizës së literaturës shkencore, dokumenteve evropiane dhe raporteve ndërkombëtare, punimi trajton lidhjen ndërmjet edukimit qytetar, qytetarisë globale, SDG 4.7, kompetencave demokratike dhe edukimit digjital. Edhe pse fokusi kryesor është konteksti evropian, çështjet e trajtuara kanë rëndësi edhe për Kosovën, sidomos në raport me forcimin e qytetarisë demokratike, globale dhe digjitale në shkollë.

Korniza konceptuale: edukimi qytetar, qytetaria globale dhe SDG 4.7

Edukimi qytetar dhe qytetaria globale

Edukimi qytetar në qasjen bashkëkohore evropiane kuptohet si proces arsimor që synon zhvillimin e njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave që i përgatisin individët për pjesëmarrje aktive dhe të përgjegjshme në shoqëri. Ai nuk kufizohet vetëm në njohjen e institucioneve, të drejtave dhe detyrimeve qytetare, por përfshin edhe zhvillimin e mendimit kritik, komunikimit, përgjegjësisë sociale, respektit për diversitetin dhe aftësisë për të vepruar në mënyrë konstruktive në një shoqëri demokratike dhe të qëndrueshme (EACEA/Eurydice, 2017). Në arsimin formal, edukimi qytetar synon t'i pajisë të rinjtë me njohuri dhe shkathtësi që u mundësojnë të kuptojnë rolin e tyre si qytetarë dhe të marrin pjesë në jetën shoqërore. Megjithatë, zbatimi i tij në praktikë varet nga kurrikula, përgatitja e mësimdhënësve, autonomia e shkollës dhe mundësitë që u ofrohen nxënësve për të nxënë në mënyrë aktive dhe pjesëmarrëse. Nga ky këndvështrim, edukimi qytetar lidhet me të nxënit gjatë gjithë jetës dhe me zhvillimin e aftësisë për të vepruar në funksion të drejtësisë sociale dhe pjesëmarrjes qytetare (Ancheta-Arrabal & Preckler Galguera, 2025).

Në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur, qytetaria nuk kufizohet vetëm në nivelin kombëtar, por përfshin edhe kuptimin e çështjeve globale, respektin për diversitetin kulturor dhe përgjegjësinë ndaj komunitetit më të gjerë. Nisur nga kjo, kompetenca qytetare lidhet ngushtë me kompetencën globale dhe aftësinë për të kuptuar sfidat lokale e globale (OECD, 2020). Edukimi për qytetari globale paraqet zgjerim të edukimit qytetar tradicional, duke e vendosur qytetarinë në një kornizë më të gjerë lokale, evropiane dhe globale. Milana dhe Tarozzi (2019) theksojnë se edukimi për qytetari globale dhe arsimi për të rritur ndajnë qëllime të përbashkëta, si zhvillimi i përgjegjësisë qytetare, drejtësisë sociale dhe pjesëmarrjes demokratike.

Sipas UNESCO-s, edukimi për qytetari globale duhet t'i pajisë individët, që nga mosha e hershme dhe gjatë gjithë jetës, me njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe sjellje që i bëjnë ata qytetarë të informuar, të përkushtuar dhe solidarë (UNESCO, 2016). Përmbajtja e tij zhvillohet përmes tri dimensioneve kryesore: dimensionit njohës, që lidhet me njohuritë

dhe mendimin kritik; dimensionit socio-emocional, që përfshin solidaritetin, empatinë dhe respektin për dallimet; dhe dimensionit sjellor, që lidhet me veprimin e përgjegjshëm për një shoqëri më paqësore dhe më të qëndrueshme. Rëndësia e edukimit për qytetari globale është rritur në kushtet e globalizimit, digjitalizimit, migrimit dhe sfidave të reja demokratike. Schulz et al. (2023) theksojnë se këto zhvillime kanë rritur interesimin për qytetarinë globale dhe edukimin për zhvillim të qëndrueshëm si përgjigje ndaj sfidave mjedisore, sociale dhe ekonomike. Në vijim të kësaj analize, edukimi qytetar dhe qytetaria globale lidhen natyrshëm me zhvillimin e qëndrueshëm, sepse mbështeten në vlera të përbashkëta si respekti, drejtësia, solidariteti dhe përgjegjësia ndaj komunitetit dhe mjedisit (Mulcahy & Tutiaux-Guillon, 2005; Council of the European Union, 2022).

Zhvillimi i qëndrueshëm dhe SDG 4.7

Në kuadër të Agjendës 2030, SDG 4 e vendos arsimin gjithëpërfshirës, të barabartë dhe cilësor në qendër të zhvillimit të qëndrueshëm, ndërsa SDG 4.7 e zgjeron këtë orientim duke e lidhur arsimin me edukimin për zhvillim të qëndrueshëm, qytetarinë globale, të drejtat e njeriut, kulturën e paqes, diversitetin kulturor dhe përgjegjësinë qytetare. Në vijim të kësaj, SDG 4.7 nuk paraqet vetëm një nënobjektiv teknik brenda SDG 4, por një pikë lidhëse ndërmjet arsimit cilësor, edukimit qytetar dhe formimit të qytetarëve të aftë për pjesëmarrje demokratike e të përgjegjshme në shoqëri të qëndrueshme. UNESCO e paraqet arsimin si instrument kyç për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke theksuar se edukimi për zhvillim të qëndrueshëm synon të zhvillojë njohuri, aftësi, vlera dhe qëndrime që i ndihmojnë individët të kontribuojnë në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të qëndrueshme. Brenda kësaj qasjeje, arsimi nuk ka vetëm funksion informues, por edhe transformues, sepse përgatit individë të aftë për të kuptuar sfidat globale, për të marrë vendime të përgjegjshme dhe për të vepruar në mënyrë etike në shoqëri (UNESCO, 2017).

Lidhja ndërmjet edukimit qytetar dhe zhvillimit të qëndrueshëm mbështetet në vlera të përbashkëta, si të drejtat, përgjegjësitë, pjesëmarrja demokratike dhe kujdesi ndaj komunitetit e mjedisit. Edukimi qytetar synon formimin e qytetarëve aktivë dhe të përgjegjshëm, ndërsa edukimi për zhvillim të qëndrueshëm e zgjeron këtë përgjegjësi drejt ndërvarësisë

ndërmjet aspekteve sociale, ekonomike dhe mjedisore. Në vijim të kësaj, këto dy fusha mund të trajtohen si pjesë të një qasjeje të përbashkët që synon zhvillimin e shoqërive demokratike dhe të qëndrueshme (Mulcahy & Tutiaux-Guillon, 2005; EACEA/Eurydice, 2017). Në nivel ndërkombëtar, kjo lidhje bëhet veçanërisht e dukshme përmes Agjendës 2030 dhe SDG 4.7, i cili e vendos edukimin për qytetari globale dhe edukimin për zhvillim të qëndrueshëm në qendër të arsimit cilësor. Përfshirja e këtyre fushave në politika dhe kurrikula kërkon mbështetje institucionale, veprime afatgjata dhe trajnim fillestar e të vazhdueshëm të mësimdhënësve (United Nations, 2012; UNESCO, 2015).

Këshilli i Bashkimit Evropian e vlerëson edukimin për zhvillim të qëndrueshëm dhe qytetari globale si proces me rol transformues për shoqërinë, mirëqenien dhe zhvillimin e qëndrueshëm (Council of the European Union, 2022). Ky edukim konsiderohet pjesë përbërëse e SDG 4 dhe një mundësues i rëndësishëm për arritjen e objektivave të tjera të zhvillimit të qëndrueshëm. Si rrjedhojë, cilësia e arsimit mbetet thelbësore, sepse pjesëmarrja demokratike dhe përgjegjësia qytetare kërkojnë arsim gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt kompetencave (United Nations, 2024). SDG-të mund të përdoren edhe si përmbajtje mësimore për zhvillimin e kompetencave qytetare dhe demokratike. Përmes tyre, nxënësit dhe studentët mund të zhvillojnë njohuri, shkathtësi dhe qëndrime që lidhen me të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, kulturën e paqes, qytetarinë globale, diversitetin kulturor dhe përgjegjësinë ndaj zhvillimit të qëndrueshëm. Garcia-Esteban (2020) thekson se integrimi i SDG-ve në kurrikulë ndihmon në promovimin e këtyre kompetencave dhe e lidh edukimin qytetar me sfidat më të gjera shoqërore e globale. Në kontekstin e Kosovës, ky orientim është i rëndësishëm për forcimin e arsimit cilësor, qytetarisë aktive dhe ndërgjegjësimit për zhvillim të qëndrueshëm në shkolla.

Metodologjia e punimit

Ky punim mbështetet në metodën e shqyrtimit të literaturës dhe analizës dokumentare. Për analizë janë përdorur burime shkencore, raporte ndërkombëtare dhe dokumente të politikave arsimore që trajtojnë edukimin qytetar, qytetarinë globale, zhvillimin e qëndrueshëm dhe SDG 4.7 në kontekstin evropian. Burimet e shqyrtuara përfshijnë dokumente të UNESCO-s, Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian, raporte të

Eurydice dhe studime akademike relevante. Përzgjedhja e burimeve është orientuar nga rëndësia e tyre për temat kryesore të punimit, si edukimi qytetar, qytetaria globale, SDG 4.7, kompetencat demokratike, edukimi digjital dhe roli i mësimdhënësve në zbatimin e këtyre fushave në praktikën shkollore. Në analizë janë përfshirë kryesisht burime akademike dhe dokumente institucionale të publikuara nga organizata ndërkombëtare dhe evropiane, me fokus në zhvillimet bashkëkohore në arsim dhe në politikat që lidhen me qytetarinë demokratike dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Analiza është realizuar në mënyrë tematike, duke u përqendruar në identifikimin e koncepteve kryesore, sfidave dhe mundësive që lidhen me rolin e edukimit qytetar në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm demokratik. Në këtë kuadër, edukimi qytetar është trajtuar si fushë shumëdimensionale që përfshin njohuri, vlera, qëndrime dhe pjesëmarrje qytetare. Po ashtu, analiza është mbështetur edhe në qasjen e raportit ICCS 2022, i cili trajton njohuritë qytetare, perceptimet për demokracinë, besimin në institucione dhe pritjet për pjesëmarrje qytetare (Schulz et al., 2023). Vëmendje e veçantë i është kushtuar lidhjes ndërmjet edukimit qytetar, SDG 4.7, kompetencave demokratike, edukimit digjital dhe rolit të mësimdhënësve. Burimet janë përzgjedhur duke u bazuar në relevancën tematike, karakterin institucional ose shkencor të tyre, si dhe lidhjen e drejtpërdrejtë me edukimin qytetar, SDG 4.7 dhe zhvillimin e qëndrueshëm në kontekstin evropian. Kjo qasje ka mundësuar nxjerrjen e kategorive kryesore të analizës: sfidat, mundësitë dhe drejtimet e zhvillimit të edukimit qytetar në kontekstin evropian.

Edukimi qytetar në kontekstin evropian

Në kontekstin evropian, edukimi qytetar dhe edukimi për qytetari globale janë zhvilluar përmes dokumenteve politike, iniciativave ndërkombëtare dhe studimeve krahasuese që synojnë forcimin e qytetarisë demokratike, të drejtave të njeriut dhe pjesëmarrjes aktive të të rinjve. Karta e Këshillit të Evropës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut e vitit 2010, si dhe korniza e UNESCO-s për edukimin për qytetari globale e vitit 2015, kanë ndikuar në promovimin e këtyre koncepteve në shkallë më të gjerë. Po ashtu, studimet ndërkombëtare të IEA-së dhe raportet e Eurydice kanë analizuar mënyrën se si të rinjtë përgatiten për rolin e tyre si qytetarë dhe si edukimi qytetar përfshihet në

sistemet arsimore evropiane (Schulz et al., 2018; Schulz et al., 2023; EACEA/Eurydice, 2023).

Megjithëse ekziston një orientim i përbashkët evropian drejt qytetarisë demokratike, globale dhe të qëndrueshme, zbatimi i edukimit qytetar ndryshon sipas traditave historike, politike dhe arsimore të secilit vend. Sipas analizës krahasuese të Ancheta-Arrabal dhe Preckler Galguera (2025), në disa sisteme arsimore edukimi qytetar paraqitet si lëndë e veçantë, në disa të tjera si temë ndërkurrikulare, ndërsa në raste të tjera integrohet në lëndë ekzistuese. Kjo tregon se në Evropë nuk ekziston një model i vetëm i zbatimit të edukimit qytetar, por forma të ndryshme që përshtaten me kornizat kombëtare arsimore.

Information-sharing partnerships: Collaboration with public law enforcement and data-sharing within the private sector (public-private partnerships) is key to identifying new, emerging typologies of financing, as highlighted in FATF reports.

New technologies and regulatory focus: There is increasing integration of artificial intelligence and machine learning to analyze large datasets to spot financing trends, helping firms shift from reactive to proactive approaches.

Regulatory Reform: Reforming anti-money laundering/countering the financing of terrorism (AML/CFT) programs to focus on risk-based approaches, not just compliance checklists.

The analysis of terrorist financing trends provides an overview of the evolution of financial flows associated with the travel and activities of foreign terrorist fighters over the past decade, taking into account changes in their geographic locations and operational circumstances. The financial activity associated with foreign terrorist fighters is often characterized by the collection and transfer of relatively small amounts of money, as well as the financing of their own or others' travel to areas affected by terrorist activity.[12]

1. The funds are largely derived from legal sources, most often from personal savings, and in some cases are collected on behalf of others. The use of encrypted mobile applications for coordinating donations, the transfer of funds in the form of virtual assets, international transfers through fiat money service providers, and the use of courier services when funds are provided in cash have been observed. Overall, the financial models associated with foreign terrorist fighters show a high level of adaptability. Over the years, there has been a shift from relatively simple financing methods to increasingly sophisticated, technologically advanced and harder-to-detect approaches, which poses an additional challenge to systems for preventing and detecting terrorist financing.

2. The decentralization of terrorist groups is likely to lead to a corresponding decentralization in their methods of financing terrorism. This

[12] United Nations., (2024), Evolving Trends in the Financing of Foreign Terrorist Fighters, https://www.un.org ›

may result in an increase in self-financing cells, each adapting to the specific needs and circumstances of their operational areas. Such decentralization also leads to the emergence of more lone actors or small cells - making detection and intervention increasingly challenging for law enforcement and intelligence agencies. The diversification of funding sources at the local level may further complicate efforts to disrupt larger financial networks.

3. In recent decades, terrorist financing has significantly evolved and adapted to changes in the global financial system, technological advances and strengthened regulatory measures. Modern trends point to increasingly sophisticated methods for securing and concealing financial assets, which poses a serious challenge for financial institutions and supervisory authorities. One of the key trends is the increased use of legal sources of funds. Unlike in the past, when terrorist financing was mainly associated with organized crime, donations, income from legal businesses and individual small transactions are increasingly used today. This trend makes it more difficult to identify suspicious activities, as the funds often have a legal origin.

4. Another significant trend is the fragmentation of financial transactions, known as “smurfing”, in which a large number of small transactions are carried out in order to avoid detection by financial institutions. This method requires advanced systems for monitoring and analyzing transactions, which increases the role of technological solutions in banks.

5. The use of digital and alternative financial channels, such as electronic payments, online platforms, virtual assets and informal money transfer systems, is also increasing. These channels enable the rapid and often anonymous transfer of funds across borders, which poses a new risk to financial supervision and regulation.

6. In terms of prevention, one of the key trends is the strengthening of the regulatory framework and a risk-based approach. Financial institutions are increasingly applying a risk-based approach, with resources being directed towards customers, products and transactions with a higher risk of terrorist financing. This contributes to more efficient detection of suspicious activities. In addition, there is a trend towards increased inter-institutional

and international cooperation. Financial institutions are cooperating more closely with financial intelligence units, regulators and international organizations to exchange information and comply with international standards. An important trend in the fight against terrorist financing is the growing role of technology and analytical tools, including automated transaction monitoring systems and data analysis. These tools enable financial institutions to identify suspicious patterns in a timely manner and take appropriate measures to prevent terrorist financing.

Trends in terrorist financing indicate a constant evolution of the methods and channels used to secure funds for terrorist activities. In recent years, there has been a shift from traditional and direct forms of financing to more sophisticated, flexible and technologically advanced models, with the aim of avoiding detection and control by competent institutions.[13]

1. The financial resources used for terrorist purposes increasingly originate from legal sources, such as personal savings, income from legitimate business activities or donations, but at the same time the use of illegal sources continues, including organized crime, drug, arms and human trafficking, as well as extortion and kidnapping. There has also been an increased misuse of charitable organizations and non-profit structures to conceal the true purpose of the funds.

2. In terms of mechanisms for transferring funds, there is an increasing use of digital and alternative financial channels. These include electronic payments, virtual assets, online platforms, as well as informal money transfer systems. Coordination and communication regarding financing is often carried out through encrypted applications, which further complicates the identification and monitoring of financial flows.

4. A particular trend is the financing of individual actors and small cells, using relatively small amounts of money, but with significant operational impact. These models are characterized by a high level of adaptability and rapid change of tactics, depending on the security and regulatory measures applied.

[13] Teichmann, M. F., (2025), Current trends in terrorist financing, RePEc: Research Papers in Economics., https://ideas.repec.org ›

5. Overall, contemporary trends in terrorist financing represent a serious and dynamic challenge, which requires continuous monitoring, improvement of regulatory frameworks and strengthened national, regional and international cooperation in order to timely detect and prevent these activities.

Modern forms of terrorist financing are constantly changing under the influence of globalization, technological development and digitalization of the financial system. Terrorist organizations are increasingly using innovative methods and modern financial tools to conceal the origin of funds, their transfer and financing of illegal activities. These new trends pose a serious challenge for financial institutions, regulatory bodies and security services.[14]

1. Use of cryptocurrencies and digital assets. Due to the possibility of relative anonymity, fast transactions and transnational transfer of funds, cryptocurrencies are becoming an attractive tool for financing terrorist activities. Although blockchain technology allows for the tracking of transactions, the use of anonymous wallets, mixers and decentralized financial platforms complicates the identification of users and the sources of funds.

2. Abuse of fintech platforms and digital payment systems. Mobile payment applications, electronic wallets and online platforms allow for quick and easy transfer of funds with minimal physical contact and limited supervision in certain cases. Terrorist groups use these platforms for small and frequent transactions in order to avoid detection by monitoring systems.

4. Using social networks, crowdfunding platforms and humanitarian organizations to raise funds. Through online campaigns, fake charities and online donations, funds are collected from supporters around the world. This method is particularly dangerous because it is often disguised as legitimate humanitarian or religious activities.

5. Using small individual donations and self-financing. Instead of large and easily detectable transactions, modern terrorist cells use limited financial resources provided through personal income, small loans, illegal

[14] FATF., (2026), Publications on money laundering, terrorist financing and proliferation financing methods and trends › https://www.fatf-gafi.org ›

trade or online fraud. This model makes it difficult for financial institutions to detect suspicious activities.

6. Hacking attacks, ransomware activities, digital data theft and online financial fraud are used as sources of income to finance extremist activities. With the increasing digitalization of the financial sector, the risks of such abuses are further increasing.

Due to these modern trends, financial institutions must constantly improve their systems for risk analysis, transaction monitoring and cybersecurity. International cooperation, information exchange and the application of advanced technologies such as artificial intelligence and machine learning are key to timely detection and prevention of terrorist financing in the digital age.

Conclusion

Terrorist financing is one of the most serious and complex threats to modern society, as it directly affects national and international security, economic stability and confidence in the financial system. Terrorist organizations cannot function without continuous financial support, which makes the fight against terrorist financing an essential part of the global strategy for preventing terrorist activities. Modern forms of financing are becoming increasingly sophisticated and difficult to detect, especially due to the development of digital financial technologies, cryptocurrencies, electronic transactions and alternative systems for transferring funds.

Terrorist groups use a variety of sources of financing, such as illegal trade, money laundering, cybercrime, abuse of humanitarian organizations, small individual donations and various legal business activities through which they conceal financial flows. These methods allow financial assets to move through multiple countries and financial systems, which further complicates their identification and control. Therefore, financial institutions have an extremely important role in the timely detection and prevention of suspicious activities related to the financing of terrorism.

Banks, insurance companies, brokerage firms, fintech companies and other financial intermediaries represent the first line of defense in the fight against financial crime and terrorist financing. Through the application of

customer identification and verification systems, transaction monitoring, risk analysis, compliance with legal regulations and timely reporting of suspicious activities, they contribute to preserving the integrity and stability of the financial system. The application of modern technological solutions, such as artificial intelligence, machine learning and automated data analysis systems, which enable faster detection of potential threats and suspicious financial models, is particularly important.

The effectiveness of measures to prevent the financing of terrorism depends not only on financial institutions, but also on the existence of a strong legal and regulatory framework. International standards established by organizations such as FATF, the United Nations and the European Union play a key role in creating unified rules and mechanisms for combating money laundering and terrorist financing. National legislation must be constantly aligned with these standards in order to ensure effective supervision, transparency and coordinated application of measures.

The fight against terrorist financing requires strong international and inter-institutional cooperation. The exchange of information between states, financial institutions, regulatory bodies and security services is necessary for the timely detection and prevention of transnational financial activities related to terrorism. Since terrorist networks operate globally and use different financial systems and technologies, no institution or state can successfully deal with this problem alone.

The challenges related to terrorist financing will continue to grow in parallel with technological development and the digitalization of financial services. Therefore, continuous improvement of control mechanisms, investments in cybersecurity, education of employees in the financial sector and development of modern analytical systems for risk detection are necessary. Only through an integrated, coordinated and proactive approach can the risk of financing terrorist activities be effectively reduced and greater security, stability and confidence in the global financial system and society as a whole be ensur

Reference

1. Anderson, J., (2025), The evolving threat of terrorist financing: understanding and managing risk, https://www.whitecase.com ›
2. Anti Money Laundering / Countering Financing of Terrorism., (2025), What is Terrorism Financing?, https://amlcft.bnm.gov.my ›
3. Arctic Intelligence. (2026), The Role of Financial Institutions in Combating Terrorism Financing, https://arctic-intelligence.com ›
4. Banka e Shqipërisë., (2025), Prevention of money laundering and terrorism financing, https://www.bankofalbania.org ›
5. Coe.int., (2025), Financing of terrorism - The Council of Europe, https://www.coe.int ›
6. European Banking Authority., (2025), Countering Terrorist Financing, https://www.eba.europa.eu ›
7. FATF., (2026), Publications on money laundering, terrorist financing and proliferation financing methods and trends › https://www.fatf-gafi.org ›
8. FATF report., (2025), Terrorist financing risks and warns of gaps in global understanding of the threats., https://www.fatf-gafi.org ›
9. International Monetary Fund., (2026), Anti-Money Laundering and Combating the Financing of Terrorism (AML/CFT), https://www.imf.org ›
10. Melissa Data., (2025), What is Terrorist Financing?, https://knowledge.melissa.com ›
11. Teichmann, M. F., (2025), Current trends in terrorist financing, RePEc: Research Papers in Economics., https://ideas.repec.org ›
12. United Nations., (2025), Countering the financing of terrorism, https://www.un.org › ›
13. United Nations., (2024), Evolving Trends in the Financing of Foreign Terrorist Fighters, https://www.un.org ›
14. United Nations Office on Drugs and Crime, (2025), Combating Terrorist Financing, https://www.unodc.org ›

NDIKIMI I BUXHETIT TË RMV-SË NË ZHVILLIMIN EKONOMI (RAST STUDIMOR PERIUDHA 2020-2025)

Prof.Dr. Gëzim Selimi

Mr.Sc. Hasime Durmishi

Abstract

This scientific paper analyzes the impact of the state budget of North Macedonia on the country's economic development during the period 2020-2025. Through empirical analysis of budgetary data, the research focuses on evaluating the quality of expenditures, the realization rate of capital investments, the structure of revenues and expenditures, and the allocation efficiency of public funds. The findings indicate a significant dominance of current expenditures and social transfers over capital investments and education, highlighting a fiscal policy oriented towards consumption and social maintenance rather than long-term development. The chronic issue of under-execution of capital expenditures (averaging 81% during the period) and the use of the budget deficit primarily for current needs remain critical challenges. The paper concludes that without a structural reorientation towards productive spending, the budget fails to serve as a genuine catalyst for economic growth.

Keywords: *State budget, economic development, capital investments, fiscal policy, North Macedonia, public spending.*

Hyrje

Buxheti i shtetit nuk është thjesht një pasqyrë kontabël e të ardhurave dhe shpenzimeve vjetore, por instrumenti më i fuqishëm i politikës makroekonomike që ka në dispozicion një qeveri për të nxitur rritjen, stabilizuar ekonominë dhe përmirësuar mirëqenien e qytetarëve. Buxheti përbën instrumentin kryesor të politikës fiskale përmes të cilit qeveritë ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe social të një vendi. Në teorinë ekonomike pranohet gjerësisht se mënyra se si një shtet i mbledh dhe i shpenzon paratë publike përcakton trajektoren e zhvillimit të tij. Për vendet në tranzicion dhe ato në zhvillim, siç është Maqedonia e Veriut, krijimi i një hapësire fiskale për investime kapitale dhe rritja e efikasitetit të shpenzimeve publike janë kushte të pa negociueshme për progres.

Ky punim synon të trajtojë një nga çështjet më thelbësore të ekonomisë politike në Maqedoninë e Veriut: A po funksionon buxheti si një motor i zhvillimit ekonomik apo thjesht si një mekanizëm për ruajtjen e paqes sociale dhe konsumit të përditshëm? Duke analizuar të dhënat zyrtare fiskale të periudhës 2020-2025 hulumtimi zbërthen strukturën e buxhetit shtetëror me theks të veçantë te cilësia e shpenzimeve, raporti i realizimit të investimeve kapitale ndaj PBB-së, si dhe alokimet për sektorë gjenerues të zhvillimit (si arsimi) kundrejt atyre konsumues (si mbrojtja sociale).

Një element kyç i analizës është roli i investimeve kapitale, të cilat konsiderohen si faktor kryesor për nxitjen e rritjes ekonomike dhe përmirësimin e infrastrukturës. Megjithëse këto investime kanë shënuar rritje në disa vite, ato mbeten relativisht të ulëta në raport me nevojat zhvillimore dhe shpesh karakterizohen nga probleme në realizim.

Përmes kësaj analize, punimi tenton të identifikojë pabarazitë (disbalancat) strukturore të politikës fiskale në Republika e Maqedonisë së Veriut dhe të vlerësojë nëse paratë e taksapaguesve po shpenzohen në mënyrë efektive. Rezultatet e këtij studimi synojnë të ofrojnë një pasqyrë reale dhe rekomandime për politikbërësit mbi domosdoshmërinë e kalimit nga një "buxhet mbijetese" në një "buxhet zhvillimi".

1. Kuptimi dhe rëndësia e buxhetit në planifikimin e zhvillimit ekonomik

Në literaturën ekonomike janë dhënë shumë përkufizime mbi buxhetin dhe rëndësinë e tij. Buxheti është instrumenti themelor financiar i shtetit dhe i formave të tij organizative, i cili, në formën e një akti juridik, përcakton dhe sintetizon paraprakisht të ardhurat publike dhe shpenzimet publike sipas vëllimit dhe strukturës. Po ashtu, buxheti financon shpenzimet publike në një periudhë të caktuar kohore për kryerjen e aktiviteteve dhe funksioneve shtetërore dhe përmbushjen e nevojave publike që bien brenda juridiksionit të tij. Ai ka implikime të natyrës politike, ekonomike dhe sociale.

Buxheti është një instrument financiar publiko-juridik, i lidhur ekskluzivisht me shtetin dhe paraqet një instrument i përgjithshëm për financimin e shpenzimeve publike e njëherit është një akt ligjor pasi ka karakter planifikues dhe karakter balancues që harmonizon të ardhurat dhe shpenzimet publike. Buxheti është një instrument periodik dhe afatshkurtër.

Buxheti ka karakter funksional (si instrument për zbatimin e funksioneve shtetërore) edhe atë si: Instrument i stabilizimit ekonomik (ndikim në prodhim, shkëmbim, konsum, çmime); dhe si instrument i rishpërndarjes (ndikon në rishpërndarjen e produktit shoqëror). Lënda e financimit të buxhetit në përgjithësi është: financimi i organeve shtetërore, financimi i shërbimeve publike, financimi i programeve sociale (mbrojtja sociale) dhe financimi i stimujve të zhvillimit, etj.

Qëllimi kryesor i përpilimit dhe realizimit të një buxheti publik është që ai të mundëson që shpenzimi publik të jetë sa më racional dhe efikas në përputhje me aftësitë ekonomike të shoqërisë. Zbatimi i këtyre parimeve mundëson transparencë më të madhe të buxhetit (thjeshtësi teknike), gjithashtu mundëson kontrollin e degës legjislative mbi degën ekzekutive. Parimet e buxhetit kanë ndryshuar me ndryshimin e kushteve socio-ekonomike dhe forcimin e rolit ndërhyrës të shtetit, me një tendencë për të forcuar si pavarësinë e degës ekzekutive ashtu edhe kontrollin mbi aktivitetet e saj.

Por qeveritë, për arsye politike, mungesë të të dhënave cilësore, mungesës të metodave të përshtatshme të planifikimit, për shkak të dobësisë të organeve të planifikimit, për shkak të afatit të gjatë midis kohës së planifikimit dhe kohës së ekzekutimit të buxhetit si dhe nga një

paqëndrueshmëri ekonomike dhe tendencës inflacioniste mund të propozojnë buxhete të mbivlerësuara ose nënvlerësuara në mënyrë joreale.

Treguesi	2020	2021	2022	2023	2024	2025
1.Të ardhurat totale	189.554	218.021	243.085	277.128	305.553	362.377
2.Shpenzimet totale	243.421	256.906	278.596	318.538	374.454	403.727
3.Deficiti buxhetor	53.867	35.511	41.410	41.901	41.350	39.239
1a.Të ardhurat tatimore	106.900	125.690	142.567	157.733	177.889	292.100
1b.Të ardhura jo tatimore	11.173	13.882	17.189	16.866	16.920	30.608
1c.Të ardhura kapitale	1.846	1.928	2.273	2.071	1.851	2.830
1d. Donacione	3.071	5.894	3.437	7.836	3.225	9.743
2a. Rroga dhe kontribute	29.775	31.010	32.159	36.877	43.889	49.189
-Pagesa e Penzioneve	60.216	62.289	67.567	77.967	90.646	106.515
-Transfere sociale	117.799	121.439	131.758	148.866	170.027	193.296
2b.Mallra dhe shërbime	15.423	20.110	21.001	21.117	22.923	28.025
2c. Transfere në NJVL	21.373	21.218	23.365	27.459	30.781	33.516
2d. Subvencione dhe transfere	34.905	30.635	32.536	27.754	33.324	31.734
3. Shpenzime kapitale	16.115	23.408	28.637	43.524	28.698	47.351
-Realizimi i shpenz. Kapitale	80,1%	78%	85%	82.6%	81,4%	78%
% e shpenzimeve totale Arsim	10%	9,8%	10,7%	8,9%	9,5%	9,7%
% e shpenzimeve totale Shëndetësi	12,1%	14%	15%	12,4%	13%	13,3%
Kultura	1,5%	1,5%	1,7%	1,3%	1,3%	1,3%
Mbrojtja sociale	31%	31%	33,1%	29%	31,5%	`33%

Duke nisur nga qëllimi i këtij hulumtimi kemi parashtruar tre hipoteza:

Hipoteza e Parë - Dominimi i shpenzimeve korrente dhe transfereve sociale ndaj investimeve kapitale në buxhetin e Maqedonisë së Veriut kufizon potencialin e vendit për rritje ekonomike afatgjatë.

Hipoteza e Dytë - Mosrealizimi i plotë i investimeve kapitale të planifikuara (normat nën 100%) dëmton drejtpërdrejt efikasitetin e buxhetit si instrument gjenerues i zhvillimit ekonomik.

Hipoteza e Tretë - Deficiti i vazhdueshëm buxhetor në periudhën 2020-2025 përdoret kryesisht për të mbuluar shpenzimet e konsumit shtetëror (paga, sociale) dhe jo për krijimin e vlerës së shtuar në ekonomi.

Analiza e buxhetit të RMV-së që nga viti 2020 – 2025

Për analizë të buxhetit janë shfrytëzuar të dhëna nga institucione vendore ashtu edhe nga institucione relevante ndërkombëtare. Analiza e buxhetit për periudhën 2020–2025 në Republika e Maqedonisë së Veriut do të fokusohet në disa tregues kryesor të cilët tregues ofrojnë një pasqyrë të qartë jo vetëm mbi nivelin e shpenzimeve, por mbi mënyrën se si alokohen dhe sa kontribuojnë ato në zhvillimin ekonomik.

Tabela nr. 1. Të dhënat buxhetore të RMV-së 2020-2025

Burimi: Gazeta zyrtare e RMV-së

Në këtë kontekst, cilësia e shpenzimeve vlerësohet përmes strukturës së tyre, duke dalluar midis shpenzimeve konsumuese dhe atyre zhvillimore. Një vëmendje e veçantë i kushtohet investimeve kapitale, të cilat konsiderohen si faktor kyç për rritjen ekonomike dhe përmirësimin e infrastrukturës. Paralelisht, analiza e buxhetit si përqindje e BPV-së mundëson vlerësimin e rolit të shtetit në ekonomi dhe qëndrueshmërinë e politikës fiskale.

Kjo qasje e integruar lejon një vlerësim më të plotë të performancës fiskale, duke identifikuar jo vetëm nivelin e shpenzimeve, por edhe efektivitetin dhe ndikimin e tyre në zhvillimin ekonomik afatshkurtër dhe afatgjatë.

Analiza e buxhetit të shtetit është thelbësore për të kuptuar nëse një qeveri po nxit rritjen ekonomike apo thjesht po mirëmban "paqen sociale" përmes konsumit. Më poshtë do të ofrojmë një analizë të detajuar të buxhetit bazuar në të dhënat e lartshënuara, e ndarë në të pesë pika.

a. Cilësia e shpenzimeve

Në teorinë ekonomike, "cilësia e shpenzimeve" matet me raportin midis shpenzimeve korrente – për konsum (rroga, pensione, ndihma sociale, blerje mallrash) dhe shpenzimeve produktive (investime kapitale, arsim, hulumtim dhe zhvillim).

Analiza e të dhënave: Të dhënat e paraqitura në tabelën nr.1tregojnë një cilësi të ulët të shpenzimeve. Buxheti i Maqedonisë së Veriut është dukshëm një buxhet i orientuar drejt konsumit dhe anës sociale, jo drejt

zhvillimit. Për shembull, në vitin 2023, transferet sociale dhe pensionet së bashku zënë pjesën dërrmuese të shpenzimeve, ndërsa pagat e administratës (rroga dhe kontribute) rriten vazhdimisht nga 29.775 milion denarë në 2020, në 49.189 milion denarë në vitin 2025.

Pra, vlera e madhe e rrogave, pensioneve, transfereve dhe subvencioneve tregon se buxhetet janë më shumë sociale (redistributiv) sesa zhvillimor dhe nxitës të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Çdo buxhet, 60–65% shkon për transfere dhe paga, nuk gjeneron rritje ekonomike direkte dhe nuk është buxhet zhvillimor por buxhet social, respektivisht buxhet që blenë paqen sociale. Një rritje ekonomike e qëndrueshme kërkon shpenzime që krijojnë vlerë të shtuar në të ardhmen. Shpenzimet e larta korrente mund të nxisin konsumin afatshkurtër, por nuk rrisin kapacitetin prodhues të vendit.

b. Investimet kapitale

Investimet kapitale (infrastrukturë, shkolla, spitale, digjitalizim) janë motori i zhvillimit ekonomik. Sa i takon investimeve kapitale sipas tabelës nr. 2 vërehet se shpenzimet kapitale kanë një rritje të vazhdueshme nga viti në vit, ku rritja më e madhe bëhet në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022, ku rritja është për 52%, respektivisht për 14.887 milion dinarë.

Tabela nr.2 Shpenzimet totale dhe ato kapitale

Treguesi	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Shpenzimet totale	243.421	256.906	278.596	318.538	374.454	403.727
Shpenzime kapitale	16.115	23.408	28.637	43.524	28.698	47.351
-Realizimi i shpenz. Kapitale	80,1%	78%	85%	82.6%	81,4%	78%

Por, shpenzimet kapitale kanë peshë e ulët në buxhet. Nëse i llogarisim për vitin 2020: Shpenzimet kapitale / shpenzimet totale x100 do të kemi 16.115/243421x100 = 6.6% Ndërsa për vitin 2025 është 11.7%. Edhe pse ka një tendencë rritjeje (veçanërisht një kërcim në 2023 dhe 2025), ato mbeten në nivele shumë të ulëta krahasuar me nevojat e një vendi në zhvillim, siç është RMV-ja.

Në buxhetin e RMV-së problem është realizimi i shpenzimeve kapitale dhe tabela nr.2 nxjerr në pah një problem kronik: mosrealizimin e investimeve kapitale (luhatet nga 78% në 85%). Kjo do të thotë se paratë që planifikohen për zhvillim (p.sh. autostrada, shkolla) mbeten të pashpenzuara,

shpesh për shkak të mungesës së kapaciteteve administrative, procedurave të stërzgjatura të tenderimit apo korrupsionit. Investimet janë të paqëndrueshme, të pamjaftueshëm dhe kjo ndikon në rritjen ekonomike të kufizuar, që është një goditje e drejtpërdrejtë për rritjen ekonomike.

c. Buxheti si % e PBB

Në bazë të këtyre vlerave shpenzimet totale lëvizin nga 243 deri në 403 miliard denarë, ndërsa PBB në RMV është afërsisht prej 1.250 mild. denarë në vitin 2020 deri në 1.884 miliard denarë në vitin 2025. Po ashtu kemi zgjerimi masiv të buxhetit ku të ardhurat totale pothuajse po dyfishohen nga 189.554 në 2020 në 362.377 në 2025. E njëjta gjë vlen edhe për shpenzimet ku në vitin 2020 kanë qenë 243.421 milion denarë ndërsa në vitin 2025 janë 403.724 milin denarë.

Tabela nr.3. Shpenzimet kapitale 2020 - 2025

Treguesi	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Të ardhurat totale	189.554	218.021	243.085	277.128	305.553	362.377
Shpenzimet totale	243.421	256.906	278.596	318.538	374.454	403.727
Të ardhurat tatimore	106.900	125.690	142.567	157.733	177.889	292.100
Të ardhura jo tatimore	11.173	13.882	17.189	16.866	16.920	30.608
Të ardhura kapitale	1.846	1.928	2.273	2.071	1.851	2.830
Donacione	3.071	5.894	3.437	7.836	3.225	9.743
Deficiti buxhetor	53.867	35.511	41.410	41.901	41.350	39.239

Një rritje kaq e madhe nominale e buxhetit zakonisht tregon një shtrirje më të madhe të shtetit në ekonomi (buxheti merr një % më të madhe të PBB-së). Kur buxheti rritet me ritme më të shpejta se rritja reale ekonomike (PBB), kjo shpesh shoqërohet me barra të reja tatimore për sektorin privat (siç shihet nga kërcimi dramatik i të ardhurave tatimore nga 177.889 në 2024 në 292.100 në 2025) dhe rritje të borxhit publik (deficit i vazhdueshëm prej mbi 35.000 deri në 53.000 milion çdo vit).

d. Struktura e shpenzimeve dhe të ardhurave

Të ardhurat janë shumë të varura nga taksat - të ardhurat tatimore që dominojnë me mbi 80% dhe të mbajnë peshën kryesore, ndërsa ato jo-

tatimore dhe ato kapitale janë shumë të ulëta. Të ardhurat kapitale janë mikroskopike (1.846 deri 2.830), gjë që tregon se shteti nuk po gjeneron të ardhura nga asetet e veta. Rritja e taksave në vitin 2025 ndikohet nga rritja e çmimeve te produkteve vendore si dhe atyre të importit.

Treguesi	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Shpenzimet totale	243.421	256.906	278.596	318.538	374.454	403.727
Rroga dhe kontribute	29.775	31.010	32.159	36.877	43.889	49.189
Pagesa e Penzioneve	60.216	62.289	67.567	77.967	90.646	106.515
Transfere sociale	117.799	121.439	131.758	148.866	170.027	193.296
Mallra dhe shërbime	15.423	20.110	21.001	21.117	22.923	28.025
Transfere në NJVL	21.373	21.218	23.365	27.459	30.781	33.516
Subvencione dhe transfere	34.905	30.635	32.536	27.754	33.324	31.734
Shpenzime kapitale	16.115	23.408	28.637	43.524	28.698	47.351
Shp.kapitale/Shp.totalex100	6,7%	9,1%	10,3%	13,7%	7,6%	11,7%

Shpenzimet - Struktura është jashtëzakonisht identike prej viti në vit ku pjesa dërrmuese e buxhetit shkon për "shpenzime të detyrueshme" (transfere sociale, roga, subvencione). Mbrojtje sociale përfshin 29% – 33% nga shuma e përgjithshme e shpenzimeve dhe kur shtohen edhe pagesat e pensioneve, pjesa që mbetet për politika zhvillimore dhe subvencionim të inovacioneve është minimale.

e. Si shpenzohen dhe sa janë efektive paratë e shpenzuara

Efikasiteti i parasë publike matet me atë se çfarë rezultati sjell çdo denar i harxhuar.

Buxheti i RMV-së për periudhën e analizuar ndan 31% - 33.1% vetëm për mbrojtjen sociale (pensionet, ndihmat, subvencione, etj.). Kjo është jetike për zbutjen e varfërisë, për sigurimin e paqes sociale, për rritjen e konsumit afatshkurtër, por nuk është gjenerator i rritjes ekonomike.

Shpenzimet për arsim mbeten të ndrydhura në nivelin 8.9% - 10.7%. Shpenzimet për arsim relativisht janë stabile, por fokus kryesor kanë pagat dhe mirëmbajtjen ndërsa investimet kapitale janë të kufizuara. Për arsim ka pak investim në cilësi (teknologji, laboratorë, reforma) dhe sistemi financohet për të funksionuar por jo për t'u transformuar. Në ekonominë moderne, zhvillimi ekonomik varet direkt nga kapitali njerëzor. Nivele kaq të ulëta dhe pa rritje reale tregojnë se vendi nuk po investon mjaftueshëm në ngritjen e cilësisë së fuqisë punëtore.

Shteti vazhdimisht mbledh më pak para se sa që shpenzon, duke krijuar deficit buxhetor rreth 40.000 milion denarë (me nivelin më të lartë prej 53.867 milion denarë në vitin 2020, si pasojë e pandemisë Covid 19). Fakti që ky deficit shkon kryesisht për të mbuluar shpenzimet korrente dhe transferet sociale (dhe jo për investime kapitale shtesë) do të thotë se paratë nuk po shpenzohen në mënyrë efektive. Po merret borxh për të konsumuar sot, duke ia lënë barrën e pagesës brezave të ardhshëm.

Sa i takon H1 -Dominimi i shpenzimeve korrente dhe transfereve sociale ndaj investimeve kapitale në buxhetin e Maqedonisë së Veriut kufizon potencialin e vendit për rritje ekonomike afatgjatë, vërtetohet plotësisht duke pasur parasysh vlerën e ulët të investimeve kapitale përball shpenzimeve korrente. Përqindja më e vogël e investimeve kapitale 6,7% ka ndodhur në vitin 2000, ndërsa më e larta 13,7% n2 vitin 2003. Pas një rrënje në vitin 2004 pasoi një rritje në 11,7% në vitin 2005, por në buxhetin e vitit 2026 është projektuar përsëri në zvogëlim i investimeve kapitale.

H2 - Mosrealizimi i plotë i investimeve kapitale të planifikuara (normat nën 100%) dëmton drejtpërdrejt efikasitetin e buxhetit si instrument gjenerues i zhvillimit ekonomik, po ashtu vërtetohet plotësisht pasi këtë e mbështesni me të dhënat e tabelës nr.1 ku pasqyrohet realizimi i shpenzimeve kapitale që variojnë nga 78% në 85%).

Ndërsa H3 - Deficiti i vazhdueshëm buxhetor në periudhën 2020-2025 përdoret kryesisht për të mbuluar shpenzimet e konsumit shtetëror (paga, sociale) dhe jo për krijimin e vlerës së shtuar në ekonomi po ashtu vërtetohet plotësisht duke analizuar që vlera e deficitit çdo vit është gati e barabartë ose më e madhe se totali i shpenzimeve kapitale, pra shteti merr borxh për të paguar shpenzime korrente.

Përfundim

Nga analiza e deritashme mund të konkludojmë se:

-Buxhetet e RMV-së karakterizohen nga një strukturë jo optimale të shpenzimeve ku dominojnë shpenzimet sociale dhe ato administrative ndaj atyre zhvillimore, prej ku buxheti e humbet funksionin e tij si instrument për zhvillim ekonomik afatgjatë

- Efikasiteti i shpenzimeve publike në RMV-së është në përmirësim, por jo optimal. Përmirësim të efikasitetit kemi sidomos pas vitit 2020, ku shpenzimet publike, respektivisht burimet ekzistuese, pësojnë një përdorim më të mirë. Në vitin vijues 2021/22 kemi stagnim sa i takon efikasitetit, ndërsa në vitin 2022/23 kemi një përmirësim real, në periudhën e ardhshme 2023/24 kemi një rrënje të lehtë dhe periudha e ardhshme 2024/25 ka menjëherë një rikthim pozitiv sa i takon efikasitetit të shfrytëzimit të shpenzimeve publike.

- Në buxhetet e analizuara (2020-2025) të RMV-së dominojnë shpenzimet jo-produktive veçanërisht transferet sociale dhe pensionet të cilat nuk krijojnë produktivitet, përkundrazi rritin konsumin dhe jo kapacitetin ekonomik.

- Investimet kapitale për shkak të realizimit jo të plot, janë jo stabile (të paqëndrueshme) nga viti në vit dhe kanë mungesë konsistence në politikat publike, shkaktojnë një progres të kufizuar dhe si rezultat kanë një ndikim modest në rritjen ekonomike.

-Pasi nuk ka transformim të thellë strukturor, nuk ka progres të qëndrueshëm strukturor, struktura aktuale e buxhetit kufizon potencialin për rritje afatgjatë.

- Buxhetet e RMV-së karakterizohen me deficit të vazhdueshëm që nënkupton financim të shpenzimeve me borxh, që zakonisht, paraqet rrezik për stabilitet fiskal afatgjatë.

Literatura

1. Abdylmenaf Bexheti, Financat publike, Tetovë, 2007.
2. Alqi Naqellari, Politikat ekonomike dhe ambienti politik shqiptar, Tiranë, 2010.
3. Alqi Naqellari, Politikat ekonomike Keynsianizmi-I, Tranë 2020.
4. Anastas Angjeli &Adrian Civici, Përballë Krizës, Tiranë, 2021.
5. Anastas Angjeli, Kriza ekonomike në kohën e koronavirusit, Tiranë, 2020.
6. Aristotel Pano & Anastas Angjeli, Ndërhyrja e shtetit në ekonomi, Tiranë, 2015.
7. Asim Stranjak, Monetarne financije, Mostar, 1979.
8. Dimitar Eftimoski, Ekonomija na razvojot, Shkup, 2003.
9. Edlira Luci&Dorina Kripa, Investime, Tiranë, 2007.

10. Greta Angjeli, Auditimi dhe qeverisja e mirë, Tiranë, 2014.
11. Gëzim Selimi, Planifikimi ekonomik, Strugë 2026.
12. Halit Xhafa&Beshir Ciceri, Drejtimi financiar 1, Tiranë 2003.
13. Halit Xhafa&Beshir Ciceri, Drejtimi financiar 2 Tiranë 2003.
14. I. Shuli&R. Perri, Analiza e pasqyrave financiare, Tiranë 2016.
15. Isa Mustafa, Menaxhmenti financiar, Prishtinë, 2007.
16. Margarita Janeska&Marjan Angeleski, Finansiska i aktuarska matematika, Prilep, 2009.
17. Metodija Nestorovski, Ekonomija na investiciite, Shkup, 2000.
18. Mishkin, Ekonomiksi, Prishtinë 2022.
19. Nazmi Iballi, Analiza financiare me auditim, Prishtinë 2019.
20. Sabahudin Komoni, Financat, Prishtinë 2009.
21. Sabri Kadriu, Financa publike, Prishtinë 2012
22. Selman Selmanaj, Sistemet ekonomike bashkëkohore, Prishtinë, 1996.
23. Sh.Jakupi & H. Shehu, Revizioni financiar, prishtinë 2011.
24. Spiro Brumbulli, Investimet, Tiranë 2002.
25. Ministria e financave – www.finance.gov.mk
26. Ministria e ekonomisë – www.economy.gov.mk
27. Banaka Popullore – www.nbrm.mk
28. Enti Shteteror për statistikë -www.stat.gov.mk
29. Statistikat rajonale dhe të përgjithshme – www.stat.mk
30. Drejtoria e te Hyrave Publike DHP – www.ujp.gov.mk
31. Faktor.mk; denar.mk; opserver.mk; scribd.com; capitalam.mk; epbih.ba; portalb.mk; prishtinaonline.com; Respublika.edu.mk; alfaz.mk;

ROLI I PROVAVE FORENZIKE NË PROCEDURËN PENALE

Prof. Dr. Emin Huseini

Doc. Dr. Robert Dauti

MSc. Abidin Trena

Abstrakt

Ky punim kërkimor shqyrton në mënyrë shteruese rolin kritik që luajnë provat forenzike në procedurën penale bashkëkohore, duke u fokusuar në integrimin e shkencës në sistemin e drejtësisë. Në një epokë ku metodat tradicionale të hetimit, si dëshmitë dhe pranimet e fajësisë, po e humbin peshën e tyre absolute përballë saktësisë shkencore, forenzika është shndërruar në mjetin kryesor për vërtetimin e fakteve juridikisht relevante. Analiza përfshin një vështrim të detajuar mbi llojet e provave biologjike, balistike dhe daktiloskopike, me një vëmendje të shtuar ndaj sfidave të reja që paraqet forenzika digjitale. Përmes studimit të legjislacionit në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, raporti analizon përputhshmërinë e procedurave vendase me standardet evropiane, rëndësinë e zinxhirit të ruajtjes së provës dhe integritetin e ekspertit mjeko-ligjor. Gjetjet tregojnë se suksesi i një procesi penal varet drejtpërdrejt nga cilësia e mbledhjes së provave në vendin e ngjarjes dhe nga aftësia e gjykatës për të interpretuar saktë konstatimet teknike. Raporti ofron një vlerësim të thellë të balancës mes efikasitetit të hetimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke propozuar rritjen e bashkëpunimit rajonal dhe investimet në teknologji për të garantuar një proces të rregullt ligjor.

Fjalët kyçe: *Forenzika, procedura penale, prova shkencore, forenzika dixhitale, ekspertiza gjyqësore.*

Hyrje

Procedura penale bashkëkohore mbështetet në një sistem të ndërlikuar provash, të cilat kanë për qëllim zbulimin e së vërtetës materiale dhe garantimin e një vendimmarrjeje të drejtë gjyqësore. Në këtë kuadër, provat forenzike kanë fituar një rëndësi të veçantë, duke u shndërruar në një nga mjetet më të besueshme për identifikimin e autorëve të veprave penale, zbardhjen e rrethanave të ngjarjes dhe sigurimin e fakteve relevante për procedurën penale. Zhvillimi i vazhdueshëm i shkencave forenzike dhe aplikimi i metodave moderne shkencore kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e efikasitetit të organeve të ndjekjes penale dhe të gjykatave në luftimin e kriminalitetit.

Provë forenzike konsiderohet çdo provë e përfituar përmes metodave dhe teknikave shkencore, e cila shërben për vërtetimin ose rrëzimin e fakteve që kanë rëndësi për procedurën penale. Këto prova përfshijnë ekspertizat biologjike, analizat e ADN-së, ekzaminimet daktiloskopike, ekspertizat balistike, analizat toksikologjike, ekspertizat digjitale dhe forma të tjera të hetimit shkencor. Për shkak të shkallës së lartë të saktësisë dhe objektivitetit, provat forenzike konsiderohen si një ndër instrumentet më efektive për sigurimin e drejtësisë penale dhe për minimizimin e rrezikut të gabimeve gjyqësore.

Rëndësia e provave forenzike nuk kufizohet vetëm në identifikimin e autorëve të veprave penale, por shtrihet edhe në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Përdorimi korrekt i ekspertizave forenzike kontribuon në respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, garantimin e së drejtës për mbrojtje dhe sigurimin e një procesi të rregullt ligjor. Në të njëjtën kohë, administrimi i këtyre provave kërkon respektimin e standardeve të larta procedurale, veçanërisht lidhur me mbledhjen, ruajtjen dhe paraqitjen e tyre para organeve kompetente.

Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Shqipëria kanë ndërtuar sisteme juridike dhe institucionale që njohin dhe rregullojnë përdorimin e provave forenzike në procedurën penale. Megjithëse këto shtete ndajnë tradita juridike të ngjashme dhe synime të përbashkëta për harmonizim me standardet evropiane, ekzistojnë dallime në organizimin e institucioneve forenzike, në kuadrin ligjor dhe në kapacitetet teknike të disponueshme për

zbatimin e ekspertizave shkencore. Analiza krahasuese e këtyre sistemeve ofron mundësinë për të identifikuar praktikat më të mira, sfidat ekzistuese dhe nevojën për reforma të mëtejshme në funksion të forcimit të sundimit të ligjit.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë rolin e provave forenzike në procedurën penale, duke shqyrtuar bazën teorike dhe juridike të tyre, rëndësinë që ato kanë në faza të ndryshme të procedimit penal dhe mënyrën e rregullimit të tyre në legjislacionin e Maqedonisë së Veriut, Kosovës dhe Shqipërisë. Përmes metodës krahasuese synohet të evidentohen ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet këtyre tre sistemeve juridike, si dhe të vlerësohet kontributi i provave forenzike në rritjen e efikasitetit të drejtësisë penale dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Kuadri teorik dhe juridik i provave forenzike në procedurën penale

Administrimi i drejtësisë penale në shtetet moderne mbështetet gjithnjë e më shumë në përdorimin e metodave shkencore për identifikimin, mbledhjen, analizimin dhe interpretimin e provave. Në këtë kontekst, provat forenzike përfaqësojnë një kategori të veçantë të mjeteve provuese, të cilat sigurojnë njohuri të specializuara shkencore mbi faktet relevante për procedurën penale. Vlera e tyre qëndron në aftësinë për të ofruar të dhëna objektive dhe të verifikueshme, duke reduktuar varësinë e procesit penal nga deklarimet subjektive të dëshmitarëve ose nga pranimi i fajësisë prej të pandehurit. Megjithatë, pretendimi se provat forenzike përfaqësojnë gjithmonë të vërtetën absolute është bërë objekt i kritikave të shumta në literaturën bashkëkohore juridike dhe kriminalistike, e cila thekson se rezultatet shkencore varen nga cilësia e mostrave, metodologjia e përdorur dhe kompetenca profesionale e ekspertëve.[1]

Nga këndvështrimi teorik, provat forenzike konsiderohen produkte të aplikimit të shkencës në funksion të procedurës penale. Ato përfshijnë analiza biologjike, gjenetike, daktiloskopike, balistike, toksikologjike, antropologjike dhe digjitale, të cilat shërbejnë për të vërtetuar ekzistencën ose mungesën e fakteve juridikisht relevante. Teoria moderne e provave i

[1] Paul C. Giannelli, Forensic Science: Why No Research?, Fordham Urban Law Journal, 2007

trajton këto mjete si burime të rëndësishme të njohurive, por jo si prova që gëzojnë epërsi automatike ndaj mjeteve të tjera provuese. Gjykata mbetet organi kompetent për të vlerësuar forcën provuese të ekspertizës në raport me tërësinë e materialit provues, në përputhje me parimin e vlerësimit të lirë të provave.[2]

Aspekti juridik i provave forenzike lidhet ngushtë me rregullat procedurale që garantojnë ligjshmërinë e sigurimit dhe përdorimit të tyre. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ekspertiza si mjet provues rregullohet nga dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, të cilat përcaktojnë kushtet për emërimin e ekspertëve, kryerjen e ekspertizës dhe paraqitjen e mendimit profesional para gjykatës.[3] Një qasje e ngjashme ndiqet edhe në Kosovë, ku ekspertiza konsiderohet veprim procedural i domosdoshëm kur vlerësimi i fakteve kërkon njohuri profesionale që tejkalojnë kompetencën e zakonshme të gjykatës dhe prokurorisë.[4] Në Shqipëri, ekspertimi rregullohet në mënyrë të detajuar dhe përbën një ndër mjetet më të rëndësishme të administrimit të provave në procedimin penal.[5]

Pavarësisht harmonizimit formal të legjislacionit me standardet evropiane, praktika ka treguar se sfidat kryesore lidhen me ruajtjen e integritetit të provave dhe garantimin e zinxhirit të posedimit. Çdo ndërprerje ose mangësi në dokumentimin e lëvizjes së provës nga momenti i zbulimit deri në paraqitjen e saj në gjykatë mund të cenojë besueshmërinë e saj dhe të krijojë dyshime të arsyeshme mbi autenticitetin e rezultateve. Për këtë arsye, standardet ndërkombëtare insistojnë në procedura rigoroze të dokumentimit dhe kontrollit të cilësisë gjatë gjithë procesit të ekzaminimit forenzik.[6]

Një tjetër dimension kritik lidhet me fenomenin e ashtuquajtur të pagabueshmërisë shkencore. Raportet e institucioneve ndërkombëtare kanë evidentuar se disa disiplina tradicionale forenzike nuk mbështeten gjithmonë në baza empirike të mjaftueshme dhe mund të prodhojnë rezultate të diskutueshme nëse nuk zbatohen standarde të unifikuara shkencore. Kjo

[2] Mirjan Damaška, Evidence Law Adrift, New Haven: Yale University Press, 1997
[3] Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare nr. 150/2010, nenet 234–252
[4] Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, nenet 137–149
[5] Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, nenet 178–191
[6] United Nations Office on Drugs and Crime, Criminalistics: Forensic Science and Crime Scene Investigation, New York: United Nations, 2009

është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur ekspertiza paraqitet si provë kyçe për shpalljen e fajësisë së një personi.[7] Për rrjedhojë, kuadri bashkëkohor juridik nuk duhet të kufizohet vetëm në njohjen formale të provave forenzike, por duhet të sigurojë mekanizma efektivë kontrolli, verifikimi dhe kundërshtimi të tyre, në mënyrë që përdorimi i shkencës në procedurën penale të mbetet në funksion të drejtësisë dhe jo të krijimit të një autoriteti të pakontestueshëm teknik.

Roli i provave forenzike në fazat e procedurës penale

Funksionimi efektiv i procedurës penale varet në masë të konsiderueshme nga aftësia e organeve kompetente për të siguruar dhe administruar prova të besueshme, të cilat mundësojnë zbardhjen e saktë të rrethanave të një vepre penale. Në këtë aspekt, provat forenzike luajnë rol të pazëvendësueshëm në të gjitha fazat e procedimit penal, duke filluar nga hetimi fillestar e deri te vendimmarrja përfundimtare e gjykatës. Rëndësia e tyre buron nga fakti se ato mbështeten në metoda shkencore të verifikueshme, të cilat synojnë të ofrojnë njohuri objektive mbi faktet që kanë rëndësi juridike për çështjen konkrete. Megjithatë, ndikimi i tyre në proces nuk është uniform në çdo fazë, pasi funksioni dhe pesha e tyre ndryshon në varësi të nevojave procedurale dhe standardeve të provimit që kërkohen.

Në fazën e hetimit paraprak, provat forenzike shërbejnë si instrument kyç për identifikimin e autorëve të mundshëm dhe për orientimin e veprimeve hetimore. Analizat biologjike, gjurmët daktiloskopike, ekzaminimet balistike dhe ekspertizat digjitale mundësojnë lidhjen e një personi me vendin e ngjarjes ose me objektet e përdorura gjatë kryerjes së veprës penale. Në shumë raste, këto prova krijojnë bazën faktike mbi të cilën prokuroria ndërton hipotezën hetimore dhe vendos për ndërmarrjen e veprimeve të mëtejshme procedurale. Megjithatë, literatura bashkëkohore thekson se ekziston rreziku që hetuesit t'u japin peshë të tepruar rezultateve fillestare të ekspertizës, duke neglizhuar mundësinë e interpretimeve alternative të të dhënave shkencore.[8]

[7] National Research Council, Strengthening Forensic Science in the United States: A Path Forward, Washington, D.C.: National Academies Press, 2009

[8] William C. Thompson and Simon A. Cole, "Psychological Aspects of Forensic Identification Evidence," Annual Review of Law and Social Science 2007

Gjatë fazës së ndjekjes penale, provat forenzike marrin një funksion më kompleks, pasi ato përdoren jo vetëm për të mbështetur akuzën, por edhe për të vlerësuar qëndrueshmërinë juridike të saj. Prokurori është i detyruar të sigurojë që ekspertizat janë kryer në përputhje me kërkesat procedurale dhe standardet shkencore të njohura, pasi çdo mangësi në këtë drejtim mund të ndikojë në pranueshmërinë e provës para gjykatës.[9] Njëkohësisht, mbrojtja gëzon të drejtën të kundërshtojë metodologjinë, kompetencën e ekspertit ose përfundimet e raportit forenzik, duke siguruar respektimin e parimit të barazisë së armëve në proces.[10]

Në fazën gjyqësore, provat forenzike paraqiten si pjesë e materialit provues që i nënshtrohet shqyrtimit kontradiktor. Edhe pse ekspertiza shkencore shpesh perceptohet si provë me shkallë të lartë besueshmërie, gjykata nuk është e detyruar të pranojë automatikisht përfundimet e ekspertit. Parimi i vlerësimit të lirë të provave kërkon që raporti forenzik të analizohet në lidhje me provat e tjera dhe me rrethanat konkrete të çështjes.[11] Pikërisht në këtë fazë shfaqet tensioni ndërmjet autoritetit shkencor dhe kompetencës gjyqësore, pasi gjyqtarët duhet të vlerësojnë prova që shpesh bazohen në njohuri teknike jashtë fushës së tyre profesionale.

Nga një perspektivë kritike, rritja e varësisë së sistemit penal nga ekspertizat forenzike ka krijuar edhe sfida të reja. Raporti i Akademisë Kombëtare të Shkencave të Shteteve të Bashkuara ka evidentuar mangësi metodologjike në disa disiplina forenzike dhe ka vënë në dyshim nivelin e validimit shkencor të praktikave të caktuara që përdoren rregullisht në gjykata.[12] Për më tepër, gabimet në mbledhjen, ruajtjen ose analizimin e provave mund të çojnë në dënime të padrejta ose në lirimin e autorëve realë të veprave penale. Kjo tregon se vlera e provave forenzike nuk qëndron vetëm në potencialin e tyre shkencor, por edhe në respektimin rigoroz të

[9] Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare nr. 150/2010, nenet 234–252
[10] Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, nenet 137–149
[11] Mirjan Damaška, Evidence Law Adrift, New Haven: Yale University Press, 1997
[12] National Research Council, Strengthening Forensic Science in the United States: A Path Forward, Washington, D.C.: National Academies Press, 2009

procedurave juridike që garantojnë integritetin dhe besueshmërinë e tyre gjatë gjithë rrjedhës së procedurës penale.[13]

Analizë krahasuese e sistemit të provave forenzike në Maqedoninë e Veriut, Kosovë dhe Shqipëri

Zhvillimi i shkencave forenzike ka ndikuar ndjeshëm në transformimin e sistemeve bashkëkohore të drejtësisë penale, duke i orientuar ato drejt përdorimit më të madh të metodave shkencore në procesin e provimit. Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Shqipëria kanë ndërtuar kuadro ligjore që njohin ekspertizën forenzike si një nga mjetet më të rëndësishme të sigurimit dhe administrimit të provave penale. Megjithëse të tre shtetet janë ndikuar nga tradita juridike kontinentale evropiane dhe kanë harmonizuar pjesërisht legjislacionin e tyre me standardet ndërkombëtare, dallimet në aspektin institucional, procedural dhe teknik vazhdojnë të jenë të dukshme.

Në aspektin normativ, sistemet juridike të të tre vendeve parashikojnë mundësinë e përdorimit të ekspertizave kur për vlerësimin e fakteve nevojiten njohuri të specializuara shkencore. Kodi i Procedurës Penale i Maqedonisë së Veriut përmban dispozita relativisht të detajuara lidhur me emërimin e ekspertëve, mënyrën e kryerjes së ekspertizës dhe paraqitjen e saj në procedurë.[14] Një rregullim i ngjashëm gjendet edhe në legjislacionin e Kosovës, ku ekspertiza trajtohet si veprim procedural i veçantë dhe si mjet provues me rëndësi të lartë për procesin penal.[15] Në Shqipëri, kuadri juridik ndjek të njëjtën logjikë procedurale, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e ekspertëve, si dhe mënyrën e administrimit të ekspertimit në procesin penal.[16]

Megjithatë, ngjashmëritë ligjore nuk reflektohen gjithmonë në të njëjtin nivel të kapaciteteve institucionale. Maqedonia e Veriut ka investuar në zhvillimin e laboratorëve kriminalistikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ka avancuar në përdorimin e analizave gjenetike dhe databazave kriminalistike. Kosova, ndonëse ka bërë progres të

[13] United Nations Office on Drugs and Crime, Criminalistics: Forensic Science and Crime Scene Investigation, New York: United Nations, 2009
[14] Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare nr. 150/2010, nenet 234–252
[15] Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, nenet 137–149
[16] Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, nenet 178–191

konsiderueshëm në ngritjen e kapaciteteve të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, vazhdon të përballet me kufizime në burime njerëzore dhe teknologjike për disa kategori të ekspertizave të specializuara. Shqipëria ka zhvilluar Institutin e Policisë Shkencore si institucion qendror në këtë fushë, por literatura profesionale dhe raportet ndërkombëtare kanë evidentuar nevojën për investime të mëtejshme në pajisje moderne dhe trajnime të vazhdueshme të personelit.[17]

Një aspekt me rëndësi të veçantë krahasuese lidhet me pavarësinë dhe objektivitetin e ekspertizës forenzike. Në të tre shtetet, shumica e institucioneve forenzike funksionojnë brenda strukturave shtetërore të sigurisë ose organeve të zbatimit të ligjit. Kjo situatë ka ngritur shqetësime në literaturën juridike lidhur me perceptimin e pavarësisë së ekspertëve dhe me mundësinë e ndikimit institucional në procesin e prodhimit të provës shkencore.[18] Edhe pse legjislacionet respektive garantojnë formalitetin e paanshmërisë së ekspertit, praktika tregon se mbrojtja shpesh përballet me vështirësi në sigurimin e ekspertizave alternative ose të kundërta.

Nga këndvështrimi i standardeve ndërkombëtare, të tre vendet synojnë harmonizimin me kërkesat evropiane në fushën e administrimit të provave shkencore. Megjithatë, ekzistojnë dallime në nivelin e akreditimit të laboratorëve, në procedurat e kontrollit të cilësisë dhe në zbatimin e standardeve teknike ndërkombëtare. Raportet ndërkombëtare vazhdimisht theksojnë se besueshmëria e provave forenzike nuk varet vetëm nga ekzistenca e normave juridike, por edhe nga kapaciteti institucional për t'i zbatuar ato në mënyrë konsistente dhe transparente.[19] Për këtë arsye, sfida kryesore për Maqedoninë e Veriut, Kosovën dhe Shqipërinë nuk lidhet më me mungesën e bazës ligjore, por me nevojën për forcimin e pavarësisë profesionale, modernizimin teknologjik dhe ngritjen e mekanizmave efektivë të kontrollit shkencor, të cilët do të garantonin një përdorim më të sigurt dhe më të besueshëm të provave forenzike në procedurën penale.

[17] European Commission, Albania Report 2024, Brussels: European Commission, 2024
[18] Nigel Fielding, Raymond M. Lee and Grant Blank, The Sage Handbook of Online Research Methods, London: Sage Publications, 2017
[19] European Network of Forensic Science Institutes, Guidance on the Management of Crime Scene Investigation, Wiesbaden: European Network of Forensic Science Institutes, 2023

Perfundim

Provat forenzike përfaqësojnë një nga elementet më të rëndësishme të procedurës penale bashkëkohore, pasi ato mundësojnë identifikimin, dokumentimin dhe vërtetimin e fakteve relevante për zgjidhjen e çështjeve penale nëpërmjet metodave shkencore. Rëndësia e tyre është veçanërisht e dukshme në kushtet e zhvillimit të kriminalitetit modern, ku format e reja të veprave penale kërkojnë përdorimin e teknikave gjithnjë e më të avancuara të hetimit dhe analizës. Në këtë kuptim, shkencat forenzike kanë kontribuar ndjeshëm në rritjen e efikasitetit të organeve të ndjekjes penale, në forcimin e kapaciteteve hetimore dhe në përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes gjyqësore.

Analiza e kuadrit teorik dhe juridik ka treguar se provat forenzike nuk duhet të konsiderohen vetëm si produkte të shkencës, por edhe si kategori juridike që i nënshtrohen rregullave të caktuara procedurale. Besueshmëria e tyre nuk varet vetëm nga saktësia e metodave shkencore të përdorura, por edhe nga respektimi i standardeve ligjore që lidhen me mbledhjen, ruajtjen, analizimin dhe administrimin e provave. Për këtë arsye, integriteti i procesit forenzik përbën një kusht thelbësor për garantimin e vlefshmërisë dhe forcës provuese të rezultateve të ekspertizës.

Shqyrtimi i rolit të provave forenzike në faza të ndryshme të procedurës penale ka evidentuar se ato kanë ndikim të drejtpërdrejtë në orientimin e hetimeve, mbështetjen e akuzës, realizimin e të drejtës së mbrojtjes dhe formimin e bindjes së gjykatës. Megjithatë, përdorimi i tyre kërkon një qasje të kujdesshme dhe kritike, pasi edhe provat me bazë shkencore mund të jenë të cenueshme nga gabimet metodologjike, mangësitë teknike ose interpretimet e pasakta. Për rrjedhojë, ekspertiza forenzike nuk duhet të trajtohet si provë e pakontestueshme, por si pjesë e tërësisë së materialit provues që i nënshtrohet vlerësimit gjyqësor.

Vështrimi krahasues ndërmjet Maqedonisë së Veriut, Kosovës dhe Shqipërisë ka treguar se të tri shtetet disponojnë baza ligjore relativisht të harmonizuara për përdorimin e provave forenzike dhe ndjekin standarde të ngjashme procedurale. Megjithatë, dallimet vazhdojnë të ekzistojnë në aspektin e kapaciteteve institucionale, nivelit të zhvillimit teknologjik, akreditimit të laboratorëve dhe pavarësisë funksionale të ekspertëve. Këto

dallime ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë dhe efektivitetin e përdorimit të provave forenzike në praktikën gjyqësore.

Në perspektivë, forcimi i sistemit të provave forenzike në të tri vendet kërkon investime të vazhdueshme në infrastrukturë teknologjike, specializim profesional të ekspertëve, akreditim sipas standardeve ndërkombëtare dhe zhvillim të mekanizmave të pavarur të kontrollit të cilësisë. Vetëm përmes kombinimit të garancive juridike me standardet më të avancuara shkencore mund të sigurohet që provat forenzike të vazhdojnë të shërbejnë si një instrument i besueshëm në funksion të zbulimit të së vërtetës, mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe realizimit të drejtësisë penale.

Literatura

1. Paul C. Giannelli, Forensic Science: Why No Research?, Fordham Urban Law Journal, 2007
2. Mirjan Damaška, Evidence Law Adrift, New Haven: Yale University Press, 1997
3. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare nr. 150/2010, nenet 234–252
4. Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, nenet 137–149
5. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, nenet 178–191
6. United Nations Office on Drugs and Crime, Criminalistics: Forensic Science and Crime Scene Investigation, New York: United Nations, 2009
7. National Research Council, Strengthening Forensic Science in the United States: A Path Forward, Washington, D.C.: National Academies Press, 2009
8. William C. Thompson and Simon A. Cole, "Psychological Aspects of Forensic Identification Evidence," Annual Review of Law and Social Science 2007
9. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare nr. 150/2010, nenet 234–252
10. Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, nenet 137–149
11. Mirjan Damaška, Evidence Law Adrift, New Haven: Yale University Press, 1997
12. National Research Council, Strengthening Forensic Science in the United States: A Path Forward, Washington, D.C.: National Academies Press, 2009

13. United Nations Office on Drugs and Crime, Criminalistics: Forensic Science and Crime Scene Investigation, New York: United Nations, 2009
14. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare nr. 150/2010, nenet 234–252
15. Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, nenet 137–149
16. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, nenet 178–191
17. European Commission, Albania Report 2024, Brussels: European Commission, 2024
18. Nigel Fielding, Raymond M. Lee and Grant Blank, The Sage Handbook of Online Research Methods, London: Sage Publications, 2017
19. European Network of Forensic Science Institutes, Guidance on the Management of Crime Scene Investigation, Wiesbaden: European Network of Forensic Science Institutes, 2023

ROLI I DIPLOMACISË NË PARANDALIMIN E KONFLIKTEVE NDËRKOMBËTARE

MSc.Djellza Lena

Abstrakt

Ky punim trajton rolin e diplomacisë në parandalimin e konflikteve ndërkombëtare, duke analizuar konceptin, evoluimin historik dhe format kryesore të saj në kontekstin bashkëkohor. Diplomacia paraqitet si një instrument thelbësor i politikës së jashtme, i cili mundëson menaxhimin paqësor të marrëdhënieve ndërmjet shteteve përmes dialogut, negociatave dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur dhe shpesh të tensionuar, diplomacia mbetet një nga mjetet më të rëndësishme për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit ndërkombëtar. Ky punim synon të analizojë rolin e diplomacisë në parandalimin e konflikteve ndërkombëtare, duke u fokusuar jo vetëm në aspektin teorik, por edhe në rëndësinë e saj praktike në jetën e përditshme të shteteve dhe shoqërive.Nga analiza e rolit të negociatorëve, ndërmjetësimit dhe organizatave ndërkombëtare,punimi thekson se parandalimi i konflikteve nuk është vetëm një objektiv strategjik, por edhe një domosdoshmëri njerëzore.

Në këtë kuadër, punimi shqyrton zhvillimin e diplomacisë nga format e hershme deri te diplomacia moderne dhe digjitale, duke theksuar transformimet që ka pësuar si rezultat i globalizimit dhe përparimeve teknologjike. Gjithashtu, analizohen llojet kryesore të diplomacisë, si ajo bilaterale, multilaterale dhe publike, si dhe roli i tyre në adresimin e sfidave globale. Nëpërmjet analizës së rolit të negociatave, ndërmjetësimit dhe organizatave ndërkombëtare, punimi thekson se parandalimi i konflikteve nuk është vetëm një objektiv strategjik, por edhe një domosdoshmëri njerëzore.

Fjalë kyçe: *Diplomacia, konfliktet ndërkombëtare, parandalimi i konflikteve, marrëdhëniet ndërkombëtare, negociatat, stabiliteti global.*

Hyrje

Në marrëdhëniet ndërkombëtare, diplomacia ka qenë dhe mbetet një nga instrumentet më të rëndësishme për ruajtjen e paqes dhe shmangien e konflikteve të armatosura. Në një botë ku shtetet janë gjithnjë e më të ndërlidhura, por njëkohësisht edhe të ekspozuara ndaj tensioneve politike, ekonomike dhe gjeopolitike, diplomacia paraqitet si ura kryesore e komunikimit dhe mirëkuptimit ndërmjet popujve dhe qeverive. Ajo nuk është vetëm një proces formal mes institucioneve shtetërore, por edhe një mënyrë për të ndërtuar besim, për të parandaluar keqkuptimet dhe për të gjetur zgjidhje paqësore në situata komplekse ndërkombëtare.

Zgjedhja e kësaj teme nuk është e rastësishme. Ajo vjen nga interesi për të kuptuar më thellë se si vendimet politike dhe proceset diplomatike ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e njerëzve, shpesh duke përcaktuar nëse një shoqëri do të jetojë në paqe apo në konflikt. Konfliktet e ndryshme në botë, por edhe përpjekjet e vazhdueshme për dialog dhe marrëveshje, tregojnë se diplomacia nuk është thjesht teori, por një realitet që ka pasoja konkrete njerëzore, sociale dhe ekonomike. Në këtë kuptim, kjo temë ka një dimension jo vetëm akademik, por edhe human, pasi lidhet me jetën, sigurinë dhe të ardhmen e individëve dhe komuniteteve.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë rolin e diplomacisë në parandalimin e konflikteve ndërkombëtare, duke u fokusuar në format e saj kryesore si diplomacia bilaterale, multilaterale dhe publike, si dhe në aplikimin e saj në rajone të ndryshme të botës. Përmes kësaj analize synohet të kuptohet se si mekanizmat diplomatikë kontribuojnë në ruajtjen e stabilitetit global dhe në ndërtimin e marrëdhënieve të qëndrueshme ndërmjet shteteve. Punimi gjithashtu synon të nxjerrë në pah sfidat që e shoqërojnë diplomacinë në kohët moderne, veçanërisht në një sistem ndërkombëtar gjithnjë e më kompleks dhe dinamik.

Në këtë mënyrë, ky studim përpiqet të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar mbi rëndësinë e diplomacisë, duke e trajtuar atë si një mjet të domosdoshëm për paqen dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, por edhe si një proces që kërkon vazhdimisht përshtatje dhe zhvillim në përputhje me sfidat e kohës.

Kuptimi dhe Evoluimi i Diplomacisë

Përkufizimi i diplomacisë

Diplomacia përkufizohet si procesi përmes të cilit shtetet dhe aktorët ndërkombëtarë menaxhojnë marrëdhëniet e tyre në mënyrë paqësore, duke përdorur mjete si negociatat, dialogu dhe marrëveshjet ndërkombëtare[1]. Ajo konsiderohet një nga instrumentet kryesore të politikës së jashtme, që synon mbrojtjen e interesave kombëtare pa përdorimin e forcës[2].

Diplomacia është aplikim i inteligjencës dhe taktit në rregullimin e marrëdhënieve zyrtare midis qeverive të shteteve të pavaruara(Satow).Ajo është shkencë mbi marrëdhëniet ose punët e jashtme të shteteve, shkencë ose art i bisedimeve. Sipas John R.Wood-it diplomacia është art i zgjedhjes së vështirësive ndërkombëtare në mënyrë paqësore. Ajo është njëkohësisht teknikë ose mjeshtri që mbretron në zhvillimin harmonik të marrëdhënieve ndërkombëtare.[3] Promovimi i imazhit të shtetit, zgjerimi dhe ndikimi i opinionit publik gjë e cila realizohet nëpërmjet medias, komunikimit strategjik që sendërtohen të gjitha këto marrëdhënie pozitive, realizohen nëpërmjet diplomacisë publike.

Fjala diplomaci origjinën e vet e ka nga fjala e greqishtes së vjetër diploma, e cila ishte nje dokument i shkruar në dy faqe të lidhura, që është dhënë kryesuesit të misionit dhe ka përmbajtur instruksione,qëllimet e misionit. Me termin diplomatikë duhet të nënkuptuar koleksionin e dokumenteve origjinale shtetërore që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërkombëtare.Trupi dipomatik është tërësia e përfaqësuesve zyrtar të huaj në një shtet (ambasadorët, të dërguarit dhe personat e ngarkuar të misioneve të huaja me seli në vendin e një qeverie). Shërbimi diplomatik është një pjesë e shërbimit të posaçëm publik, i cili i furnizon misionet e përhershme në shtetet e jashtme me personel. Diplomatët janë anëtarët e këtij trupi ose çdo nëpunës publik i cili punon në punë diplomatike(në ministri të punëve të jashtme,ambasadë ose përfaqësi tjetër diplomatike).[4]

[1] Berridge, G.R., *Diplomacy: Theory and Practice*, 2015.
[2] Morgenthau, H., *Politics Among Nations*, 2006.
[3] Zejnullah Gruda, E drejta ndërkombëtare publike fq.247
[4] Zejnullah Gruda, E drejta ndërkombëtare publike fq.248

Zhvillimi historik i diplomacisë

Diplomacia ka një histori të gjatë që daton që në qytetërimet e lashta, ku shtetet përdornin përfaqësues për të komunikuar dhe për të ruajtur marrëdhënie me njëra-tjetrën[5]. Në Greqinë e lashtë dhe në Perandorinë Romake, dërgimi i ambasadorëve ishte një praktikë e zakonshme për negocimin e paqes dhe aleancave.[6] Gjatë mesjetës diplomacia ishte më pak e institucionalizuar dhe shpesh lidhej me misione të përkohshme diplomatike, edhe pse një zhvillim i rëndësishëm ndodhi gjatë Rilindjes në Itali, ku u krijuan për here të pare ambasadat e përhershme,duke vendosur bazat e diplomacisë moderne.[7]

Pas Luftës së dytë botërore Komisioni i së drejtës Ndërkombëtare çështjen e kodifikimit të së drejtës diplomatike e ka përfshirë si çështje të rëndësishme dhe në bazë të projektit të tij, më 1961, është miratuar Konventa mbi Marrëdhëniet Diplomatike. Me miratimin e Konventave të Vjenës mund të thuhet se ka përfunduar me sukses përpjekja që të jepet version i kodifikuar i rregullave ekzistuese që miratohen nga shumica e shteteve.Për më tepër, konventat përfaqësojnë zhvillimin progesiv të së drejtës diplomatike dhe konsullore. Shtetet nuk janë të detyruara të dërgojnë ose të pranojn përfaqësues diplomatikë. Para se të vendosen marrëdhëniet diplomatike duhet të bëhet njohja diplomatike midis dy qeverive. Kjo në disa raste sendërtohet me marrjen e vendimit për hyrje në marrëdhënie diplomatike.Konventa e Vjenës, në nenin 2, parasheh shprehimisht që vendosja e marrëdhënieve diplomatike në mes shteteve, dhe dërgimi i misioneve të përhershme diplomatike, bëhet në bazë të pajtimit reciprok.[8]

Një dimension më të madh dhe të ri diplomacia e mori për shkak të krijimit të organizatave ndërkombëtare, ku rëndësia e bashkëpunimit multilateral u arrit fal Organizatës së Kombete të Bashkuara (OKB) .

Llojet e diplomacisë

Në varësi nga mënyra e zhvillimit dhe aktorëve të përfshirë, kemi disa lloje të diplomacisë:

[5] Hamilton, K. & Langhorne, R., *The Practice of Diplomacy*, 2011.
[6] Nicolson, H., *Diplomacy*, 2001.
[7] Mattingly, G., *Renaissance Diplomacy*, 1988.
[8] Zejnullah Gruda, E drejta ndërkombëtare publike fq.248-249

Diplomacia bilateral-është forma më tradicionale e diplomacisë sepse i referohet marrëdhënieve midis dy shteteve, që është themeluar mbi parimin e reciprocitetit dhe barazisë juridike ndërmjet shteteve për të patur mundësin e komunikimit për cështjet e tyre të përbashkëta.[9] Kjo formë e diplomacisë realizohet përmes përfaqësive diplomatike, si dhe ambasadat dhe konsullatat sepse këta kanë rol kryesor në përfaqësimin e interesave të shtetit të tyre, në aspekt politik, ekonomik, kulturor si dhe në mbrojtjen e shtetasve jashtë vendit. Negociojnë për marrëveshjet që i përkasin fushave të ndryshme si tregtia siguria, bashkëpunimi ekonomik, arsimor, kulturor.Megjithatë, diplomacia bilaterale nuk është pa sfida, mund të ndikohet nga pabarazitë e fuqisë ndërmjet shteteve,interesat e kundërta dhe ndryshimet në sistemet politike po kulturore[10].

Diplomacia bilaterale vazhdon të mbetet një instrument i pazëvendësueshëm dhe i rëndësishëm sepse të jep mundësinë e fleksibilitetit dhe efikasitetit në vendimmarrje, duke kontribuar kështu në ruajtjen e paqes, zhvillimin e bashkëpunimit dhe zgjidhjen e konflikteve në mënyrë paqësore.

Diplomacia multilaterale- është forma e cila zhvillohet ndërmjet më shumë se dy shteteve dhe zakonisht realizohet në kuadër të organizatave ndërkombëtare. Kjo formë e diplomacisë ka fituar rëndësi të veçantë në sistemin bashkëkohor ndërkombëtar, ku shumë nga sfidat kryesore – si siguria globale, ndryshimet klimatike dhe zhvillimi ekonomik – kërkojnë bashkëpunim të gjerë ndërkombëtar.[11] Një nga platformat më të rëndësishme të diplomacisë multilaterale është Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), e cila shërben si forum global për diskutimin dhe zgjidhjen e çështjeve ndërkombëtare[12]. Përmes organeve të saj, si Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli i Sigurimit, shtetet kanë mundësi të shprehin qëndrimet e tyre dhe të kontribuojnë në vendimmarrje kolektive[13]. Përveç OKB-së, edhe organizata të tjera si Bashkimi Evropian (BE), NATO dhe Organizata Botërore e Tregtisë (OBT) luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e diplomacisë multilaterale. Diplomacia multilaterale ka një funksion kyç në adresimin e problemeve globale përmes bashkëpunimit dhe

[9] Morgenthau, H., *Politics Among Nations*, 2006.
[10] Melissen, J., *The New Public Diplomacy*, 2005.
[11] Keohane, R., *International Institutions*, 1989.
[12] United Nations, *Charter of the United Nations*, 1945
[13] Weiss, T.G., *What's Wrong with the United Nations*, 2012.

koordinimit ndërkombëtar. Por, edhe diplomacia multilateral përballet me sfida të ndryshme ku një ndër to është vështirësia në arritjen e konsesusit për shkak të interesave të ndryshme, për shkak të burokracisë proceset në organizatat multilaterale mund të jenë të ngadalta por tek procesi vendimmarrjes mund të ndikoje edhe pabarazia e fuqisë ndërmjet shteteve, ku vendet më të fuqishme kanë shpesh ndikim më të madh në vendimmarrje.

Diplomacia multilateral përfaqëson një shtyllë kryesore të rendit ndërkombëtar modern, duke ofruar një hapësirë për dialog, bashkëpunim dhe zgjidhje kolektive të sfidave globale.[14]

Diplomacia publike- Ndryshe nga diplomacia tradicionale, e cila zhvillohet kryesisht në nivele zyrtare ndërmjet qeverive, diplomacia publike synon të komunikojë drejtpërdrejt me qytetarët e vendeve të tjera, duke përdorur mjete të ndryshme kulturore, informative dhe mediatike.[15]

Një nga instrumentet kryesore të diplomacisë publike është komunikimi strategjik, i cili përfshin përdorimin e mediave tradicionale dhe atyre digjitale për të shpërndarë informacione dhe për të ndikuar në perceptimet e publikut ndërkombëtar. Në këtë kontekst, rrjetet sociale kanë marrë një rol të rëndësishëm, duke u bërë platforma kyçe për komunikimin e drejtpërdrejtë të institucioneve shtetërore me audiencën globale[16]. Diplomacia publike që të krijojë lidhje afatgjate ndërmjet shoqërive të ndryshme përdor programe shkëmbimi kulturor dhe arsimor ku shtetet përmes bursave, projekteve kulturore dhe bashkëpunimeve akademike kontribojnë në ndërtimin e besimit ndërkombëtar. Rol të rëndësishëm këtu luajnë edhe institucionet kulturore dhe organizatat joqeveritare.Diplomacia publike përballet me sfida të shumta në epokën moderne, veçanërisht për shkak të përhapjes së dezinformimit dhe manipulimit të informacionit në hapësirën digjitale. Në këto kushte, ruajtja e besueshmërisë dhe transparencës bëhet thelbësore për efektivitetin e saj.[17].

Diplomacia publike përfaqëson një instrument të rëndësishëm për ndërtimin e marrëdhënieve ndërkombëtare të qëndrueshme, duke kontribuar

[14] Berridge, G.R., 2015.
[15] Arben Puto, *E Drejta Ndërkombëtare Publike*, Tiranë, 2010.
[16] Fatos Tarifa, 2008.
[17] Daut Dauti, 2010.

në promovimin e dialogut, mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërmjet popujve.[18]

Funksionet e përfaqësuesit diplomatik

Përkundër përpjekjeve të cilat janë bërë, ende nuk egziston një unanimitet i plotë përkitazi me funksionet kryesore të përfaqësuesit diplomatik. Numri i tyre gjithnjë ka ardhur duke u shtuar, kurse në ditët e sotme, si rezultat i një zhvillimi shumë të hovshëm,atyre u mvishet detyra që të përparojnë marrëdhëniet tregtare, marrëdhëniet me mjetet e informimit dhe marrëdhëniet publike në përgjithsi. Duhet thënë se ekzistojnë edhe disa lëmenj të cilët kanë mbetur të rregullohen me marrëveshje në mes shteteve.[19] Konventa e Vjenës, duke u përpjekur që ti precizojë detyra e përfaqësuesve diplomatikë, ka vënë në plan të parëpesë funksione kryesore. Sipas nenit 3 të Konventës, funksionet e misionit diplomatic janë:

Përfaqësimi i shtetit i cili akrediton në shtetin ku janë akredituar

Mbrojtja e interesave të shtetit i cili i ka akredituar dhe të shtetasve të tij në shtetin ku janë akredituar, brenda kufijve që e lejon e drejta ndërkombëtare

Bisedimet me qeverinë e shtetit ku janë akredituar

Informimi me të gjitha mjetet e lejuara mbi kushtet dhe zhvillimin e ngjarjeve në shtetin ku janë akredituar dhe dhënien e raporteve mbi këto të qeverisë sl shtetit i cili ka akredituar

Përparimi i marrëdhënieve miqësore dhe zhvillimi i marrëdhënieve ekonomike, kulturore e shkencore midis shtetit që akrediton dhe shtetit ku janë akredituar.[20]

Mënyra e të ushtruarit të funksionit

Konventa e Vjenës,neni 41 parasheh se të gjithë personat që gëzojnë privilegjet dhe imunitet janë të detyruara ti respektojnë ligjet dhe rregullat e shtetit në të cilin janë akredituar.Është thënë shprehimisht se këta persona janë të detyruar që të mos përzihen në punët e brendshme të shtetit ku janë

[18] Arben Puto, 2010.
[19] Zejnullah Gruda, E drejta ndërkombëtare Publike fq.256
[20] Zejnullah Gruda, E drejta ndërkombëtare Publike fq.256

akredituar.Parimisht, ministria e punëve të jashtme është kanali i vetëm i komunikimit nëpërmes të të cilit misioni diplomatik ushtron punët e veta.Kështu, çështjet e politikës së jashtme mbesin në kompetencë të ministrisë së punëve të jashtme.Mirëpo, pranohet që për çështje të caktuara dhe materie speciale të autorizohen organet e tjera të qeverisë të një shteti.[21]

Shembuj Aktualë të Diplomacisë në Parandalimin e Konflikteve

Roli i diplomacisë në konfliktin Rusi-Ukrainë

Konflikti ndërmjet Rusisë dhe Ukrainës përfaqëson një nga zhvillimet më të rëndësishme gjeopolitike të kohës moderne, i cili ka nxjerrë në pah rëndësinë dhe njëkohësisht kufizimet e diplomacisë në parandalimin e konflikteve ndërkombëtare[22]. Ky konflikt ka filluar të intensifikohet që nga viti 2014, me aneksimin e Krimesë nga Rusia dhe përshkallëzimin e tensioneve në lindje të Ukrainës, duke kulmuar me ndërhyrjen ushtarake të vitit 2022.

Në këtë kontekst, diplomacia është përdorur si një mjet kryesor për të menaxhuar krizën dhe për të shmangur përhapjen e saj në një konflikt më të gjerë ndërkombëtar. Një nga përpjekjet më të rëndësishme diplomatike kanë qenë Marrëveshjet e Minskut, të ndërmjetësuara nga aktorë ndërkombëtarë, të cilat synonin arritjen e armëpushimit dhe stabilizimin e situatës[23]. Të githa këto përfshijnë masa konkrete si ndalimi i luftimeve, tërheqja e armëve të rënda dhe zhvillimi i dialogut politik ndërmjet palëve. Përveç negociatave direkte, rol të rëndësishëm në këtë konflikt ka luajtur edhe diplomacia multilaterale, përmes organizatave ndërkombëtare si Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. Këto institucione kanë ndërmarrë iniciativa për të dënuar veprimet ushtarake, për të vendosur sanksione dhe për të nxitur dialogun ndërmjet palëve[24].

Mund të theksohet se diplomacia në konfliktin Rusi–Ukrainë ka luajtur një rol të rëndësishëm në menaxhimin e krizës dhe në parandalimin e përshkallëzimit të mëtejshëm, por nuk ka arritur të sigurojë një zgjidhje

[21] Zejnullah Gruda, E drejta ndërkombëtare Publike fq.257
[22] Fatos Tarifa, *Marrëdhëniet Ndërkombëtare*, Tiranë, 2008.
[23] Enver Hasani, *E Drejta Ndërkombëtare*, Prishtinë, 2013.
[24] Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Studime për Marrëdhëniet Ndërkombëtare*, Tiranë, 2015.

përfundimtare të konfliktit.[25] Kjo dëshmon se diplomacia është një instrument thelbësor, por efektiviteti i saj varet nga faktorë të tjerë si balanca e fuqisë, interesat strategjike dhe gatishmëria e palëve për kompromis.

Negociatat ndërkombëtar në Lindjen e Mesme

Konflikti izraelito-palestinez si një ndër çështjet më të gjata dhe më të ndërlikuara ka qenë në qendër të përpjekjeve diplomatike për dekada duke qenë se është një nga proceset më të ndërlikuara sa i përket diplomacisë bashkëkohore.

Një nga momentet më të rëndësishme në këtë drejtim ka qenë arritja e Marrëveshjeve të Oslos në vitin 1993, të cilat synonin krijimin e një kuadri për vetëqeverisjen palestineze dhe njohjen reciproke ndërmjet palëve. Megjithatë, pavarësisht progresit fillestar, negociatat kanë hasur në pengesa të shumta, duke përfshirë mungesën e besimit ndërmjet palëve dhe ndryshimet në balancën politike rajonale. Diplomacia multilaterale ka luajtur gjithashtu një rol të rëndësishëm përmes përfshirjes së aktorëve si Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Rusia, por efektiviteti i këtyre përpjekjeve ka qenë i kufizuar për shkak të interesave të ndryshme strategjike dhe mungesës së konsensusit ndërkombëtar.[26]

Negociatat ndërkombëtare në Lindjen e Mesme tregojnë se diplomacia mbetet një instrument i domosdoshëm për menaxhimin e konflikteve, por suksesi i saj varet nga vullneti politik i palëve dhe mbështetja e koordinuar ndërkombëtare.

Diplomacia në Ballkanin Perëndimor

Diplomacia në Ballkanin Perëndimor ka marrë një rol të rëndësishëm në periudhën pas përfundimit të konflikteve të viteve 1990, duke u përqendruar kryesisht në stabilizimin politik dhe ndërtimin e institucioneve demokratike. Pas shpërbërjes së Jugosllavisë, rajoni u përball me konflikte të armatosura që kërkuan ndërhyrje dhe ndërmjetësim të fuqishëm

[25] Freedman, Lawrence, *Ukraine and the Art of Strategy*, Oxford University Press, 2019, fq. 210–215.

[26] Oslo Accords, *Declaration of Principles on Interim Self-Government Arrangements*, 1993; Quandt, William B., *Peace Process: American Diplomacy and the Arab-Israeli Conflict since 1967*, Brookings Institution Press, 2005, fq. 3–15; Shlaim, Avi, *The Iron Wall: Israel and the Arab World*, W.W. Norton & Company, 2014, fq. 600–610; Cleveland, William L. & Bunton, Martin, *A History of the Modern Middle East*, Westview Press, 2016, fq. 350–370.

ndërkombëtar. Në këtë kontekst, diplomacia u përdor si mjet kryesor për arritjen e marrëveshjeve të paqes dhe për krijimin e kushteve për bashkëjetesë ndërmjet komuniteteve etnike.[27]

Një nga aktorët më të rëndësishëm në këtë proces ka qenë European Union, i cili përmes politikës së zgjerimit dhe Procesit të Stabilizim-Asociimit ka ndikuar në transformimin e vendeve të rajonit. Bashkimi Evropian ka përdorur diplomacinë si instrument për të nxitur reformat politike, forcimin e shtetit ligjor dhe bashkëpunimin rajonal, duke vendosur kushte të qarta për integrimin e vendeve të Ballkanit në strukturat evropiane[28]. Përveç Bashkimit Evropian, një rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe NATO dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, veçanërisht në garantimin e sigurisë dhe stabilitetit në rajon. Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë në vitin 1999 dhe prania e vazhdueshme ndërkombëtare në Bosnje dhe Hercegovinë kanë qenë vendimtare për parandalimin e përshkallëzimit të konflikteve dhe për krijimin e një ambienti më të sigurt për zhvillimin politik dhe ekonomik.[29]Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme diplomatike, Ballkani Perëndimor vazhdon të përballet me sfida të shumta, përfshirë tensionet etnike, ndikimin e fuqive të jashtme dhe ritmin e ngadaltë të reformave. Këto faktorë e bëjnë diplomacinë një proces të vazhdueshëm dhe kompleks, ku bashkëpunimi ndërkombëtar mbetet thelbësor për sigurimin e paqes dhe stabilitetit afatgjatë në rajon.[30]

Analizë kritike e rasteve

Nga rastet e mësipërme nënkuptojmë se diplomacia mbetet një instrument thelbësor në parandalimin dhe menaxhimin e konflikteve ndërkombëtare, por efektiviteti i saj ka të bëjë me vullnetin politik të palëve, mbështetja ndërkombëtare dhe ekzistenca e mekanizmave institucionalë për zbatimin e marrëveshjeve.

Në rastin e konfliktit Rusi-Ukrainë, diplomacia ka qenë e kufizuar nga interesat strategjike të fuqive të mëdha, që ndikonte në vështirësin për

[27] Glenny, Misha, *The Balkans: Nationalism, War and the Great Powers, 1804–2012*, Penguin Books, 2012, fq. 634–650.
[28] European Commission, *A Credible Enlargement Perspective for and Enhanced EU Engagement with the Western Balkans*, 2018.
[29] NATO, *NATO's Role in Kosovo*, raport zyrtar; Judah, Tim, *Kosovo: What Everyone Needs to Know*, Oxford University Press, 2008, fq. 98–110.
[30] Council on Foreign Relations, "The Balkans: Challenges and Opportunities", 2022.

gjetjen e një zgjidhjeje. Ndërsa në Lindjen e Mesme për shkak të faktorëve historik dhe kompleksitetit të konflikteve e bën procesin diplomatik më të ndërlikuar dhe më afatgjatë. Në Ballkanin Perëndimor, për shkak të perspektivës së integrimit evropian diplomacia ka treguar rezultate që ka shërbyer si motivim për shtetet për bashkëpunimin e mëtejshëm.

Përfundim

Në përfundim të këtij punimi, mund të theksohet se diplomacia përfaqëson një nga mekanizmat më të rëndësishëm për menaxhimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe për zgjidhjen paqësore të konflikteve. Analiza e formave të ndryshme të diplomacisë, përfshirë diplomacinë multilaterale, publike dhe rolin e saj në rajone të ndryshme si Ballkani Perëndimor dhe Lindja e Mesme, dëshmon se kjo veprimtari është thelbësore për ruajtjen e stabilitetit dhe promovimin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Diplomacia nuk është vetëm një mjet komunikimi ndërmjet shteteve, por një proces kompleks që përfshin negociata, ndërmjetësim dhe ndërtim të besimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm ndërkombëtarë.

Roli i diplomacisë multilaterale ka rezultuar veçanërisht i rëndësishëm në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur, ku sfidat globale si konfliktet e armatosura, ndryshimet klimatike dhe zhvillimi ekonomik kërkojnë zgjidhje të përbashkëta. Në këtë kuadër, organizatat ndërkombëtare si United Nations dhe Bashkimi Evropian kanë shërbyer si platforma kyçe për dialog dhe vendimmarrje kolektive. Megjithatë, siç u evidentua gjatë trajtimit të rasteve konkrete, suksesi i diplomacisë nuk është gjithmonë i garantuar dhe shpesh ndikohet nga interesat strategjike të shteteve, balanca e fuqisë dhe mungesa e vullnetit politik për kompromis.

Rastet e analizuara tregojnë se diplomacia ka arritur të kontribuojë në parandalimin e përshkallëzimit të konflikteve dhe në krijimin e kushteve për paqe, por në shumë raste nuk ka arritur të sigurojë zgjidhje përfundimtare dhe të qëndrueshme. Kjo vlen veçanërisht për konfliktet komplekse si ato në Lindjen e Mesme apo tensionet e vazhdueshme në Ballkanin Perëndimor, ku faktorë historikë, etnikë dhe gjeopolitikë vazhdojnë të ndikojnë në proceset diplomatike. Në këtë drejtim, diplomacia duhet të shoqërohet me mekanizma të tjerë politikë, ekonomikë dhe të sigurisë për të qenë më efektive.

Në një perspektivë më të gjerë, mund të konkludohet se diplomacia mbetet një instrument i pazëvendësueshëm në sistemin ndërkombëtar, pavarësisht sfidave me të cilat përballet. E ardhmja e saj do të varet nga aftësia e shteteve dhe aktorëve ndërkombëtarë për të ndërtuar besim, për të respektuar normat ndërkombëtare dhe për të bashkëpunuar në mënyrë konstruktive. Vetëm përmes një qasjeje të tillë mund të arrihet një rend ndërkombëtar më i qëndrueshëm, i bazuar në paqe, siguri dhe zhvillim të përbashkët.

Referenca

1. Berridge, G.R., *Diplomacy: Theory and Practice*, 2015.
2. Zejnullah Gruda, E drejta ndërkombëtare publike fq.247
3. Hamilton, K. & Langhorne, R., *The Practice of Diplomacy*, 2011.
4. Nicolson, H., *Diplomacy*, 2001.
5. Mattingly, G., *Renaissance Diplomacy*, 1988.
6. Morgenthau, H., *Politics Among Nations*, 2006.
7. Melissen, J., *The New Public Diplomacy*, 2005.
8. Keohane, R., *International Institutions*, 1989.
9. United Nations, *Charter of the United Nations*, 1945
10. Weiss, T.G., *What's Wrong with the United Nations*, 2012.
11. Berridge, G.R., 2015.
12. Arben Puto, *E Drejta Ndërkombëtare Publike*, Tiranë, 2010.
13. Daut Dauti, 2010.
14. Fatos Tarifa, *Marrëdhëniet Ndërkombëtare*, Tiranë, 2008.
15. Enver Hasani, *E Drejta Ndërkombëtare*, Prishtinë, 2013.
16. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Studime për Marrëdhëniet Ndërkombëtare*, Tiranë, 2015.
17. Freedman, Lawrence, *Ukraine and the Art of Strategy*, Oxford University Press, 2019, fq. 210–215.
18. Oslo Accords, *Declaration of Principles on Interim Self-Government Arrangements*, 1993; Quandt, William B., *Peace Process: American Diplomacy and the Arab-Israeli Conflict since 1967*, Brookings Institution Press, 2005, fq. 3–15; Shlaim, Avi, *The Iron Wall: Israel and the Arab World*, W.W. Norton & Company, 2014, fq. 600–610; Cleveland, William L. & Bunton, Martin, *A History of the Modern Middle East*, Westview Press, 2016, fq. 350–370.
19. Glenny, Misha, *The Balkans: Nationalism, War and the Great Powers, 1804–2012*, Penguin Books, 2012, fq. 634–650.
20. European Commission, *A Credible Enlargement Perspective for and Enhanced EU Engagement with the Western Balkans*, 2018.

21. NATO, *NATO's Role in Kosovo*, raport zyrtar; Judah, Tim, *Kosovo: What Everyone Needs to Know*, Oxford University Press, 2008, fq. 98–110.
22. Council on Foreign Relations, "The Balkans: Challenges and Opportunities", 2022.

BUSINESS ETHICS AND COMMERCIAL COMMUNICATION - A STUDY ON DISCRIMINATORY ADVERTISING AND CONSUMER LEGAL PROTECTION

PhD Cand. Manjola Islamaj

MSc. Magistrate Irena Plaku

MSc. Magistrate Matilda Çela

Abstract

This paper examines the phenomenon of discriminatory advertising in Albania by analyzing the ethical and legal dimensions of commercial communication and its impact on consumer protection. Advertising, as a key instrument of modern marketing, influences not only consumers' economic behavior but also the formation of social perceptions, stereotypes, and cultural attitudes. In this context, advertisements containing discriminatory messages based on gender, race, age, religion, disability, or other personal characteristics constitute a significant ethical and legal concern.

The purpose of this study is to assess whether discriminatory advertising exists in the Albanian market, to identify its principal manifestations, and to evaluate the institutional and legal mechanisms available for controlling and preventing this phenomenon. The study examines the Albanian legal framework, in particular Law No. 10221 dated 4 February 2010 “On Protection from Discrimination,” Law No. 9902 dated 17 April 2008 “On Consumer Protection,” as well as European Union standards and international instruments governing commercial communication practices.

Special attention is devoted to the role of Commissioner for Protection from Discrimination and other competent institutions in addressing advertisements containing discriminatory content. The paper also discusses emerging challenges related to digital marketing, social media, and the use of artificial intelligence in consumer targeting.

Through doctrinal and legal analysis, the study concludes that although Albania has established a legal framework largely aligned with European Union standards, the practical enforcement and effective

monitoring of discriminatory advertising remain limited. Strengthening institutional mechanisms, developing self-regulatory standards, and increasing business awareness are essential to ensuring commercial communication that respects dignity, equality, and consumer rights.

Keywords: *discriminatory advertising; business ethics; commercial communication; consumer protection; discrimination; digital marketing; Albania.*

Hyrje

Në shoqërinë moderne, reklama përbën një nga instrumentet më të rëndësishme të komunikimit tregtar dhe të zhvillimit ekonomik. Përmes saj, bizneset promovojnë produkte dhe shërbime, ndikojnë në sjelljen e konsumatorit dhe krijojnë identitetin e markës në treg. Megjithatë, ndikimi i reklamës nuk kufizohet vetëm në aspektin ekonomik. Reklamimi ushtron një ndikim të drejtpërdrejtë edhe në kulturën shoqërore, në mënyrën se si perceptohen grupet sociale, rolet gjinore, standardet estetike dhe marrëdhëniet ndërmjet individëve.

Në këtë kontekst, etika në biznes dhe komunikimi tregtar marrin një rëndësi të veçantë. Bizneset nuk kanë vetëm detyrimin për të respektuar ligjin, por edhe përgjegjësinë morale për të shmangur përmbajtje që cenojnë dinjitetin njerëzor ose krijojnë diskriminim ndaj individëve dhe grupeve të ndryshme shoqërore. Reklamimi diskriminues konsiderohet një nga format më problematike të komunikimit tregtar, pasi ai mund të përforcojë stereotipe negative, të nxisë paragjykime dhe të ndikojë negativisht në barazinë sociale.

Diskriminimi në reklama mund të shfaqet në forma të ndryshme, si stereotipizimi gjinor, përjashtimi racial ose etnik, diskriminimi mbi bazën e moshës, fesë, aftësisë së kufizuar ose orientimit social. Në shumë raste, reklamat përdorin figura dhe mesazhe që objektivizojnë gratë, minimizojnë rolin e grupeve të caktuara ose promovojnë standarde të paarritshme sociale dhe estetike. Për pasojë, reklama nuk ndikon vetëm në zgjedhjen ekonomike të konsumatorit, por edhe në mënyrën se si individët perceptojnë veten dhe të tjerët në shoqëri.

Përballë këtyre problematikave, shtetet dhe organizatat ndërkombëtare kanë krijuar mekanizma juridikë për mbrojtjen e konsumatorëve dhe garantimin e një komunikimi tregtar të ndershëm. Legjislacioni i Bashkimit Evropian dhe ai shqiptar parashikojnë rregulla specifike kundër praktikave diskriminuese dhe mashtruese në reklama, duke synuar ruajtjen e dinjitetit njerëzor dhe mbrojtjen e interesave ekonomike e sociale të konsumatorëve.

Ky punim synon të analizojë marrëdhënien ndërmjet etikës së biznesit dhe komunikimit tregtar, me fokus të veçantë në reklamimin diskriminues dhe mbrojtjen ligjore të konsumatorit. Punimi trajton aspektet teorike të etikës në reklamim, format kryesore të diskriminimit në komunikimin tregtar, standardet ndërkombëtare dhe evropiane, si dhe kuadrin ligjor shqiptar për mbrojtjen nga diskriminimi dhe praktikat e padrejta tregtare.

Business Ethics and Commercial Communication

Business ethics refers to the set of moral principles and standards that guide the behavior of economic actors in the conduct of their commercial activities and in their interactions with consumers, employees, and society as a whole (Ferrell et al., 2019). In this context, it is closely linked to business decision-making processes, the development of trust-based relationships with consumers, and the broader social and economic impact of corporate activity. In contemporary economies, business success is no longer evaluated solely on financial profit but increasingly also on social responsibility, transparency, and adherence to ethical values, where companies are expected to act in a fair, honest, and accountable manner toward all stakeholders.

From a theoretical perspective, business ethics is grounded in several key philosophical approaches that help interpret what constitutes right or wrong conduct in economic activity. Deontological theory posits that certain actions are morally right or wrong regardless of their consequences, and within this framework businesses have a moral duty to respect consumer dignity and avoid any form of commercial communication that violates it (Kant, 1785/2012). Utilitarianism, by contrast, evaluates ethics based on outcomes and overall utility, aiming to maximize benefits for the majority; however, in marketing practice this approach may lead to the justification of

stereotypical or discriminatory advertising if such practices increase effectiveness, which raises serious ethical concerns due to harm inflicted on specific social groups (Mill, 1863/2001). Corporate Social Responsibility (CSR) emphasizes that businesses should contribute positively to society and avoid practices that generate inequality or social harm, implying that commercial communication must remain honest, respectful, and free from discrimination (Carroll, 1991).

Commercial communication, as a fundamental component of modern business activity, encompasses all forms of messaging intended to promote products, services, or corporate image, including television advertising, digital marketing, social media content, and influencer-based promotion. Through these channels, businesses not only inform consumers but also shape societal perceptions of gender roles, success, beauty standards, and cultural identity. For this reason, commercial communication exerts significant social influence, as it may contribute to the creation, reinforcement, or challenge of existing stereotypes, thereby positioning advertising not only as an economic instrument but also as a cultural and social force with broad societal impact (Kotler & Keller, 2016).

Discriminatory Advertising

Discriminatory advertising is defined as any form of commercial communication that contains messages, images, or content that devalues, excludes, or stereotypes individuals or specific social groups based on gender, race, religion, age, disability, or other personal characteristics. Such communication is inconsistent with the principles of equality and the ethical and legal obligation of businesses to respect human dignity in all forms of public communication.

One of the most common forms of discriminatory advertising is gender stereotyping, where women are often portrayed as aesthetic objects or confined to traditional domestic roles, while men are represented as dominant and decision-making figures. These representations contribute directly to the reinforcement of traditional gender roles and the persistence of social inequality (Grau & Zotos, 2016). Similarly, racial and ethnic discrimination occurs when advertisements use cultural, physical, or linguistic elements in a derogatory, exclusionary, or stereotypical manner,

undermining the principle of diversity and reinforcing prejudice against specific groups (Kotler & Keller, 2016). Discrimination against persons with disabilities is reflected in the absence of representation or in degrading portrayals, which contribute to social marginalization and reduced inclusion in public and economic life. Age-based discrimination is also frequently observed, particularly in advertising that prioritizes youth-oriented standards, thereby excluding or negatively portraying older individuals.

The consequences of discriminatory advertising are extensive and affect both individuals and society as a whole. At the social level, such advertising reinforces existing stereotypes and prejudices and negatively impacts social cohesion and equality. At the psychological level, it may lower individuals' self-esteem and create feelings of exclusion among marginalized groups. From an economic and reputational perspective, discriminatory advertising can damage brand image, reduce consumer trust, and lead to public backlash, including boycotts of products or services (Kotler & Keller, 2016; Ferrell et al., 2019).

Several well-known international cases illustrate the real-world implications of discriminatory advertising. The H&M case (2018) involved a campaign in which a Black child wore a hoodie with the phrase "coolest monkey in the jungle," which was widely interpreted as racially offensive and led to global backlash and withdrawal of the campaign. The Dove (2017) advertisement was criticized for a video in which a Black woman appeared to transform into a white woman after using a product, raising concerns about racial implications and problematic beauty standards. Similarly, the Pepsi (2017) campaign featuring Kendall Jenner was widely condemned for appropriating imagery of social justice protests in a way that trivialized civil rights movements and demonstrated a lack of sensitivity toward social inequality (Banet-Weiser, 2018).

These cases demonstrate that discriminatory advertising is not merely a theoretical issue but a real phenomenon with significant social, economic, and reputational consequences, highlighting the need for stronger regulatory frameworks and higher ethical awareness in commercial communication.

International and European Legal Protection

Legal protection against discrimination constitutes one of the fundamental pillars of contemporary international and European human rights law. Its primary objective is to ensure the principles of equality and human dignity across all areas of social life, including commercial communication and advertising, which significantly influence social perceptions and consumer behavior. In this context, the prohibition of discrimination extends beyond formal equal treatment and includes the prevention of practices that may generate stereotypes, social exclusion, or structural inequality.

At the international level, the Universal Declaration of Human Rights (UDHR, 1948) establishes the foundational principle that all human beings are born free and equal in dignity and rights, thereby providing a universal normative framework for the prohibition of discrimination (United Nations, 1948). Although not legally binding, the UDHR has had a profound influence on the development of international law and national constitutional systems. In the same direction, the European Convention on Human Rights (ECHR, 1950) strengthens individual legal protection by prohibiting discrimination in the enjoyment of the rights and freedoms guaranteed by the Convention (Council of Europe, 1950). The jurisprudence of the European Court of Human Rights has further contributed to the dynamic interpretation and expansion of equality and non-discrimination standards.

Within the European Union legal order, the protection against discrimination and the regulation of commercial practices have developed through a comprehensive system of primary and secondary legislation aimed at safeguarding fundamental rights while ensuring the proper functioning of the internal market. The Charter of Fundamental Rights of the European Union explicitly prohibits any form of discrimination based on sex, race, ethnic or social origin, religion or belief, age, or disability under Article 21 (European Union, 2012). This provision elevates the principle of equality to a constitutional level within EU law.

Governments and international organizations increasingly use:

- Twitter/X,
- online media,
- digital campaigns,
- and virtual meetings to communicate with global audiences.[13] (Sevin & Dinnie, 2015)

Communication Challenges in Diplomacy

Diplomatic communication faces several challenges:

- political sensitivity,

[10] Digital diplomacy has transformed communication between governments and citizens.
[11] Social media platforms increasingly shape diplomatic communication strategies.
[12] Technical English supports global collaboration in engineering and technology.
[13] (Sevin & Dinnie, 2015)

- cultural differences,
- translation difficulties,
- and information security concerns.

Diplomats must communicate carefully because even small linguistic misunderstandings may influence international relations.

ESP in Technology

Technology and Global Communication

Technology has accelerated the global spread of English. The majority of:

- programming languages[14],
- technical documentation,
- scientific publications,
- and software interfaces[15] use English as the primary language.

As a result, technological professionals require specialized English skills to function in international environments.

Technical English

Technical English focuses on:

- manuals,
- engineering communication,
- scientific writing,
- coding documentation,
- and software instructions.

Technology ESP includes terminology related to:

- artificial intelligence,
- cybersecurity,
- cloud computing,
- data science,
- and information systems.

Professionals in technology fields must communicate clearly because technical misunderstandings may cause operational or security problems.[16]

[14] Most programming documentation and software interfaces use English terminology.
[15] Artificial intelligence is reshaping language learning methodologies.
[16] AI-powered educational systems can personalize learning experiences.

Digital Communication and ESP

Modern ESP instruction increasingly incorporates digital learning technologies such as:

- online platforms,
- virtual classrooms,
- AI-based learning systems,
- and collaborative tools.
- Digital communication has changed workplace interaction through:
- remote work,
- online collaboration,
- video conferencing,
- and cloud-based communication.

Research on digital diplomacy and technological transformation demonstrates that digital tools now influence communication practices across professional sectors.

Artificial Intelligence and Language Learning

Artificial Intelligence (AI) is transforming ESP education[17] by providing:

- personalized learning,
- automated feedback,
- language analytics,
- and adaptive instruction.

AI-powered platforms can analyze learner performance and customize lessons according to professional goals.[18]

Furthermore, machine translation and natural language processing are changing international communication practices, although human communicative competence remains essential.[19] (Hyland, K., & Jiang, F. (2021)

The Role of Technology in ESP Education

Online Learning Platforms

[17] Online learning platforms have expanded access to ESP education.
[18] Remote work has increased the importance of virtual communication skills.
[19] Hyland, K., & Jiang, F. (2021)

ESP instruction increasingly uses online learning management systems[20] and digital resources. These platforms provide:

- flexibility,
- accessibility,
- and interactive learning environments.
- Examples include:
- virtual simulations,
- business communication scenarios,
- and online negotiation exercises.

Virtual Communication Skills

Modern professionals often work remotely with international teams.[21] Therefore, ESP programs now emphasize:

- virtual presentation skills,
- email etiquette,
- online collaboration,
- and video conferencing communication.

Challenges of Technology Integration

Despite its advantages, technological integration presents challenges:[22]

- unequal access to technology,
- digital literacy gaps,
- and reduced face-to-face communication.

Teachers must balance technological tools with human interaction and communicative practice.

Challenges Facing ESP

ESP faces several important challenges:

- Rapidly Changing Professional Needs

[20] Technology integration in education also presents challenges related to accessibility.
[21] Global English variations may create communication barriers in professional settings.
[22] Cultural diversity strongly influences communication styles and expectations.

Business, diplomacy, and technology evolve rapidly, requiring constant updates to ESP materials and curricula.

- Interdisciplinary Knowledge

ESP instructors often need both language expertise and knowledge of specialized professional fields.

- Global English Variations

International communication involves multiple English accents and varieties, which may create comprehension difficulties.[23]

- Cultural Diversity

Cross-cultural communication remains one of the most complex aspects of ESP because language use varies according to cultural norms and expectations.

Future Directions of ESP

The future of ESP will likely involve:

- greater technological integration,
- AI-supported learning,
- virtual reality simulations,
- and increased focus on intercultural communication.

As globalization continues, ESP will become even more important in preparing professionals for international collaboration.

Researchers suggest that digital transformation and global communication networks will continue reshaping business, diplomacy, and technology communication practices. [24](Hedling & Bremberg, 2021)

Conclusion

English for Specific Purposes has become a vital component of modern education and professional development. In business, diplomacy, and technology, effective communication is essential for international cooperation, negotiation, innovation, and organizational success.

[23] Future ESP development will likely include virtual reality and AI-supported simulations.
[24] (Hedling & Bremberg, 2021).

ESP differs from General English because it focuses on the specific communicative needs of learners within professional environments. Business English supports global trade and corporate communication, diplomatic English facilitates international relations and negotiations, while technological English enables scientific and digital collaboration.

Technological advancement and globalization have further increased the importance of ESP by transforming workplace communication and creating new forms of digital interaction. Consequently, ESP education must continue adapting to emerging technologies, intercultural communication challenges, and rapidly changing professional demands.

Ultimately, ESP plays a crucial role in preparing individuals to participate successfully in the globalized world, making it one of the most important fields within modern applied linguistics.

References

1. Alammar, F. M., & Pauleen, D. J. (2016). *Business diplomacy management: A conceptual overview and an integrative framework*. International Journal of Diplomacy and Economy, 3(1), 3–26.
2. Hyland, K., & Jiang, F. (2021). *Delivering relevance: The emergence of ESP as a discipline*. English for Specific Purposes, 64, 13–25.
3. Kesteleyn, J., Riordan, S., & Ruel, H. J. M. (2014). *Introduction: Business Diplomacy*. The Hague Journal of Diplomacy, 9(4), 303–309.
4. Sevin, E., & Dinnie, K. (2015). *Digital channels and technologies for commercial diplomacy: Conceptualisation and future research propositions*. International Journal of Diplomacy and Economy, 2(4), 266–277.
5. Hedling, E., & Bremberg, N. (2021). *Practice approaches to the digital transformations of diplomacy: Toward a new research agenda*. International Studies Review, 23(4), 1595–1618.
6. Benchea, L. (2023). *Impact of Digitalization on Economic Diplomacy: Mega-Trends and Opportunities*. Romanian Economic Journal, 26(85), 13–20.
7. Weerakkody, V., Sivarajah, U., & Almuftah, H. (2024). *E-Diplomacy: A Systematic Literature Review*.

SANKSIONET PENALE NË TË DREJTËN ISLAME DHE KRAHASIMI I TYRE ME KODIN PENAL TË R. MAQEDONISË SË VERIUT

Prof. Dr. Emin Huseini

Abstrakt

Ky punim paraqet një analizë krahasuese ndërmjet sistemit penal islam dhe atij të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke u përqendruar në filozofinë, qëllimin dhe zbatimin e sanksioneve penale. Qëllimi kryesor është të ndriçohen ngjashmëritë dhe dallimet midis dy koncepteve të drejtësisë: drejtësisë hyjnore, që buron nga Sheriati, dhe drejtësisë ligjore, që buron nga sovraniteti shtetëror.

Në pjesën e parë trajtohen burimet themelore të së drejtës islame (Kurani, Suneti, Ixhma dhe Kijasi) dhe klasifikimi i dënimeve në hudud, kisas dhe taʿzir. Analiza tregon se dënimet në Islam nuk kanë për qëllim vetëm ndëshkimin, por edukimin moral dhe ruajtjen e rendit shoqëror. Pjesa e dytë përshkruan sistemin penal të Maqedonisë së Veriut, parimet themelore të Kodit Penal (2024), llojet e veprave penale dhe masat ndëshkuese, të cilat bazohen në drejtësinë, proporcionalitetin dhe humanizmin e dënimit.

Në pjesën krahasuese, vërehet se, pavarësisht prejardhjes së ndryshme, të dy sistemet ndajnë qëllime të përbashkëta si mbrojtja e jetës, pasurisë dhe dinjitetit njerëzor.

E drejta islame i jep rëndësi pajtimit dhe pendimit moral, ndërsa ligji modern fokusohet në parandalim, rehabilitim dhe mbrojtje institucionale të individit. Në përfundim, theksohet se drejtësia në të dyja qasjet ka vlera universale: ajo që ndryshon është burimi i autoritetit dhe forma e zbatimit, por jo synimi përfundimtar - ruajtja e rendit, moralit dhe jetës njerëzore.

Fjalë kyçe: *e drejta penale islame, Kodi Penal i Maqedonisë së Veriut, sanksione penale, hudud, drejtësi, krahasim juridik.*

Hyrje

E drejta penale përbën një ndër shtyllat themelore të çdo sistemi juridik, pasi ajo përcakton kufijtë e lirisë individuale dhe mbron rendin shoqëror. Që nga kohët më të hershme, njerëzit kanë ndier nevojën për një sistem rregullash që të ndalojë padrejtësinë, të mbrojë jetën, pasurinë dhe dinjitetin njerëzor. Në këtë kuptim, ligji penal është pasqyra e ndërgjegjes morale dhe juridike të një populli.

Në mesin e këtyre sistemeve, e drejta penale islame (Sheriati) zë një vend të veçantë, sepse ajo nuk është vetëm produkt i mendimit njerëzor, por konsiderohet si zbatim i vullnetit hyjnor në jetën shoqërore. Në Islam, dënimi nuk shihet vetëm si ndëshkim, por edhe si mjet edukimi dhe parandalimi, duke ruajtur barazinë ndërmjet mëshirës dhe drejtësisë.

Sistemi penal islam synon që përmes dënimeve të përcaktuara nga Kurani dhe Suneti të vendosë drejtësi, paqe dhe moralitet në shoqëri. Allahu i Madhërishëm thotë:
"Vërtet, Allahu urdhëron drejtësi dhe bamirësi[1]."

Një nga studiusit mbi të drejtën penale islame është edhe Muhammad Hashim Kamali, i cili ka botu librin "Crime and Punishment in Islamic Law 2019" (Krimi dhe Ndëshkimi në Ligjin Islam). Libri i autorit Kamalit është një studim akademik që eksploron mënyrën se si e drejta islame (sheria) e koncepton krimin, përgjegjësinë penale dhe llojet e dënimeve. Autori mbështetet në burimet klasike (Kur'an, Sunet, jurisprudenca tradicionale) dhe i krahasojnë ato me nevojat e botës moderne. Autori argumenton se ligji islam është më shumë parimor dhe preventiv, se sa represiv. Prof. Dr. Kamali e paraqet ligjin islam si një sistem të balancuar, të ndërgjegjshëm dhe njerëzor, jo brutal siç shpesh përpiqen ta paraqesin disa qarqe dashakeqe.

Një nga autorët bashkëkohorë është edhe Abdulkhaliq Fasaihi me veprën"The Philosophy of Punishment in Islamic Statute 2024" (Filozofia e Ndëshkimit në Ligjin Islam). Vepra e Abdulkhaliq Fasaihi është një studim filozofik dhe juridik mbi kuptimin, qëllimin dhe parimet e dënimit në të drejtën islame. Autori nuk merret thjesht me listimin e dënimeve; ai

[1] Shih: Kur'an, En-Nahl, 16:90.

eksploron arsyet e ndëshkimeve në Islam , logjikën morale dhe dimensionet etike të ndëshkimit.

Libri synon të tregojë se dënimet në sharia nuk janë thjesht masa ndëshkuese, por pjesë e një filozofie të zhvilluar që kombinon:

- drejtësinë,
- moralin,
- arsyen,
- dhe mbrojtjen e rendit shoqëror.

Një autor tjetër i kësaj kohe është erdhe Khaled Abou El Fadl, profesor i së drejtës dhe një nga mendimtarët më me ndikim në studimin modern të shariatit. Ai njihet për qasjen e tij etike, kritike dhe të balancuar ndaj ligjit islam, duke theksuar se shariati nuk mund të kuptohet si një kod i ngurtë, por si proces moral, i bazuar në drejtësi, mëshirë dhe përgjegjësi.

Në veprën "Islam and the Challenge of Democracy", (Islami dhe Sfidat e Dekokracisë) ai argumenton se Islami është i pajtueshëm me parimet demokratike, por vetëm nëse ligji islam interpretohet me etikë dhe larg abuzimeve politike. Ai kritikon literalizmin dhe mënyrën se si disa shtete përdorin ligjin islam për legjitimitet, pa respektuar parimet morale të tij.

Ai thekson se dënimet penale islame janë të rënda vetëm në teori, sepse zbatimi i tyre kërkon kushte shumë të rrepta, standard provash të larta dhe një sistem të drejtësisë së vërtetë. Për të, ligji penal islam duhet të jetë mbi të gjitha një mision etik, jo një instrument ndëshkues.

Në tërësi, mendimi i Abou El Fadlit mbështetet në idenë se ligji islam duhet të udhëhiqet nga morali, drejtësia dhe ndërgjegjja, duke kundërshtuar çdo formë të interpretimit të verbër apo autoritar.

Dr. Tarik Ramadan është një akademik bashkëkohor me origjinë egjiptiane, profesor i filozofisë dhe studimeve islame. Ai njihet për qasjen reformiste, që përpiqet të lidhë traditën islame me realitetet moderne shoqërore, ligjore dhe etike.

Dr. Tariq Ramadan kritikon zbatimin e dënimeve penale aktual në disa shtete islame, dhe argumenton se shumë shtete që pretendojnë se zbatojnë ligjin penal islam:

- nuk respektojnë standardet e provës,
- nuk përmbushin kërkesat e drejtësisë islame,
- i përdorin dënimet për arsye politike,
- dhe nuk garantojnë gjykim të drejtë.

Ai thekson se pa kushte ligjore, ekonomike dhe shoqërore të përshtatshme, zbatimi i dënimeve të rrepta është i padrejtë dhe jo islamik.

Në anën tjetër, sistemi penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut përfaqëson një model modern, sekular dhe demokratik, që synon mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ruajtjen e rendit publik përmes ligjeve të miratuara nga Parlamenti. Kodi Penal, i përditësuar sipas standardeve evropiane, garanton parimin e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit në dënime.

Studimi i krahasuar ndërmjet sanksioneve penale islame dhe Kodit Penal të Maqedonisë së Veriut ndihmon në kuptimin më të gjerë të drejtësisë, si në dimensionin hyjnor, ashtu edhe në atë njerëzor.

Kjo qasje jo vetëm ndriçon dallimet thelbësore ndërmjet një sistemi fetar dhe atij laik, por tregon edhe pikat e përbashkëta në qëllimin final – mbrojtjen e njeriut dhe shoqërisë.

Burimet e së drejtës penale islame

E drejta penale islame është pjesë e pandashme e sistemit juridik të Sheriatit dhe bazohet mbi katër burimet themelore: Kuranin, Sunetin, Ixhman dhe Kijasin. Këto burime formojnë bazën e çdo dispozite ligjore që rregullon jetën shoqërore dhe penale të myslimanit.

Mirëpo, ka dallime në qëndrimet e juristëve, sa i përket burimeve në fushën e së drejtës penale[2]. Lidhur me këtë, juristët i pranojnë si burime Kuranin, Sunetin dhe Ixhma-në, ndërsa për Kijasin – analogjinë ka qëndrime të ndryshme[3].

Kurani është burimi i parë dhe themelor i çdo ligji islam. Ai përmban norma të qarta që përcaktojnë dënime për disa vepra të rënda si vjedhja, amoraliteti, shpifja, pirja e alkoolit dhe rebelimi kundër rendit shoqëror.

Suneti (hadithet e Profetit Muhamed) është burimi i dytë, që shpjegon dhe plotëson dispozitat e Kuranit.

[2] Shih: Sh. Sulejmani; E Drejta Penale Islame, Shkup, 2012, fq. 43.
[3] Shih: Po aty.

Ixhma (konsensusi i dijetarëve) është pajtimi unanim i juristëve islamë për një çështje ligjore pas vdekjes së Profetit.

Konsensusi i të gjithë jurstëve muxhtehidë gjat periudhave për një çështje të caktuar juridike, i cili vendim nuk ka qenë në kundërshtim me Kuranin dhe Synetin, llogaritet si Ixhma[4].

Në të drejtën penale islame, ixhma ka luajtur rol të rëndësishëm në përcaktimin e kushteve të dënimeve dhe mënyrës së zbatimit të tyre, veçanërisht në rastet ku Kurani dhe Suneti nuk japin udhëzim të drejtpërdrejtë.

Kijasi (analogjia juridike) përdoret për të nxjerrë dispozita për çështje të reja në bazë të ngjashmërisë me raste të ngjashme të përmendura në burimet e paraë; për shembull, ndalimi i drogave moderne është nxjerrë përmes kijasit, duke u bazuar në ndalimin e alkoolit në Kur'an, pasi të dyja kanë efekt dehës. Disa jurista islam analogjinë e llogarisin si burim të sheriatit; mirëpo , kur është fjala për të drejtën penale kanë mendim ndryshe[5]. Ata mendojnë se analogjia nuk është burim i të drejtëd penale, por ajo mund të konsiderohet vetëm si burim për interpretimin e teksteve me karakter penal[6].

Juristat islam, të cilët e pranojnë kijasin si burim të së drejtës penale, konsiderojnë se kijasi mund të aplikohet vetëm për kategoritë e veprave penale, për të cilat janë parashikuar dënime të papërcaktuara (et-Teazir), sepse për këto vepra gjykatësit i lejohet që të përcaktojë në mënyrë të lirë, sipas bindjes së tij juridike[7]. Për veprat tjera penale, nuk është i lejuar të aplikohet kijasi, përveç rasteve kur ka bazë të fuqishme, se krahasimi është i ngjashëm me atë që është përcaktu me tekst kuranor apo nga syneti[8].

[4] Shih: V, Zuhejli. Usul Fikëhi, bl. 1, vep. e cit., 487-95.
[5] Shih: H. El-Xhad; Fikretul ukubat et-Tebijje ve tekmilije fish-Sheriatil Islamije, Kairo, 1993, Fq. 90.
[6] Shih: A. Aude; Analiza nga penalisti Islam bashkëkohorë, vep, cit., fq. 184.
[7] Shih: Sh. Sulejmani; E Drejta Penale Islame, Shkup, 2012, fq. 47.
[8] Shih: M. Ebu Zehra; El-Xheremi vel ukube fi sheriatil islamije el-xherime, Kajro, 1990, fq. 198.

Llojet e sanksioneve penale në të drejtën islame

E drejta penale islame parashikon katër kategori kryesore dënimesh. Çdo kategori ka bazë të ndryshme juridike, mënyra të ndryshme zbatimi dhe hapësira të ndryshme për interpretim. Sistemi penal në të drejtën islame përbën një ndërtim juridik kompleks, ku ndërthuren elementët fetarë me parimet e drejtësisë dhe të ruajtjes së rendit shoqëror. Kategorizimi i dënimeve në këtë sistem nuk është arbitrar, por ndërtuar mbi burime të qarta normative – Kur'ani, Suneti dhe tradita juridike (fikh-u).

Në teorinë e së Drejtës Penale, juristët muslimanë nuk i kanë kushtuar ndonjë punim të veçantë klasifikimit të veprave penale[9]. Nga literatura profesionale penale islame mund të lexojmë, se juristët islam duke kosultuar burimet themelore të Sheriatit Islam, Kuranin dhe synetin-traditën profetike, në përgjithësi përcaktuan katër lloje të veprave penale, duke marrë për kriter bazë llojin e sanksionit që parashihet për ato vepra, si:

- vepra penale për të cilat janë parashikuar dënime "el-Hudud",
- vepra penale për të cilat janë parashikuar dënime "el-Kisas",
- vepra penale për të cilat parashikohet dënimi "ed-Dije"-shpagim gjaku (sistemi i kompenzimit),
- vepra penale për të cilat parashikohen dënime të papërcaktuara, diskrecionale "et-Te'azir"[10].

Në të drejtën penale islame mund të bëhet edhe ndarja e veprave penale në varësi të natyrës së tyre:

- vepra penale ndaj pasurisë;
- vepra penale ndaj jetës dhe trupit;
- vepra penale ndaj integritetit trupor[11].

Kjo ndarje ka rëndësi teorike dhe praktike në zbatimin e sanksioneve të parashikuara për çdo vepër penale veç e veç[12].

Sistemi penal në të drejtën islame përfaqëson një kombinim të parimeve etike, morale dhe juridike që synojnë ruajtjen e rendit publik, të drejtave të individit dhe stabilitetit shoqëror. Ai mbështetet në parimet e së

[9] Shih: Sh. Sulejmani; E Drejta Penale Islame, Shkup, 2012, fq. 75.
[10] Shih: Po aty.
[11] Shih: Po aty.
[12] Shih: Po aty, fq. 76, vep e cit; V. Zuhejli; Fikhul islami, fq. 211.

drejtës hyjnore (sharia), e cila i jep rëndësi jo vetëm ndëshkimit, por edhe parandalimit, edukimit dhe resocializimit.

Parimet bazë të sanksioneve penale në të drejtën islame janë:

- Parimi i përgjegjësisë individuale - askush nuk mban përgjegjësi për krimet e tjetrit. Përgjegjësia ligjore lidhet me veprimin, qëllimin dhe kapacitetin mendor.
- Parimi i drejtësisë - dënimet duhet të jenë proporcionale me veprën dhe të bazuara në prova të sigurta. Shpesh ekziston parimi "shmangia e dënimeve në rast dyshimi".
- Parimi i proporcionalitetit - dënimet nuk mund të tejkalojnë kufijtë e përcaktuar nga Kurani dhe Suneti, sidomos tek krimet Hadd.

Roli i moralit dhe edukimit - dënimet kanë karakter edukues, duke synuar ripërmirësimin moral të individit[13].

Qëllimi i dënimeve në Islam

Në sistemin penal islam, dënimi nuk ka për qëllim vetëm ndëshkimin e fajtorit, por edhe parandalimin e krimit, edukimin moral të individit dhe mbrojtjen e rendit shoqëror.
Parimet e drejtësisë islame janë të mbështetura mbi konceptin se qëllimet themelore të ligjit islNdryshe nga sistemet penale moderne, që shpesh mbështeten vetëm në parimin e ndëshkimit ose parandalimit, e drejta penale islame synon reformimin shpirtëror dhe moral të individit, duke ruajtur interesin e përgjithshëm të umetit (bashkësisë).am janë: mbrojtja e fesë, jetës, mendjes, pasurisë dhe nderit.

Qëllimi i dënimeve penale në të drejtën e sheriatit Islam janë[14]:

- Parandalimi
- Qëllimi i parë i dënimit është parandalimi i krimit, duke e bërë njeriun të mendojë për pasojat e veprës së tij. Zoti në Kuran thotë:
- "Në kisas keni jetë, o ju që keni mend, që të ruani vetveten nga mëkatet[15]."

[13] Shih: Muhammad. H. Kamali; "Principles of Islamic Jurisprudence", Islamic Texts Society, Texats, 2011, fq. 35.
[14] Shih: Po aty, fq. 97-110.
[15] Shih: Kur'an, El-Bekare, 2:179.

Kështu, drejtësia islame synon të parandalojë shpërbërjen morale përmes përgjegjësisë personale dhe ndëshkimit të ligjshëm.

Drejtësia dhe barazia

Një aspekt themelor i sanksioneve islame është barazia para ligjit. Sheriati nuk bën dallim midis të pasurit e të varfërit, apo midis pushtetarit e qytetarit të zakonshëm. Profeti ka thënë:

"Popujt para jush u shkatërruan, sepse kur vidhte fisniku e linin të lirë, por kur vidhte i varfri e ndëshkonin[16]."

Ky hadith përmban thelbin e drejtësisë universale: të gjithë janë të barabartë para ligjit.

Edukimi dhe rehabilitimi

Sistemi penal islam e sheh dënimin si mjet për ta kthyer njeriun në rrugën e drejtë, jo për ta përjashtuar atë nga shoqëria. Profeti ﷺ i ka nxitur mëkatarët të pendohen përpara se të zbatohen dënimet, duke treguar se pendimi është më i vlefshëm se ndëshkimi fizik.

"Ai që pendohet për mëkatin, është si ai që s'ka bërë mëkat[17]."

Kjo tregon se ligji islam është thellësisht moral dhe human, duke synuar reformimin e shpirtit dhe shoqërisë.

Mbrojtja e shoqërisë dhe e moralit publik

Dënimet penale në Islam kanë për qëllim mbrojtjen e pesë interesave themelore:

- Mbrojtjen e fesë.
- Mbrojtjen e jetës.
- Mbrojtjen e mendjes.
- Mbrojtjen e pasurisë.
- Mbrojtjen e nderit.

Pa ruajtjen e këtyre pesë shtyllave, nuk mund të ekzistojë një shoqëri e drejtë dhe e qëndrueshme. Dënimi shërben si garanci për paqe dhe rend, duke i siguruar çdo anëtari të shoqërisë siguri për jetën dhe pronën e tij.

[16] Shih: Sahih Buhari, nr. 6785.
[17] Shih: Sunan Ibn Maxhe, nr. 4250

E drejta penale islame është një sistem i ndërtuar mbi drejtësinë hyjnore, ku qëllimi nuk është ashpërsia e dënimit, por mbrojtja e dinjitetit njerëzor.
Në dallim nga shumë ligje moderne, Sheriati i jep një rëndësi të veçantë pendimit, faljes dhe pajtimit, duke balancuar midis dënimit dhe mëshirës. Kështu, mund të themi se dënimet islame janë moralizuese, edukative dhe parandaluese, dhe për këtë arsye kanë qëndrueshmëri në kohë.

Në Islam, njeriu shihet si qenie e gabueshme por e pendueshme. Dënimi synon ta ndihmojë të reflektojë, të pendohet dhe të kthehet në rrugën e drejtë.

Kjo është veçanërisht e dukshme në dënimet ta‘zir, ku gjykatësi mund të zgjedhë masa edukative si:

- këshillim,
- qortim,
- burgim i shkurtër, ose
- detyrim për punë të dobishme.

Pra, dënimi nuk është hakmarrje, por proces edukimi dhe pastrimi shpirtëror.

Një nga funksionet themelore të dënimeve në Islam është parandalimi i së keqes përmes frikës së ndëshkimit. Hududet, për shembull, janë dënime të rënda, por vendosen me kushte shumë të rrepta provash - qëllimi nuk është t’i zbatosh shpesh, por të krijosh vetëdije frenuese apo parandaluese në shoqëri.

Në rastet e kisas dhe dije, qëllimi është rivendosja e drejtësisë për viktimën dhe familjen e saj.
Ky sistem ofron tre rrugë:

- Dënim të barabartë me dëmin (*kisas*).
- Dëmshpërblim financiar (*dije*).
- Falje nga familja e viktimës, që shihet si akt i madh shpirtëror.

Kështu, drejtësia nuk është vetëm ligjore, por edhe morale e shpirtërore, duke ruajtur balancën midis të drejtave të Zotit dhe të njerëzve.

Qasje krahasues midis sistemit penal të RMV-së me të drejtën penale islame

Sistemi penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut bazohet në parimet e së drejtës pozitive, që burojnë nga tradita evropiane kontinentale dhe nga parimet e humanizmit, ligjshmërisë dhe proporcionalitetit të dënimeve. Qëllimi kryesor i dënimit në këtë sistem është riedukimi dhe riintegrimi i kryesit të veprës penale në shoqëri, duke shmangur hakmarrjen dhe duke respektuar dinjitetin njerëzor.

Në të drejtën penale islame (Sheriat), ndëshkimi ka një dimension të dyfishtë: juridik dhe moral. Dënimi nuk synon vetëm mbrojtjen e rendit shoqëror, por edhe pastrimin shpirtëror të individit dhe përmirësimin e karakterit të tij. Sheriati njeh disa kategori dënimesh – hudud, kisas, dhe tazir – ku secila lidhet me shkallën e fajësisë dhe qëllimin e përmirësimit moral e shoqëror.

Ndërsa në sistemin penal të RMV-së burimi kryesor i ligjit është Kodi Penal dhe Kushtetuta, në të drejtën islame burimi është Kurani, Suneti, Ixhmaja dhe Kijasi. Megjithëse bazat janë të ndryshme, të dy sistemet ndajnë një parim të përbashkët të humanizmit, duke kërkuar që dënimi të jetë i drejtë, proporcional dhe me funksion edukues.

Në Kodin Penal të RMV-së, dënimet si burgimi, gjoba apo masa alternative zbatohen për qëllime parandaluese, ndërsa në Islam dënimet si hudud (për krime të caktuara nga Zoti) dhe tazir (që përcaktohen nga gjykatësi) kanë për qëllim ruajtjen e rendit shoqëror dhe moral sipas udhëzimeve hyjnore.

bashkëkohorë theksojnë nevojën për interpretim fleksibil të Sheriatit, që të harmonizohet me standardet e të drejtave të njeriut dhe me normat ligjore të shteteve bashkëkohore, siç është rasti i RMV-së.

Sistemi penal i RMV-së, ndonëse laik, në shumë aspekte ndan të njëjtat objektiva morale me Sheriatin: drejtësinë, barazinë dhe edukimin e fajtorit. Dallimi qëndron në burimin e autoritetit ligjor – në Islam, ligji rrjedh nga Zoti, ndërsa në shtetin laik, nga sovraniteti popullor.

Të dy sistemet përpiqen të arrijnë mbrojtjen e jetës, pronës dhe nderit të individit, por ndërsa Sheriati e sheh krimin si mëkat ndaj Zotit dhe

shoqërisë, ligji laik e trajton si shkelje të rendit publik. Kjo tregon se, në thelb, qëllimi i drejtësisë është universale, dhe mund të realizohet përmes rrugëve të ndryshme që respektojnë kontekstin historik dhe kulturor të çdo shoqërie.

Në përfundim, mund të thuhet se të dy sistemet, pavarësisht dallimeve burimore dhe konceptuale, kanë synime të përbashkëta: mbrojtjen e rendit publik, drejtësinë dhe riedukimin e individit. Dallimi qëndron në bazën filozofike — ku njëri mbështetet në normat ligjor, ndërsa tjetri në normat ligjore-hyjnore dhe morale.

Ngjashmëritë dhe dallimet në konceptimin e krimit

Koncepti i krimit përbën një nga shtyllat themelore të çdo sistemi juridik. Si në të drejtën penale islame ashtu edhe në atë të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV), krimi shihet si një akt që dëmton rendin dhe harmoninë shoqërore. Megjithatë, këto dy sisteme ndërtohen mbi parime filozofike, fetare dhe juridike të ndryshme. E drejta islame mbështetet në Kuran dhe Sunet, Ixhma dhe Kijas, ndërsa e drejta penale e RMV-së në normat penale juridike.

Të dy sistemet penale kanë ngjashmëri në konceptimin e krimit, edhe atë në:

a) Qëllimi i mbrojtjes së rendit shoqëror

Të dy sistemet synojnë të mbrojnë rëndin, sigurinë dhe drejtësinë shoqërore. Krimi konsiderohet si një akt që rrezikon interesin publik dhe cënon paqen e përgjithshme[18].

b) Parimi i përgjegjësisë individuale - Në të drejtën islame, secili person është përgjegjës për veprimet e tij: "Kush bën mirë, e ka për vete, dhe kush bën keq, e ka kundër vetes[19]". Edhe në të drejtën penale të RMV-së, përgjegjësia është individuale, duke u bazuar në parimin "nuk ka dënim pa faj[20]".

c) Qëllimi parandalues dhe edukues i dënimit

[18] Shih: A. Q. Audah, Et-Teshri' el-Jina'i el-Islami, (Legjislacioni Penal Islam) vëll. 2, Dar el-Kitab el-Arabi, Bejrut, 1983, fq. 45.
[19] Shih: Kuran: 45:15.
[20] Shih: Kodi Penal i RMV-së.

Të dy sistemet e shohin dënimin si mjet parandalues dhe edukues, për të ndaluar krimet e ardhshme dhe për të riedukuar autorin e veprës penale.

Në të drejtën penale islame, krimi përkufizohet: çdo veprim ose mosveprim që bie ndesh me urdhrat e Allahut dhe dëmton individin apo shoqërinë. Ai ka dimension moral dhe shpirtëror, sepse çdo mëkat është në të njëjtën kohë shkelje ligjore dhe morale.
Në të drejtën penale laike, përfshirë edhe Kodin Penal të RMV-së, krimi përkufizohet si vepër e kundërligjshme e kryer me dashje ose nga pakujdesia, që shkel rendin juridik të shtetit dhe parashikon ndëshkim në bazë të dispozitave penale juridike.

d) Ekzistenca e elementeve të veprës penale

Të dy sistemet penale njohin elementet themelore të veprës penale:

- veprimi ose mosveprimi,
- rrezkishmëria shoqëro,
- kundërligjshmëria,
- përcaktueshmëria e veprës penale me ligj,
- përgjegjësia penale e kryerësit (fajsia).

Përveç ngjashmërive këto dy siteme penale kanë edhe disa dallimet, edhe atë:

a) Burimi i normave penale juridike

Në të drejtën penale islame, burimi është hyjnor (Kurani, Suneti, Ixhma, Kijasi), ndërsa në sistemin penal të RMV-së , burimi është Kodi Penal, i hartuar nga organi legjislativ (paralamenti) dhe i bazuar në parime pozitiviste dhe laike.

Natyrë fetare kundrejt asaj laike

Në Islam, krimi është një shkelje ndaj Zotit dhe shoqërisë, pra ka karakter moral dhe fetar[5].
Në RMV, krimi është shkelje e ligjit penal i cili cenon vlerat vitale të individit, sigurinë e vendit si dhe rendin juridik të shtetit, pra ligji penal laik është pa dimension moral ose fetar.

c) Klasifikimi i krimeve

Sipas të drejtës penale islame krimet ndahen në tre kategori kryesore[6]:

Hudud – krime me dënime të përcaktuara nga Zoti (p.sh. vjedhja, zinaja, pirja e alkoolit, etj.);

Qisas/Dije – krime kundër jetës dhe trupit (hakmarrje e drejtë ose kompensim financiar);

Ta'zir – krime të përcaktuara nga autoriteti shtetëror, ku gjykatësi ka diskrecion në dënim.

Sipas Kodit Penal të RMV-së krimet ndahen sipas nivelit të rrezikshmërisë shoqërore, edhe atë si: krimet kundër jetës dhe trupit, kundër rendit juridik, kundër sigurisë së shtetit, krimet kundër pronës etj.

d) Qasja ndaj provave dhe procedurës

Në Islam, prova ka vlerë morale dhe fetare, dhe kërkohen standarde shumë të larta të të provuarit (p.sh. katër dëshmitarë për zinan). Në RMV, dënimi për veprë penale bazohet në parimin e të vërtetës materiale, pra fajësia duhet të bazohet në prova materiale.

e) Qëllimi shpirtëror dhe moral

Në Islam, dënimi shërben për pastrimin shpirtëror të mëkatarit dhe faljen e tij nga Zoti.
Në sistemin penal juridik të RMV-së, dënimi synon vetëm rehabilitimin shoqëror dhe ruajtjen e rendit juridik, pra pa aspekt shpirtëror.

f) Roli i faljes dhe mëshirës

Në Islam, falja e viktimës ose pendesa e sinqertë mund të lehtësojë ose shmangë dënimin.
Në RMV, falja është akt juridik i shtetit i rregulluar me ligj (amnisti nga parlamenti ose falje nga presidenti), e jo marrëdhënie individuale ndërmjet palëve.

Në përfundim, të dy sistemet synojnë mbrojtjen e shoqërisë dhe vendosjen e drejtësisë, por dallojnë në burimet, filozofinë dhe natyrën morale të konceptit të krimit.

E drejta islame mbështetet në vlera morale dhe shpirtërore, duke e parë krimin si mëkat ndaj Zotit dhe shoqërisë;

ndërsa e drejta penale e RMV-së e trajton atë si shkelje të normës juridike, në kuadër të parimeve demokratike dhe laike.

Kjo tregon se ndonëse të ndryshme në origjinë, të dy sistemet synojnë të ruajnë rendin, drejtësinë dhe dinjitetin e njeriut në mënyrën e tyre.

Konkluzione

Nga analiza e detajuar që u zhvillua në këtë punim, del qartë se e drejta penale islame dhe e drejta penale e Maqedonisë së Veriut, megjithëse kanë burime të ndryshme, ndajnë thelbin e përbashkët të drejtësisë — mbrojtjen e njeriut dhe ruajtjen e rendit shoqëror.

Sheriati islam është sistem që e lidh drejtësinë me moralin dhe besimin, duke e konsideruar dënimin si mjet edukimi dhe pastrimi shpirtëror, ndërsa ligji modern e sheh si instrument juridik për ruajtjen e rendit dhe sigurisë. Ky dallim filozofik tregon se në Islam drejtësia është pjesë e besimit, ndërsa në sistemin laik ajo është produkt i shoqërisë. Megjithatë, qëllimi i përbashkët është parandalimi i krimit dhe rehabilitimi i individit.

Sanksionet islame – hudud, kisas dhe taʿzir – përfaqësojnë tri nivele drejtësie që mbulojnë të gjitha aspektet e krimeve, nga ato kundër Zotit e deri te ato kundër njeriut. Ndërsa Kodi Penal i RMV-së i ndan veprat sipas shkallës së rrezikshmërisë dhe parashikon masa të ndryshme ndëshkuese, nga gjoba deri te burgimi i përjetshëm. Kjo tregon një strukturë logjike të ngjashme, ku çdo shkelje shoqërohet me një përgjegjësi të përshtatshme dhe me dënime që janë në nivelin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale.

Një nga tiparet më të dallueshme të së drejtës islame është hapësira e faljes. Sheriati i jep familjes së viktimës mundësinë të falë ose të kërkojë kompensim, duke nxitur pajtimin dhe paqen shoqërore. Kjo qasje morale shpesh mungon në ligjet moderne, të cilat janë të përqendruara te ndëshkimi

institucional. Kështu, drejtësia islame ruan një balancë midis mëshirës dhe drejtësisë.

Të dy sistemet pranojnë se askush nuk është mbi ligjin. Sheriati ndalon privilegjet shoqërore në gjykim, ndërsa Kodi Penal i Maqedonisë garanton barazinë e qytetarëve para ligjit përmes dispozitave kushtetuese. Kjo tregon se drejtësia e vërtetë është universale dhe se buron nga parimi i barazisë njerëzore.

Në epokën moderne, zbatimi i ligjit penal islam mbetet i ndryshëm nga vendi në vend. Sfida kryesore sot është harmonizimi midis Sheriatit dhe ligjeve penale të sheteve. Ky proces kërkon qasje të matur dhe akademike, ku parimet hyjnore të drejtësisë islame interpretohen në dritën e realiteteve sociale bashkëkohore.

E drejta penale islame mbetet një model unik i drejtësisë fetare, që vendos theksin te përgjegjësia shpirtërore dhe shoqërore, ndërsa ligji penal i Maqedonisë së Veriut është model institucional që garanton drejtësi përmes rregullave pozitive. Ndërveprimi midis këtyre dy sistemeve nuk duhet parë si konflikt, por si mundësi për dialog ndërkulturor, që pasuron konceptin global të drejtësisë.

Në përfundim, mund të thuhet se drejtësia është një vlerë universale që bashkon, e jo që ndan. Qoftë përmes ligjit hyjnor apo atij njerëzor, synimi përfundimtar është i njëjtë: ndërtimi i një shoqërie të drejtë, të moralshme dhe të qëndrueshme, ku njeriu gëzon siguri, dinjitet dhe paqe.

Literatura

1. Sh. Sulejmani. E Drejta Penale Islame, Shkup, 2012.
2. M. Tuhmaz, Fikhu Hanefi, E Drejta Penale, vëll, 3, Zurich, 2012.
3. Abdul-Qadir Audah, At-Tashri‘ al-Jina’i al-Islami, vëll. 1 (Beirut: Dar al-Kitab al-Arabi, 1408 H/1988).
4. M. Ebu Zehra; El-Xheremi vel ukube fi sheriatil islamije el-xherime, Kajro, 1990.
5. Kur’an-i Famëlartë, përkthim dhe koment. Medine: Kompleksi Mbret Fahd për botimin e Kuranit, botim i standardizuar.
6. Sahih Buhari, nr. 6533, 6785.
7. Sunan Tirmidhi, nr. 1424.

8. Sunan Ibn Maxhe, nr. 4250.
9. Ramadan, T. (2009). *Radical Reform: Islamic Ethics and Liberation* (Reforma Radikale: Etika Islame dhe Emancipimi). Oxford: Oxford University Press.
10. Zia-ul-Haq, M. (1979). *Hudood Ordinance* [Ligji penal islam për zina dhe vjedhje]. Islamabad: Government of Pakistan.
11. Halili, S. (2020). *E drejta penale – pjesa e përgjithshme*. Shkup: Fakulteti Juridik.
12. Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkup: Ministria e Drejtësisë.
13. H. El-Xhad; Fikretul ukubat et-Tebijje ve tekmilije fish-Sheriatil Islamije, Kairo, 1993.
14. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (1950). Strasburg: Këshilli i Evropës.
15. Muhammad. H. Kamali; "Principles of Islamic Jurisprudence" (Parimet e Jurisprudencës Islame), Islamic Texts Society, Texats, 2011.
16. M. H. Kamali, Crime and Punishment in Islamic Law (Krimi dhe Ndëshkimi në të Drejtën Islame), Oxford University Press, 2019.
17. Sh. Halili. E drejta penale islame dhe parimet e saj krahasuar me të drejtën penale bashkëkohore, Shkup, 2020.
18. M. S. El-Awa, Punishment in Islamic Law (Ndëshkimi në të Drejtën Islame), International Institute of Islamic Thought, Virginia, 1993.

BURNOUT DHE EDUKIMI LIGJOR PUBLIK (MBROJTJA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE E STUDENTËVE – SPORTISTË)

Doc. Dr. Dorian Leka

International University of Struga, d.leka@eust.edu.mk

Klea Kodra

Universiteti Barleti

Abstrakt

Ky studim shqyrton prevalencën e shkallës së lodhjes emocionale dhe fizike (si nënkategori e sindromës Burnout) tek studentët-sportistë të moshës 18 deri në 21 vjeç, duke përdorur dimensionin përkatës së lodhjes emocionale/fizike në Pyetësorin e Burnout për Sportistët (Athlete Burnout Questionnaire – ABQ; Physical and Emotional Exhaustion - PEE).

Një total prej 98 pjesëmarrësish përfunduan anketën, e cila vlerëson lodhjen emocionale/fizike në shifra domethënëse (62.2%), duke sugjeruar riskun e shtuar për sindromën e shterjes (Burnout).

Analizohen lidhjet ndërmjet demografisë dhe niveleve të lodhjes emocionale/fizike referuar sindromës Burnout. Në këtë aspekt, mosha rezultoi të kishte një ndikim statistikisht domethënës, ndonëse të vogël, mbi nivelin e përgjithshëm të lodhjes emocionale dhe fizike, me sportistët 21-vjeçarë që raportuan nivele më të larta të të dyjave. Këto rezultate sugjerojnë se, ndonëse niveli i lodhjes emocionale dhe fizike nuk është i rëndë në këtë popullatë, simptomat mesatare janë të zakonshme dhe më të theksuara tek sportistët më të rritur, e cila përkthehet në risk të shtuar për Burnout.

Studimi sugjeron nevojën për ndërhyrje institucionale dhe ligjore, duke lidhur analizën empirike me kuadrin ligjor kombëtar dhe europian, për të mbështetur mirëqenien e sportistëve studentë dhe për të reduktuar rrezikun e shterjes psikologjike afatgjatë.

Fjalë kyçe: *lodhje emocionale, lodhje fizike, student-sportist, burnout.*

Konteksti

Ky punim është realizuar me qëllim që të hedhë dritë më tepër mbi nivelin e lodhjes emocionale dhe fizike (në kontekstin e Burnout) te sportistët që aktualisht janë duke ndjekur studimet e larta universitare në vendin tonë, përkatësisht të grupmoshës 18-21 vjeçare. Nëpërmjet këtij hulumtimi merren masa për të parandaluar sindromën e shterjes emocionale dhe fizike te studentët sportistë, e cila përkthehet në pasoja të tilla si mungesë produktiviteti në aspektin sportive, akademik, social dhe personal. Ndër të tjera, shihet konteksti ligjor dhe roli që luajnë institucionet dhe ligjet mbarëvajtëse për sportin, të cilat duhet t'u vijnë në ndihmë sportistëve, sa i përket shëndetit mendor dhe performancës lidhur me të.

Çka është synuar në kryerjen e punimit ka qenë nxjerrja e shifrave reale që masin nivelin e lodhjes emocionale dhe fizike te studentët sportistë, që tregojnë se sa i shpeshtë është ky fenomen ndërmjet studentëve të angazhuar në kompeticione sportive profesionale. Gjithashtu, është marrë në konsideratë ndikimi i të dhënave demografike në nivelin e lodhjes emocionale dhe fizike.

Ky studim eksploron literaturën ekzistuese dhe shton informacion mbi nivelin e lodhjes emocionale dhe fizike në kontekst të sindromës Burnout, duke u fokusuar posaçërisht në përvojat e studentëve-sportistë, një popullatë që shpesh përballet me sfida unike për shkak të kërkesave të dyfishta akademike dhe sportive. Duke përdorur Pyetësorin e Burnout-it për Sportistët (ABQ) dhe duke analizuar të dhëna nga 98 pjesëmarrës, studimi ofron një pasqyrë më të qartë se si shfaqet burnout-i në këtë kontekst. Gjetjet mund të ndihmojnë stafin akademik të fakulteteve që kanë në mesin e tyre studentë-sportistë, trajnerët dhe ekspertët e sportit, si edhe profesionistët e shëndetit mendor të kuptojnë më mirë presionet psikologjike me të cilat përballen studentët-sportistë dhe të zhvillojnë strategji më efektive për parandalim dhe mbështetje. Për më tepër, ky kërkim shton vlerë në fushën akademike shqiptare, ku psikologjia e sportit dhe shëndeti mendor i sportistëve janë ende fusha të paprekura mjaftueshëm, duke ofruar një bazë për studime dhe ndërhyrje të ardhshme të përshtatura për kontekstin e Republikës së Shqipërisë.

Problematika

Në gjuhën shqipe burnout mund ta asociojmë me fjalë si rraskapitje apo lodhje nga stresi. Në mënyrë intuitive mund të kemi një ndjesi të përgjithshme mbi këtë term, megjithatë, për herë të parë në studim sindroma Burnout është përdorur nga Herbert Freudenberger në vitin 1974, duke u përkufizuar nga tre komponentë:

lodhje emocionale- lodhje e vazhdueshme intensive e ardhur nga kujdesi dhe eforti për një kohë të gjatë;

depersonalizimi- reduktimi i empatisë, kujdesit dhe dhembshurisë;

sensi i reduktuar i arritjeve- sens kotësie: ndjesi se çdo gjë që të bësh nuk përbën asnjë lloj diference (Freudenberger, 1974)[21].

Ky pohim ka lënë hapësirë për studiues të tjerë të hedhin hipotezat e tyre dhe të japin informacion më të gjerë mbi përkufizimin e Burnout. Në fjalë të tjera, burnout është një përgjigje e zgjatur ndaj stresorëve kronikë emocionalë dhe ndërpersonalë në punë dhe përcaktohet nga tre dimensionet e lodhjes, cinizmit dhe joefikasitetit (Maslach, Schaufeli, & Leiter, Job Burnout, 2001)[22].

Lodhja emocionale dhe fizike i referohet ndjenjës së sportistit se është i rraskapitur dhe i pamundur për të qenë në kapacitetin maksimal të performancës sportive, por jo vetëm. Duke qenë se sindroma Burnout përbëhet nga tre komponentë, sipas këtij modeli, burnout-i nuk është thjesht rezultat i mbingarkesës fizike, por edhe i mënyrës se si sportisti e përpunon emocionalisht presionin konkurrues. Këto modele ndihmojnë në shpjegimin e faktit pse dy sportistë me ngarkesa të ngjashme mund të përjetojnë nivele të ndryshme burnout-i, sepse përgjigjja e brendshme ndaj stresit është shumë subjektive dhe varet nga mekanizmat e përballimit dhe menaxhimi emocional.

Ndonëse në studim shqyrtohet njëra kategori referuar burnout, në këndvështrim makro, lodhja apo rraskapitja emocionale dhe fizike është ajo

[21] Herbert J. Freudenberger, *Staff Burn-Out*, Journal of Social Issues, botuar nga Wiley, New York, SHBA, 1974, fq. 159
[22] Christina Maslach, Wilmar B. Schaufeli & Michael P. Leiter, *Job Burnout*, Annual Review of Psychology, Annual Reviews, Palo Alto, Kaliforni, SHBA, 2001, fq. 399

që vërehet më shpejt dhe që shprehet më shpesh si shqetësim, në veçanti te studentët sportistë. Duke folur për këta të fundit, merret në konsideratë se në pamje të parë, dallimet midis studentëve sportistë dhe studentëve të tjerë në universitet duken të vogla. Të dyja grupet ndjekin studimet; njëri luan në një sport me pjesëmarrje në kompeticion profesional, ndërsa tjetri jo. Megjithatë, të luash një sport në nivel profesional shton një shtresë komplekse në jetën studentore. Studenti sportist përballet me të gjitha sfidat që përjetojnë edhe studentët që nuk janë sportistë (përshtatja sociale, eksplorimi i karrierës, rritja intelektuale). Por, përveç rutinës së përditshme studentore (ndjekja e orëve, shkuarja në kafene dhe pjesëmarrja në ngjarje sociale), studentët sportistë gjithashtu kanë aktivitetet e tyre lidhur me sportin (stërvitje çdo ditë, vizita tek fizioterapisti për trajtimin e lëndimeve, udhëtimet për ndeshjet jashtë qytetit/shtetit, studimi i strategjive të ekipit etj) (Etzel, Ferrante, & Pinkney, 1996)[23] (Martens & Lee, 1998)[24] (Street, 1999)[25]. Ata përballen vazhdimisht me sfidën e balancimit të roleve si student dhe sportist (Street, 1999).

Në varësi të Kategorisë ku studentët sportistë janë pjesëmarrës, eksperienca e tyre e jetës studentore diferencon nga ajo e studentëve jo sportistë, për shkak të impenjimit sportiv. Ka disa aspekte në të cilat pjesëmarrja sportive interferon në eksperiencën dhe formësimin e studentëve. Ka shumë aspekte pozitive të pjesëmarrjes në sport, por fatkeqësisht, pjesëmarrja në aktivitete sportive sjell edhe pasoja negative.

Në disa institucione dhe në disa sporte, trajnerët dhe bashkëmoshatarët theksojnë rëndësinë e fitores me çdo kusht dhe miratojnë sjelljet agresive. Disa studiues thonë se këto qëndrime mund të kontribuojnë në tolerimin dhe nxitjen e agresionit seksual, homofobisë, përdorimit të steroideve, ofendimeve verbale dhe një imazhi të pashëndetshëm të trupit

[23] Edward F. Etzel, Anthony P. Ferrante & John W. Pinkney (red.), *Counseling College Student-Athletes: Issues and Interventions* (botimi i 2-të), Fitness Information Technology, Morgantown, West Virginia, SHBA, 1996.

[24] Matthew P. Martens & Fong K. Lee, *Promoting Life-Career Development in the Student Athlete: "How Can Career Centers Help?"*, Journal of Career Development, Springer, New York, SHBA, 1998, fq. 123

[25] J. Street, *Self-Efficacy: A Tool for Providing Effective Support Services for Student-Athletes*, në S. Robinson (red.), *Gaining the Competitive Edge: Enriching the Collegiate Experience of the New Student-Athlete* (Monograph Series No. 27), National Resource Center for The First-Year Experience and Students in Transition, Columbia, South Carolina, SHBA, 1999, fq. 29

(Hebel, 1999)[26] (Presley, Meilman, Cashin, & Leichliter, 1997)[27] (Karl & Delaney, 1993)[28]. Sipas Jordan dhe Denson (Jordan & Denson, 1990)[29] programimi i orarit të ditës për një student sportist është shumë më jo fleksibël dhe kërkues krahasimisht me studentët e tjerë. Lidhur me këtë, problematikë tjetër është gjithashtu izolimi nga studentët e tjerë për shkak të kalimit të kohës më tepër me sportistë të tjerë (Lanning & Toye, 1993)[30]. Si rrjedhojë, sportisti veçohet më tepër nga kolegët e tij të universitetit, gjë që ndikon në qasjen e tij ndaj identitetit si student dhe jetës studentore.

Ndjenja e identitetit është një tjetër aspekt që mund të ndikojë negativisht në përvojën si student sportist. Studentët sportistë marrin përforcime pozitive dhe negative nga mjedisi përreth tyre. Këto përforcime mund të ndihmojnë në zhvillimin e një identiteti si student dhe sportist, ose mund ta nxisin studentin sportist të përqendrohet vetëm në një aspekt të këtij identiteti, në dëm të tjetrit. Për shumë studentë sportistë, identiteti si student kalon në plan të dytë përballë atij si sportist. Kjo mund ta nxisë sportistin të neglizhojë aktivitetet dhe përgjegjësitë që janë të nevojshme për të qenë një student i suksesshëm (Martens & Lee, 1998 cituar në Watt & Moore, 2001)[31]. Thënë këto, vlerësimi i rregullt i Burnout kontribuon në zhvillimin e përgjithshëm të sportistëve të rinj duke adresuar në mënyrë aktive shqetësimet për shëndetin mendor. Kjo qasje jo vetëm që përmirëson performancën sportive, por gjithashtu mbështet rritjen gjithëpërfshirëse të studentëve-sportistë, duke i përgatitur ata për sukses si në fushë ashtu edhe jashtë saj. Sa më shpejt të jetë e mundur të pikaset Burnout aq më shpejt mund të menaxhohet dhe aq më pak dëme sjell në jetën e individit.

---

[26] Sara Hebel, *Supreme Court Says Colleges May Be Liable for Student-on-Student Harassment*, The Chronicle of Higher Education, Washington, D.C., SHBA, 25 maj 1999, Vol. 45, fq. A40

[27] Cheryl A. Presley, Philip W. Meilman, Jeffrey R. Cashin & Jami S. Leichliter, *Alcohol and Drugs on American College Campuses: Issues of Violence and Harassment*, Southern Illinois University, Core Institute, Carbondale, Illinois, SHBA, 1997.

[28] Kevin B. Fields & Michael Delaney, *Controversies in Sports Medicine*, në W. D. Kirk & S. V. Kirk (red.), *Student Athletes: Shattering the Myths & Sharing the Realities*, American Counseling Association, 1993, fq. 143

[29] J. M. Jordan & E. L. Denson, *A Multicultural Perspective on Career*, Journal of Counseling & Development, Vol. 69, Nr. 1, 1990, fq. 95

[30] W. Lanning & P. Toye, *Counseling the Student-Athlete*, në W. D. Kirk & S. V. Kirk (red.), *Student Athletes: Shattering the Myths & Sharing the Realities*, American Counseling Association, 1993, fq. 167

[31] Sharon K. Watt & James L. Moore III, *Who Are Student Athletes?*, New Directions for Student Services, Wiley, 2001, Nr. 93, fq. 7

Instrumenti Matës

Sipas temës të zgjedhur në këtë punim është përdorur metoda sasiore për të eksploruar nivelet e burnout-it tek studentët-sportistë me metodën e pyetësorit, pasi mundëson mbledhjen efikase të të dhënave nga një kampion relativisht i madh, duke siguruar rezultate të matshme dhe të krahasueshme.

Ky punim konsiston në një model hulumtimi përfaqësimor, në të cilin është përdorur pyetësori "Athlete Burnout Questionnaire" (Raedeke & Smith, 2001)[32]. Ky pyetësor përmban 15 pyetje që tentojnë të masin tre komponentë kyç lidhur me burnout te sportistët:

matjen e lodhjes fizike/emocionale (E=emotional/physical exhaustion);

matjen e sensit të reduktuar të arritjeve (RA=reduced sense of accomplishment), dhe

matjen e zhvlerësimit (D=devaluation).

Kalkulimi bëhet nëpërmjet shkallës Likert, përkatësisht:

1- pothuajse asnjëherë
2- rrallë
3- ndonjëherë
4- shpesh
5- pothuajse gjithmonë.

Dy prej pyetjeve (1 dhe 14) në pyetësor bëhen me kalkulim të kundërt.

Nga këto tre kategori për studimin është marrë në shqyrtim lodhja emocionale dhe fizike, pyetjet e së cilës mund të qëndrojnë më vete dhe të maten bazuar në manualin përkatës të pyetësorit, i cili është i validuar dhe me shkallë besueshmërie të lartë.

Për analizën e të dhënave është përdorur SPSS, duke bazuar përllogaritjet te "Manuali i Pyetësorit të Burnout për Sportistët" (Smith &

[32] Thomas D. Raedeke & Alan L. Smith, *Development and Preliminary Validation of an Athlete Burnout Measure*, Journal of Sport & Exercise Psychology, Vol. 23, Nr. 4, 2001, fq. 281

Raedeke, 2009)[33]. Cilido pjesëmarrës që ka plotësuar pyetësorin e shpërndarë nëpërmjet Google Forms ka shprehur aprovimin për plotësimin e pyetësorit duke i ruajtur anonimatin dhe vullnetin e tyre të lirë për të marrë pjesë dhe për t'u përgjigjur pyetjeve të pyetësorit. Megjithëse ky studim ofron njohuri të vlefshme mbi burnout-in tek studentët-sportistë, është e rëndësishme të pranojmë disa kufizime.

Së pari, përdorimi i një pyetësori vetë-raportues (ABQ) mund të sjellë pirje në përgjigje, pasi pjesëmarrësit mund të përgjigjen në mënyra që konsiderohen shoqërisht të pranueshme ose të nënvlerësojnë nivelin e stresit që përjetojnë.

Së dyti, metoda e studimit kufizon aftësinë për të përcaktuar tërësisht marrëdhënie shkak-pasojë, pjesë kjo që mund të zgjerojë qasjen dhe konceptin e funksionimit të Burnout.

Së treti, kampioni përfshiu vetëm 98 pjesëmarrës, shumica prej të cilëve vinin nga një nivel sportiv i caktuar (kryesisht volejboll dhe futboll) ose nga një kontekst i caktuar akademik (fakultetet sportive), gjë që mund të kufizojë vlefshmërinë e përgjithësimit të rezultateve në popullata më të gjera të studentëve-sportistë.

Mbrojtja e studentëve sportistë, baza ligjore dhe qasja institucionale

Lodhja emocionale dhe gjendja fizike tek studentët e angazhuar me sportet, duke gjykuar përtej dimensionit psikologjik, duhet vëzhguar edhe në këndvështrimin ligjor dhe qasjen institucionale, sepse në këtë binom kemi të bëjmë me një marrëdhënie të dyfishtë, jemi në kushtet e zhvillimit akademik dhe sportiv. Në këtë këtë këndvështrim, ajo që shquajmë nga rezultatet e këtij studimi, është *prevalenca e konsiderueshme e lodhjes emocionale dhe fizike*, paçka se në nivel mesatar, por nuk mund të trajtohen vetëm duke u parë si përvoja personale të studentëve/sportistëve, por edhe si tregues të nevojës për ndërhyrje të mirë-organizuara nga institucionet e arsimit sportiv (konkretisht atij të lartë), si edhe strukturat sportive. Gjetjet e studimit nxjerrin në pah nevojën për një qasje ndryshe dhe vëmendje institucionale, si edhe ligjore, në mbështetje të mirëqenies së studentëve të angazhuar me sport, por edhe për

[33] Thomas D. Raedeke & Alan L. Smith, *The Athlete Burnout Questionnaire Manual*, Fitness Information Technology, Morgantown, West Virginia, SHBA, 2009.

të parandaluar apo të paktën minimizuar riskun e lodhjes psikologjike në terma afatgjatë.

Si referencë/bazë parësore normative e gjejmë tek Ligji Nr. 79/2017 PËR SPORTIN", i ndryshuar, i cili që në Nenin e parë përcakton qëllimin e këtij ligji, duke përfshirë me përgjegjësi institucionet e pushtetit vendor dhe qendror, si edhe në drejtim të organizimit dhe mbështetjes ligjore e financiare.[34] Këto detyrime janë ngarkuar edhe nga Karta Europiane e Sportit[35] duke nxjerrë në pah se veprimtaria sportive nuk merret në konsideratë vetëm në aspektin dhe logjikën e performancës dhe konkurrencës, por ajo vendoset nën një regjim mbrojtjeje, garanti ligjor, si edhe mbështetjeje apo përgjegjësie publike. Nga kjo kuptojmë, se mbrojtja e studentëve sportistë nuk duhet kuptuar vetëm në aspektin e ngushtë si (1) nxitja e pjesëmarrjes në aktivitete, por edhe si (2) mbrojtje dhe garant të krijimit të kushteve për ta bërë këtë pjesëmarrje të shëndetshme, të qëndrueshme dhe në një korrelacion me dinjitetin dhe mirëqenien e vetë studentit/sportistit. Prandaj, në rastin e tyre, ky proces sado kompleks, duhet të marrë në konsideratë këtë marrëdhënie të dyfishtë, duke synuar balancimin e ngarkesës që prodhon, asaj sportive dhe akademike.

Këtë ligjvënësi ka tentuar ta rregullojë me Nenin 6 të Ligjit për Sportin tek Pjesa "Edukimi fizik dhe sporti në sistemin arsimor"[36], duke i konsideruar ndryshe me statusin *'studentë që ushtrojnë veprimtari sportive'*, për të vijuar më pas me institucionet përgjegjëse *'aktivitetet sportive në institucionet arsimore universitare'*, *'shoqatat sportive universitare'*, *'Federata Shqiptare e Sportit Universitar'*, në funksion të të cilëve (studentëve sportistë), kuptojmë se renditen tek individët, që kryejnë paralelisht edhe studimet, edhe veprimtari sportive (kryesisht për studentët që ndjekin sportet si studime universitare). Duke synuar (ligji) që institucionet përgjegjëse të krijojnë kushtet e nevojshme organizative,

[34] Neni 1, Ligji Nr. 79/2017 PËR SPORTIN", i ndryshuar, https://qbz.gov.al/eli/ligj/2017/04/27/79-2017, aksesuar së fundmi më 08/05/2026

[35] Revised European Sports Charter, Recommendation CM/Rec(2021)5 Adopted by the Committee of Ministers on 13 October 2021, Enlarged Partial Agreement on Sport (EPAS), Council of Europe, Strasbourg, June 2022, https://edoc.coe.int/en/sport-for-all/11299-revised-european-sports-charter.html, aksesuar së fundmi më 08/05/2026

[36] Neni 6, Ligji Nr. 79/2017 PËR SPORTIN", i ndryshuar, https://qbz.gov.al/eli/ligj/2017/04/27/79-2017, aksesuar së fundmi më 08/05/2026

drejtuese, por edhe duke mbikëqyrur sportin në nivel universitar për të marrë masa parandaluese dhe mbështetëse.

Aktualisht, merren masa për krijimin e kushteve të përshtatshme për ndihmesën e studentëve që janë në pozita të disfavorshme fizike, si edhe duke favorizuar studentët elitarë, të paktën nga Universiteti i Sporteve të Tiranës.[37]

Por ç'ndodh me studentët që janë në mes të këtij përcaktimi, pra nuk i takojnë asnjërës prej kategorive?

Si trajtohen studentët që kanë zgjedhur të ndjekin studimet universitare në një drejtim tjetër, jo për sporte, por i takojnë një skuadre, si studentë – sportistë?

A organizohen senaca këshillimi me psikologë apo ka një sistem monitorimi dhe vlerërimi të ngarkesës psikologjike dhe lodhjes së këtyre studentëve?

Praktika dëshmon se janë të paqarta mënyrat e trajtimit të studentëve që nuk ju takojnë këtyre kategorive të favorizuara 'formalisht', por që ballafaqohen me ngarkesën e dyfishtë akademike dhe sportive. Si edhe, po e paqartë është situata e studentëve që ndjekin drejtime të ndryshme në studimet universitare (jo domosdoshmëritsht për sporte), por janë pjesë e ekipeve sportive ne kompeticione profesionale. Pra, në të njëjtën linjë, rezulton se nuk ka mekanizma të formalizuar në aktet e brendshme rregulluese të IAL-ve për vlerësimin dhe këshillimin psikologjik, qoftë edhe për monitorimin e vazhduar të ngarkesës emocionale dhe fizike, për këtë kategori të studentëve. Zbrazëtira të tilla normative, tregojnë se njohja e ligjit për sportin (universitar) nuk pasohet me masa të unifikuara dhe standarde mbështetëse në të gjitha IAL-të në Shqipëri.

Nga të dhënat e grumbulluara dominon përshtypja e studentëve sportistë, se 'de facto', favorizohen gjatë programit mësimor, por jo

[37] Lead Reviewer Mr. Grant Horsburgh, Reviewers Dr. Gjergj Thomai dhe Ms. Penny Renwick, Institutional Review of Higher Education Institutions in Albania, Report of the Institutional Review of Sports University of Albania, Tirana, April 2017, Evaluation Area 5, Students and their Support, 5.4. /b, Students confirmed the availability of flexible individualized study programmes for elite students (SER p. 46; 5; 71; 158; FE14; M3; M5), pg. 23

'formalisht', sepse në rregulloret e IAL-ve nuk parashikohen kushte lehtësimi, apo programe akademike të personalizuara, duke përfshirë integrimin e veprimtarisë sportive. Studentët shprehen të mbështetur, duke vlerësuar edhe faktin që disa prej IAL-ve ofrojnë bursa studimi (deri në 100%) për studentët e talentuar që zgjedhin të angazhohen me ekipin e universitetit, duke i lehtësuar financiarisht, por jo në kontekstin që kërkon ligji apo Karta Europiane e Sportit. Tek Karta[38] (Neni 8, pika dy, Integriteti), kërkon që në sport integriteti të mos limitohet dhe mjaftohet vetëm me garantin dhe përkushtimin për ndershmërin e garave, por të përfshijë kujdesin ndaj edukimit, parandalimit dhe sidomos mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke parashikuar që institucionet arsimore dhe të rrjetit, të jenë të kujdesshme gjatë identifikimit dhe parandalimit të problemeve që rrjedhin nga ky aktivitet i vazhduar, që sipas këtij studimi, kjo dispozitë mund të gjejë shprehje për të rekomanduar universitetet të jenë të kujdeshëm për të vlerësuar riskun e lodhjes emocionale apo fizike/burnout tek studentët-sportistë dhe të konsiderohet si çështje e sigurimit të integritetit të IAL-ve që aplikojnë sportet në institucionet e tyre dhe kanë si pjesë përbërse studentë sportistë .

Në këtë kontekst, edukimi ligjor publik mbi çështjen e lodhjes fizike dhe emocionale, si përllogaritjes së riskut për studentët e angazhuar me sport, duhet kuptuar si pjesë e pandarë e detyrimeve institucionale të cilët duhet të garantojnë zhvillimin e veprimtarisë sportive në kushte të përshtatshme me të drejtën për arsimin universitar, por edhe për mirëqenie. Duhet të kapërcehet hendeku i vetëm respektimit formal të dispozitave (si në planin ligjor kombëtar, po ashtu edhe në atë ndërkombëtar/europian), për të hartuar me ekspertë të fushës dhe për të siguruar më pas, ndërgjegjësimin e profesorëve, trajnerëve, gjithë stafit akademik universitar të përfshirë, si edhe opionion publi dhe vetë studentët, se mbingarkesa e marrëdhënies së dyfishtë sportive dhe akademike, nuk lidhet vetëm me arritjet, performancën e studentëve dhe rrjedhimisht sukseset dhe trofetë, por është një çështje që kërkon respektimin e të drejtave themelore të studentëve, mbrojtjes së shëndetit të tyre fizik dhe mendor, si edhe ofrimi i kësaj sigurie për interesin më të lartë të studentëve.

[38] Revised European Sports Charter, Recommendation CM/Rec(2021)5 Adopted by the Committee of Ministers on 13 October 2021, Enlarged Partial Agreement on Sport (EPAS), Council of Europe, Strasbourg, June 2022, https://edoc.coe.int/en/sport-for-all/11299-revised-european-sports-charter.html, aksesuar së fundmi më 08/05/2026, fq. 20

Gjetje

Kategoria e Lodhjes Emocionale/Fizike vlerëson shkallën në të cilën studentët-sportistë ndihen të rraskapitur, si mendërisht ashtu edhe fizikisht, si pasojë e kërkesave që lidhen me aktivitetin e tyre sportiv. Ky dimension është qendror në konceptin e burnout dhe shpesh konsiderohet si simptoma më e menjëhershme dhe më e dallueshme te atletët që përjetojnë stres të zgjatur.

Besueshmëria e brendshme e kësaj nënshkalle, e matur përmes koeficientit Cronbach's Alpha, ishte 0.79, duke treguar një nivel po ashtu të kënaqshëm besueshmërie. Kjo vlerë bie brenda kufijve të pranuar në mënyrë të përgjithshme dhe sugjeron se pyetjet që përdoren për të matur lodhjen emocionale dhe fizike kanë domethënie statistikore.

Mesatarja e pikëve në këtë nënshkallë ishte 13.23, duke treguar një nivel të moderuar lodhjeje në të gjithë kampionin. Kjo nënkupton se, në përgjithësi, studentët-sportistë raportuan ndjenja të caktuara të lodhjes ose rraskapitjes si rezultat i pjesëmarrjes në sport. Përjetimi i lodhjes ka të ngjarë të ndikohet nga një kombinim faktorësh si intensiteti i stërvitjes fizike, ngarkesa akademike, presioni nga garat dhe mungesa e kohës për rikuperim.

Devijimi standard prej 3.60 dhe varianca prej 13.06 tregojnë një shkallë të moderuar të shpërndarjes së të dhënave, që do të thotë se ndërsa shumë studentë-atletë u grupuan rreth mesatares, disa raportuan nivele dukshëm më të larta ose më të ulëta të lodhjes. Kjo ndryshueshmëri nënkupton dallime individuale në mënyrën se si atletët e rinj përjetojnë dhe përballen me kërkesat emocionale dhe fizike, të cilat mund të eksplorohen më tej përmes krahasimeve sipas variablave demografikë si gjinia, mosha apo lloji i sportit. Megjithatë, kurba e shpërndarjes së matur është normale, prandaj janë përdorur teste parametrike për matje të mëvonshmë me variabla të tjera.

Hapësira e pikëve shtrihej nga minimumi 5 deri në maksimumin 21, çka sugjeron se ndërsa disa sportistë raportuan nivele relativisht të ulëta të lodhjes, të tjerë arritën kufirin e sipërm të nënshkallës. Më tej, lidhur me po këto të dhëna shohim prevalencën e pjesëmarrësve të rezultuar me nivel të lartë të shkallës së lodhjes emocionale dhe fizike (7.1%), të ulët (30.6%) dhe mesatare (62.2%) të cilat janë ilustruar edhe në Figurën e mëposhtme.



Figure 1 Shpërndarja e nivelit të lodhjes emocionale dhe fizike të pjesëmarrësve

Burimi: Studimi "Prevalenca e Shkallës së Sindromës Burnout te Studentët-Sportistë të Grupmoshës 18-21 Vjeçare (Republika E Shqipërisë)", Fig. 5, fq. 30, Universiteti Barleti, Tiranë 2025

Po ashtu, u krye një T-test për mesatare të pavarura (Independent Samples t-test) për të hetuar nëse studentët-sportistë meshkuj dhe femra ndryshonin në raportim të niveleve të Lodhjes Emocionale/Fizike. Analiza nuk zbuloi asnjë diferencë statistikisht të rëndësishme në Lodhjen Emocionale/Fizike midis meshkujve dhe femrave, me një vlerë p prej 0.213 ($p > 0.05$). Kjo tregon se çdo ndryshim i vëzhguar në mesataret e lodhjes ka të ngjarë të jetë rezultat i rastësisë dhe jo një diferencë reale në popullatë. Me fjalë të tjera, studentët-sportistë meshkuj dhe femra në këtë kampion raportuan nivele të ngjashme të lodhjes emocionale dhe fizike që lidhet me përfshirjen e tyre në sport. Këto rezultate sugjerojnë se gjinia nuk ndikon në mënyrë të rëndësishme në shkallën e lodhjes që përjetojnë studentët-sportistë nga 18 deri në 21 vjeç brenda këtij studimi, duke theksuar se lodhja emocionale dhe fizike është një përvojë e përbashkët ndërmjet gjinive në kontekstin e sportistëve që frekuentojnë universitetin në të njëjtën kohë.

Marrë në konsideratë të tre kategorite e sindromës Burnout, përfshirë këtu edhe lodhjen emocionale/fizike, rezultoi se me rritjen e moshës kishte një rritje domethënëse të nivelit të përgjithshëm të Burnout. Thënë kjo, sportistët që janë studentë në vitet më të larta janë më të rrezikuar ndaj shterjes psikologjike dhe fizike.

Përfundime

Studimi i bërë kishte për qëllim të shqyrtonte përhapjen e burnout tek studentët-sportistë të moshës 18 deri në 21 vjeç, me vëmendje të veçantë ndaj kategorisë së burnout: lodhja emocionale dhe fizike. Duke konsideruar çdo kategori individualisht, lodhja emocionale/fizike kishte përhapjen më të lartë të nivelit mesatar prej 62.2%. Rezultatet treguan se, megjithëse shumica e student-sportistëve nuk përjetojnë nivele ekstreme të shterjes psikologjike, një numër i konsiderueshëm përjeton simptoma të moderuara në të gjitha dimensionet. Lodhja emocionale dhe fizike doli të jetë shqetësimi më i rëndësishëm, duke treguar se kërkesat fizike dhe mendore të vendosura mbi studentët-sportistë mund të jenë një kontribuues kyç në përvojën e tyre të përgjithshme të lodhjes.

Në eksplorimin e korrelacioneve demografike, studimi nuk gjeti një marrëdhënie statistikisht të rëndësishme midis gjinisë dhe Burnout në asnjë prej nënshkallëve ose në matjen e përgjithshme të Burnout. Kjo sugjeron se Burnout ndikon në mënyra të ngjashme tek studentët-sportistë meshkuj dhe femra, të paktën brenda kampionit së studiuar.

Studimi rezultoi se nuk ka një regjim standard, të unifikuar dhe të posaçëm në Shqipëri, mbi edukimin ligjor publik të problematikës së lodhjes fizike dhe emocionale, si edhe të riskut për burnout te studentët-sportistë. Edhe pse kuadri ligjor njeh sportin universitar, në dispozitat përkatëse duhet të shoqërohet me politika, programe, protokolle dhe mekanizma ndërgjegjësues konkrete mbi edukimi ligjor të kësaj kategorie individësh të përfshirë, duke synuar të kapërcehet njohja formale e problemit, drejt marrjes së masave të qarta informuese, parandaluese dhe rrjedhimisht mbështetëse në aspektin isntitucional për studentët sportistë.

Rekomandime

Edukim ligjor dhe ndërgjegjësim mbi shëndetin mendor të studentëve-sportistë, si në nivel universitar ashtu edhe sportive. Njohja me problematikat e sindromës së Burnout në veçanti dhe krijimi i hapësirave për të kontribuar në menaxhimin e stresit dhe përballimin e sfidave personale apo profesionale.

Fuqizimi i një mjedisi sportiv dhe akademik i ekuilibruar, ku brenda mundësive dy institucionet bashkëpunojnë për të krijuar ambient sa më fleksibël dhe komod për studentët-sportistë.

Akses te një psikolog sportiv për të gjithë studentë-sportistët dhe jo vetëm, për të menaxhuar dhe ulur nivelin e Burnout dhe për të rritur performancën në sport dhe më tej.

Kryerje e kërkimeve të mëtejshme mbi sindromën e Burnout, prevalencën, faktorët ndikues dhe pasojat. Studimi dhe monitorimi i vazhdueshëm mund të ofrojë njohuri më të thella dhe të informojë ndërhyrje më të përshtatshme në kohë.

Bibliografia

1. Freudenberger, H. J. (1974). Staff burn-out. Journal of Social Issues, 30(1)
2. Maslach, C., Schaufeli, W. B., & Leiter, M. P. (2001). Job burnout. Annual Review of Psychology, 52(1)
3. Etzel, E. F., Ferrante, A. P., & Pinkney, J. W. (Eds.). (1996). Counseling college student-athletes: Issues and interventions (2nd ed.). Fitness Information Technology.
4. Martens, M. P., & Lee, F. K. (1998). Promoting life-career development in the student athlete: How can career centers help? Journal of Career Development, 25(2)
5. Street, J. (1999). Self-efficacy: A tool for providing effective support services for student-athletes. In S. Robinson (Ed.), Gaining the competitive edge: Enriching the collegiate experience of the new student-athlete (Monograph Series No. 27)
6. Hebel, S. (1999, May 25). Supreme Court says colleges may be liable for student-on-student harassment. The Chronicle of Higher Education, 45
7. Presley, C. A., Meilman, P. W., Cashin, J. R., & Leichliter, J. S. (1997). Alcohol and drugs on American college campuses: Issues of violence and harassment. Southern Illinois University, Core Institute.
8. Fields, K. B., & Delaney, M. (1993). Controversies in sports medicine. In W. D. Kirk & S. V. Kirk (Eds.), Student athletes: Shattering the myths & sharing the realities. American Counseling Association.
9. Jordan, J. M., & Denson, E. L. (1990). Journal of Counseling & Development, 69(1)

10. Lanning, W ., & Toye, P. (1993). Counseling the student-athlete. In W. D. Kirk & S. V. Kirk (Eds.), Student athletes: Shattering the myths & sharing the realities (pp. 167–177). American Counseling Association.
11. W att, S. K., & Moore, J. L., III. (2001). Who are student athletes? New Directions for Student Services, 2001(93), 7–18.
12. Raedeke, T. D., & Smith, A. L. (2001). Development and preliminary validation of an athlete burnout measure. Journal of Sport & Exercise Psychology, 23(4), 281–306.
13. Raedeke, T. D., & Smith, A. L. (2009). The athlete burnout questionnaire manual. Fitness Information Technology.
14. Ligji Nr. 79/2017 PËR SPORTIN", i ndryshuar, https://qbz.gov.al/eli/ligj/2017/04/27/79-2017
15. Revised European Sports Charter, Recommendation CM/Rec(2021)5 Adopted by the Committee of Ministers on 13 October 2021, Enlarged Partial Agreement on Sport (EPAS), Council of Europe, Strasbourg, June 2022, https://edoc.coe.int/en/sport-for-all/11299-revised-european-sports-charter.html
16. Institutional Review of Higher Education Institutions in Albania, Report of the Institutional Review of Sports University of Albania, Lead Review er Mr. Grant Horsburgh, Review ers Dr. Gjergj Thomai dhe Ms. Penny Renwick,Tirana, April 2017, Evaluation Area 5, Students and their Support, 5.4. /b, Students confirmed the availability of flexible individualized study programmes for elite students (SER p. 46; 5; 71; 158; FE14; M3; M5)

STUDIMI I NDËRVEPRIMIT DHE HARMONIZIMIT TË PËRBËRËSVE KYÇ TË SISTEMIT TË BURIMEVE NJERËZORE NË BIZNESET E MËDHA TË QARKUT TË KORÇËS

Assoc. Prof. Dr. Sonela Stillo

"Fan S. Noli" University, Korçë, sonelastillo@yahoo.com

Abstract

Human resources are essential for the functioning of organizations, whether they are large or small, private or public. Although technology evolves every day, human resources continue to have their own essential role. This study focuses on analyzing the role and contribution of human resources in organizations as a strategic partner, as well as the challenges managers face in measuring this contribution and creating a human resource architecture. With a properly developed strategic human resource architecture, managers in all firms can understand how people create value and how to measure the value creation process.

The research focuses on studying the interaction and alignment of human resources in large businesses in the Korçë Region. The study aims to determine the current situation of the key components of the human resource management system in the businesses included in the research, to identify the level of interaction and alignment among the key components of the human resource management system, and to provide recommendations for improving the interaction and alignment of the human resource management system.

Keywords: *human resources, strategy, architecture, interaction, alignment*

Hyrje

Burimet njerëzore janë esenciale për funksionimin e organizatave, qofshin këto të mëdha apo të vogla, private apo publike. Edhe pse teknologjia evoluon çdo ditë, burimet njerëzore kanë rolin absolut në organizata. Pa njerëz nuk mund të ketë organizata, ama pa organizata ka njerëz. Janë ata të cilët marrin vendime për firmat, hartojnë strategji konkurruese dhe i kundërpërgjigjen riskut. Organizatat gjithmonë e më shumë po përballen me presionin për t'u bërë më efikase dhe më efektive nga ana e kostos. Si rezultat, shumë kompani janë drejtuar drejt eksternalizimit dhe internalizimit të burimeve si një mënyrë për të optimizuar operacionet e tyre.

Internalizimi i kapitalit njerëzor i referohet një kompanie që merr përsipër menaxhimin dhe administrimin e rekrutimit, trajnimit, zhvillimit dhe mbajtjes së punonjësve të saj. Kjo do të thotë që kompania do t'i trajtojë këto aktivitete brenda saj dhe do të ketë kontroll mbi procesin e punësimit, hartimin dhe ofrimin e programeve të trajnimit, si edhe menaxhimin e performancës dhe zhvillimin punonjësve. Kjo qasje mund të ofrojë kontroll dhe fleksibilitet më të madh mbi këto funksione dhe mund t'i lejojë një kompanie të përshtasë praktikat e saj të burimeve njerëzore për të përmbushur nevojat dhe qëllimet e saj specifike.

Nga ana tjetër, eksternalizimi i kapitalit njerëzor i referohet një kompanie që i jep disa aspekte të menaxhimit të burimeve njerëzore ofruesve të jashtëm. Kjo mund të përfshijë aktivitete të tilla si rekrutimi, trajnimi, administrimi i pagave dhe përfitimeve dhe madje edhe disa aspekte të menaxhimit të performancës. Eksternalizimi i këtyre aktiviteteve mund t'i kursejë kompanisë kohë dhe para dhe mund të lirojë burime që mund të përdoren për qëllime të tjera. Megjithatë, ai gjithashtu mund të kufizojë potencialisht kontrollin dhe fleksibilitetin e një kompanie mbi praktikat e saj të burimeve njerëzore dhe mund ta detyrojë atë të mbështetet në ekspertizën dhe aftësitë e ofruesit të jashtëm.

Rishikim literature

Burimet njerëzore si një partner strategjik

Rëndësia e burimeve njerëzore. Pse Burime Njerëzore? Pse tani?

Tashmë është e ditur që organizatat në përbërjen e tyre kanë kapital fizik dhe kapital intelektual, por gjithmonë lind pyetja se cili është më i rëndësishëm, kapitali fizik apo kapitali intelekual?

Në shumë industri është e mundur të blihen në tregjet botërore makineri apo pajisje, por aksesi në këto makineri dhe pajisje nuk është faktori dallues, por është aftësia për t'i përdorur ato. Një kompani, e cila i humb të gjitha pajisjet, por mban aftësitë dhe njohuritë e fuqisë së vet punëtore, mund të kthehet në biznes relativisht shpejt, ndërsa një kompani që humb fuqinë e vet punëtore ndërkohë që mban pajisjet nuk do t'a marrrë veten kurrë. Më i rëndësishëm është kapitali njerëzor. Në ekonominë e sotme potenciali strategjik i burimeve njerëzore varet nga roli qendror i aseteve të patrupëzuara dhe kapitalit intelektual.

Interesi, por edhe vështirësia e të parit të njerëzve si lëndë të para dhe trajtimi i tyre në të njëjtën mënyrë si asetet e tjera të prekshme është se ata nuk i përshtaten përkufizimit strikt të një "aseti". Sipas Mayo-s (2001) punonjësit duhet të shihen si asete jo të prekshme, sepse nuk mund të shkëmbehen, le të themi që nuk mund të blihen dhe të shiten sipas dëshirës; kontributi i tyre është individual dhe i ndryshëm; ata nuk mund të vlerësohen sipas parimeve tradicionale financiare.

Megjithatë, paaftësia ose dyshimi i shumë organizatave për të vlerësuar "asetet njerëzore" mund të ketë pasoja të rëndësishme. Së pari, menaxherët që janë të paaftë të vlerësojnë ose të llogarisin vlefshmërinë ose vlerën e individit në organizatë, janë gjithashtu të paaftë të zhvillojnë praktika të burimeve njerëzore, të cilat i reflektojnë këto diferenca në performancë dhe kontributin e punonjësit. Kjo përçan efektivisht zhvillimin e qasjes individuale ose të një qasjeje të diferencuar për menaxhimin e njerëzve, me implikimin se "një masë u përshtatet të gjithëve" do të vazhdojë të adaptohet pothuajse automatikisht. Së dyti, kthimi në investime për trajnim dhe zhvillim do të jetë i vështirë të llogaritet për shkak të paaftësisë menaxheriale për të matur ndryshimet në vlerën e punonjësit përmes rritjes së kompetencës, e cila mund të mund të rrjedhë nga këto investime.

Rishfaqja e këtij interesi në vlerën ekonomike të njerëzvë si burime ose asete, përmes rritjes në atë që mund të përshkruhet si "modeli i shpenzimit" të kontabilitetit të burimeve njerëzore (Fitz-Enz, 2000; Mayo,

2001) konfirmon rëndësinë që ka për organizatat gjetja e mënyrave për të alokuar vlera financiare në vlerat e aseteve të punonjësit dhe për të qenë i aftë të llogarisë vlerën e punësimit të njerëzve përmes matjes dhe vlerësimit sistematik të kostos të tyre dhe vlerës së tyre të kontributeve. Kjo nuk është në asnjë mënyrë një detyrë e lehtë, por megjithatë është një detyrë që shihet si gjithnjë e më e rëndësishme nëse burimet njerëzore duhet të angazhohen dhe të mbështesin programin ekonomik dhe financiar të organizatës. Paradoksi i vazhdueshëm që menaxherët përpiqen të zgjidhin dhe që është thelbësor për të kuptuar sfidat që ata hasin është se punonjësit janë edhe njerëz me kërkesa dhe me ndjeshmëri njerëzore, por janë edhe burime ekonomike me vlera asetesh të diferencuara dhe të ndryshueshme.

Vlera strategjike e kapitalit njerëzor i referohet potencialit të individëve për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e organizatës, për të zbuluar dhe nxjerrë mundësitë e tregut dhe për të neutralizuar angazhimet e mundshme mjedisore (Benn et al., 2014).

Kuadri i zhvillimit të burimeve njerëzore nga partner profesional në partner strategjik

Burimet njerëzore në një organizatë përfaqësojnë një prej investimeve më të mëdha të saj. Edhe pse disa menaxherë të burimeve njerëzore kanë një vizion të zhvilluar mirë të vlerës strategjike të departamentit të burimeve njerëzore, përsëri shumë prej tyre janë skeptikë ndaj rolit të burimeve njerëzore në suksesin e firmës. Ata e njohin frazën "Njerëzit janë aseti ynë më i rëndësishëm", por ajo që ata nuk mund të kuptojnë është se si funksioni i burimeve njerëzore e bën realitet atë vizion. Problemi qëndron në faktin se ndikimi i burimeve njerëzore në performancë është i vështirë për t'u matur. Burimet njerëzore gjithnjë e më shumë po shërbejnë si një partner strategjik, sepse burimi parësor i prodhimit në ekonomi është zhvendosur nga kapital fizik në kapital intelektual (S.Stillo, 2016). Por çdo të thotë të jesh një partner strategjik?

Lepak dhe Snell (2002) theksuan vlerën strategjike dhe veçantinë e kapitalit njerëzor si nxitësi kryesorë i mënyrave të rekrutimit dhe kombinimeve të burimeve njerëzore. Të jesh një partner strategjik do të thotë vështiresi për të tregëtuar dhe imituar burime dhe aftësi të pakta, të përshtatshme dhe të specializuara, të cilat i japin avantazhin konkurrues

firmës. Në qoftë se marrim në konsideratë rezultatet e arkitekturës së burimeve njerëzore (funksionet, sistemin, sjelljet e punonjësve) dhe cilësitë e burimeve njerëzore (fuqi punëtore e aftë dhe e angazhuar, zhvillimin e kompetencave themelore të punonjësve) që janë thelbësore për zbatimin e strategjisë konkurruese, për pjesën më të madhe të firmave këto elemente nuk kanë shumë përshtatje. Edhe kur ka përshtatje, drejtuesit e lartë nuk janë dakord me faktin se burimet njerëzore krijojnë vlerë në organizatë. Asrsyeja e saj është se realiteti i ri ekonomik po ushtron presione mbi burimet njerëzore për të zgjeruar fokusin e vet nga roli administrativ që ka patur tradicionalisht në një rol më të gjerë strategjik. Asetet strategjike bëjnë të mprehtë avantazhin konkurrues të një firmë për një kohë të gjatë dhe njëkohësisht ato janë të vështira për t'u kopjuar.

Dekadat e fundit roli i burimeve njerëzore ka ndryshuar. Në këndvështrimin tradicional menaxherët e shihnin funksionin e burimeve njerëzore si administrativ dhe profesional; stafi i burimeve njerëzore më shumë ka qenë i fokusuar në përfitimet administruese dhe funksione të tjera operacionale, sesa si pjesëmarrës në strategjinë e përgjithshme të firmës. Teoricienët kanë analizuar metodologjinë dhe praktikat të cilat fokusohen në nivelin e punonjësit individual, punën individuale dhe praktikën individuale. Më pas teoricienët filluan të njihnin ndikimin e përshtatjes së sistemeve të burimeve njerëzore në përpjekjet për zbatimin e strategjisë së kompanisë, si edhe vlerësimin e cilësisë së kësaj përshtatjeje. Sot, ka në përdorim shumë lloje modelesh të burimeve njerëzore të cilat konsiderohen si përfaqësuese të vlerësimit të burimeve njerëzore si asete strategjike. Mund të përmendim:

a.Perspektiva e personelit (Biznesi merr në punë dhe paguan njerëz, por nuk fokusohet në marrjen në punë të punonjësve më të mirë apo tek ata që kanë zhvillim të shkëlqyer) b.Perspektiva e kompensimit (Biznesi përdor bonuse, pagesa stimuluese dhe dallime në pagesa për ata që kanë performancë të lartë. Ky është hapi i parë drejt konsiderimit të njerëzve si burim avantazhi konkurrues, por nuk shfrytëzon totalisht përfitimet e burimeve njerëzore si një aset strategjik.

c.Perspektiva e renditjes (Menaxherët e lartë i shohin punonjësit si asete strategjike, por nuk investojnë në rindërtimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore)

d.Perspektiva e performancës së lartë (Ajo që menaxherët duhet të bëjnë është që të zhvillojnë një sistem matjeje i cili tregon bindshëm ndikimin e burimeve njerëzore në performancën e biznesit. Për të dizenjuar një sistem të tillë matjeje duhet që menaxherët të fokusohen tek mënyra se si burimet njerëzore duhet të luajnë një rol themelor në zbatimin e strategjisë së firmës dhe tek ndërtimi i një arkitekture strategjike të burimeve njerëzore të zhvilluar siç duhet, me qëllim që të kuptohet se si njerëzit krijojnë vlera dhe si të matet procesi i krijimit të saj. Nëse funksioni i burimeve njerëzore nuk mund të tregojë se ajo shton vlerë, ai rrezikon të dalë jashtë përdorimit, por ama me qëndrimin e duhur dhe mjetet e duhura të matjes, arkitektura e burimeve njerëzore mund të bëjë diferencën midis një kompanie që mban të njëjtin hap me konkurencën dhe një tjetre që përparon më shumë se konkurenca.

Arkitektura e burimeve njerëzore si një aset strategjik

Për t'a kuptuar dhe studiuar siç duhet ndërveprimin dhe harmonizimin e përbërësve kyç të sistemit të burimeve njerëzore, së pari duhet të qartësohet kuptimi i arkitekturës së burimeve njerëzore.

Ka shumë paqartësi rreth termit arkitekturë e menaxhimit të burimeve njerëzore. Becker dhe Gerhart (1996) ishin autorët e parë që përdorën këto terma në tekstet mbi sistemet e menaxhimit të burimeve njerëzore. Në këto diskutime, ata evokuan lidhjen midis filozofisë së menaxhimit të burimeve njerëzore, politikës së menaxhimit të burimeve njerëzore dhe metodës ose veprimeve të menaxhimit të burimeve njerëzore.

Më pas Lepak dhe Snell (2002) e përdorën termin disi ndryshe. Ata flasin për pamjen e përgjithshme se si drejtuesit e biznesit përdorin lloje të ndryshme të burimeve njerëzore për të arritur qëllimet e tyre. Sipas Lepak dhe Snell (2002), kapitali njerëzor është qendra kryesore e krijimit të vlerës dhe përcaktuesi i aseteve organizative. Këta dy ekspertë krijuan një kornizë të quajtur arkitektura e burimeve njerëzore.

Arkitektura e burimeve njerëzore mund të përkufizohet si struktura dhe dizajni i përgjithshëm i sistemit të burimeve njerëzore të një kompanie. Ajo përfshin politikat, proceset dhe sistemet që një kompani përdor për të menaxhuar kapitalin e saj njerëzor. Kjo përfshin rekrutimin, punësimin,

trajnimin dhe zhvillimin, menaxhimin e performancës, kompensimin dhe përfitimet, si dhe marrëdhëniet me punonjësit (S.Stillo, 2016).

Arkitektura e burimeve njerëzore gjithashtu merr në konsideratë elementët unikë dhe të vlefshëm të kapitalit njerëzor të kompanisë, i ndan dhe i menaxhon ato në një mënyrë që maksimizon vlerën dhe përputhet me qëllimet strategjike të kompanisë.

Ajo përfshin; përcaktimin se cilat role dhe funksione duhen internalizuar dhe cilat duhen eksternalizuar, bazuar në karakteristikat e tyre unike dhe vlerën që ato i ofrojnë organizatës, duke rishikuar dhe përditësuar rregullisht arkitekturën e burimeve njerëzore për të siguruar që ajo të mbetet në përputhje me qëllimet në ndryshim të kompanisë dhe kushtet e tregut.

Arkitektura e burimeve njerëzore është procesi i identifikimit dhe kombinimit të elementëve përkatës të menaxhimit të burimeve njerëzore për të krijuar dhe paraqitur një pamje të burimeve njerëzore (HR) të një organizate në të cilën sinergjitë midis punonjësve, sistemit të burimeve njerëzore (HRS), aktiviteteve të burimeve njerëzore dhe misionit dhe qëllimeve të organizatës janë të vetëkuptueshme (Shokrollahi et al., 2020). Arkitektura e burimeve njerëzore kërkon të transformojë qasjen e një organizate ndaj HRM-së për të reflektuar përbërjen njerëzore të organizatës dhe paraqitjen e saj ndaj kërkesave të reja me fokus tek njerëzit si një avantazh i rëndësishëm konkurrues i organizatës (Ranjbarian dhe Azizi (2014). Potencialisht, arkitektura e HR-së mund të jetë një aset strategjik për organizatën, si dhe një burim i avantazhit konkurrues të qëndrueshëm (Luddin dhe Suyatno, 2019).

Arkitektura e burimeve njerëzore është një mekanizëm për menaxhimin e burimeve njerëzore të bazuar në njohuri. Në arkitekturën e burimeve njerëzore nga njëra anë ekziston organizata që shpenzon të gjitha burimet e saj për të përmbushur misionet e saj dhe nga ana tjetër ka njerëz që ofrojnë një avantazh konkurrues të qëndrueshëm për të (Zare, 2019). Arkitektura e burimeve njerëzore kërkon studimin dhe përcaktimin e arkitekturës së burimeve njerëzore aktuale të organizatës dhe qëllimi i saj është të nxjerrë në pah fytyrën njerëzore të organizatës duke punësuar njerëz të kualifikuar në aspektin e krijimit të vlerës dhe njohurive unike në organizatë në përputhje me misionin dhe strategjitë e saj. Individët të cilët

mund të përdorin njohuritë e tyre unike për të krijuar vlerë jo vetëm në formën e një pune specifike, por edhe në kuadër të misionit dhe qëllimeve të organizatës (Happell et al., 2021). Nga ana tjetër, me të gjitha karakteristikat e burimeve njerëzore dhe vlerën e tyre në organizata dhe sipas ndarjes së organizatave në publike, private dhe lokale, ekziston një detyrim për të përdorur arkitekturën e burimeve njerëzore; sepse hartimi i një modeli të arkitekturës së burimeve njerëzore për bashkitë është një nga çështjet më të rëndësishme (singh et al., 2019).

Arkitektura e Burimeve Njerëzore të firmës përbëhet nga tre elementë:

Funksioni i burimeve njerëzore

Sistemi i burimeve njerëzore

Sjellja e punonjësve



Figura 2.1 Arkitektura strategjike e burimeve njerëzore

Burimi: Autori

Funksioni i burimeve njerëzore

Funksioni i burimeve njerëzore të një organizate është të hartojë strategjinë e saj. Kjo realizohet nga profesionistët e burimeve njerëzore dhe për ta bërë të mundur një gjë të tillë kërkohen kompetenca të reja nga ana e profesionistëve të burimeve njerëzore. Duke qenë një partner strategjik kërkohet që profesionistët të bëjnë gjëra të ndryshme, të shfaqen në një rol

komplet ndryshe. Menaxhimi i burimeve njerëzore ka dy dimensione themelore :

Menaxhim teknik i burimeve njerëzore, i cili ka të bëjë me dhënien e bazave të burimeve njerëzore të tilla si: marrja në punë, kompensimet dhe përfitimet.

Menaxhim strategjik i burimeve njerëzore, që ka të bëjë me dhënien e atyre shërbimeve në një mënyrë që mbështet direkt zbatimin e strategjisë së organizatës .

Pjesa më e madhe e menaxherëve janë të aftë për të dhënë aktivitetet teknike dhe shumë pak meanaxherë japin aktivitetet strategjike (këtu futen profesionistët e burimeve njerëzore.)

Sistemi i burimeve njerëzore

Praktikat dhe politikat janë elementët kryesorë të sistemit. Të dyja këto, praktikat dhe politikat të renditura strategjikisht çojnë në një performancë të lartë. Modeli i këtij sistemi quhet "sistemi i punës me performancë të lartë". Në një sistem pune me performancë të lartë, çdo element i sistemit të burimeve njerëzore projektohet për të maksimizuar të gjithë cilësinë e kapitalit njerëzor në organizatë. Për të krijuar dhe mbajtur një kapital të talentuar njerëzor, sistemi i punës me performancë të lartë duhet që të :

- lidhë vendimet e veta për zgjidhje dhe të promovojë me modelet e vlefshme të kompetencave.
- zhvillojë strategji që sigurojnë mbështetje efikase
- miratojë kompensimin dhe politikat e menaxhimit të performances, të cilat tërheqin, mbajnë dhe motivojnë punonjësit me performancë të tillë.

Me qëllim që burimet njerëzore të krijojnë vlera, një organizatë duhet të strukturojë çdo element të sistemit të vet të burimeve njerëzore në mënyrë që të nxjerrë në pah mbështetjen dhe të forcojë një fuqi punëtore me performancë të lartë. Organizatat me sisteme pune me performancë të lartë i përshtasin praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore shumë ndryshe nga firmat me performancë të ulët.

Ato i dedikojnë burime të konsiderueshme marrjes në punë dhe zgjedhjes.

Ato trajnojnë më shumë cilësi dhe bëjnë më tepër menaxhim performance dhe lidhin kompensimin me të.

Ato përdorin grupet e punës në pjesën më të madhe.

Dyfishojnë numrin e profesionistëve të burimeve njerëzore.

Zhvillojnë një qëllim të qartë strategjik dhe e komunikojnë atë me efikasitet tek punonjësit.

Zhvillojnë një sistem të detajuar matjeje për të komunikuar tek punonjësit informacionin jo financiar.

Sitemi i punës me performancë të lartë është në vetvete një sistem zbatimi strategjie, i futur brenda sistemit të zbatimit të strategjisë së firmës. Burimet njerëzore gërshetohen me këtë sistem të madh në shumë pika të ndryshme dhe ndoshta me elemente të shumtë të sistemit të burimeve njerëzore në të njëjtën pikë. Të kuptuarit sesi identifikohen këto pika gërshetimi dhe mënyrën sesi të përshtasim sistemin e burimeve njerëzore ashtu si duhet, janë çelësi për të siguruar një rol strategjik.

Sjelljet strategjike të punonjësve

Sjelljet strategjike përkufizohen si një grup sjelljesh prodhimtare që shërbejnë direkt në zbatimin e strategjisë së firmës.

Këto sjellje strategjike ndahen në dy kategori :

E para, janë sjelljet themelore që dalin direkt nga kompetencat themlore të sjelljes të përcaktuara nga organizata. Këto janë sjellje që konsiderohen elementare për suksesin e saj në të gjitha nivelet dhe departamentet.

E dyta, janë sjelljet specifike në varësi të situatës që janë thelbësore në pikat kyçe të zinxhirit të vlerës të njësisë së biznesit .

Përqendrimi në sjellje ku përfshihen të gjitha përpjekjet për të ndikuar dhe matur kontributin e burimeve njerëzore në performance e firmës është një sfidë. Cilat sjellje janë më të rëndësishme? Si duhet të "menaxhohen ato"? Për këtë duhen pasur parasysh disa aspekte. Së pari, rëndësia e sjelljeve do të përcaktohet nga rëndësia e tyre në zbatimin e strategjisë së saj. Si menaxhohet kjo? E rëndësishme është që të kuptohet se

si njerëzit dhe proceset brenda firmës krijojnë në të vërtetë vlera. Kjo analizë do të zbulojë të dyja llojet e sjelljeve që kërkohen në të gjithë firmën dhe ato me vlerë specifike në pikat kyç në zinxhirin e vlerave. Së dyti, është e rëndësishme të mbahet parasysh se ato nuk ndikojmë direct sjelljet strategjike. Ato janë rezultati final i arkitekturës së madhe të burimeve njerëzore. E rëndësishme është sidomos ndikimi i një sistemi të burimeve njerëzore që përputhet me strategjinë e firmës.

Përputhja e matjes së performancës dhe zbatimit të strategjisë

Të gjithë e njohin shprehjen : "Çfarë matet menaxhohet dhe çfarë menaxhohet përmbushet", por problemi qëndron në vërtetësinë e saj. A mundet që matja e proceseve organizative të sigurojë avantazh konkurrues? Zhvillimi i kompetencës së matjes është i rëndësishëm, sepse shton vlera në nivel të firmës, por pak menaxherë kanë kompetenca të forta në këtë fushë. Ajo që duhet të bëjnë është të përpunojnë dhe aftësitë e tyre matëse duke mësuar rreth çështjeve të financës dhe llogaritjes, sepse e rëndësishme është matja e performances së biznesit nga perspektiva e zbatimit të strategjisë. Në këtë këndvështrim studiuesit Robert Kaplan dhe David Norton kanë prezantuar metodën e tyre “Karta e balancuar e rezultateve”. Për të përdorur këtë metodë një organizatë duhet të specifikojë jo vetëm elementët financiarë të zinxhirit të vlerës, por gjithashtu edhe klientin, biznesin dhe elementët e të mësuarit dhe të rritjes. Më pas firma duhet të zhvillojë mënyra të prekshme për të vlerësuar secilën prej tyre. Premisa e kesaj metode është që menaxherët e lartë t’i kushtojnë vëmendje dimensioneve financiare të performances dhe jo mjaftueshëm vëmendje forcave që drejtojnë ato rezultate. Kjo ndodh sepse i gjithë sistemi i matjes së kartës së balancuar të rezultateve i nxit menaxherët të angazhohen në mënyrë aktive në procesin e zbatimit të strategjisë, sesa thjesht të monitorojnë rezultatet financiare. Duke specifikuar masat e procesit jetësor, duke i vlerësuar ato dhe duke komunikuar rregullisht performance e firmës mbi këto kritere tek punonjësit, menaxherët sigurojnë se e gjithë organizata merr pjesë në zbatimin e strategjisë. Metoda e kartës së balancuar të rezultateve e bën strategjinë çështje për këdo.

Metodologjia e përdorur

Për të realizuar studimin dhe për të hulumtuar ndërveprimin dhe harmonizimin e përbërësve kyc të sistemit të burimeve njerwzore, u fokusuam tek bizneset e mëdha të cilat zhvillojnë aktivitetin në Qarkun e Korçës. Studimi u dizenjua në mënyrë cilësore dhe sasiore duke u fokusuar tek opinionet, historitë dhe përvojat e menaxherwve të këtyre bizneseve, duke përdorur pyetësorin gjysëm të strukturuara për të realizuar mbledhjen e të dhënave. Megjithatë, ne po vazhdojmë punën për vazhdimin e studimit, për të analizuar nga ana sasiore peshën e ndikimit që kanë faktorët e marrë në analizë tek krijimi i një arkitekture efektive të menaxhimit të burimeve njerëzore. Në qarkun e Korcës ushtrojnë aktivitetin 936 binese të mëdha.

Për studimin, u përzgjodh formula e përpunuar nga Yamane (1967):

$$n = \frac{N}{1 + N(e)^2}$$

ku:

n = madhësia e kampionit të kërkuar;

e = kufiri i gabimit;

N = madhësia e popullatës.

Popullata, në këtë studim, përbëhet nga 936 biznese, madhësia e kampionit rezulton:

$$n = \frac{936}{1 + 936(0.05)^2} = 280$$

Rezultatet e kërkimit

Edhe pse interesi i menaxherëve në përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të burimeve njerëzore ka ardhur duke u rritur, përsëri ndërveprimi dhe harmonizimi në sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore mbetet një problem për bizneset e marra në studim. Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore që funksionon në bizneset e mëdha në Qarkun e Korçës ka një sërë “fushash problematike", të cilat përfshijnë

ndërveprim të dobët dhe harmonizim të paarritur, i cili rezulton në efekte të pamjaftueshme nga përdorimi i sistemit. Ky studim paraqet rezultatet kryesore të konstatuara në biznese të mëdha në Qarkun e Korçës. Metoda e studimit përfshin një pyetësor të hartuar kryesisht për të analizuar ndërveprimin dhe harmonizimin e përbërësve kyç të sistemit të burimeve njerëzore. Indikatorët kyç që përfshihen në ketë studim janë :

Marrja në punë dhe zgjedhja e punonjësve

Vlerësimi i performancës në punë

Trajnimi dhe zhvillimi i punonjësve

Menaxhimi i kompensimit

Detyrat e kërkimit janë:

Përcaktimi i situatës të përbërësve kyç të sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore në bizneset e analizuara.

Zbulimi i gjendjes së ndërveprimit dhe harmonizimit midis përbërësve kyç të sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore.

Prezantimi i argumenteve në mbështetje të rekomandimeve për përmirësimin e ndërveprimit dhe harmonizimit të sistemeve të marra në analizë.

Zgjedhja e aplikantëve i referohet përputhjes midis kërkesave për pozicionin e lirë dhe cilësive të aplikantëve, që zë përqindjen më të lartë në këtë studim rreth 36 %. Rreth 14% e kompanive të studiuara bazohen në rekomandimet e punonjësve të mëparshëm, 30% punësojnë punonjësit duke aplikuar intervistat dhe vetëm 21% duke u bazuar në kriteret e përcaktuara.

30% e atyre që u studiuan njohin praninë e rregullave në kompanitë e tyre, 20% shprehen se mekanizmat për vlerësimin e performancës në punë dhe krijimin e klasifikimit total të vlerësimit të stafit janë të qarta dhe të kuptueshme, 15% e menaxherëve pohojnë praninë e treguesve të diferencuar në vlerësim dhe vetëm 10% pohojnë se trajnimi është bërë mbi rregullat dhe mekanizmat për vlerësimin e performancës në punë (fig.5.1).



Figura 5.1.Vlerësimi i performancës në punë

Burimi: Autori

Kjo tregon se ka "fusha problematike" në vlerësimin e performancës në punë. Një arsye për këtë problematikë është mangësia e programeve të trajnimit të drejtuesve të cilët janë përgjegjës për vlerësimin e stafit. Ndërkaq, në 22% të kompanive trajnimi zhvillohej nëpërmjet rregulloreve të brendshme, 45% e kompanive kryenin trajnimin jo vetëm për qëllim të kapërcimit të mangësive aktuale, por edhe për perspektivën e nevojave të ardhshme, vetëm 11% konfirmojnë se ato ndjekin parimet shkencore bazë për krijimin e sistemit dhe programeve për trajnimin e stafit, 11 % pohojne se ka një praktikë për të vlerësuar efektet dhe efektivitetin e trajnimit (fig.5.2). Konstatohet se firmat e analizuara kanë në dispozicion rezerva të papërdorura për zbatimin me sukses të trajnimit.



Figura 5.2.Trajnimi i punonjësve *Burimi: Autori*

Menaxhimi i kompensimit është përbërësi në sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore që lidhet ngushtë me ndjenjën e përmbushjes që ka punonjësi në nivelin më të lartë. Kërkimi tregoi se 33 % e bizneseve konfirmojnë se pjesa relative e pjesës së ndryshueshme është shumë e vogël, 17% e tyre shprehen se kanë vështirësi objektive në rritjen e pjesës relative të pjesës së ndryshueshme të pagesës, 17% e firmave konfirmojnë se pronarët dhe menaxherët e tyre mbështesin pikpamjen e mbajtjes fiks të kompensimit dhe vetëm 17% konfirmojnë se firmat kanë përshtatur një politikë për të rritur pjesën relative të pjesës së ndryshueshme të pagës dhe të reduktojnë atë fikse (fig.5.3.) .



Figura 5.3. Menaxhimi i kompensimit në kompani

Burimi: Autori

Interesi më i madh në studim është orientuar drejt gjendjes së ndërveprimit dhe harmonizimit të sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe marrja e opinioneve të ekspertëve për këto probleme.

Në studim shfaqet interesi për të analizuar ndërveprimin midis marrjes në punë dhe zgjedhjes së stafit nga njëra anë dhe vlerësimit të performancës në punë nga ana tjetër, si edhe a ka një lidhje midis shkakut dhe pasojës.

Pjesa më e madhe e menaxherëve të pyetur (60% e tyre) ndajnë mendimin se ka një lidhje dhe ndërveprim midis përbërësve të nxjerrë në pah dhe konfirmojnë gjithashtu se e marrin në konsideratë në kompanitë e

tyre, 40% e menaxherëve konstatojnë se janë dakord deri diku se ka një lidhje midis shkakut dhe pasojës. Ndërkohë, 80% e menaxherëve pohojnë se rezultatet e vlerësimit kanë ndikim në vlerësimin e cilësisë gjatë marrjes në punë dhe zgjedhjes së stafit të kompanisë dhe vetëm 20% e tyre janë deri diku dakord me faktin se rezultatet e vlerësimit kanë ndikim në vlerësimin e cilësisë gjatë marrjes në punë dhe zgjedhjes së stafit.

Një lidhje e rëndësishme që duhet studiuar është ajo midis vlerësimit të performancës dhe programeve të trainimit. Studimi tregon se 60% e kompanive kanë mbështetje për pyetjen që vlerësimi i performancës në punë ka ndikim në trajnim, por në të njëjtën kohë ka dhe mbështetje se ndërveprimi i tyre është marrë në konsideratë nga rregullorja e kompanisë në sistemin e burimeve njerëzore. Por, 20% e të anketuarve hezitojnë të ndajnë pikpamjen se vlerësimi i performancës ka ndikim në trajnim dhe 20% nuk janë dakord. Në përgjithësi rezulton "një fushë problematike", e cila reflektohet nga nënvlerësimi i vendit dhe rolit kyç të vlerësimit të performancës në punë në të gjithë ndërveprimin midis përbërësve të sistemit.

Harmonizimi i përbërësve të sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore është një problem domethënës për funksionimin e suksesshëm të sistemit dhe arritjen e objektivave të vendosura. Menaxherët e kuptojnë dhe e pranojnë rëndësinë e harmonizimit të sistemit dhe për këtë është e nevojshme që organizata të funksionojë si një organizëm i unifikuar. Në studim 40% e tyre e marrin parasysh një gjë të tillë, 20% nuk janë dakord me këtë fakt dhe nuk e marrin fare parasysh në kompanitë e tyre .

Harmonizimi i përbërësve të sistemit kërkon përdorimin e metodave dhe rregullave me anë të të cilave ato zbatohen, afërsi dhe koordinim të synimeve të cilat i ndjekin për të arritur objektivat e sistemit, përcaktimin e aktiviteteve në bazë të përbërësve sipas kritereve për vlerësimin e punonjësve. 40% e të intervistuarve pohojnë se kërkesat për harmonizim të përbërësve kyç të sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore janë përmbushur; 60% e tyre pohojnë se këto kërkesa nuk janë përmbushur, pra kjo reflekton se ka akoma shumë punë për të bërë. Përbërësit kyç të sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore në kompani nuk kërkojnë rregullore të brendshme strikte, por më tepër kërkojnë udhëzime për zbatimin e tyre dhe një nivel të lartë lirie për stafin ekzekutiv dhe në rastin konkret 60% e të

anketuarve e mbështesin këtë dhe e marrin parasysh në sistemin e tyre, ndërsa 40% nuk konfirmojnë mjaftueshëm këtë fakt.

Pavarësisht të gjithave, rregullat e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore duke perfshirë edhe metodën për të siguruar ndërveprim dhe harmonizim të përbërësve kyç varen gjerësisht nga cilësia e burimeve njerëzore në kompani. 80% e kompanive konfirmojnë gjerësisht se cilësia e faktorit të burimeve njerëzore është marrë në konsideratë në krijimin dhe përmirësimin e sistemit dhe në sigurimin e ndërveprimit dhe harmonizimit brenda tij.

Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore i kompanisë duhet dhe mund të këtë një potencial motivues, rregulla, duhet të kërkojë zbatimin e aktiviteteve në përputhje me sistemin dhe mbi të gjitha të mund të motivojnë punonjësit jo vetëm të përfitojnë kompetenca dhe t'i pasqyrojnë ato, por dhe të rrisin përmbushjen e tyre në punë .

Shumica e kompanive (80% e tyre) ndajnë mendimin dhe e mbështesin faktin se sistemi ka potencialin e nevojshëm për të motivuar. Gjithashtu, sistemi është krijuar edhe duke marrë në konsideratë perspektivat e të paturit ndikime motivuese për punonjësit.

Konkluzione

Dështimi për të vlerësuar rëndësinë e krijimit të sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore në formën e rregullores së brendshme u jep shkas vështirësive serioze në sigurimin e ndërveprimit dhe harmonizimit të burimeve njerëzore në kompani. Përmbajtja e dobët e përbërësve kyç, sidomos për sa i përket metodave të vlerësimit është arsye serioze e dështimit, si edhe ndërveprimit të pjesshëm të zbatuar midis vlerësimit të performancës në punë, trajnimit, menaxhimit të zhvillimit dhe kompensimit. Këto dobësi të shoqëruara me kompetencë të pamjaftueshme të personave të ngarkuar në drejtimin e aktiviteteve të sistemit, sjellin një sërë vështirësish për funksionimin e tij si një organizëm i unifikuar. Thelbi i vlerësimit, i cili mat përbërësit kyç të sistemit dhe që ka një rol drejtues në aktivizimin e ndërveprimit dhe harmonizimit, nuk është kuptuar ashtu siç duhet. Potenciali i ulët motivues i sistemit është kryesisht rezultat i ndërveprimit dhe harmonizimit jo të përsosur të përbërësve të tij kyç. Përdorimi i pamjaftueshëm i një mekanizmi modern shkencor, i kombinuar me

mos−vëzhgimin e rregullave dhe mekanizmave të sistemit, rezultojnë në shkallë të ulët të përputhjes së përbërësve të sistemit dhe sidomos në një nivel të ulët harmonizimi brenda tij.

Pavarësisht problematikave vlerësohet pozitiv fakti se ka një nivel të lartë ndërgjegjësimi dhe njohjeje mbi rëndësinë e krijimit burimeve njerëzore nga ana e menaxhimit të kompanisë dhe janë të pranishme sjelljet positive që vijnë nga besimi që menaxherët konfirmojnë se burimet njerëzore mund të sjellin avantazhe konkurruese për kompanitë.

Kërkimi nxjerr në pah nevojën për krijimin dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore në formën e rregulloreve të brendshme dhe kjo të konsiderohet prioritet për menaxhimin e suksesshëm të kompanisë.

Zgjedhja e suksesshme duhet të bazohet në një politikë të burimeve njerëzore të qartë, të kuptueshme, të menduar mire dhe të bëra publike. Eshtë e domosdoshme të bëhet zhvillimi i "rregullave " të sistemit në përputhje me politikën, përdorimi i asistencës nga konsulentët në krijimin dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, rifreskimi i përshkrimeve të punës duke u bazuar në kuptimin që ato janë kusht themelor për funksionin e suksesshëm të sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore. Një kusht për sukses është rritja e rolit të departamenteve të menaxhimit të burimeve njerëzore, duke përfshirë përparimin e aftësive të tyre profesionale në punë dhe rezultatet e funksionit të sistemit në një mënyrë që të jetë konform kërkesave shkencore. Një faktor dominant suksesi është ndërmarrja e veprimeve për të tërhequr specialistë të aftë, me njohuri të thella mbi sistemin, për përbërësit e tij si dhe mekanizmat shkencore. Sic u konstatua nga studimi, trajnimi objektiv dhe i rregullt i drejtuesve dhe në veçanti i drejtuesve kryesore të hierarkisë menaxhuese mbi rregullat dhe mekanizmat e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore është kusht për sukses. Për ndërveprimin dhe harmonizimin e përbëresve të sistemit duhet të sigurohet shpërndarja e rregullave të sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore tek të gjithë punonjësit e kompanisë si edhe të sigurohen mjetet e duhura për të marrë feedback nëse ata i shohin rregullat si të drejta.

Referenca

1. Antony, K.M., (2020). Organizational architecture of human resources.
2. Barry Gerhart, Sara L. Rrynes, 2003, “Compensation” Theory, Evidence and Strategic Implications.
3. Berrett-Kohler, Cascio W. F, (2002), “Responsible restructuring: Creative and Profitable alternatives to layoffs San Francisco”.
4. Brian E.Becker, Mark A. Huselid, Dave Ulrich”, (2001), “The HR Scorecard. Linking People, Strategy, and Performance”, Harvard Business School Press.
5. David A.De Cenzo, Stephen P.Robbins, (1996), “Human Resources Management”.
6. Kang, S.C.; Morris, S.S.; Snell, S.A., (2007). Relational archetypes, organizational learning, and value creation: extending the human resource architecture. Acad. Manage. Rev., 32(1): 236- 256 (21 pages).
7. Khan, K.; Khan, M.A.; Thebo, J.A.; Ahmed, T.; Rahoo, L.A., (2021). Examining the human resource architecture relationship with employee productivity of chemical industries.
8. Lepak, D.P.; Snell, S.A., (2002). Examining the human resource architecture: the relationships among human capital, employment, and human resource configurations. J. Manage., 28(4): 517-543 (27 pages).
9. Luddin, M.R.; Suyatno, T., (2019). Human resource architecture transformation case study in Construction Company. Int. J. Hum. Capital Manage., 3(2): 27-41 (15 pages).
10. Lloyd L. Byard, Leslie W. Rue, (2006), “Human Resource Management”.
11. Mirpour, S.; Ahmadi, E.; Zareie, R.; Amirianzadeh, M., (2020). Presentation of human resource architecture model (Combined Approach.
12. Patricia Buhler, (2002), “Human Resources Management”.
13. Ranjbarian, R.; Azizi, S., (2014). The role of human resource architecture in organizational development, The First International Conference on Management in the 21st Century, Tehran. (In Persian) Salamon.
14. Sonela Stillo, (2016), “Menaxhimi i burimeve njerëzore”
15. Wayne F Cascio, (1992), “Managing Human Resources”.
16. Wayne F.Cascio, (2006), “Managing Human Resoueces” Productivity, Quality of Work Life, Profits.
17. Sakib, M. N., et al. (2025). A twenty-two-year journey of sustainable human resource management research: bibliometric analysis. Future Business Journal, 11, 187.
18. Zhang, Q., Gong, H., Ouyang, C., Han, J., & Saks, A. M. (2025). Building Micro-Foundations for Positive Workplace Relationships:

Validation of a Strategic Relational Human Resource Management Measure. Human Resource Management, 64, 793–810
19. Lu, Y., & Zhang, M. M. (2025). Enhancing Employee Outcomes Through Common Good Human Resource Management: Exploring the Role of Meaningfulness and Thriving. Human Resource Management.
20. Deloitte (2025). 2025 Global Human Capital Trends
21. Peng, J., Qiu, D., Zhang, L., & Arokiasamy, L. (2025). Human resource development: An empirical study on analyzing the role of human resource development in organizational efficiency. SAGE Open.
22. Iqbal, J., Aukhoon, M. A., Aman-Ullah, A., Jahangir, J., & Parray, Z. A. (2025). Green Human Resource Management Practices and Organizational Sustainable Development: A Moderated Mediation Model of Circular Economy and Green Organizational Culture. Business Strategy & Development.
23. Armstrong, M., & Taylor, S. (2023). Armstrong's Handbook of Human Resource Management Practice (16th ed.). Kogan Page.
24. Ulrich, D. (1997). Human Resource Champions: The Next Agenda for Adding Value and Delivering Results. Harvard Business School Press.

VENDIMMARRJA NË KUSHTET E SITUATAVE KRITIKE

Dr. Adriatik TAFÇIU

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Tiranë, Shqipëri,
tafciuadriatik@gmail.com

Abstrakt

Ky punim trajton natyrën komplekse dhe dinamike të procesit të vendimmarrjes gjatë situatave kritike dhe krizave moderne, duke e vendosur theksin te rëndësia e lidershipit efektiv dhe menaxhimit emergjent. Ndryshe nga vendimmarrja në kushte normale, e cila është metodike dhe e planifikuar, situatat kritike karakterizohen nga presioni i lartë kohor, pasiguria e madhe dhe informacioni i pjesshëm. Punimi analizon faktorët e ndryshëm psikologjikë, organizativë, socialë dhe politikë që ndikojnë në këtë proces, si dhe modelet e qasjeve racionale, intuitive dhe të bazuara në përvojë.

Një vëmendje e veçantë i kushtohet trajtimit të informacionit në kohë reale përmes platformave bashkëkohore të paralajmërimit publik (si *Alert.al* dhe *IPAWS*), si dhe kuadrit ligjor shqiptar për mbrojtjen civile. Më tej, dokumenti analizon vendimmarrjen kolektive si një nevojë strukturore për koordinimin ndërinstitucional, duke marrë në konsideratë modele ndërkombëtare si *Incident Command System*, etj. Së fundmi, trajtohen dilemat e thella etike që shoqërojnë menaxhimin e krizave, me fokus te shpërndarja e burimeve të kufizuara dhe rëndësia e transparencës dhe llogaridhënies për ruajtjen e besimit të publikut. Punimi konkludon se një vendimmarrje e shpejtë, e koordinuar dhe etike është përcaktuese në minimizimin e humbjeve njerëzore e materiale dhe në stabilitetin social.

Fjalët kyçe: *Vendimmarrje kritike, menaxhim krizash, mbrojtje civile, vendimmarrje kolektive, etika në emergjenca, lidership strategjik.*

Hyrje

Në mjedisin dinamik dhe të ndërlidhur bashkëkohor, menaxhimi i suksesshëm i organizatave dhe institucioneve publike varet pashmangshmërisht nga cilësia e lidershipit. Një ndër cilësitë themelore dhe më sfiduese që duhet të zotërojë një drejtues apo menaxher në kohët moderne është aftësia për të marrë vendime të duhura, sidomos në raste vështirësish dhe krizash të papritura. Vendimmarrja gjatë krizave nuk është thjesht një veprim administrativ i radhës, por përbën një komponent shumë të rëndësishëm dhe strategjik të menaxhimit emergjent. Në këtë kontekst, aftësia e liderit për të marrë vendime të sakta, të shpejta dhe mbi të gjitha etike, ndikon drejtpërdrejt në efikasitetin e reagimit dhe në reduktimin e humbjeve njerëzore, institucionale dhe materiale.

Diferenca kryesore midis operacioneve rutinë dhe emergjencave qëndron te natyra e mjedisit ku operohet. Ndërsa vendimmarrja në kushte normale mund të jetë një proces i planifikuar, metodik dhe i bazuar në parashikueshmëri afatgjatë, situatat kritike thyejnë çdo strukturë lineare. Ato kërkojnë një shkallë të lartë fleksibiliteti, shpejtësi ekstreme në reagim dhe një vlerësim të thellë të riskut në kohë reale, shpesh nën presionin e mungesës së informacionit dhe kohës.[1]

Përtej përgjegjësisë menaxheriale, në nivel shtetëror kjo kompetencë rregullohet dhe me kornizë ligjore e cila detyron veprimin e koordinuar.

Për shembull, Ligji "Për mbrojtjen civile" në Republikën e Shqipërisë, ndër të tjera, përcakton qartë se institucionet shtetërore kanë detyrimin ligjor të marrin vendime të koordinuara mirë, të harmonizuara midis strukturave të ndryshme dhe të bazuara në informacion të saktë e të verifikuar gjatë situatave emergjente.[2] Kjo tregon se suksesi në përballjen me krizat nuk varet vetëm nga vullneti individual, por nga funksionimi i një sistemi të tërë institucional.

Mbi këtë bazë, ky punim synon të analizojë natyrën komplekse të këtij procesi, duke u fokusuar në disa shtylla kryesore. Specifikisht, këtu do të trajtohen:

[1] Mitroff, I. I. *Crisis Leadership: Planning for the Unthinkable*. Wiley, 2004
[2] Ligji nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", Nenet 6-9

Procesi i vendimmarrjes në kushte normale dhe emergjente: Analizimi i ndryshimeve strukturore dhe dinamikave që pëson procesi kur kalohet nga një mjedis i qëndrueshëm në një mjedis krize.

Faktorët psikologjikë, socialë, politikë dhe organizativë: Shqyrtimi i elementeve të brendshme (si stresi dhe paniku) dhe atyre të jashtme (si presioni publik, hierarkia dhe legjislacioni) që ndikojnë ose kushtëzojnë vendimin e drejtuesit.

Modelet e ndryshme të vendimmarrjes: Rishikimi i qasjeve kryesore teorike dhe praktike, duke përfshirë modelin racional, intuitiv dhe atë të bazuar në përvojën paraprake.

Roli i informacionit, bashkëpunimit kolektiv dhe lidershipit etiko-profesional: Vlerësimi i sistemeve të menaxhimit të të dhënave, rëndësia e strukturave të unifikuara të komandimit dhe domosdoshmëria e ruajtjes së parimeve morale dhe transparencës përballë dilemave të vështira të krizës.

Rëndësia e vendimmarrjes në menaxhimin e krizave

Vendimmarrja efektive është thelbësore për menaxhimin efektiv të krizave sepse çdo vonesë ose vendim i gabuar mund të përkeqësojë pasojat.

Në momentet kur një organizatë, institucion apo komunitet përballet me një situatë kritike, procesi i vendimmarrjes bëhet faktori kryesor që përcakton drejtimin dhe fatin e gjithë veprimit të mëtejshëm. Situatat kritike, për nga vetë natyra e tyre, karakterizohen nga pasiguri, presion i lartë, mungesë kohe dhe nevoja për veprime të menjëhershme. Në këto rrethana, çdo vendim - i marrë apo i vonuar - mund të ketë pasoja të thella, qoftë në uljen e rrezikut, qoftë në përshkallëzimin e krizës.

Procesi i vendimmarrjes në kushte kritike nuk është vetëm një akt racional, por edhe një provë për aftësinë menaxheriale, profesionalizmin dhe integritetin e drejtuesve.[3] Ai kërkon balancimin e shpejtësisë me kujdesin, të intuitës me analizën, dhe të autoritetit me bashkëpunimin. Një vendim i marrë me nxitim, pa u mbështetur në të dhëna të mjaftueshme, mund të përkeqësojë situatën; por po aq i dëmshëm mund të jetë edhe vonimi i një vendimi kur koha është faktor kritik.

[3] Weick, K. E., & Sutcliffe, K. M. *Managing the Unexpected: Resilient Performance in an Age of Uncertainty*. Jossey-Bass, 2007

Në praktikë, rëndësia e vendimmarrjes shihet në çdo fazë të menaxhimit të krizës: që nga momenti i identifikimit të problemit, deri në koordinimin e burimeve dhe komunikimin me publikun. Vendimmarrja e saktë në momentin e duhur mund të ndalojë përhapjen e panikut, të sigurojë mbështetjen e strukturave përkatëse dhe të krijojë një ndjenjë kontrolli mbi situatën. Kjo është arsyeja pse shumë organizata investojnë në trajnimin e ekipeve të tyre për zhvillimin e aftësive të mendimit kritik, menaxhimit të stresit dhe planifikimit strategjik në kushte presioni.

Në aspektin njerëzor, vendimmarrja në situata kritike përfaqëson një test të vërtetë të lidershipit.[4] Drejtuesit që arrijnë të ruajnë qetësinë, të analizojnë informacionin në mënyrë të paanshme dhe të marrin vendime të guximshme, frymëzojnë besim dhe mobilizojnë të tjerët për veprim. Kjo është arsyeja pse një krizë shpesh konsiderohet edhe si një mundësi për të shfaqur lidershipin e vërtetë - atë që buron nga përgjegjësia, maturia dhe përkushtimi ndaj detyrës.

Pra, vendimmarrja në situata kritike është jo vetëm një proces teknik, por edhe një akt strategjik dhe moral. Një vendim i marrë me profesionalizëm, transparencë dhe vizion mund të shndërrojë krizën në një pikë kthese pozitive - një mësim që forcon strukturën, kulturën dhe besimin në drejtim.[5]

Avantazhet e vendimmarrjes efektive

Vendimmarrja efektive paraqitet si një element themelor në menaxhimin e krizave, duke ndikuar drejtpërdrejt në kapacitetin e institucioneve për t'u përgjigjur shpejt, në mënyrë koherente dhe të koordinuar. Në literaturën bashkëkohore, ajo konsiderohet një proces i vazhdueshëm dhe dinamik, i cili bashkon informacionin, analizën dhe veprimin, veçanërisht në situata kur presioni kohor dhe rreziku janë të lartë.

Shembujt ndërkombëtarë të dekadave të fundit dëshmojnë se cilësia e vendimeve që merren në fazat kritike të krizës shpesh përcakton përmasat e pasojave dhe ritmin e rimëkëmbjes.

[4] Boin, A., 't Hart, P., Stern, E., & Sundelius, B. *The Politics of Crisis Management: Public Leadership Under Pressure*. Cambridge University Press, 2017
[5] Arnold H. Glasow - *One of the tests of leadership*, 1998

Reduktimi i humbjeve materiale dhe njerëzore

Një nga avantazhet kryesore të vendimmarrjes efektive është ulja e ndjeshme e humbjeve materiale dhe njerëzore. Kur autoritetet marrin vendime të shpejta, të bazuara në analiza të sakta dhe të koordinuara me ekspertët, efektet e krizës mund të zbuten në mënyrë të konsiderueshme.

Shembull ilustrues është tërmeti i Japonisë më 2011, ku aktivizimi i menjëhershëm i sistemit të alarmit të hershëm dhe protokollet e evakuimit kontribuan në shpëtimin e mijëra jetëve, pavarësisht magnitudës së jashtëzakonshme të katastrofës. Ndërsa, gjatë uraganit Katrina në SHBA (2005), vonesat dhe mungesa e koordinimit në vendimmarrje çuan në rritjen e ndjeshme të viktimave dhe dëmeve, duke shërbyer si një shembull i njohur ndërkombëtar se si vendimmarrja joefektive mund të thellojë pasojat e krizës.[6]

Një shembull tjetër është shpërthimi vullkanik i Eyjafjallajökull në Islandë më 2010, ku autoritetet islandeze morën vendimin e menjëhershëm për të mbyllur hapësirën ajrore dhe për të zbatuar protokollet e sigurisë. Ky veprim, pavarësisht ndikimit ekonomik, konsiderohet si vendim thelbësor që shmangu incidente të mëdha ajrore dhe humbje jetësh. Në të kundërt, situata të tjera demonstrojnë pasojat e vendimmarrjes së vonuar: gjatë tërmetit shkatërrues në Turqi më 2023, vonesat në mobilizimin e ekipeve të shpëtimit dhe koordinimi i dobët ndërinstitucional "kontribuan" në rritjen e bilancit tragjik të viktimave, duke u shndërruar në një argument të fuqishëm për rëndësinë e menaxhimit të centralizuar dhe të shpejtë të krizës.

Koordinimi më i mirë i ekipeve emergjente

Vendimmarrja e centralizuar dhe e qartë është faktor vendimtar për koordinimin efektiv të ekipeve emergjente. Në situata ku shumë institucione duhet të bashkëveprojnë njëkohësisht, qartësia në drejtim dhe komunikim shmang mbivendosjet e përgjegjësive dhe rrit efikasitetin operues.

Koordinimi ndërmjet ekipeve të shpëtimit dhe institucioneve shtetërore është një element kritik që varet drejtpërdrejt nga cilësia e

[6] Alexander, D. *Principles of Emergency Planning and Management*. Oxford University Press, 2013

vendimmarrjes. Shembujt ndërkombëtarë tregojnë se sa i rëndësishëm është një sistem komandimi i unifikuar.

I tillë është rasti i zjarreve masive në Australi gjatë viteve 2019-2020, ku megjithëse përmasat e flakëve ishin të paprecedenta, vendimet e centralizuara, bashkëpunimi midis forcave ushtarake, zjarrfikësve shtetërorë dhe vullnetarëve, si dhe aktivizimi i protokolleve të evakuimit, konsiderohen një faktr vendimtar për të shmangur humbje më të mëdha njerëzore.

Një rast i konsideruar model në literaturë është reagimi i shtetit të Kilit gjatë tërmetit të vitit 2010, ku drejtimi i unifikuar i forcave të ushtrisë, policisë dhe njësive të mbrojtjes civile më të cilat u integruan edhe ekspertët sizmologjikë, lehtësoi koordinimin e ndërhyrjeve dhe rivendosjen e shpejtë të rrjeteve kritike.

Ndryshe, shembulli i Ebola-s në Afrikën Perëndimore (2014-2016) tregon se mungesa e një strukture të qartë vendimmarrëse ndërkombëtare dhe vendore e zgjati kohën e reagimit, duke ndikuar në përhapjen e gjerë të epidemisë.[7]

Rritja e besimit të publikut dhe stabilitetit social

Besimi i publikut në institucionet shtetërore rritet ndjeshëm kur vendimmarrja është transparente, e argumentuar dhe e shoqëruar me komunikim të vazhdueshëm. Shembujt ndërkombëtarë tregojnë se mënyra se si autoritetet komunikojnë dhe marrin vendime gjatë krizave mund të jetë po aq e rëndësishme sa vetë masat e marra.

Vendimmarrja efektive, e cila shoqërohet me komunikim transparent dhe të qëndrueshëm, ndikon drejtpërdrejt në besimin e publikut. Raste të ndryshme ndërkombëtare demonstrojnë se mënyra se si autoritetet flasin dhe veprojnë gjatë krizës ka fuqinë të stabilizojë ose destabilizojë mjedisin shoqëror.

Një rast shpesh i cituar është menaxhimi i pandemisë COVID-19 në Zelandën e Re, ku komunikimi i rregullt, i qartë dhe i bazuar në të dhëna i kryeministres Jacinda Ardern u vlerësua si faktor kyç për rritjen e besimit publik dhe për respektimin e masave të izolimit. Në kontrast, vendet ku

[7] Boin, A., 't Hart, P., Stern, E., & Sundelius, B. *The Politics of Crisis Management*. Cambridge University Press, 2017

komunikimi institucional ishte i fragmentuar panë rritje të ndjeshme të skepticizmit publik dhe qarkullim të dezinformatave, duke dobësuar efektin e masave të ndërmarra.[8]

Procesi i vendimmarrjes në kushte normale dhe në situata të pasigurisë

Vendimmarrja është një proces themelor i jetës së përditshme, qoftë në nivel personal, organizativ apo institucional. Në kushte normale, kur informacioni është i plotë dhe pasiguria minimale, procesi i vendimmarrjes zhvillohet në mënyrë të strukturuar. Individët ose drejtuesit analizojnë alternativat, vlerësojnë përfitimet dhe rreziqet dhe zgjedhin opsionin më të favorshëm. Kohëzgjatja dhe kujdesi për detajet janë pjesë natyrale e këtij procesi, ndërsa pasojat e vendimeve janë zakonisht të parashikueshme dhe menaxhueshme.

Në kontrast, kur situatat përfshijnë pasiguri të lartë, presion kohe ose rreziqe të paparashikueshme, procesi i vendimmarrjes merr një dinamikë krejt tjetër. Në këto rrethana, vendimmarrja nuk është vetëm një akt racional, por edhe një test i aftësisë për të menaxhuar stresin, për të përdorur intuitën dhe për të marrë përgjegjësi. Informacioni shpesh është i pjesshëm ose i kontradiktor, dhe vendimi i gabuar mund të ketë pasoja serioze. Një udhëheqës ose profesionist i trajnuar duhet të balancojë shpejtësinë me kujdesin, të kombinojë analizën logjike me përvojën praktike dhe të marrë vendime që ruajnë integritetin dhe sigurinë e ekipeve ose komunitetit.[9]

Procesi i vendimmarrjes në kushte pasigurie kërkon gjithashtu fleksibilitet. Vendimet e marra shpesh duhet të rishikohen dhe përshtaten në kohë reale, duke reflektuar ndryshimet në informacion ose zhvillimet e situatës. Ky proces dinamik nuk është i lehtë; ai kërkon qetësi nën presion, vëmendje ndaj detajeve dhe vizion për pasojat afatgjata. Një vendim i marrë me maturi dhe profesionalizëm, edhe në kushte të pasigurta, mund të shndërrojë krizën në një mundësi për mësim dhe përmirësim të proceseve dhe strukturave të organizatës.

[8] Covello, V. *Risk Communication and Public Trust*. Springer, 2010
[9] John P. Kotter, *Leading Change, Boston: Harvard Business School Press,* 1996

Pra, vendimmarrja në kushte normale dhe në situata të pasigurisë reflekton dy aspekte të ndryshme të të njëjtit proces.[10] Në të dyja rastet, ajo kërkon analizë, vlerësim dhe përgjegjësi, por sfida dhe kompleksiteti rriten ndjeshëm kur koha është e shkurtër dhe pasiguria e madhe.

Aftësia për të vepruar me qetësi, për të përdorur të dhënat në mënyrë efektive dhe për të ruajtur besimin e ekipeve dhe komunitetit është ajo që dallon vendimmarrjen efektive në situata kritike nga vendimmarrja rutinore.

Kushtet normale:

- Vendimmarrje metodike dhe e planifikuar.
- Hapat e vendimmarrjes:
- Identifikimi i problemit → Analizimi i alternativave → Zgjedhja → Implementimi → Vlerësimi

Situatat kritike:

- Vendime të shpejta me informacion të pjesshëm;
- Rrezik i lartë dhe pasiguri e madhe;
- Përdorimi i skenarëve hipotetikë dhe prioriteteve emergjente.

Hapat e vendimmarrjes:

Identifikimi i krizës → Mbledhja e informacionit → Vlerësimi i opsioneve → Vendimi emergjent → Implementimi

Faktorët që ndikojnë në vendimmarrjen efektive gjatë krizës

Faktorë psikologjikë:

- Stresi, paniku dhe ngarkesa emocionale;
- Paragjykimi i perceptimit të rrezikut dhe tendenca për të vonuar vendimet.[11]

Faktorë organizativë:

- Hierarkia dhe qartësia e përgjegjësive;
- Disponueshmëria e burimeve dhe kapaciteteve;

[10] Herbert A. Simon, *Administrative Behavior: A Study of Decision-Making Processes in Administrative Organizations* New York: Free Press, 1997

[11] Hermann, C. F. *"Some Consequences of Crisis Which Limit the Viability of Organizations"* Administrative Science Quarterly, 1963

- Protokollet dhe procedurat e paracaktuara.

Faktorë politikë dhe socialë:

- Presioni i opinionit publik dhe politik;
- Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe marrëveshjet mes aktorëve;
- Legjislacioni dhe standardet e sigurisë.

Modelet e vendimmarrjes në kushte presioni dhe emergjence

Qasja racionale

- Analizë logjike e alternativave;
- Krahasimi i kostove dhe përfitimeve.

Qasja intuitive

- Vendime bazuar në instinkt dhe eksperiencë;
- Përdoret kryesisht kur koha është e kufizuar.

Qasja e bazuar në përvojë

- Mësime nga situata të ngjashme të kaluara;
- Kombinon intuitën dhe analizën logjike.[12]

Trajtimi i informacionit dhe menaxhimit të tij në procesin vendimmarrës

Grumbullimi dhe filtrimi:

- Të dhëna nga raporte, sensorë, satelitë, etj.
- Verifikimi i informacionit:
- Parandalimi i shpërndarjes së lajmeve të rreme.
- Analiza dhe shpërndarja:
- Përdorimi i sistemeve si Alert.al dhe IPAWS.[13]

Siç e kemi përmendur edhe më parë, Alert.al është platforma shqiptare e paralajmërimit publik, e zhvilluar nga Agjencia Kombëtare e

[12] Coombs, W. T. *Ongoing Crisis Communication: Planning, Managing, and Responding.* Sage, 2012
[13] AKMC. *Platforma Alert.al për informim publik dhe emergjencat*, 2024

Mbrojtjes Civile (AKMC) në bashkëpunim me institucione të tjera shtetërore që ka si qëllim të sigurojë komunikim të menjëhershëm me qytetarët në rast emergjencash natyrore, teknologjike apo shëndetësore.

IPAWS është sistemi amerikan i paralajmërimit dhe informimit publik, i menaxhuar nga FEMA (Federal Emergency Management Agency), që ka si qëllim të integrojë në një sistem unik të gjitha platformat ekzistuese të paralajmërimit në SHBA.

Llojet e informacionit dhe përdorimi i tyre

Lloji i informacionit	Funksioni në vendimmarrje	Shembuj
Meteorologjik	Parashikim përmbytjesh	Sensorë lumenjsh
Shëndetësor	Parandalimi i përhapjes së sëmundjeve	Raporte epidemiologjike
Operacional	Koordinimi i forcave operacionale	Dronë, satelitë, njësitë operuese

Vendimmarrja kolektive

Vendimmarrja kolektive është një komponent thelbësor i sistemeve moderne të menaxhimit të krizave, duke reflektuar domosdoshmërinë e koordinimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm institucionalë, teknikë dhe politikë.

Krizat, për nga natyra e tyre, janë fenomene komplekse, shumëdimensionale dhe shpesh të paparashikueshme, të cilat rrallëherë mund të menaxhohen në mënyrë efektive nga një institucion i vetëm. Ato shfaqin një ndërthurje faktorësh që kalojnë kufijtë administrativë, profesionalë dhe organizativë, duke kërkuar bashkëpunim të zgjeruar, komunikim të qartë dhe një proces të mirë-strukturuar vendimmarrjeje.

Në kushtet kur krizave moderne u shtohet intensiteti i globalizimit, ndërlidhja e sistemeve kritike dhe rritja e rreziqeve ndërkufitare, vendimmarrja kolektive nuk është më vetëm një zgjedhje, por një nevojë strukturore. Ajo ofron një kornizë ku aktorët e institucioneve të ndryshme - si shërbimet emergjente, autoritetet lokale, ministritë qendrore, agjencitë teknike dhe organizatat ndërkombëtare -mund të bashkëpunojnë në mënyrë efikase për të siguruar një reagim të koordinuar, të shpejtë dhe të unifikuar.[14]

Pikat kryesore:

- Koordinimi ndërinstitucional
- Siguron që të gjithë aktorët të ndjekin të njëjtën strategji;
- Redukton konfliktet dhe dykuptimet.
- Bashkëpunimi i ekipeve multidisiplinare
- Kombinon ekspertizë nga fusha të ndryshme: shëndetësore, teknologjike, mjedisore.
- Procesi i vendimmarrjes kolektive
- Mbledhja e informacionit nga të gjithë aktorët;
- Diskutimi i alternativave dhe marrja e konsensusit;
- Implementimi i vendimeve me përgjegjësi të ndara.

Roli i vendimmarrjes kolektive në kuadrin e krizave bashkëkohore

Vendimmarrja kolektive ndihmon në harmonizimin e interesave të ndryshme, integrimin e informacionit të shumëburueshëm dhe krijimin e strategjive të përbashkëta që synojnë minimizimin e humbjeve njerëzore, materiale dhe institucionale.

Në këtë kontekst, vendimmarrja kolektive shërben si një mekanizëm koordinues që i lejon institucionet të funksionojnë si pjesë e një sistemi më të gjerë, në të cilin secili aktor ka një rol specifik. Krijimi i komisioneve të përbashkëta, qendrave të koordinimit, task-forcave ndërinstitucionale dhe strukturave të komandimit të unifikuar është shndërruar në praktikë

[14] Boin, A., 't Hart, P., Stern, E., & Sundelius, B. *The Politics of Crisis Management*. Cambridge University Press, 2017

standarde në shumë vende demokratike, duke reflektuar këtë transformim të paradigmave të menaxhimit të krizave.[15]

Ky proces përfshin jo vetëm shkëmbimin e informacionit dhe komunikimin vertikal e horizontal, por edhe ndarjen e burimeve, harmonizimin e protokolleve të reagimit dhe integrimin e njohurive nga fusha të ndryshme si: siguria publike, shëndeti, infrastruktura kritike, logjistika dhe menaxhimi politik.

Zhvillimi i procesit vendimmarrës kolektiv

Vendimmarrja kolektive karakterizohet nga një ndërthurje e faktorëve teknikë, institucionalë dhe njerëzorë. Ajo nuk është thjesht një proces formal, por një dinamikë e gjallë interaksionesh mes aktorëve me kompetenca, hierarki dhe përgjegjësi të ndryshme.

Në nivel teknik, ky proces kërkon integrimin e të dhënave nga burime të shumta, verifikimin e saktësisë së informacionit dhe interpretimin teknik të situatave në evoluim. Agjencitë meteorologjike, institucionet sizmologjike, strukturat e shëndetit publik dhe shërbimet e emergjencës kontribuojnë me njohuritë e tyre për të ndërtuar një panoramë të qartë të rrezikut.

Në nivel institucional, vendimmarrja kolektive synon koordinimin midis aktorëve që shpesh kanë jo vetëm mandate të ndryshme, por edhe kultura organizative të dallueshme. Për shembull, forcat e sigurisë funksionojnë sipas hierarkive të forta, ndërsa institucionet teknike zakonisht mbështeten në ekspertizë dhe analiza profesionale. Integrimi i këtyre dy logjikave kërkon një mekanizëm që i bën bashkë, duke reduktuar tensionet potenciale dhe duke rritur koherencën e veprimit.

Në nivel njerëzor, vendimmarrja kolektive është e ndikuar nga aspektet psikologjike të drejtuesve dhe ekspertëve. Krizat krijojnë presion të lartë kohor, pasiguri dhe rrezik të perceptuar, çka ndikon në mënyrën se si individët analizojnë informacionin, vlerësojnë rreziqet dhe marrin vendime. Prandaj, aftësia për të komunikuar qartë, për të dëgjuar zërat e ndryshëm

[15] Rosenthal, U., Charles, M., & 't Hart, P. *Coping with Crises: The Management of Disasters, Riots and Terrorism*. Charles C Thomas, 1989

profesionalë dhe për të qëndruar të fokusuar përbën një pjesë esenciale të procesit të vendimmarrjes kolektive.[16]

Ndarja e përgjegjësive në vendimmarrjen kolektive

Një nga parimet kryesore të vendimmarrjes kolektive është ndarja e qartë dhe funksionale e përgjegjësive. Nuk mjafton të kesh shumë aktorë të përfshirë në proces; është e domosdoshme që secili prej tyre të ketë një rol të përcaktuar qartë për të shmangur konfuzionin dhe mbivendosjet.

Sistemet moderne të komandimit dhe kontrollit, si modeli Incident Command System (ICS) i përdorur gjerësisht në SHBA, Kanada dhe disa vende të BE-së janë zhvilluar pikërisht për këtë arsye: të krijojnë një strukturë fleksibël ku rolet janë të ndara qartë, por që mund të adaptohen shpejt sipas natyrës së krizës.[17]

Ndarja e përgjegjësive ndihmon në:

- Rritjen e efikasitetit operativ;
- Eliminimin e mbivendosjeve institucionale;
- Uljen e riskut të vonesave;
- Sigurimin e komunikimit të unifikuar publik;
- Menaxhimin e burimeve në mënyrë optimale.

Përveç strukturës së brendshme, vendimmarrja kolektive përfshin edhe dimensionin ndërkombëtar. Bashkëpunimi ndërkufitar është bërë një pjesë kritike e arkitekturës së sigurisë globale.

Përfitimet e vendimmarrjes kolektive në situata krize

Studiuesit që trajtojnë menaxhimin e krizave theksojnë disa përfitime të qarta të vendimmarrjes kolektive.

Rritja e cilësisë së vendimeve

Kur shumë aktorë kontribuojnë me ekspertizën e tyre, vendimet bazohen në një analizë më të gjerë dhe më të thellë. Kjo redukton rrezikun e gabimeve strategjike.

Përmirësimi i koordinimit operues

[16] Weick, K. E., & Sutcliffe, K. M. *Managing the Unexpected*. Jossey-Bass, 2007

[17] Buck, D. A., Trainor, J. E., & Aguirre, B. E. *A Critical Evaluation of the Incident Command System*. Journal of Homeland Security and Emergency Management, 2006

Vendimmarrja kolektive siguron që institucionet të punojnë në mënyrë të sinkronizuar, duke shmangur vonesa, keqkomunikime dhe fragmentim.

Rritja e legjitimitetit institucional

Vendimet e marra kolektivisht perceptohen si më të drejta dhe më të balancuara, duke forcuar besimin publik gjatë situatave të tensionuara.

Optimizimi i burimeve

Bashkëpunimi ndërinstitucional mundëson ndarjen e pajisjeve, personelit, informacionit dhe fondeve.

Shpejtësia në reagim

Edhe pse vendimmarrja kolektive mund të duket si proces i ngadaltë, strukturat e mirëorganizuara kolektive arrijnë të marrin vendime të shpejta përmes procedurave të standardizuara.

Etika në vendimmarrje gjatë krizave

Etika në vendimmarrje do të thotë:

- Sigurimi i drejtësisë dhe transparencës;
- Marrja e vendimeve që respektojnë sigurinë dhe të drejtat e individëve;
- Përgjegjësi morale dhe ligjore e vendimmarrësve.[18]

Në situata me kohë të kufizuar, informacion të paplotë, dhe pasoja të larta, rreziku i shkeljes së parimeve etike rritet ndjeshëm. Përballë një pandemie, një fatkeqësie natyrore, apo një krize financiare, vendimet nuk janë vetëm operacionale apo strategjike, por thellësisht morale.

Një prej dilemave kryesore është balancimi midis utilitarizmit (maksimizimit të të mirës për numrin më të madh të njerëzve) dhe etikës së detyrës (ruajtjes së të drejtave dhe dinjitetit të individëve, veçanërisht grupeve të margjinalizuara).

Për të ruajtur integritetin, organizatat duhet të vendosin një kornizë etike solide para se kriza të shfaqet. Kjo kornizë duhet të theksojë parime si

[18] Pearson, C. M., & Clair, J. A. *"Reframing Crisis Management"* Academy of Management Review, 1998

transparenca, llogaridhënia dhe drejtësia. Udhëheqësit duhet të jenë të gatshëm të komunikojnë hapur arsyetimin e tyre, edhe kur vendimet janë të vështira ose të papëlqyeshme. Mungesa e transparencës shkatërron besimin e publikut, duke e përkeqësuar krizën.

Një konsideratë tjetër kritike është ndikimi afatgjatë i vendimeve të krizës. Shpesh, masat emergjente, si kufizimi i lirisë civile ose përdorimi i teknologjisë së mbikëqyrjes, mund të vazhdojnë të ekzistojnë edhe pasi kriza të ketë kaluar. Udhëheqësit etikë duhet të sigurohen që masat e krizës të jenë përkohshme, proporcionale, dhe të shqyrtohen rregullisht për domosdoshmërinë e tyre.

Pra, etika në vendimmarrjen e krizës kërkon guxim moral. Ajo shkon përtej pajtueshmërisë me ligjin; kërkon aftësinë për të marrë vendime që mbrojnë vlerat thelbësore njerëzore, edhe kur kostoja personale, politike apo financiare është e lartë. Ruajtja e parimeve etike gjatë një krize nuk është vetëm gjëja "e drejtë" për t'u bërë, por është thelbësore për rimëkëmbjen efektive dhe rivendosjen e besimit në shoqëri.

Më poshtë është një analizë më e thellë e dilemës së shpërndarjes së burimeve dhe rëndësisë së transparencës në menaxhimin etik të krizave:

Dilema e shpërndarjes së burimeve

Gjatë një krize, si një fatkeqësi masive ose një pandemi, burimet jetike bëhen të kufizuara. Kjo krijon dilemën e seleksionimit, ku vendimmarrësit duhet të zgjedhin se kush do të ketë qasje në trajtim dhe kush jo. Kjo është ndoshta zgjedhja më e vështirë etike, pasi prek drejtpërdrejt jetën njerëzore.

Qasjet etike kryesore

Qasja utilitare (maksimizimi i jetëve): Prioritet u jepet atyre pacientëve që kanë shanset më të larta për të mbijetuar dhe potencialisht kanë më shumë vite jetë për të jetuar pas rikuperimit. Argumenti është se kjo kursen numrin më të madh të jetëve totale për shoqërinë. Megjithatë, kjo qasje mund të diskriminojë në mënyrë indirekte njerëzit e moshuar ose ata me sëmundje kronike ekzistuese.

Qasja e drejtësisë (barazia): Burimet shpërndahen bazuar në renditjen kronologjike ose përmes një lotarie (rastësie), duke siguruar që asnjë grup të mos favorizohet mbi një tjetër. Kjo ruan barazinë, por mund të rezultojë në përdorimin e burimeve mbi individë me shanse të ulëta mbijetese, duke lënë pa trajtim të tjerë me shanse më të larta.

Qasja e Vlerës Sociale/Reciprocitetit: Ky model i jep prioritet punëtorëve thelbësorë (mjekë, zjarrfikës, policë) që rrezikojnë jetën e tyre për të menaxhuar krizën. Reciprociteti nënkupton kthimin e nderit duke siguruar që ata të kenë qasje në burimet e nevojshme.

Vendimi etik: Një vendim i qëndrueshëm duhet të jetë një kombinim i këtyre parimeve. Ai duhet të jetë i parashikueshëm (i përcaktuar para krizës), i aplikueshëm në mënyrë të barabartë, dhe të përqendrohet në shëndetin publik si tërësi, duke minimizuar dëmin.

Transparenca dhe llogaridhënia në komunikim

Transparenca nuk është thjesht një praktikë e mirë; është një imperativ etik gjatë krizave. Ajo lidhet drejtpërdrejt me besimin e publikut, i cili është një aset kritik për menaxhimin e çdo situate emergjente.

Pikat kryesore të transparencës:

- Shpjegimi i arsyetimit etik: Udhëheqësit duhet të komunikojnë PSE një vendim i caktuar u mor, veçanërisht kur ai është i vështirë ose ka pasoja të dhimbshme. Shpjegimi i parimeve (p.sh., "Vendimi për ndalimin e udhëtimit bazohet në parimin e maksimizimit të sigurisë për komunitetin, duke pranuar koston e lirisë individuale") u tregon qytetarëve se vendimi nuk ishte arbitrar.
- Transparenca e të dhënave: Duhet të publikohet informacioni i plotë dhe i saktë rreth krizës (numri i rasteve, viktimat, kapaciteti spitalor). Fshehja ose manipulimi i të dhënave shkakton konfuzion dhe ushqen teoritë e konspiracionit, duke minuar të gjitha përpjekjet e menaxhimit të krizës.
- Llogaridhënia për gabimet: Asnjë vendimmarrje në krizë nuk është perfekte. Udhëheqësit etikë duhet të jenë të gatshëm të pranojnë gabimet, të shpjegojnë se si do të mësojnë prej tyre dhe të ndryshojnë strategjinë në mënyrë transparente. Kjo tregon pjekuri dhe forcon besimin.
- Pa transparencë, çdo përpjekje për të zbatuar një kornizë etike të shpërndarjes së burimeve shihet me dyshim, duke dështuar në qëllimin e saj. Në thelb, komunikimi i sinqertë dhe i hapur është themeli mbi të cilin ndërtohet besimi dhe bashkëpunimi i nevojshëm për t'i mbijetuar krizës.

Konkluzione

Natyra dikotomike (e ndarë në dy pjesë) e vendimmarrjes: Vendimmarrja në kushte normale dhe ajo në situata kritike përfaqësojnë dy realitete krejtësisht të ndryshme operacionale. Ndërsa e para është metodike, lineare dhe e planifikuar, e dyta thyen çdo strukturë rutinë duke kërkuar fleksibilitet, shpejtësi ekstreme dhe vlerësim të riskut në kohë reale nën presionin e pasigurisë.

Lidershipi si faktor përcaktues: Situatat kritike shërbejnë si një test i vërtetë për lidershipin. Ruajtja e qetësisë, aftësia për të filtruar informacionin e pjesshëm dhe guximi moral i drejtuesve ndikojnë drejtpërdrejt në parandalimin e panikut dhe menaxhimin e suksesshëm të krizës.

Vlera e vendimmarrjes efektive: Vendimet e sakta dhe të shpejta kanë impakt të drejtpërdrejtë në reduktimin e humbjeve njerëzore dhe materiale, ndërsa vonesat dhe fragmentimi institucional i thellojnë pasojat.

Nevoja strukturore për vendimmarrje kolektive: Krizat bashkëkohore janë shumëdimensionale dhe nuk mund të menaxhohen nga një institucion i vetëm. Bashkëpunimi ndërinstitucional, përdorimi i ekipeve multidisiplinare dhe modelet e unifikuara të komandimit rrisin cilësinë e vendimeve dhe optimizojnë burimet.

Imperativi etik dhe besimi publik: Vendimet gjatë krizave mbartin peshë të madhe morale (p.sh. dilemat e shpërndarjes së burimeve të kufizuara). Transparenca absolute, llogaridhënia për gabimet dhe shpjegimi i arsyetimit etik janë të domosdoshme për ruajtjen e besimit të publikut dhe stabilitetit social.

Rekomandime

Standardizimi i protokolleve dhe strukturave të unifikuara: Sugjerohet që institucionet shtetërore të integrojnë plotësisht modele të standardizuara të menaxhimit të krizave, duke bërë një ndarje të qartë dhe të prerë të përgjegjësive përpara se të ndodhë kriza, me qëllim eliminimin e mbivendosjeve institucionale.

Investimi në trajnime dhe simulime të vazhdueshme: Drejtuesit dhe ekipet emergjente duhet t'u nënshtrohen trajnimeve të rregullta të mendimit

kritik dhe menaxhimit të stresit përmes skenarëve hipotetikë dhe simulimeve në kohë reale, për të zhvilluar si qasjen racionale ashtu edhe atë intuitive.

Modernizimi i sistemeve të informacionit dhe paralajmërimit: Duhet të fuqizohet dhe zgjerohet përdorimi i platformave teknologjike si *Alert.al* (në nivel kombëtar) apo sistemeve të ngjashme me *IPAWS*, duke investuar në sensorë, satelitë dhe teknologji të verifikimit të të dhënave për të luftuar dezinformimin në kohë reale.

Hartimi i kornizave etike paraprake: Organizatat dhe institucionet e shëndetit apo mbrojtjes civile duhet të krijojnë korniza dhe udhëzues etikë të qartë e të parashikueshëm përpara krizës (p.sh. rregulla të qarta për shpërndarjen e burimeve), në mënyrë që vendimet nën presion të mos jenë arbitrare apo diskriminuese.

Forcimi i komunikimit strategjik dhe transparencës: Rekomandohet që komunikimi me publikun të jetë i centralizuar, i vazhdueshëm dhe i bazuar në të dhëna të verifikuara. Drejtuesit duhet të jenë transparentë jo vetëm për masat e marra, por edhe për arsyetimin që qëndron pas tyre, duke pranuar hapur dhe me llogaridhënie gabimet eventuale operacionale.

Bibliografi

1. Mitroff, I. I. *Crisis Leadership: Planning for the Unthinkable.* Wiley, 2004
2. Ligji nr.45/2019, *"Për mbrojtjen civile"*
3. Weick, K. E., & Sutcliffe, K. M. *Managing the Unexpected: Resilient Performance in an Age of Uncertainty*. Jossey-Bass, 2007
4. Boin, A., 't Hart, P., Stern, E., & Sundelius, B. *The Politics of Crisis Management: Public Leadership Under Pressure*. Cambridge University Press, 2017
5. Arnold H. Glasow - *One of the tests of leadership*, 1998
6. Alexander, D. *Principles of Emergency Planning and Management*. Oxford University Press, 2013
7. Covello, V. *Risk Communication and Public Trust*. Springer, 2010
8. John P. Kotter, *Leading Change, Boston: Harvard Business School Press, 1996*
9. Herbert A. Simon, *Administrative Behavior: A Study of Decision-Making Processes in Administrative Organizations* New York: Free Press, 1997

10. Hermann, C. F. *"Some Consequences of Crisis Which Limit the Viability of Organizations"* Administrative Science Quarterly, 1963
11. Coombs, W. T. *Ongoing Crisis Communication: Planning, Managing, and Responding.* Sage, 2012
12. AKMC. *Platforma Alert.al për informim publik dhe emergjencat*, 2024
13. Rosenthal, U., Charles, M., & 't Hart, P. *Coping with Crises: The Management of Disasters, Riots and Terrorism*. Charles C Thomas, 1989
14. Buck, D. A., Trainor, J. E., & Aguirre, B. E. *A Critical Evaluation of the Incident Command System*. Journal of Homeland Security and Emergency Management, 2006
15. Pearson, C. M., & Clair, J. A. *"Reframing Crisis Management"* Academy of Management Review, 1998

THE INSTITUTION OF CIVIL LIABILITY ARISING FROM NON-PECUNIARY DAMAGE UNDER THE LEGISLATION OF THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA

Prof.Dr. Shemsije Demiri

International University of Struga sh.demiri@eust.edu.mk

Prof.Dr. Driton Haruni

International University of Struga d.haruni@eust.edu.mk

Doc.Dr. Rudina Kaja

International University of Struga r.sela@eust.edu.mk

Abstract

The objective of this research paper is to analyze the impact of the institution of civil liability arising from non-pecuniary damage within the legal framework of the Republic of North Macedonia, with the aim of contributing to the clarification of the characteristics of such damage, as well as to the identification of the constituent elements of civil liability.

Elements such as the parties involved, the objective and subjective aspects, the causal link, and other necessary conditions for the establishment of non-pecuniary damage directly influence its legal determination and assessment in domestic judicial practice.

The characteristics of non-pecuniary damage, as a consequence of unlawful conduct toward third parties, are examined not only from the theoretical perspective of the form and substance of the damage, but also in relation to the general conditions associated with the existence of the constituent elements of civil liability under the legislation of the Republic of North Macedonia.

The current legislation in the Republic of North Macedonia leaves room for further intervention and advancement, particularly with regard to judicial procedures, the practical implementation of legal principles in civil proceedings, as well as issues related to the burden of proof, compensation for damages, and the fulfillment of obligations.

This paper considers it essential to establish closer institutional alignment between domestic judicial practice and legislation with the standards and jurisprudence of the European Court of Human Rights. The jurisprudence of this

Court should not serve merely as a basis for the review of civil judicial decisions, but should also be integrated into the judicial mindset and legal infrastructure of the Republic of North Macedonia, being regarded as an important source of law and as guidance for the harmonization of domestic practice with European standards in the protection of human rights.

Hyrje

Përgjegjësia civile paraqet një nga institutet themelore të së drejtës civile, e cila ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të personave nga pasojat e veprimeve ose mosveprimeve të kundërligjshme. Në kuadër të saj, një rëndësi të veçantë zë përgjegjësia për dëmin jopasuror, e cila lidhet me cenimin e të mirave personale të individit, siç janë nderi, dinjiteti, reputacioni, integriteti fizik dhe psikik, liria dhe të drejtat e tjera personale.Legjislacioni i Republikës së Maqedonisë së Veriut, veçanërisht përmes Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore , parashikon bazat juridike për kompensimin e dëmit jopasuror dhe përcakton kushtet nën të cilat lind përgjegjësia civile për shkaktimin e tij. Ky institut synon jo vetëm kompensimin e vuajtjeve fizike dhe shpirtërore të të dëmtuarit, por edhe rivendosjen e drejtësisë dhe parandalimin e sjelljeve që cenojnë të drejtat personale të qytetarëve.

Punimi do të trajtojë konceptin e dëmit jopasuror, kushtet për lindjen e përgjegjësisë civile, format e kompensimit, si dhe praktikën juridike dhe rëndësinë e këtij instituti në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Koncepti i demit jopasuror

“Dëmi jo pasuror”, në termat e një punimi shkencor, përfshin kërkime që i përkasin një fushë shumë delikate, të pashkelur pothuajse tërësisht dhe, për këtë shkak po aq interesante, të së drejtës civile. Tërheqja ndaj këtij objekti është rrjedhojë e mishërimit në të, thuajse të të gjithë parimeve të së drejtës civile. Është rrjedhojë e vështirësive për të njohur, kuptuar dhe zbatuar elementet e posaçëm të kësaj pjesë të së drejtës. Pretendimet e mia në formimin teorik, gjejnë në këtë fushë, lëndë për të eksploruar, për të kundërshtuar, për të krijuar, së fundi, për të shfaqur opinione vlerësuese. Përgjegjësia civile nga shkaktimi i dëmit, u materializua fillimisht me norma

juridike në të drejtën romake. Kërkimi i dëmit u përfaqësuar nga "padia aquiliane". Ecuria e tij nuk gjeti forma të qëndrueshme, përveç se në erën e Napolonit, pikërisht në Kodin Civil kur, jo vetëm në këtë fushë, arrihet përshtatja me zhvillimet e shoqërisë, e të drejtës civile në përgjithësi dhe e përgjegjësisë nga shkaktimi i dëmit në veçanti.

Kushtet për lindjen e përgjegjësisë civile për dëmin jo pasuror

Përgjegjësia civile realizohet si përgjegjësi "kontraktore", kur dëmi i shkaktuar rezulton nga mospërmbushja e detyrimeve kontraktore. Debitori duhet të shpërblejë dëmin që rezulton nga mungesa e përmbushjes së detyrimeve objekt i kontratës. Duke mos nënvleftësuar përdorimin shembujve, do të mjaftohem vetëm, duke kujtuar pasojat që vijnë nga mos furnizimi në një kontratë për furnizimin me produkte ushqimorë, apo vonesat në këtë furnizim. Ndërsa përgjegjësia civile jashtë kontraktore (gjithmonë nga shkaktimi i dëmit) ekziston kur dëmi i është shkaktuar një subjekti me të cilin nuk ekzistojnë marrëdhënie kontraktore ose, jo për shkak të mospërmbushjes se detyrimeve kontraktore. Në rrethanat e përditshme, i njëjti fakt mund të jetë burim i përgjegjësisë së dyfishtë, penale dhe civile njëkohësisht dhe, për këtë arsye jo rrallë, detyrohemi të dallojmë dhe ndajmë përgjegjësinë penale nga përgjegjësia civile. Dallimi midis tyre është, ndoshta, detyra më e lehtë, pasi karakteristikat e të dy përgjegjësive pavarësisht së janë thuajse të njëjta, realizojnë Dëmi jo pasuror përfshin çdo lloj dëmi të pësuar nga cenimi i të drejtave dhe interesave jopasurore, që bëjnë pjesë në vlerat e njeriut. dhe mbrojnë norma dhe marrëdhënie të ndryshme juridike.

Përgjegjësia në shkaktimin e dëmit jo pasuror, kërkon të njëjtët elementë fajësie sikurse në dëmin pasuror. Në rrethanat e faktit të vërtetuara gjyqësisht duhet të identifikohen subjekti i kundërligjshmërisë civile, i cili me sjelljet dhe veprimet e tij ka zbuluar fajin, ana objektive që përfaqësohet nga veprimet e kundërligjshme të kryera, e cila provon njëkohësisht dhe lidhjen shkakësore midis faktit dhe cenimit moral të pësuar, si dhe dëmi jo pasuror i shkaktuar. Dëmi jopasuror paraqet cenimin e të drejtave personale dhe vlerave shpirtërore të individit, të cilat nuk kanë karakter material apo ekonomik, por që ndikojnë në integritetin fizik, psikik, emocional dhe moral të personit. Në të drejtën civile të Republika e Maqedonisë së Veriut, dëmi

jopasuror trajtohet si bazë për krijimin e përgjegjësisë civile dhe për realizimin e kompensimit të drejtë ndaj personit të dëmtuar.

Ndryshe nga dëmi pasuror, i cili manifestohet në humbje materiale dhe mund të llogaritet ekonomikisht, dëmi jopasuror lidhet me vuajtjet shpirtërore, dhimbjet fizike, cenimin e nderit, reputacionit, dinjitetit, privatësisë dhe të drejtave të tjera personale të individit.

Dëmi jopasuror ka disa karakteristika themelore: nuk ka natyrë materiale apo ekonomike: lidhet drejtpërdrejt me personalitetin dhe integritetin e individit; shkakton pasoja psikike, emocionale ose morale;nuk mund të matet me saktësi absolute në vlerë monetare; Kompensimi ka karakter satisfaktiv dhe nuk mund ti kthehet plotësisht të gjendjes së mëparshme. Ky lloj dëmi lind si rezultat i një veprimi ose mosveprimi kundërligjor që cenon të drejtat personale të një individi.

Llojet e Dëmit jopasuror

Në teori dhe praktikë juridike, dëmi jopasuror paraqitet në forma të ndryshme: dëmi moral që përfshin vuajtjet shpirtërore, dhimbjen emocionale, stresin dhe cenimin e dinjitetit të personit. shpifja dhe fyerja, cenimi i nderit dhe reputacionit, publikimi i paautorizuar i të dhënave personale.

Dëmi fizik- ka të bëjë me dhimbjet fizike dhe pasojat e shkaktuara nga lëndimet trupore ose dëmtimi i shëndetit. Dëmi psikik dhe emocional- përfshin frikën, ankthin, traumën psikologjike dhe pasigurinë emocionale të shkaktuar nga veprimi i kundërligjshëm. Dëmi ekzistencial lidhet me cenimin e cilësisë së jetës dhe pamundësinë për të zhvilluar normalisht aktivitetet jetësore dhe shoqërore.

Elementet e Përgjegjësisë Civile për Dëmin Jopasuror

Për të ekzistuar përgjegjësia civile për dëmin jopasuror duhet të plotësohen disa kushte juridike:

Kundërligjshmëria- veprimi ose mosveprimi duhet të jetë në kundërshtim me normat juridike ose me të drejtat e garantuara të individit.

Ekzistimi i dëmit- Duhet të provohet se personi ka pësuar vuajtje fizike, psikike ose morale. Lidhja shkakore-duhet të ekzistojë lidhje e

drejtpërdrejtë ndërmjet veprimit të kundërligjshëm dhe pasojës së shkaktuar. Faji- personi përgjegjës duhet të ketë vepruar me dashje ose nga pakujdesia.

Kompensimi i Dëmit Jopasuror- Qëllimi i kompensimit nuk është pasurimi i personit të dëmtuar, por lehtësimi i pasojave morale dhe psikike të shkaktuara. Gjykata gjatë përcaktimit të shumës së kompensimit merr parasysh: intensitetin e dhimbjes dhe vuajtjes, kohëzgjatjen e pasojave, moshën dhe gjendjen e personit të dëmtuar, rëndësinë e të drejtës së cenuar, rrethanat konkrete të rastit.

Dëmi jopasuror sipas Praktikës Gjyqësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Praktika gjyqësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut njeh të drejtën për kompensim të dëmit jopasuror në raste të: lëndimeve trupore, cenimit të nderit dhe reputacionit, shkeljes së të drejtave personale, vuajtjeve për shkak të humbjes së personit të afërt, diskriminimit dhe trajtimit degradues. Megjithatë, ende ekziston nevoja për unifikimin e praktikës gjyqësore dhe përcaktimin më të qartë të standardeve për vlerësimin e këtij dëmi.

Rëndësia e Jurisprudencës së Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Jurisprudenca e kësaj gjykate ka ndikim të madh në zhvillimin e konceptit të dëmit jopasuror, veçanërisht në mbrojtjen e: dinjitetit njerëzor, privatësisë, integritetit fizik dhe psikik, lirisë dhe barazisë së individit. Standardet e vendosura nga kjo gjykatë ndihmojnë në harmonizimin e praktikës vendase me standardet evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Shembull praktik i dëmit jopasuror

Në praktikën gjyqësore të Maqedonisë kemi raste të shpeshta të vendimeve gjyqësore për shpërblim të dëmit jomaterial për shkak të shkaktimit të frikës apo dëmeve tjera. Kështu, mund të përmendim vendimin e Gjykatës Themelore Shkup - II, në lidhje me shpërblimin e dëmit jomaterial, me të cilin detyrohet pala e paditur, shoqëria e sigurimeve “Sava Tabak sh.a.”, që paditësit V.A. nga P. t’i paguajë shpërblimin e dëmit jomaterial në vlerë prej 56.000,00 denarë, nga të cilat 17.000,00 denarë për

shkaktim të dhimbjes fizike, 12.000,00 denarë për shkaktim të frikës dhe 27.000,00 denarë për shkaktim të dhimbjeve shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm për jetesë. Kjo, pasi më 12.12.2008, në ora 20:00, në P., personi M.S. nga P. me veturën e tij "Dacija Llogan", e siguruar te kompania e lartpërmendur, ka goditur paditësin duke e hedhur jashta rrugës dhe duke u larguar nga vendi i ngjarjes pa mos i ofruar ndihmën e nevojshme personit të lënduar.

Një person publikohet në rrjetet sociale dhe në media lokale me akuza të pavërteta për kinse përfshirje në korrupsion apo vepra penale, pa ekzistuar vendim gjyqësor ose prova konkrete. Si rezultat i publikimit: personi humb reputacionin në shoqëri, përjeton stres dhe vuajtje psikike, dëmtohen marrëdhëniet familjare dhe profesionale, pëson shqetësime emocionale dhe cenim të dinjitetit personal.

Në këtë rast nuk kemi dëm material të drejtpërdrejtë, por kemi cenim të nderit, reputacionit dhe integritetit psikik të individit, që përbën dëm jopasuror.

Personi i dëmtuar mund të paraqesë padi civile para gjykatës kompetente duke kërkuar: vërtetimin e cenimit të të drejtave personale, ndalimin e publikimeve të mëtejshme, kërkimfalje publike, kompensim monetar për dëmin jopasuror të shkaktuar. Gjykata gjatë vendimmarrjes merr parasysh: intensitetin e vuajtjeve psikike, pasojat në jetën private dhe profesionale, mënyrën dhe përhapjen e publikimit, shkallën e cenimit të reputacionit.

Konkluzione dhe përfundime

Nga analiza e institutit të përgjegjësisë civile për shkaktimin e dëmit jopasuror sipas legjislacionit të Republika e Maqedonisë së Veriut, mund të konstatohet se dëmi jopasuror paraqet një nga institutet më të ndërlikuara dhe më dinamike të së drejtës civile, për shkak të natyrës së tij specifike dhe vështirësive në përcaktimin dhe kompensimin e tij.

Legjislacioni i Republikës së Maqedonisë së Veriut njeh dhe rregullon përgjegjësinë civile për dëmin jopasuror, megjithatë praktika gjyqësore ende përballet me sfida të shumta lidhur me interpretimin dhe zbatimin e dispozitave përkatëse ligjore. Në veçanti, vërehet nevoja për një

përcaktim më të qartë të kritereve juridike që lidhen me vërtetimin e dëmit jopasuror, lidhjen shkakësore dhe përcaktimin e kompensimit adekuat.

Punimi evidenton se dëmi jopasuror nuk duhet të kufizohet vetëm në konceptin tradicional të dëmit moral, por duhet të trajtohet si një kategori më e gjerë juridike që përfshin cenimin e të drejtave personale, dinjitetit, integritetit psikik dhe emocional të individit. Për këtë arsye, interpretimi i këtij instituti duhet të bazohet jo vetëm në normat formale juridike, por edhe në standardet bashkëkohore të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Gjithashtu, është konstatuar se elementet përbërëse të përgjegjësisë civile, si kundërligjshmëria e veprimit, ekzistimi i dëmit, lidhja shkakësore dhe faji, kanë rëndësi thelbësore në vërtetimin e përgjegjësisë për dëmin jopasuror dhe në arritjen e një vendimmarrjeje të drejtë nga ana e gjykatave. Një rëndësi të veçantë në zhvillimin e këtij instituti juridik paraqet harmonizimi i legjislacionit dhe praktikës gjyqësore vendase me standardet dhe jurisprudencën e Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Jurisprudenca e kësaj gjykate duhet të shërbejë si udhërrëfyes për interpretimin dhe zbatimin e normave juridike vendase, me qëllim forcimin e sigurisë juridike dhe mbrojtjes efektive të të drejtave të individit.

Si përfundim mund të them se avancimi i kuadrit ligjor, unifikimi i praktikës gjyqësore dhe ngritja profesionale e institucioneve juridike mbeten faktorë të domosdoshëm për zhvillimin efektiv të institutit të përgjegjësisë civile nga shkaktimi i dëmit jopasuror në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Literaturë

1. Alishani Alajdin, (2002), E Drejta e Detyrimeve, Pjesa e Përgjithshme, Botimi i dytë, Prishtinë
2. Aliu Abdulla, (2013), E Drejta Civile, Pjesa e Përgjithshme, Prishtinë
3. Dauti Nerxhivane & Berisha Ruzhdi & Aliu Abdulla & Vokshi Adem, (2013), Komentari – Ligji për

1. Marrëdhëniet e Detyrimeve – Libri I,

4. Dauti Nerxhivane, (2013), E Drejta e Detyrimeve, Botim i plotësuar dhe përmirësuar, Pjesa e Përgjithshme,Prishtinë
5. Dauti Nerxhivane, (2016), E Drejta e Detyrimeve, Botim i plotësuar dhe përmirësuar, Pjesa e Përgjithshme,Prishtinë

6. Gams Andrija, (1972), Hyrje në të Drejtën Civile, Prishtinë
7. Latifi Juliana (2009), E Drejta Civile – Pjesa e Përgjithshme, AlbPaper, Tiranë
8. Légier Gérard, (2008), E Drejta Civile - Detyrimet, Botimi i 19-të, Përktheu Edmond Xhabija,
9. Nuni Ardian, (2012), E Drejta Civile, Pjesa e Përgjithshme, Tiranë
10. Boris Vizner, Komentar na Zakonot za Obligacioni Odnosi , Zagreb, 1978.
11. Dimitar Pop Georgiev, Obligaciono pravo, Shkup, 1985.
12. Gale Galev&Jadranka Daboviq Anastasovska, "Obligacionopravo", Shkup, 2009.
13. Ivica Crnić, "Odštetno pravo", Zagreb, 2008.
14. Dr. Ivo Puhan, E drejta romake, Prishtinë, 1989.
15. Kiril Çavdar & Mr. Kimo Çavdar, "Ligji për marrëdhënie të Detyrimeve" - komente, sqarime, praktik gjyqësore dheregjistri i lëndëve, Shkup, 2008.
16. Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
17. Ligji për përgjegjësi civile për shpifje dhe fyerje i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
18. Vendim i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, Rev. nr. 274/93 të datës 08.04.1993.
19. Vendim i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, G. Zh. Nr 391/77, të datës 08.12.1977.
20. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Shtip, G. Zh. nr. 2932/05 të datës 13.01.2006.
21. Aktgjykim i Gjykatës Themelore Shkup - II, XXXVIII П. P. nr. 2423/09, datë 01.07.2010.
22. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Shkup, G. Zh. nr. 1179/98 të datës 06.VII.2000.

DEEPFAKE DHE DEZINFORMIMI DIGJITAL: SFIDA TË REJA PËR SHOQËRINË MODERNE

Msc. Denisa Hani (d.hani@eust.edu.mk)

Abstract

Ky punim analizon ndikimin e teknologjisë deepfake dhe dezinformimit digjital në shoqërinë moderne, duke u fokusuar në rreziqet që sjell përdorimi i Inteligjencës Artificiale në manipulimin e informacionit. Zhvillimi i algoritmeve të IA ka mundësuar krijimin e videove, audios dhe imazheve të manipuluara që janë gjithnjë e më të vështira për t'u dalluar nga përmbajtja reale. Kjo paraqet sfida serioze për sigurinë kibernetike, privatësinë, demokracinë dhe besueshmërinë e informacionit në epokën digjitale. Punimi trajton gjithashtu aspektet etike dhe ligjore të përdorimit të deepfake, si dhe nevojën për politika dhe mekanizma mbrojtës për të parandaluar keqpërdorimin e teknologjisë.

Përveç ndikimit në sigurinë digjitale, teknologjia deepfake po ndikon edhe në mënyrën se si qytetarët perceptojnë informacionin dhe mediat online. Përhapja e përmbajtjeve të manipuluara mund të krijojë konfuzion social, të ndikojë opinionin publik dhe të përdoret për propagandë politike apo mashtrime financiare. Në këtë kontekst, bëhet e domosdoshme zhvillimi i sistemeve të avancuara për identifikimin e përmbajtjeve false, rritja e edukimit digjital dhe forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar për të garantuar përdorimin etik dhe të sigurt të Inteligjencës Artificiale në shoqërinë moderne.

Fjalë kyçe: *Deepfake, Artificial Intelligence, Digital Disinformation, Cybersecurity, Privacy, AI Ethics*

Hyrja

Zhvillimi i shpejtë i Inteligjencës Artificiale (IA) ka sjellë ndryshime të mëdha në mënyrën se si funksionon shoqëria moderne dhe si krijohet, përpunohet dhe shpërndahet informacioni. Teknologjitë e bazuara në IA përdoren sot në shumë fusha, duke përfshirë komunikimin, biznesin, arsimin, shëndetësinë, sigurinë kibernetike dhe mediat digjitale. Automatizimi i proceseve dhe aftësia për të analizuar sasi të mëdha të dhënash kanë krijuar mundësi të reja për zhvillim dhe inovacion teknologjik. Megjithatë, krahas përfitimeve të shumta, zhvillimi i këtyre teknologjive ka sjellë edhe sfida të reja që lidhen me sigurinë, privatësinë dhe besueshmërinë e informacionit në internet.

Një nga fenomenet më të diskutuara dhe më shqetësuese të viteve të fundit është teknologjia deepfake. Kjo teknologji përdor algoritme të avancuara të *deep learning* dhe rrjete neurale artificiale për të krijuar ose manipuluar video, audio dhe imazhe në mënyrë shumë reale. Përmbajtjet e krijuara përmes deepfake shpesh janë aq bindëse sa përdoruesit e zakonshëm e kanë të vështirë të dallojnë nëse materiali është autentik apo i manipuluar artificialisht.

Fillimisht, deepfake u përdor kryesisht për argëtim dhe krijime digjitale kreative, por me kalimin e kohës ai filloi të përdorej edhe për qëllime më problematike dhe të rrezikshme. Sot, deepfake konsiderohet një sfidë serioze për shoqërinë moderne, pasi mund të përdoret për përhapjen e dezinformatave, manipulimin e opinionit publik, mashtrimet financiare, sulmet kibernetike dhe dëmtimin e reputacionit të individëve apo institucioneve. Për më tepër, përhapja e përmbajtjeve të manipuluara ndikon drejtpërdrejt në besimin e qytetarëve ndaj mediave dhe informacionit online.

Për këtë arsye, analiza e ndikimit të deepfake dhe dezinformimit digjital është bërë një çështje shumë e rëndësishme në fushën e sigurisë kibernetike dhe komunikimit modern. Ky punim synon të trajtojë rreziqet kryesore që lidhen me këtë teknologji, ndikimin e saj në shoqëri dhe rëndësinë e masave ligjore, etike dhe teknologjike për parandalimin e abuzimeve.

Çfarë është Deepfake?

Deepfake është një teknologji e bazuar në Inteligjencën Artificiale (IA) dhe në metodat e mësimit të thellë (*deep learning*), e cila mundëson krijimin e përmbajtjeve audio, video dhe imazhe të manipuluara në mënyrë shumë realiste. Kjo teknologji përdor kryesisht rrjete neurale artificiale, si *Generative Adversarial Networks (GANs)*, të cilat trajnohen me sasi të mëdha të dhënash vizuale dhe zanore për të imituar me saktësi fytyrën, zërin dhe mimikën e një personi real[1].

Me përparimin e shpejtë të inteligjencës artificiale, deepfake është bërë gjithnjë e më i sofistikuar, duke e bërë të vështirë dallimin midis përmbajtjes reale dhe asaj të gjeneruar artificialisht nga përdoruesit e zakonshëm apo edhe sistemet bazë të verifikimit. Algoritmet moderne janë në gjendje të riprodhojnë lëvizje të detajuara të fytyrës, sinkronizim të buzëve me zërin dhe ndryshime të ndriçimit që e bëjnë përmbajtjen shumë bindëse[2].

Fillimisht, deepfake u përdor kryesisht për qëllime argëtimi, filma, efekte vizuale dhe krijime digjitale kreative. Megjithatë, me kalimin e kohës, përdorimi i tij është zgjeruar edhe në fusha më problematike. Sot, deepfake përdoret shpesh për manipulim politik, krijim të dezinformatave, mashtrime financiare, sulme kibernetike dhe shpërndarje të lajmeve të rreme në rrjete sociale. Këto përdorime e kanë bërë teknologjinë një nga sfidat më të mëdha të sigurisë kibernetike dhe besueshmërisë së informacionit në epokën digjitale[3].

Deepfake dhe Dezinformimi Digjital

Dezinformimi digjital i referohet përhapjes së qëllimshme të informacionit të rremë, të manipuluar ose të shtrembëruar, me synimin për të ndikuar opinionin publik, për të krijuar konfuzion social apo për të manipuluar proceset politike dhe vendimmarrëse. Në këtë kontekst, teknologjia deepfake ka përforcuar ndjeshëm kapacitetin e dezinformimit,

[1] Goodfellow, I., Pouget-Abadie, J., Mirza, M., Xu, B., Warde-Farley, D., Ozair, S., Courville, A., & Bengio, Y. (2014). *Generative Adversarial Nets*. NeurIPS.

[2] Mirsky, Y., & Lee, W. (2021). *The Creation and Detection of Deepfakes: A Survey*. ACM Computing Surveys

[3] Chesney, R., & Citron, D. (2019). *Deep Fakes: A Looming Challenge for Privacy, Democracy, and National Security*. California Law Review.

pasi lejon krijimin e materialeve audio-vizuale që duken autentike dhe janë të vështira për t'u dalluar nga përmbajtja reale[4].

Përdorimi i inteligjencës artificiale në gjenerimin e deepfake-eve mundëson imitimin e figurave publike, duke krijuar video ku politikanë, gazetarë ose persona të njohur duket sikur thonë ose bëjnë gjëra që në realitet nuk kanë ndodhur. Këto përmbajtje mund të përdoren për manipulimin e deklaratave politike, për përhapjen e propagandës apo për nxitjen e tensioneve sociale në periudha të ndjeshme[5].

Përveç kësaj, deepfake është gjithnjë e më i pranishëm edhe në mashtrimet online, ku përdoret për skema financiare, phishing të avancuar dhe manipulim të besimit të përdoruesve përmes video-thirrjeve të rreme apo mesazheve zanore të klonuara. Kjo e bën atë një mjet të fuqishëm për krimin kibernetik modern.

Pasojat e këtij fenomeni janë të gjera dhe prekin disa fusha kritike të shoqërisë, duke përfshirë dobësimin e demokracisë, uljen e besimit në media tradicionale, rrezikimin e sigurisë kombëtare dhe destabilizimin e strukturave sociale. Për këtë arsye, institucionet kërkojnë gjithnjë e më shumë zhvillimin e teknologjive të detektimit dhe rregullimin ligjor të përdorimit të deepfake[6].

Ndikimi në Shoqërinë Moderne

Deepfake dhe dezinformimi digjital kanë një ndikim të thellë në shoqërinë moderne, duke ndryshuar mënyrën se si njerëzit perceptojnë dhe konsumojnë informacionin online. Një nga problemet më serioze është humbja graduale e besimit në përmbajtjen digjitale, pasi përdoruesit nuk mund të jenë gjithmonë të sigurt nëse një video, audio apo imazh është autentik apo i gjeneruar në mënyrë artificiale. Kjo krijon një "krizë të së

[4] Chesney, R., & Citron, D. (2019). *Deep Fakes: A Looming Challenge for Privacy, Democracy, and National Security*. California Law Review.

[5] Vaccari, C., & Chadwick, A. (2020). *Deepfakes and disinformation: Exploring the impact of synthetic political video on deception, uncertainty, and trust in news*. Social Media + Society.

[6] Maras, M.-H., & Alexandrou, A. (2019). *Determining authenticity of video evidence in the age of artificial intelligence and in the wake of deepfake videos*. The International Journal of Evidence & Proof.

vërtetës" në hapësirën digjitale, ku edhe materialet reale mund të vihen në dyshim[7].

Përveç aspektit të përgjithshëm të dezinformimit, deepfake përdoret gjithnjë e më shumë edhe për qëllime të dëmshme individuale. Një nga përdorimet më problematike është shantazhi digjital, ku krijohen video të rreme për të kërcënuar ose detyruar individët. Po ashtu, kjo teknologji mund të përdoret për dëmtim reputacioni, duke prodhuar përmbajtje kompromentuese që ndikon në jetën personale ose profesionale të viktimës. Në fushën financiare, deepfake është i lidhur me mashtrime të sofistikuara, ku imitohen zëra ose video të menaxherëve të kompanive për të autorizuar transaksione të rreme[8].

Në aspektin emocional dhe social, përmbajtjet e manipuluara mund të ndikojnë në ndjenjat dhe sjelljet e individëve, duke krijuar frikë, pasiguri ose urrejtje të paarsyeshme. Në kontekstin politik, ndikimi është edhe më i madh, pasi deepfake mund të përdoret për të ndikuar opinionin publik gjatë zgjedhjeve, për të diskredituar kandidatë dhe për të nxitur tensione sociale apo polarizim politik. Kjo e bën teknologjinë një rrezik serioz për stabilitetin demokratik dhe kohezionin shoqëror[9].

Aspektet Etike, Ligjore dhe Roli i Sigurisë Kibernetike

Përdorimi i teknologjisë deepfake ngre një sërë çështjesh të rëndësishme etike dhe ligjore, të cilat lidhen kryesisht me privatësinë, pëlqimin e individit dhe përdorimin e paautorizuar të identitetit digjital. Një nga shqetësimet kryesore është fakti se përmes inteligjencës artificiale mund të krijohen video, audio apo imazhe shumë realiste pa dijeninë apo pëlqimin e personit të përfshirë, duke shkelur kështu të drejtat themelore të privatësisë

[7] Chesney, R., & Citron, D. (2019). *Deep Fakes: A Looming Challenge for Privacy, Democracy, and National Security*. California Law Review.

[8] Kietzmann, J., Lee, L. W., McCarthy, I. P., & Kietzmann, T. C. (2020). *Deepfakes: Trick or treat?*. Business Horizons

[9] Vaccari, C., & Chadwick, A. (2020). *Deepfakes and disinformation: Exploring the impact of synthetic political video on deception, uncertainty, and trust in news*. Social Media + Society.

dhe integritetit personal[10]. Kjo e bën deepfake një mjet potencial për abuzim, veçanërisht në rastet e shpifjes, shantazhit apo manipulimit publik.

Nga ana ligjore, mungesa e rregulloreve të unifikuara dhe të qarta në shumë vende e vështirëson kontrollin dhe ndëshkimin e abuzimeve të lidhura me deepfake. Për këtë arsye, Bashkimi Evropian ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm përmes *AI Act*, i cili synon të vendosë standarde më të forta për përdorimin e inteligjencës artificiale, duke përfshirë transparencën, përgjegjësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale[11]. Këto rregullore synojnë të reduktojnë rrezikun e përdorimit keqdashës të teknologjive gjeneruese.

Në këtë kontekst, siguria kibernetike luan një rol thelbësor në identifikimin, parandalimin dhe menaxhimin e kërcënimeve të krijuara nga deepfake dhe dezinformimi digjital. Sistemet moderne të sigurisë përdorin inteligjencë artificiale dhe algoritme të avancuara për analizimin e videove dhe audios, identifikimin e anomalive vizuale dhe zanore, si dhe zbulimin e përmbajtjeve të manipuluara[12]. Këto teknologji ndihmojnë në rritjen e saktësisë së verifikimit të përmbajtjes digjitale.

Megjithatë, teknologjia vetëm nuk është e mjaftueshme. Organizatat dhe institucionet duhet të investojnë gjithashtu në edukim digjital, politika të qarta sigurie, sisteme verifikimi të informacionit dhe trajnime për rritjen e ndërgjegjësimit të përdoruesve. Vetëm një qasje e kombinuar midis teknologjisë, ligjit dhe edukimit mund të ofrojë mbrojtje efektive ndaj rreziqeve që sjell deepfake në shoqërinë moderne.

5. Rastet e Deepfake dhe Dezinformimit Digjital në Maqedoninë e Veriut

Në Maqedoninë e Veriut, fenomeni i deepfake dhe dezinformimit digjital është bërë gjithnjë e më i dukshëm me rritjen e përdorimit të rrjeteve sociale dhe mjeteve të bazuara në Inteligjencën Artificiale. Edhe pse vendi ende nuk ka raportuar raste të profilit shumë të lartë si shtetet më të mëdha,

[10] Floridi, L., Cowls, J., Beltrametti, M., et al. (2018). *AI4People—An ethical framework for a good AI society*. Minds and Machines.

[11] European Commission. (2024). *Artificial Intelligence Act: Regulation on Artificial Intelligence*

[12] Mirsky, Y., & Lee, W. (2021). *The Creation and Detection of Deepfakes: A Survey*. ACM Computing Surveys.

janë evidentuar disa shembuj konkretë të manipulimit të informacionit, përdorimit të përmbajtjeve të gjeneruara me IA dhe shpërndarjes së lajmeve të rreme që kanë ndikuar në opinionin publik dhe sigurinë informative. Sipas raportimeve të mediave rajonale dhe organizatave për verifikimin e fakteve, rrjetet sociale në Maqedoninë e Veriut janë përdorur shpesh për përhapjen e përmbajtjeve manipuluese, teorive konspirative dhe videove të rreme gjatë ngjarjeve me interes publik[13].

Një nga rastet më të diskutuara lidhej me shpërndarjen e përmbajtjeve të manipuluara gjatë rastit tragjik të vrasjes së Vanja Gjorçevskës në vitin 2023, ku në rrjetet sociale u publikuan informacione të rreme, teori konspirative dhe imazhe të krijuara me Inteligjencë Artificiale për të gjeneruar klikime dhe manipulim emocional të publikut. Raportet tregojnë se përdorues të ndryshëm krijuan profile false dhe shpërndanë materiale të manipuluara që kontribuan në përhapjen e panikut dhe dezinformimit në opinionin publik.

Një tjetër rast i njohur në Maqedoninë e Veriut ishte përdorimi i videove deepfake të mjekut të njohur Zhan Mitrev, ku u përdorën manipulime audio-vizuale për ta paraqitur sikur promovonte produkte dhe çajra "mjekësorë" të rremë në internet. Organizatat për fact-checking në rajon identifikuan se videoja ishte manipuluar me teknologji të Inteligjencës Artificiale dhe përdorej për mashtrime online dhe reklamim të produkteve të dyshimta. Ky rast tregoi se deepfake nuk përdoret vetëm për propagandë politike, por edhe për mashtrime financiare dhe manipulim të besimit të qytetarëve[14].

Raste të ngjashme janë raportuar edhe në rajonin e Ballkanit, duke ndikuar indirekt edhe në Maqedoninë e Veriut. Raportet e BIRN dhe organizatave rajonale kanë evidentuar përdorimin e IA për krijimin e përmbajtjeve erotike false, manipulim identiteti dhe mashtrime financiare në Kosovë, Shqipëri, Mal të Zi dhe vende të tjera të rajonit. Në disa raste janë

[13] https://balkaninsight.com/2023/12/06/north-macedonia-double-murder-triggers-fake-news-conspiracies-and-hate-speech/bi/

[14] https://webalkans.eu/en/stories/navigating-the-ai-generated-minefield/

përdorur deepfake të figurave publike dhe politikanëve për promovimin e investimeve të rreme apo produkteve mashtruese në rrjetet sociale[15].

Përveç rasteve konkrete, ekspertët e mediave dhe sigurisë kibernetike në Maqedoninë e Veriut kanë paralajmëruar vazhdimisht se mungesa e edukimit medial dhe mungesa e rregullimit të qartë ligjor e bëjnë vendin më të ndjeshëm ndaj manipulimeve digjitale. Sipas analizave të publikuara nga organizata mediale dhe studiues të rajonit, përdoruesit shpesh kanë vështirësi në dallimin e përmbajtjeve reale nga ato të gjeneruara me Inteligjencë Artificiale, sidomos kur bëhet fjalë për video bindëse apo audio të klonuara[16].

Përfundimi dhe Rekomandime

Duke u bazuar në analizën e bërë në këtë punim, mund të përfundohet se deepfake dhe dezinformimi digjital përbëjnë një ndër sfidat më serioze të epokës së inteligjencës artificiale. Ky zhvillim teknologjik, ndonëse ka sjellë përparësi të mëdha në komunikim, krijimtari dhe automatizim, njëkohësisht ka ndryshuar mënyrën se si ne e perceptojmë realitetin digjital. Sot, përmbajtjet vizuale dhe audio nuk mund të konsiderohen gjithmonë si prova të besueshme, pasi mund të krijohen ose modifikohen me një nivel shumë të lartë realizmi.

Nga këndvështrimi im, problemi kryesor nuk qëndron vetëm te teknologjia vetë, por te mënyra se si ajo përdoret nga individët dhe grupet e ndryshme. Deepfake mund të jetë një mjet i fuqishëm për inovacion dhe kreativitet, por në mungesë të kontrollit dhe ndërgjegjësimit, ai shndërrohet në një instrument manipulimi dhe mashtrimi. Kjo e bën të domosdoshme rritjen e përgjegjësisë si nga zhvilluesit e teknologjisë, ashtu edhe nga përdoruesit e saj.

Gjithashtu, konsideroj se shoqëria ende nuk është plotësisht e përgatitur për të përballuar pasojat e dezinformimit të avancuar digjital. Edukimi medial dhe digjital mbetet i pamjaftueshëm, duke i bërë përdoruesit më të ndjeshëm ndaj manipulimeve online. Për këtë arsye, ndërgjegjësimi

[15] https://prishtinainsight.com/deep-fake-content-a-new-reality-awaiting-state-regulation-mag/

[16] https://respublica.edu.mk/blog-en/media/without-proper-oversight-ai-technologies-can-become-a-threat/

publik duhet të jetë një prioritet, duke filluar nga institucionet arsimore deri te platformat digjitale.

Mund të them se e ardhmja e inteligjencës artificiale do të varet shumë nga mënyra se si ne e menaxhojmë atë sot. Nëse krijohen mekanizma të duhur ligjorë, etikë dhe teknologjikë, deepfake mund të mbetet një mjet inovativ dhe i kontrolluar. Por nëse këto masa mungojnë, rreziku i manipulimit të informacionit dhe humbjes së besimit në botën digjitale do të vazhdojë të rritet. Për këtë arsye, është e rëndësishme një qasje e balancuar mes inovacionit dhe përgjegjësisë.

Rekomandime

Bazuar në analizën e bërë në këtë punim, rekomandimet kryesore lidhen me përmirësimin e sigurisë, edukimit dhe kontrollit të përdorimit të teknologjive të bazuara në Inteligjencën Artificiale, veçanërisht deepfake.

Së pari, konsideroj se edukimi digjital duhet të fillojë që në nivelin arsimor. Nxënësit dhe studentët duhet të mësojnë si të dallojnë përmbajtjet e manipuluara, si funksionon dezinformimi dhe cilat janë rreziqet e tij. Kjo do të ndihmonte në krijimin e një shoqërie më të vetëdijshme dhe më kritike ndaj informacionit online.

Së dyti, platformat sociale dhe mediat digjitale duhet të kenë mekanizma më të fortë verifikimi dhe filtrimi të përmbajtjes. Etiketimi i materialeve të dyshimta ose të gjeneruara me IA, si dhe transparenca mbi origjinën e përmbajtjes, do të ndihmonte në uljen e përhapjes së dezinformimit.

Së treti, institucionet shtetërore duhet të krijojnë ligje më të qarta dhe më të zbatueshme për përdorimin e deepfake, sidomos në rastet kur ai përdoret për mashtrim, shantazh ose dëmtim reputacioni. Këto ligje duhet të jenë të përshtatura me zhvillimet e shpejta teknologjike.

Së katërti, duhet të investohet më shumë në teknologjitë e sigurisë kibernetike që kanë për qëllim zbulimin automatik të përmbajtjeve të manipuluara. Bashkëpunimi midis institucioneve akademike, sektorit privat dhe qeverive është shumë i rëndësishëm në këtë drejtim.

Së fundi, mendoj se një nga elementët më të rëndësishëm është ndërgjegjësimi individual. Çdo përdorues duhet të jetë më i kujdesshëm me informacionin që konsumon dhe shpërndan, duke mos e marrë çdo përmbajtje si të vërtetë pa verifikim. Vetëm përmes një kombinimi të edukimit, teknologjisë dhe rregullimit ligjor mund të minimizohen rreziqet që sjell deepfake në shoqërinë moderne.

Referencat:

1. Chesney, R., & Citron, D. (2019). *Deep Fakes: A Looming Challenge for Privacy, Democracy, and National Security*. California Law Review.
2. European Commission. (2024). *Artificial Intelligence Act: Regulation on Artificial Intelligence*
3. Floridi, L., Cowls, J., Beltrametti, M., et al. (2018). *AI4People—An ethical framework for a good AI society*. Minds and Machines.
4. Goodfellow, I., Pouget-Abadie, J., Mirza, M., Xu, B., Warde-Farley, D., Ozair, S., Courville, A., & Bengio, Y. (2014). *Generative Adversarial Nets*. NeurIPS.
5. Kietzmann, J., Lee, L. W., McCarthy, I. P., & Kietzmann, T. C. (2020). *Deepfakes: Trick or treat?*. Business Horizons
6. Maras, M.-H., & Alexandrou, A. (2019). *Determining authenticity of video evidence in the age of artificial intelligence and in the wake of deepfake videos*. The International Journal of Evidence & Proof.
7. Mirsky, Y., & Lee, W. (2021). *The Creation and Detection of Deepfakes: A Survey*. ACM Computing Surveys
8. Vaccari, C., & Chadwick, A. (2020). *Deepfakes and disinformation: Exploring the impact of synthetic political video on deception, uncertainty, and trust in news*. Social Media + Society.
9. https://balkaninsight.com/2023/12/06/north-macedonia-double-murder-triggers-fake-news-conspiracies-and-hate-speech/bi/
10. https://webalkans.eu/en/stories/navigating-the-ai-generated-minefield/
11. https://prishtinainsight.com/deep-fake-content-a-new-reality-awaiting-state-regulation-mag/
12. https://respublica.edu.mk/blog-en/media/without-proper-oversight-ai-technologies-can-become-a-threat/

AI-DRIVEN DECISION MAKING IN STRATEGIC MANAGEMENT: ENHANCING BUSINESS PERFORMANCE THROUGH INTELLIGENT ANALYTICS IN ALBANIA AND NORTH MACEDONIA

Doc.Dr. Lirinda Vako Abedini

l.vako@eust.edu.mk, International University of Struga

Prof.Dr. Armen Kadriu

a.kadriu@eust.edu.mk, International University of Struga

Abstract

This paper examines how artificial intelligence–driven decision-making capabilities influence strategic effectiveness and business performance in small and medium-sized enterprises operating in Albania and North Macedonia. Building on strategic management and decision-making theory, a process-oriented framework is developed linking AI-driven decision-making capabilities, decision-making quality, strategic effectiveness, and business performance. A quantitative research design is employed using survey data collected from SME managers and decision-makers. Regression-based mediation analysis with bootstrapping is applied to test both direct and indirect relationships among the constructs. The findings indicate that AI-driven decision-making capabilities positively affect decision-making quality, which in turn enhances strategic effectiveness and overall business performance.

Keywords: *Artificial Intelligence; AI-Driven Decision Making; Strategic Management; Decision Quality; Business Performance*

Introduction

The rapid advancement of artificial intelligence is reshaping the foundations of strategic management by fundamentally altering how organizations analyze information and make decisions. In increasingly complex and data-intensive business environments, traditional managerial decision-making approaches are often insufficient to cope with uncertainty,

speed, and competitive pressure. As a result, organizations are increasingly turning to AI-driven analytics to enhance strategic insight, improve decision quality, and support superior performance outcomes (Haefner et al., 2021; Verma et al., 2023).

Contemporary research emphasizes that AI should not be understood merely as a tool for operational automation, but as a strategic capability that augments managerial cognition and decision-making processes. AI-enabled systems allow organizations to process large volumes of data, generate predictive insights, and support strategic choices under conditions of bounded rationality, thereby enhancing managerial judgment rather than replacing it (Raisch & Krakowski, 2021). This shift has positioned AI-driven decision-making as a critical component of modern strategic management.

Despite the growing body of literature on AI adoption in business, existing studies predominantly focus on technological implementation and efficiency gains, offering limited insight into the strategic mechanisms through which AI influences organizational outcomes. In particular, empirical research examining how AI-driven decision-making capabilities translate into improved strategic effectiveness and business performance remains fragmented and underdeveloped (Mikalef et al., 2021; Pappas et al., 2023). This limitation is especially pronounced in emerging economy contexts, where organizational capabilities, institutional conditions, and digital maturity differ substantially from those of developed markets.

From a strategic management perspective, decision-making quality plays a central role in determining organizational success. High-quality decisions—characterized by accuracy, timeliness, and strategic alignment—are essential for effective strategy formulation and execution. Drawing on bounded rationality theory, AI-driven analytics can mitigate cognitive and informational limitations faced by managers, thereby enhancing decision quality and strategic responsiveness (Simon, 1977; Dubey et al., 2021). Moreover, within the dynamic capabilities framework, AI capabilities can be conceptualized as higher-order resources that enable organizations to sense opportunities, seize them through informed decisions, and reconfigure strategies in response to environmental change (Teece, 2018).

However, the extent to which AI capabilities improve business performance depends not on adoption alone, but on their integration into strategic decision-making processes. In this regard, decision-making quality represents a critical mediating mechanism linking AI-driven capabilities to strategic effectiveness and organizational performance. Empirical evidence on this mediating role remains limited, particularly within small and medium-sized enterprises (SMEs), where resource constraints, managerial centralization, and environmental uncertainty intensify the importance of informed and timely strategic decisions (Verma et al., 2023).

This gap is particularly relevant in the context of Albania and North Macedonia, where SMEs constitute the backbone of the economy and increasingly face pressure to compete in digitally enabled regional and international markets. While AI-based analytics are gaining visibility in these contexts, little is known about how such technologies are actually embedded in managerial decision processes and whether they contribute to strategic effectiveness and performance beyond symbolic or experimental adoption.

Addressing this gap, the present study investigates how AI-driven decision-making capabilities influence strategic management effectiveness and business performance in SMEs operating in Albania and North Macedonia, with a specific focus on the mediating role of decision-making quality. By developing and empirically testing a theoretically grounded conceptual model, this study advances the understanding of AI as a strategic decision-support capability rather than a purely technological investment. In doing so, it contributes to the emerging literature on AI-enabled strategic management and provides actionable insights for managers in emerging economies seeking to leverage intelligent analytics to achieve sustainable competitive advantage.

Literature Review

The rapid diffusion of artificial intelligence across organizational contexts has generated significant scholarly interest in its implications for managerial decision-making and firm performance. Early research on AI in business primarily emphasized automation, cost reduction, and operational efficiency, framing AI as a technological tool designed to replace or streamline routine tasks (Brynjolfsson & McAfee, 2017; Davenport &

Ronanki, 2018). While this stream of research provided valuable insights into productivity gains and process optimization, it offered limited explanation of how AI influences strategic decision-making and long-term organizational outcomes.

More recent studies have shifted attention toward the strategic potential of AI, arguing that its value extends beyond automation to the augmentation of managerial cognition and analytical capacity. From this perspective, AI-enabled systems enhance information processing, generate predictive insights, and support decision-making under conditions of uncertainty and bounded rationality (Raisch & Krakowski, 2021; Haefner et al., 2021). Rather than substituting human judgment, AI increasingly functions as a decision-support capability that complements managerial expertise. This conceptual shift has positioned AI-driven decision-making as a central element of contemporary strategic management.

Despite this theoretical advancement, empirical research remains fragmented in how AI is conceptualized and operationalized. A substantial portion of the literature continues to rely on binary measures of AI adoption, focusing on whether organizations have implemented AI technologies rather than examining how these technologies are embedded in managerial decision processes (Mikalef et al., 2021). Such technology-centric approaches risk overstating the strategic impact of AI by overlooking organizational capabilities, governance mechanisms, and decision routines that condition its effectiveness. As a result, the strategic mechanisms through which AI contributes to organizational performance remain insufficiently specified (Pappas et al., 2023).

Strategic management research consistently highlights decision-making quality as a critical determinant of organizational success. High-quality decisions—characterized by accuracy, timeliness, and alignment with strategic objectives—are essential for effective strategy formulation and execution (Eisenhardt & Zbaracki, 1992). Drawing on bounded rationality theory, managerial decision-making is inherently constrained by limited cognitive capacity, incomplete information, and environmental complexity (Simon, 1977). AI-driven analytics have the potential to alleviate these constraints by expanding information-processing capacity, reducing

uncertainty, and enabling more systematic evaluation of strategic alternatives (Dubey et al., 2021).

Within this framework, decision-making quality emerges as a critical, yet underexplored, mechanism linking AI-driven capabilities to organizational outcomes. While several studies acknowledge that AI may improve decision accuracy or speed, decision-making quality is often treated as an implicit outcome rather than an explicit analytical construct (Verma et al., 2023). Empirical research explicitly modeling decision quality as an intermediary between AI capabilities and strategic effectiveness or business performance remains limited, restricting understanding of whether AI improves performance directly or primarily through its influence on managerial decision processes.

The dynamic capabilities perspective offers additional theoretical grounding for examining AI-driven decision-making as a strategic capability. Dynamic capabilities enable organizations to sense opportunities, seize them through informed strategic choices, and reconfigure resources in response to environmental change (Teece, 2018). AI-driven decision-making capabilities can be conceptualized as higher-order resources that support these processes by enhancing environmental scanning, analytical reasoning, and strategic responsiveness (Mikalef & Gupta, 2021). However, the mere possession of AI technologies does not guarantee the development of such capabilities; their effectiveness depends on organizational integration, managerial interpretation, and strategic alignment.

Small and medium-sized enterprises provide a particularly relevant context for examining these relationships. In SMEs, decision-making authority is often centralized, resource constraints are pronounced, and strategic errors can have disproportionate performance consequences (OECD, 2020). While SMEs increasingly adopt AI-based analytics to support strategic decisions, empirical evidence on how these technologies affect decision quality and performance in such contexts remains scarce (Verma et al., 2023). Existing studies largely focus on large organizations in developed economies, limiting the generalizability of their findings to resource-constrained and institutionally diverse environments.

This gap is especially evident in emerging economies, such as Albania and North Macedonia, where SMEs form the backbone of economic activity and face growing pressure to compete in digitally enabled regional and international markets (World Bank, 2022). In these contexts, uneven digital maturity, limited analytical expertise, and institutional uncertainty may significantly shape how AI-driven decision-making capabilities are developed and utilized. Yet, empirical research examining the strategic implications of AI in such settings remains limited, leaving important contextual questions unanswered.

In summary, while the literature increasingly recognizes the strategic potential of AI, several gaps remain. First, there is a need to move beyond adoption-based perspectives toward a capability-based understanding of AI-driven decision-making. Second, the mediating role of decision-making quality in translating AI capabilities into strategic effectiveness and performance outcomes remains underexplored. Third, empirical evidence from SMEs and emerging economy contexts is limited. Addressing these gaps, the present study develops and empirically tests a process-oriented model linking AI-driven decision-making capabilities, decision-making quality, strategic effectiveness, and business performance in SMEs operating in Albania and North Macedonia.

Conceptual framework and hypotheses

Theoretical Foundations

Strategic decision-making is increasingly challenged by environmental uncertainty, information overload, and time pressure. Contemporary research argues that artificial intelligence (AI) should be conceptualized not merely as a technological tool, but as an organizational capability that augments managerial cognition and enhances strategic decision processes (Raisch & Krakowski, 2021; Mikalef et al., 2021). By enabling advanced analytics, pattern recognition, and predictive insights, AI-driven systems expand the information-processing capacity of organizations and support more informed strategic choices.

From a **bounded rationality** perspective, managerial decisions are inherently constrained by limited cognitive capacity and incomplete information. AI-driven analytics can alleviate these constraints by improving

data interpretation and reducing uncertainty, thereby enhancing decision quality (Dubey et al., 2021). In parallel, the **dynamic capabilities** framework suggests that organizations achieve superior performance by effectively sensing opportunities, seizing them through informed decisions, and reconfiguring resources in response to environmental change. Within this framework, AI capabilities represent higher-order resources that strengthen strategic responsiveness and adaptability (Teece, 2018; Pappas et al., 2023).

Building on these theoretical perspectives, this study proposes that the impact of AI on business performance is indirect and primarily realized through improvements in decision-making quality and strategic effectiveness.

Conceptual Framework

The proposed conceptual framework consists of four core constructs:

AI-Driven Decision-Making Capabilities, referring to an organization's ability to leverage AI and advanced analytics to support strategic decisions;

Decision-Making Quality, reflecting the accuracy, timeliness, and rationality of strategic decisions;

Strategic Effectiveness, indicating the extent to which decisions contribute to the achievement of strategic objectives;

Business Performance, capturing both financial and operational outcomes.

The framework posits that AI-driven capabilities enhance decision-making quality, which subsequently improves strategic effectiveness and, ultimately, business performance. Decision-making quality is conceptualized as a key mediating mechanism through which AI capabilities translate into strategic and performance outcomes.

Hypotheses Development

AI-Driven Decision-Making Capabilities and Decision-Making Quality

Recent empirical studies demonstrate that AI-driven analytics improve managerial decision-making by enhancing data accuracy, analytical depth, and predictive capability. Organizations that effectively deploy AI are better positioned to generate timely and reliable insights, thereby improving the quality of strategic decisions (Mikalef et al., 2021; Verma et al., 2023).

H1: *AI-driven decision-making capabilities have a positive effect on decision-making quality.*

Decision-Making Quality and Strategic Effectiveness

High-quality decision-making is a fundamental determinant of strategic success. Decisions that are accurate, timely, and aligned with organizational objectives facilitate effective strategy formulation and execution. Prior research indicates that improvements in decision quality positively influence strategic coherence and organizational adaptability (Dubey et al., 2021; Pappas et al., 2023).

H2: *Decision-making quality positively influences strategic effectiveness.*

Strategic Effectiveness and Business Performance

